

VENDIM

Nr. 870, datë 14.12.2016

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT, “PËR NDËRTIMIN,
PËRMIRËSIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E AUTOSTRADËS
MILOT–MORINË”, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTERIA E
TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS, DHE
KONSORCIUMIT “CATALYST VIVA DAS
GENERAL CONTRACTING, LLC
SALILLARI SHPK - BEE TECH – VIOLIAP
ATEVE – KASTRATI SHA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/

partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës së koncesionit “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe Konsorciumit “*Catalyst Viva Das General Contracting LLC - Salillari sh.p.k. - Bee Tech - Violiap Ateve – Kastrati sh.a.*”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Datë

6 Dhjetor 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

përfaqësuar nga

**MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS SI
AUTORITETI KONTRAKTOR**

dhe

BASHKIMI I SHOQËRIVE

**“CATALYST VIVA DAS GENERAL CONTRACTING & SALILLARI
SH.P.K &VIOLIAP& BEE TECH &KASTRATI SH.A”**

si Koncesionari

MARRËVESHJE KONCESIONI

**Ndërtimi, Përmirësimi, Shfrytëzimi dhe Mirëmbajtja e Autostradës
Milot–Morinë**





Pasqyra e Lëndës

1.	Interpretimi i Marrëveshjes	3
2.	Kushtet paraprake	5
3.	Periudha e Koncesionit	8
4.	Nënkontraktimet.....	7
5.	Ndryshimi i Kontrollit.....	9
6.	Garancitë dhe detyrimet e Koncesionarit	8
7.	Garancitë dhe informacioni i dhënë nga Autoriteti Kontraktor	12
8.	Dokumentacioni dhe bashkëpunimi	14
9.	Përfaqësuesit e Palëve	17
10.	Pronësia dhe përdorimi i pronës.....	18
11.	Pagimi i taksës së rrugës dhe përdorimi i Autostradës.....	21
12.	Territori i punimeve të Projektit dhe kushtet e tokës	27
13.	Antikitetet.....	28
14.	Kërkesat mjedisore dhe pëlqimet e nevojshme	29
15.	Dokumentacioni i Projektit	31
16.	Ndërtimi	33
17.	Organizimi i Territorit të Projektit	33
18.	Cilësia	40
19.	Inspektimi, mbikëqyrja dhe raportimi.....	40
20.	Përfundimi paraprak dhe përfundimi	43
21.	Shfrytëzimi.....	41
22.	Siguria	50
23.	Urgjencat.....	50
24.	Monitorimi i ecurisë së punës	51
25.	Pagesa	52
26.	Modeli financiar	68
27.	Ngjarje kompensimi	69
28.	Ngjarje të shlyerje te detyrimit.....	61
29.	Ngjarje të forcave madhore.....	63
30.	Ndryshime në ligj.....	78
31.	Ndryshime në standarde.....	70
32.	Ndryshime në punimet apo shërbimet.....	70
33.	Përgjegjësia dhe premtimi për zhdëmtim.....	93
34.	Sigurimi.....	80
35.	Depozita të përgjithshme	Error! Bookmark not defined.
36.	Kthimi	104
37.	Përfundimi i parakohshëm	91
38.	Pasojat e përfundimit të parakohshëm	94
39.	Kompensimi për zgjidhjen e kontratës.....	

40.	Llogaritja dhe pagesa e kompensimit.....	97
41.	Ndërhyrja e Autoritetit Kontraktor.....	115
42.	Konfidencialiteti.....	100
43.	Të dhënat e Koncesionarit.....	102
44.	Korrigjimi ekskluziv dhe rikuperimi i dyfishtë.....	103
45.	Asnjë lidhje apo autorizim	103
46.	Nuk ka të drejta ndaj burimeve publike	103
47.	Të drejtat e pronësisë intelektuale.....	103
48.	Transferimi.....	105
49.	Gjuha e Marrëveshjes.....	105
50.	Dublikata të origjinalit	105
51.	Marrëveshja e plotë	105
52.	Njoftimet	105
53.	Të pjesshme.....	106
54.	Mbrojtja e të dhënave.....	106
55.	Ligji rregullues.....	106
56.	Përshkallëzimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....	107
57.	Amendamentet e Marrëveshjes	107
58.	Kostot dhe shpenzimet e palëve	107
59.	Konflikti i Marrëveshjeve	107
60.	Tatimi	108
61.	Interesi në raste mospërbushje të detyrimeve	108

Shtojcat

- | | |
|------------|---|
| Shtojca 1 | Përkufizime |
| Shtojca 2 | I papërdorur |
| Shtojca 3 | Informacioni i kërkuar rreth Koncesionarit <i>[të jepet nga Ofertuesi i përzgjedhur]</i> |
| Shtojca 4 | Dokumentet e Projektit dhe Marrëveshjet e Financimit <i>[të përgatiten në fazën e përzgjedhjes së Ofertuesit]</i> |
| Shtojca 5 | Kërkesat e Autoritetit Kontraktor |
| Shtojca 6 | Kërkesat gjeoteknike |
| Shtojca 7 | Preventivi i shpenzimeve |
| Shtojca 8 | Propozimet e Koncesionarit <i>[të paraqiten nga Ofertuesit si pjesë e Ofertave të tyre]</i> |
| Shtojca 9 | Pikat hyrëse dalëse |
| Shtojca 10 | Modeli financiar <i>[të paraqitet nga Ofertuesi i Përzgjedhur]</i> |
| Shtojca 11 | Lejet dhe licensat ekzistuese |
| Shtojca 12 | Sigurimet që kërkohen |
| Shtojca 13 | Detyrat kryesore të Inxhinierit të pavarur |
| Shtojca 14 | Territori i Projektit |
| Shtojca 15 | Të ardhurat e garantuara nga trafiku dhe pragu i ndarjes së të ardhurave nga trafiku |
| Shtojca 16 | Plani i veprimeve emergjente <i>[të paraqitet nga Ofertuesi i përzgjedhur]</i> |
| Shtojca 17 | Lista e rënë dakord për përdoruesit e përjashtuar |

Marrëveshje Koncesioni

PALËT:

- (1) **Republika e Shqipërisë**, përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, përfaqësuar nga Z.Sokol Dervishaj (Ministri) ("Autoriteti Kontraktor") dhe
- (2) **"Catalyst Viva Das General Contracting" LLC** e regjistruar si person juridik me nr. license tregtare CN-1040870/119538, me datë regjistrimi 08.09.2001, me seli qendrore Emiratet e Bashkuara Arabe, përfaqësuar nëpërmjet prokurës së posaçme nr. 1156 Rep., 295 Kol., datë 26.05.2016 nga z. Pellumb Salillari, atësia i datëlindjes lindur në dhe banues në mbajtës i pasaportës me nr.

"Salillari" sh.p.k., regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT J62903125G, me seli në adresën Rruga Vorë-Marikaj, KM 1 , Vorë, Tiranë, me administrator z. Pëllumb Salillari, atësia i datëlindjes lindur në dhe banues në mbajtës i pasaportës me nr.

"Violiap Ateve" regjistruar si person juridik, me seli në adresën Rruga Kombëtare Athinë-Korinthos P.O 19600, Mandra Attica, Greqi, përfaqësuar nga z. Liapis Charalambros, mbajtës i pasaportës me nr.

"Bee Tech" regjistruar si person juridik, me seli në adresën Rruga "Nemeseos 6, P.O 14452, Metamorfofi Attica", Greqi, përfaqësuar nga Administratori z. Yama Ghulam Dastgir, mbajtës i pasaportës me n

"Kastrati" sh.a., regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT K21711502V, me seli në adresën "Lagjia 14". Ura e Dajlanit, Durrës, përfaqësuar nga administratori z. Gani Kastrati, atësia i datëlindjes lindur në Kukës dhe banues në mbajtës i letërnjoftimit me

të cilët sëbashku përbëjnë ("**Koncesionari**")

PËRSHKRIMI

- (A) Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 1 tetor 2014 dhe Dokumentacionit të Procedurës së Tenderit, datë 27 Prill 2016, Autoriteti Kontraktor ftoi ofertuesit për të paraqitur ofertat e tyre për përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë.
- (B) Pas përfundimit të procesit të tenderit, Komisioni i Vlerësimit të Tenderit konstatoi se "Catalyst & Salillari sh.p.k & Violiap& Bee Tech & Kastrati sh.a" është ofertuesi më i mirë dhe e zgjodhi atë si Koncesionar; si pasojë, Koncesionari është përzgjedhur për të realizuar Projektin sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.
- (C) Kjo Marrëveshje pasqyron, ndër të tjera, kushtet bazë të Koncesionit sikundër përcaktohen në kushtet e Kërkesës për Propozime.

Pjesa 1: Dispozita të Përgjithshme

1. Interpretimi i Marrëveshjes

1.1 Përkufizimi i termave

Përveç se kur konteksti e kërkon ndryshe, termat që fillojnë me shkronja të mëdha këtu kanë kuptimin e dhënë në Shtojcën 1.

1.2 Interpretimi i Marrëveshjes

Në këtë Marrëveshje, përveç se kur konteksti e kërkon ndryshe, do të përdoren interpretimet e mëposhtme:

1.2.1 Shprehjet e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe e kundërta;

1.2.2 Secila gjini i përfshin të dyja gjinitë;

1.2.3 Një referim i kësaj Marrëveshjeje përfshin gjithashtu amendamentet e mundshme në të, me kusht që të jenë bërë në përputhje me këtë Marrëveshje;

1.2.4 Referimet e ligjeve i përkasin legjislacionit përkatës, të ndryshuar;

1.2.5 Referimi të një dokumenti është referim të dokumenti në formën e tij aktuale, duke përfshirë çdo amendament në të, përveç rasteve kur këto amendamente në dokumentin në fjalë kushtëzohen me pëlqimin e secilës palë në këtë Marrëveshje dhe kur ky pëlqim nuk është dhënë;

1.2.6 Titujt në këtë Marrëveshje janë vënë vetëm për lehtësi përdorimi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e dispozitave të saj; dhe

1.2.7 Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje janë pjesë përbërëse e saj.

1.3 Indeksi

Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe, përmendja e vlerave apo shumave që “indeksohen” ose “që lidhen me indeksimin” nënkupton vlera apo shuma të rregulluara ose që do të rregullohen, për të pasqyruar efektin e inflacionit, të matura me ndryshimet e Euro Indeksit të Çmimeve nga vlera e përdorur në datën financiare bazë. Këto rregullime llogariten duke përdorur formulën e mëposhtme për vlerat apo shumatat që duhen përshtatur:

$$\text{Vlera apo shuma e rregulluar} = \text{vlera apo shuma} \times \frac{\text{Referuar I\textsubscript{C}K}_m}{\text{Referuar I\textsubscript{C}K}_{bd}}$$

Ku IÇK_m bazë është Euro Indeksi i Çmimeve i vlefshëm në datën e llogaritjes dhe CPI_{bd} bazë është Euro Indeksi i Çmimeve i vlefshëm në Datën Bazë Financiare.

1.4 Referimet

Referimet këtu në lidhje me:

1.4.1 Një "klauzolë" mund të jetë, në varësi të kontekstit, një referencë ndaj Klauzoleve të nivelit më të lartë të Klauzoleve, që përbëjnë pjesë të veçanta të kësaj Marrëveshjeje (p.sh., Klauzola 1), si edhe ndaj niveleve më të ulëta (p.sh. kjo Klauzolë 1.4)); dhe

1.4.2 Një "pikë" mund të nënkuptojë, në varësi të kontekstit, çdo nivel të tekstit të klauzolës në fjalë.

1.5 Mospërputhjet ndërmjet dokumenteve

Në rastin e një mospërputhjeje ndërmjet një dispozite të kësaj Marrëveshjeje dhe Shtojcave të saj dhe një Dokumenti tjetër të Projektit ose një Dokumenti të Tenderit, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe Propozimeve të Koncesionarit, përparësi do të kenë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Pavarësisht nga sa më lart, në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, kushtet e Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë kanë përparësi.

1.6 Objekti dhe lënda e Marrëveshjes

1.6.1 Objekti

Ndërtimi, përmirësimi, operimi (duke përfshirë vjeljen e taksave të rrugës) dhe mirëmbajtja e autostradës Milot-Morinë.

1.6.2 Lënda

Në varësi të kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, Koncesionari ka të drejtën dhe detyrimin ekskluziv (i) të hartojë dokumentacionin e projektit, të specifikuar me hollësi në Marrëveshje, (ii) të realizojë punimet e ndërtimit, (iii) të sigurojë financimin, (iv) të realizojë çdo shfrytëzim dhe mirëmbajtje të Autostradës (në shkallën e përcaktuar në këtë Marrëveshje), (v) të vjelë taksën e rrugës, dhe (vi) të bëjë pagesat e Autoritetit Kontraktor, siç kërkohet në përputhje me Klauzolën 25, ndërsa Autoriteti Kontraktor është i detyruar (i) t'i dorëzojë projektin e Territorit të punimeve dhe atë ekzistues Koncesionarit për qëllimet e ndërtimit të Autostradës; (ii) ta lejojë Koncesionarin të përdorë pjesë të caktuara të Autostradës për një periudhë kohe, dhe (iii) t'i bëjë pagesat Koncesionarit, siç kërkohet në përputhje me Klauzolën 25.

1.7 Administrimi i Autostradës

1.7.1 Koncesionari e administron Autostradën në përputhje me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha ligjet e tjera përkatëse, që hyjnë në fuqi herë pas here në Shqipëri.

1.8 Monedha e vetme evropiane

1.8.1 Nëse, në çdo kohë gjatë periudhës së Koncesionit, leku zëvendësohet nga euro, atëherë, shumat e lekëve të përmendura në këtë Marrëveshje do të konsiderohen të konvertuara në euro në atë kohë, me kursin e këmbimit të vendosur nga Banka Qendrore Evropiane që përdoret në kohën e hyrjes në Eurozonë.

- 1.8.2 Në rast se euro nuk përdoret më, Palët takohen në rastin më të parë për të rënë dakord për ndryshimet që kërkohen në këtë Marrëveshje sipas Klauzolës 32, me qëllim që të dy Palët të lihen në një gjendje as më të mirë dhe as më të keqe.

1.9 Koncesionari dhe Shoqëria e Koncesionit

Ndërsa Koncesionari hyn në këtë Marrëveshje me Autoritetin Kontraktor, Palët pranojnë që, në përputhje me Klauzolën 2A.1 (Transferimi i të drejtave të Koncesionit të Shoqëria koncesionare), Shoqëria koncesionare ta realizojë këtë Marrëveshje në vend të Koncesionarit, sipas transferimit të përcaktuar, dhe në shkallën që parashikohet, në Klauzolën 2A dhe në Manualin e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes së Autostradës ekzistuese, në përputhje me Klauzolën 21.2, e vlefshme që nga Data e Transferimit. Koncesionari është përgjegjës për të siguruar që kërkesat, sipas kësaj Marrëveshjeje, të përfshihen në dokumentet themelore të Shoqërisë koncesionare. Të gjithë anëtarët e Konsorciumit që përbëjnë Koncesionarin janë së bashku dhe veçmas përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e Koncesionarit, por Anëtarët e Konsorciumit nuk janë në asnjë rrethanë përgjegjës për detyrimet e Shoqërisë Koncesionare, me përjashtim të atyre që parashikohen në legjislacionin përkatës.

2. Kushtet paraprake

- 2.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

- 2.2 Të drejtat dhe detyrimet e palëve në bazë të saj (përveç të drejtave dhe detyrimeve sipas dispozitave të Klauzolës 1, Klauzolës 2, Klauzolës 6.1, Klauzolës 6.2, Klauzolës 7.1, Klauzolës 7.5, Klauzolës 9, Klauzolës 25, Klauzolës 26, Klauzolës 29, Klauzolës 30, Klauzolës 31, Klauzolës 33, Klauzolës 42, Klauzolës 48, Klauzolës 54, Klauzolës 55, Klauzolës 56, Klauzolës 57, Klauzolës 58) varen nga:

- 2.2.1 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë;
- 2.2.2 Ofrimi nga Koncesionari i garancisë së kontratës në përputhje me Klauzolat 2.4, 2.5 dhe 2.6;
- 2.2.3 Pagesa nga Koncesionari i kostove, në përputhje me Klauzolën 2.7 (a) së kësaj Marrëveshjeje;
- 2.2.4 Paraqitja nga Koncesionari të Autoriteti Kontraktor i një modeli financiar të audituar në lidhje me Projektin, i cili të jetë i pranueshëm nga Autoriteti Kontraktor i përditësuar me termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Financimit në Përmbylljen Financiare;
- 2.2.5 Lëshimi i çdo Pëlqimi të Nevojshëm që kërkohet me qëllim mundësimin e fillimit të ndërtimit në një mënyrë të sigurt aty ku e njëjta gjë do të pritej në mënyrë të arsyeshme që të merret brenda periudhave kohore të përcaktuara në Klauzolën 2.3 më poshtë;
- 2.2.6 Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari do të rinovojnë Lidhjen 9 dhe Autoriteti Kontraktor do të mbyllë të gjitha pikat e hyrjes të identifikuara në kategorinë e parë në këtë Lidhje të përditësuar.

- 2.2.7 Përmbyllja financiare nga ana e Koncesionarit;
- 2.2.8 Ngritja nga Koncesionari e njësisë së respektimit të nivelit të shërbimit në përputhje me Seksionin 2.2.2 të Shtojcës 5; dhe
- 2.2.9 Inxhinieri i Pavarur është emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Mospërmbushja e kushteve paraprake

- 2.3 Në varësi të Klausolës 16.2.6, në rastin që kushtet paraprake të listuara në Klausolën 2.2 më sipër nuk janë përmbushur brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e kësaj Marrëveshjeje, Palët takohen për të vendosur për një propozim për plotësimin e kushteve paraprake të mbetura. Në rast se kushtet paraprake të mbetura nuk janë përmbushur ende brenda nëntë (9) muajsh nga data e kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të zgjidhet dhe:

- 2.3.1 Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk i plotëson kushtet që lidhen me të, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit, si kompensim i rënë dakord paraprakisht, kostot e zhvillimit deri në 250,000 euro, pagesë e cila bëhet në lek me kursin e këmbimit që përdoret në kohën e pagesës, që është 1 prilli vitin pasues kalendarik; dhe

- 2.3.2 Në rastin e mospërmbushjeve nga Koncesionari të kushteve të saj, Koncesionari i paguan Autoritetit Kontraktor, si kompensim i rënë dakord paraprakisht, një shumë të barabartë me 250,000 euro, detyrim i Koncesionarit ky që garantohet nga Garancia e ofertës.

Ne rast të nderprerjes sikurse përkruhet në klausolën 2.3.1 më sipër, Autoriteti Kontraktor përveç sa më sipër nuk do të kërkojë mbajtjen e Sigurimit të Ofertes.

Garancia e kontratës

- 2.4 Koncesionari siguron dhe mban një garanci kontrate për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, rast në të cilin Autoriteti Kontraktor do të lëshojë Garancinë e Ofertës brenda 10 ditëve nga paraqitja e Garancisë së Kontratës;
- 2.5 Koncesionari e mban sigurimin e kontratës me anë të një garancie të performancës ose të një garancie të performancës në një formë të pranueshme nga Autoriteti Kontraktor, në shumat e mëposhtme:
 - 2.5.1 Që nga fillimi i vitit të parë të Kontratës deri në fund të vitit të katërt të Kontratës, në shumën prej katër milion e pesëqind mijë (4.500.000) euro;
 - 2.5.2 Që nga fillimi i vitit të pestë të Kontratës deri në vitin e gjashtë të Kontratës, në shumën prej dy milion e pesëqind mijë (2.500.000) euro; dhe
 - 2.5.3 Që nga fillimi i vitit të shtatë të Kontratës deri në fund të Periudhës së Koncesionit në shumën prej një milion e pesëqind mijë (1.500.000) euro.
- 2.6 Secila Garanci e Performancës dhënë në përputhje me Klausolën 2.4 minimumi:
 - 2.6.1 Është një instrument që jepet në bazë të kërkesës i cili mbulon të gjitha detyrimet e Koncesionarit që rrjedhin nga kjo Marrëveshje;
 - 2.6.2 Emërton Autoritetin Kontraktor si përfitues të drejtpërdrejtë;

- 2.6.3 Lëshohet nga një institucion financiar i njohur sipas klasifikimit të kredive, të paktën me klasifikimin BBB- (Standard and Poor's) ose i barasvlershëm.

Kostot e tenderit

- 2.7 Koncesionari i paguan drejtpërdrejt Korporatës Financiare Ndërkombëtare vlerat prej:
- (a) 250,000 dollarë amerikanë (dyqind e pesëdhjetë mijë dollarë amerikanë) brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje; dhe
 - (b) 1,400,000 dollarë amerikanë (një milion e katërqind mijë dollarë amerikanë) brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga Përmblyllja financiare,

që janë shpenzime të lidhura me koston e procedurës së tenderit. Të dy shumat paguhen në llogarinë bankare me nr. 2000192003476 në Bankën, WELLS FARGO BANK, N.A. (e njohur me parë si WACHOVIA), ose në një bankë në një vend që Korporata Financiare Ndërkombëtare mund ta përcaktojë herë pas here me shkrim.

2A. Shoqëria koncesionare

2A.1 Transferimi i të drejtave të koncesionit te Shoqëria Koncesionare

Koncesionari do të nënshkruajë brenda 90 ditësh nga miratimi i kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, instrumentet e transferimit në përputhje me ligjin, mënyrë masa që do të hyjnë në fuqi dhe ndërmerr të gjithë hapat e tjerë të nevojshme që kërkohen për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të lidhura, që i jepen Koncesionarit nga kjo Marrëveshje, te Shoqëria koncesionare, veprim si rrjedhojë e të cilit, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, Shoqëria koncesionare është palë në të dhe zëvendëson Koncesionarin.

2A.2 Dispozitat që mbeten në fuqi në lidhje me Koncesionarin

Pas hyrjes në fuqi të transferimit të përcaktuar në Klauzolën 2A.1:

- 2A.2.1 referencat ndaj Koncesionarit në këtë Marrëveshje, përveç atyre në Klauzolën 1.9, 2, 2A.2, 5.4 6.1.1, 6.1.4 dhe 6.1.5, konsiderohen si referime te Shoqëria koncesionare; dhe
- 2A.2.2 Koncesionari çlirohet nga të drejtat dhe nuk i përmbush detyrimet që burojnë nga kjo Marrëveshje, përveç ndonjë detyrimi të lindur, por jo të shlyer, ndonjë shkeljeje ekzistuese nga Koncesionari të kësaj Marrëveshjeje dhe të Procedurës së Prokurimit Publik, dhe të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në Klauzolën 1.9, 2A.2, 2 dhe 5.4; dhe
- 2A.2.3 Klauzolat 37 (Përfundimi i parakohshëm), 38 (Pasojat e përfundimit të parakohshëm), 39 (Kompensimi për përfundimin e kontratës), 40 (Llogaritja dhe pagesa e kompensimit), 47 (Të drejtat e pronësisë intelektuale), 52 (Njoftimet), 55 (Ligji rregullues), dhe 56 (Përshkallëzimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve), dhe dispozitat përkatëse zbatohen, sipas rastit, për Koncesionarin ose për Shoqërinë koncesionare, me kusht që Klauzola 37 (Përfundimi i parakohshëm), 38 (Pasojat e përfundimit të parakohshëm), 39 (Kompensimi për përfundimin), dhe 40 (Llogaritja dhe pagesa e

kompensimit), të jenë të vlefshme për Koncesionarin dhe jo për Shoqërinë koncesionare, vetëm kur ngjarja në fjalë ka ndodhur përpara Datës së Transferimit.

3. Periudha e Koncesionit

Periudha e koncesionit fillon në Datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon në datën e përfundimit të tij ("Periudha e Koncesionit"). Në varësi të përfundimit të parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me kushtet e saj, Periudha e Koncesionit do të jetë 30 (tridhjetë) vjet. Në llogaritjen e periudhës së koncesionit nuk do të numërohen periudhat në të cilat zbatimi i kësaj Marrëveshjeje është vonuar për shkak të Ngjarjeve të Forcës Madhore ose Autoriteti Kontraktor nuk e përbush detyrimin e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

4. Nënkontratat

- 4.1 Autoriteti Kontraktor pranon se, me pranimin e ofertës së Koncesionarit, ka miratuar edhe Nënkontraktorit e propozuar, të listuar këtu:

Catalyst Viva Das General Contracting – Albania Branch Ltd / SHPK

Vio-lap Ateve

Salillari SHPK

Salillari Construcion SHPK

Salillari Security SHPK

Kastrati SHA

Kastrati SHPK

ALB – Siguracion SHA

Auto Star Albania SHA

Bee Tech

- 4.2 Koncesionari nuk hyn në asnjë marrëveshje nënkontraktore pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor i përgjigjet kërkesës për një pëlqim të tillë brenda 20 (njëzet) ditësh pune, por mund të mos e japë, mund ta vonojë, ose ta tërheqë pëlqimin e tij për shkaqe të interesit publik ose për shkak se Nënkontraktori i propozuar nuk e ka pozitën ligjore që t'i japë mundësi të kryejë detyrimet e tij sipas Nënkontratës së propozuar. Në mungesë të ndonjë komenti apo kundërshtimi nga Autoriteti Kontraktor brenda një periudhe të tillë prej 20 (njëzet) ditësh pune, do të vlerësohet se Autoriteti Kontraktor e ka dhënë pëlqimin e tij për lidhjen e Nënkontratës në fjalë.
- 4.3 Në rast se Koncesionari e prish një nënkontratë dhe propozon të hyjë në një marrëveshje tjetër zëvendësuese nënkontraktore, Koncesionari ia paraqet projekt-kontratën ndërmjet Koncesionarit dhe Nënkontraktorët zëvendësues (dhe çdo amendament në të) Autoritetit Kontraktor për pëlqim paraprak. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të mos e japë pëlqimin për projekt-kontratën, në rast se dispozitat e kontratës nuk janë të ndryshme në pikëpamje materiale nga kushtet e Nënkontratës së nënshkruar në datën e kësaj Marrëveshjeje (ndryshuar në përputhje me këtë Marrëveshjeje), ose nëse zëvendësuesi i propozuar gëzon të drejtat e nevojshme financiare, teknike dhe ligjore, të cilat i japin mundësi të kryejë detyrimet që rrjedhin nga Nënkontrata e propozuar. Në mungesë të ndonjë komenti brenda një periudhe prej 20 (njëzet) ditësh pune, vlerësohet se Autoriteti Kontraktor e ka dhënë pëlqimin e tij për kushtet e kontratës zëvendësuese.

- 4.4 Koncesionari është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht faktit se Koncesionari ose, sipas rastit, Nënkontraktori i Ndërtimit ose Nënkontraktori i Shfrytëzimit mund të përdorin Nënkontraktor për kryerjen e detyrimeve të tyre që rrjedhin nga kjo Marrëveshje dhe nga Nënkontratat.

5. Ndryshimi i Kontrollit

5.1 Njoftimi i ndryshimeve

Në varësi të Klausolës 5.2, në rast se ka ndonjë ndryshim në pronësinë e Kapitalit të Investuar ose të ndonjë ndryshimi në Kontrollin e Koncesionarit, Koncesionari është i detyruar të informojë Autoritetin Kontraktor brenda [10 (dhjetë)] ditësh pune për bërjen e një ndryshim të tillë ose, në rastin e një shoqërie të kuotuar në një bursë të njohur, në një datë të mëvonshme të arsyeshme në të cilën Koncesionari duhet të ketë marrë dënimin për një ndryshim të tillë.

5.2 Kufizimet e transferimeve

Në varësi nga kushtet e Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë dhe aftësia e Huadhënësve për të ekzekutuar garancinë në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë dhe dokumentet përkatëse të sigurisë, të cilat kanë përparësi ndaj kësaj Klausole 5.2:

- 5.2.1 Çdo ndryshim në Kontrollin e Koncesionarit gjatë Periudhave të Ndërtimit varet nga pëlqimi paraprak me shkrim i Autoritetit Kontraktor, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, i cili mund të mos jepet sipas gjykimit (diskrecionit) të Autoritetit Kontraktor.
- 5.2.2 Autoriteti Kontraktor do të marrë një njoftim vetëm nga Koncesionari për çdo transferim të aksioneve dhe Kontrollit nga çdo Aksioner ndaj një Filiali, ndaj një Aksioneri tjetër ose ndaj një Filiali i një Aksioneri tjetër. Megjithatë për shmangien e çdo dyshimi do të zbatohen dispozitat e Klausolës 1.9; dhe
- 5.2.3 Çdo ndryshim tjetër në Kontrollin e Koncesionarit, i cili nuk është subjekt i Klausolës 5.2.1 ose Klausolës 5.2.2 do të varet nga pëlqimi paraprak me shkrim i Autoritetit Kontraktor, me kusht që Autoriteti Kontraktor të japë pëlqimin e tij për çdo ndryshim të tillë në Kontrollin e Koncesionarit, kur Koncesionari të demonstrojë se të drejtat financiare, të biznesit, teknik dhe ligjor të Koncesionarit nuk do të ndryshojnë për keq si rezultat i një ndryshimi të tillë,

me kusht që pëlqimi paraprak me shkrim i Autoritetit Kontraktor të mos kërkohet për ndonjë ndryshim në pronësinë e Kapitalit të Investuar, ose për ndonjë ndryshim në Kontrollin e Koncesionarit, që rrjedh nga:

- 5.2.4 Çdo transaksion *bona fide* (në mirëbesim) i hapur tregu me aksione ose letra të tjera me vlerë, të tregtuara publikisht, të bërë në një bursë të njohur investimesh ose letrash me vlerë, me kusht që të jetë njoftuar përkatësisht Autoriteti Kontraktor për kryerjen e një transaksioni të tillë; dhe

5.2.5 çdo transferim nga ndonjë Aksioner për një Filial tek një tjetër Aksioner ose tek një Filial i një Aksioneri tjetër.

5.3 Autoriteti Kontraktor i përgjigjet çdo kërkesë për pëlqim të bërë nga Koncesionari në përputhje me Klauzolën 5.2 brenda 20 (njëzet) ditësh pune.

5.4 **Raporti i borxhit ndaj kapitalit të shoqërisë koncesionare**

Koncesionari siguron në çdo kohë që raporti i totalit të pasiveve (duke hequr Kapitalin e Investuar) me kapitalin e investuar të Shoqërisë Koncesionare të mos jetë më i madh se 4:1, me kusht që ky raport nuk ndikohet nga ngjarjet e mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor.

6. **Garancitë dhe detyrimet e Koncesionarit**

6.1 **Garancitë e Koncesionarit**

Koncesionari garanton, përfaqëson dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktor se, duke filluar nga data e kësaj Marrëveshjeje:

6.1.1 Është themeluar përkatësisht dhe është një shoqëri ekzistuese në përputhje me rregullat ligjore të vendit të tij të themelimit dhe ka përfutur ose do të përftojë, kur të kërkohet, çdo pëlqim dhe të gjitha pëlqimet dhe lejet e nevojshme (duke përfshirë të brendshme) të cilat do ta lejonin atë të përmbushte detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha Dokumenteve të Projektit dhe Marrëveshjeve të Financimit;

6.1.2 Informacioni i paraqitur në Shtojcën 3 është i vërtetë dhe i plotë;

6.1.3 Shoqëria koncesionare nuk ka ushtruar asnjëherë ndonjë veprim tregtar, që nga themelimi i saj, përveçse në lidhje me këtë Marrëveshje;

6.1.4 Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që ta bënte Koncesionarin të mos përmbushte detyrimet e tij dhe nuk ekziston asnjë fakt ose ngjarje që mund të shpinte në mospërmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit; dhe

6.1.5 Me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, Shoqëria koncesionare, Koncesionari, çdo aksioner dhe çdo palë koncesionare nuk kanë kryer asnjë veprim të ndaluar.

Koncesionari më tej garanton, përfaqëson dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktor se, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi:

6.1.6 Çdo ndërmarrje që buron nga Dokumentet e Projektit përfaqëson një ndërmarrje të vlefshme dhe të zbatueshme të Koncesionarit dhe secili nga Dokumentet e Projektit është në formën që kërkohet nga rregullat ligjore të Republikës së Shqipërisë;

6.1.7 Dokumentet e Projektit janë përgatitur dhe zbatimimi i tyre dhe kryerja e punës nga Koncesionari nuk bie ndesh me:

(a) Asnjë ligj;

- (b) Aktin e themelimit ose dokumente të tjera të brendshme të Koncesionarit ose, sipas rastit, të Nënkontraktorve; ose
- (c) Çdo detyrim, të detyrueshëm për Koncesionarin, ose për aktivet apo të ardhurat e tij;

ndërsa Koncesionari nuk jep ndonjë garanci dhe deklaratë përputhshmërie me rregullat e prokurimit publik të Autoritetit Kontraktor.

- 6.1.8 Informacioni i dhënë në Shtojcën 3 është i vërtetë dhe i plotë;
- 6.1.9 Shoqëria Koncesionare nuk ka ushtruar asnjë aktivitet tjetër tregtar që nga koha e themelimit të saj përveçse në lidhje me këtë Marrëveshje;
- 6.1.10 Nuk ka ndodhur ndonjë ngjarje që të shkaktojë mospërbushjen e detyrimeve të Koncesionarit dhe nuk ekziston asnjë fakt ose ngjarje, që mund të shpjerë në mospërbushjen e detyrimeve të Koncesionarit;



- 6.1.11 Ndaj Koncesionarit nuk është bërë asnjë padi dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor, arbitrazhi ose procedurë administrative në pritje për t'u zgjidhur apo ndonjë mosmarrëveshje tjetër, e cila është duke u zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër dhe se Koncesionari nuk ka dijeni, me gjithë kujdesin e bërë, për ndonjë mosmarrëveshje në pritje për t'u zgjidhur apo gjithsesi të pritshme, që mund të ketë ndikim negativ në aftësinë e Koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, Dokumenteve të Projektit dhe Marrëveshjeve të Financimit;
- 6.1.12 Koncesionari nuk kushtëzohet nga ndonjë ndërmarrje, kryerja e të cilës do të ndikonte negativisht në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, Dokumenteve të Projektit dhe Marrëveshjeve të Financimit;
- 6.1.13 Kopjet e Dokumenteve të Projektit dhe Marrëveshjeve të Financimit, dorëzuar Autoritetit Kontraktor, janë kopje të vërteta dhe të plota të këtyre dokumenteve dhe se këtyre dokumenteve ose dokumenteve të tjera që zëvendësojnë Dokumentet e Projektit dhe Marrëveshjeve të Financimit nuk u janë bërë amendamente dhe se nuk kanë ndonjë efekt material në interpretimin ose përdorimin e ndonjë prej Dokumenteve të Projektit dhe Marrëveshjeve të Financimit;
- 6.1.14 Koncesionari (ose sipas rastit, çdo Nënkontraktor) nuk ka marrë përsipër ndonjë financim tjetër të detyrimeve të tij këtu, përveç detyrimeve sipas Marrëveshjeve të Financimit, çdo borxhi të varur dhe detyrimeve ndaj Aksionerëve; dhe
- 6.1.15 Me realizimin e kësaj Marrëveshjeje, Shoqëria Koncesionare, Koncesionari, çdo Aksioner dhe çdo Palë e Koncesionarit nuk kanë kryer ndonjë veprim të ndaluar.

6.2 Ndërmarrjet e Koncesionarit

Koncesionari merr përsipër që gjatë vlefshmërisë së Marrëveshjes:

- 6.2.1 Të informojë Autoritetin Kontraktor, pa vonesa të tepërta, sapo Koncesionari të marrë dijeni se mund të hapet, ose se është në pritje për t'u vendosur, një proces gjyqësor, arbitrazhi ose administrativ, apo për një konflikt të trajtuar në një mënyrë tjetër, kur

një mosmarrëveshje e tillë do të ndikonte negativisht, në shkallë materiale, në aftësinë e Koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjeve të Financimit;

6.2.2 Shoqëria Koncesionare pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor (qoftë përmes një transaksioni të vetëm ose një numër transaksionesh, të lidhura ose jo me Projektin) nuk do të transferojë, japë me qira, ose të heqë aktivitetin e tij tregtar ose një pjesë të tij, apo ndonjë nga aktivet e përfshira në kryerjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç se gjatë ecurisë së zakonshme të biznesit për qëllime zëvendësimi), me kusht që një kufizim i tillë të mos përdoret në rastet e lejuara shprehimisht në Marrëveshjet e Financimit;

6.2.3 Shoqëria Koncesionare nuk themelon asnjë shoqëri apo blen ose merr në pronësi apo angazhohet për të nënshkruar ndonjë aksion, apo interes në ndonjë shoqëri, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor (i cili nuk duhet të mos jepet ose të vonohet në mënyrë të paarsyeshme), përveçse kur një shoqëri e tillë është e përfshirë në ofrimin e Punimeve ose të Shërbimeve;

6.2.4 Shoqëria Koncesionare, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor (i cili nuk duhet të mos jepet ose të vonohet në mënyrë të paarsyeshme) nuk mund të japë hua, kredi, garanci, ose kompensim për përfitimin e ndonjë personi, ose të marrë përsipër (ose me ose pa pagesë) ndonjë borxh të ndonjë personi, përveç rasteve kur kjo parashikohet nga Dokumentet e Projektit ose Marrëveshjet e Financimit;

6.2.5 Ajo nuk i ndërpret apo kufizon aktivitetet e biznesit të saj ose i ndryshon bizneset e saj në një mënyrë që mund të rrezikonte përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, apo nis ndonjë biznes tjetër, i cili është materialisht i ndryshëm nga ai që duhet kryer prej saj sipas kësaj Marrëveshjeje;

6.2.6 Ajo nuk kryen ndonjë akt të ndaluar;

6.2.7 Ajo bën përpjekje të arsyeshme për të siguruar që Aksionerët, personat e kontrolluar prej saj, Palët e tjera të Koncesionarit dhe çdokush nga stafi i tyre të mos kryejnë ndonjë akt të ndaluar për sa kohë që kjo Marrëveshje të jetë në fuqi dhe nëse një gjë e tillë ndodh, ajo do të marrë masa rregulluese, pa vonesa të panevojshme (duke përfshirë, pa kufizim, ndërprerjen e përfshirjes së palës në fjalë në çdo punë që lidhet me këtë Marrëveshje); dhe

6.2.8 Shoqëria Koncesionare nuk do të kryejë asnjë veprimtari biznesi jashtë kësaj Marrëveshjeje.

7. Garancitë dhe informacioni i dhënë nga Autoriteti Kontraktor

7.1 Të dhënat e vëna në dispozicion

7.1.1 Autoriteti Kontraktor ose çdo Autoritet përkatës ose çdo Palë e interesuar ka vënë në dispozicion të Koncesionarit materiale, dokumente dhe të dhëna të caktuara të lidhura me Projektin dhe në Territorin e Projektit, të dhëna për trafikun dhe parashikime dhe çështje të tjera të cilat lidhen ose mund të lidhen me Projektin dhe territorin e



Projektit (duke përfshirë, pa kufizim, lejet ekzistuese, skicat ekzistuese dhe dokumentet e Punimeve të Palës të Tretë ("Të dhënat e vëna në dispozicion"))).

- 7.1.2 Autoriteti Kontraktor bën përpjekjet e tij të arsyeshme për të vënë në dispozicion të Koncesionarit çdo material tjetër, që mund të bjerë në dorë të tij gjatë kohëzgjatjes së Kontratës dhe që është i llojit që do të ishte bërë i njohur në rast se do ekzistonte në kohën e vënies në dispozicion të të dhënave të disponueshme. Materiale të tilla shtesë bëhen të dhëna të vënë në dispozicion në kohën që jepen (por jo më parë).

7.2 Garancitë

- 7.2.1 Koncesionari duhet te:

- (a) Bindet për të drejtat që do të përftojë dhe natyrën dhe shkallën e risqeve që do të ndërmerra sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

- 7.2.2 Mbledh informacionin e nevojshëm për plotësimin e detyrimeve të tij kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë:

- (a) Informacionin në lidhje me natyrën, vendndodhjen dhe gjendjen e territorit të Projektit; dhe
- (b) Informacionin që lidhet me antikitetet, zonat me interes arkeologjik, shkencor ose natyror, kushtet dhe mundësitë që ofron vendi dhe cilësinë e strukturave ekzistuese.



- 7.3 Koncesionari pranon dhe konfirmon se, pavarësisht se i janë vënë në dispozicion të dhënat e disponueshme nga Autoriteti Kontraktor, nuk i është dhënë garanci në lidhje me të dhënat e vëna në dispozicion dhe Koncesionari merr përgjegjësi të plotë për ecurinë e Projektit, përshtatshmërinë e skicave ekzistuese të projektimit dhe për çdo informacion tjetër që i është dhënë. Përveçse kur përcaktohet shprehimisht si ngjarje kompensimi në Marrëveshje, Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës përpara Koncesionarit si rrjedhojë e ndonjë pasaktësie, mungese, papërshtatshmërie për ndonjë qëllim, apo ndonjë mungese të çfarëdo lloji në të dhënat që Autoriteti Kontraktor ka vëna në dispozicion të Koncesionarit.

- 7.4 Dijenja apo pëlqimi nga ana e Autoritetit Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur afati për pëlqimin nuk është respektuar, për ndonjë çështje, nuk e përjashton Autoritetin Kontraktor nga bërja e ndonjë kërkesë për zhëmtim apo ndërmarrja e ndonjë veprimi ndaj Koncesionarit, që ndryshe do të ishte i mundshëm për t'u ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktor sipas kësaj Marrëveshjeje, me kusht që Autoriteti Kontraktor te kete vepruar në mirëbesim. Pavarësisht nga natyra e përgjithshme e kësaj Klauzole 7.4, nëse Autoriteti Kontraktor ka rënë dakord për nënshkrimin apo ndryshimin e ndonjë Dokumenti të Projektit ose Marrëveshjeje të Financimit, ose për ndjekjen e një rrugë të caktuar veprimi, apo kur ka hequr dorë me shkrim shprehimisht nga një dispozitë, Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë dhe nuk mund të bëjë ndonjë kërkesë ndaj Koncesionarit vetëm në bazë të faktit që Koncesionari ka ndërmarrë hapa apo veprime në lidhje me ndonjë dispozitë nga e cila është hequr dorë shprehimisht me shkrim.

- 7.5 **Punime të bëra nga Palë të Treta**

- 7.5.1 Autoriteti Kontraktor bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që Pala e Tretë Sipërmarrëse të mos veprojë në atë mënyrë që të ndikojë negativisht në aftësinë e Koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.
- 7.5.2 Autoriteti Kontraktor zbaton të drejtat e tij sipas Dokumenteve të Punimeve të Tretëve dhe sipas ligjit, në lidhje me Punimet e të Tretëve, të bëra me kërkesën dhe me shpenzimet e Koncesionarit dhe i paguan Koncesionarit çdo shumë të përftuar nga një Sipërmarrës i Tretë, në masën që shuma të tilla lidhen me humbjet e pësuar nga Koncesionari dhe që u atribuohen shkeljeve nga ana e Sipërmarrësit të Tretë të Dokumenteve për Punimet e të Tretëve.
- 7.5.3 Gjatë kohëzgjatjes së Punimeve të të Tretëve, pjesët e prekura të Autostradës, siç përshkruhen në Dokumentet e Punimeve të të Tretëve, konsiderohen se nuk bëjnë pjesë në Territorin e Projektit dhe Koncesionari nuk ka detyrime në lidhje me këto pjesë të Autostradës. Pas përfundimit të Punimeve të të Tretëve, pjesët e prekura të Autostradës bëhen pjesë e Territorit të Projektit.
- 7.5.4 Në masën që është e mundur sipas Dokumenteve të Punimeve të Palëve të Treta, Koncesionari ka të drejtë të jetë i pranishëm në procedurat e kthimit dhe certifikimit të Punimeve të Palëve të Treta dhe gjithashtu të drejtë të bëjë përfaqësime të arsyeshme përpara Autoritetit Kontraktor në lidhje me ato gjëra që mund të kërkojë Autoriteti Kontraktor.
- 7.5.5 Autoriteti Kontraktor do të sigurojë që Punimet e Palës së Tretë përfundojnë në përputhje me Dokumentet e Punimeve të Palës së Tretë deri në [1 Janar 2019] dhe Koncesionari do të marrë pjesë në dorëzimin ndërmjet Palës së Tretë dhe të Autoritetit Kontraktor dhe ka të drejtë të paraqesë vërejtjet e veta të cilat do të merren në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor.

7.6 Ndërmarrja e Autoritetit Kontraktor

- 7.6.1 Deri në Datën e hyrjes në fuqi, Autoriteti Kontraktor vazhdon ta shfrytëzojë dhe mirëmbajë Autostradën në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën shkallë siç ka bërë më përpara.
- 7.6.2 Autoriteti Kontraktor bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme dhe bashkëpunon me mirëbesim për të përmbushur kërkesën e Huadhënësit në lidhje me arritjen e Përmbylljes Financiare.
- 7.6.3 Pavarësisht nga çdo klauzolë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti Kontraktor në të gjitha rastet që parashikohen në Klauzolën 14, 16.5, 16.6 dhe 17.3, bashkëpunon me mirëbesim dhe i ofron asistencë të arsyeshme Koncesionarit.

8. Dokumentacioni dhe bashkëpunimi

8.1 Dokumentacioni i Projektit

Koncesionari kryen të gjitha detyrimet e tij sipas Dokumenteve të Projektit, por pa pëlqimin e shprehur me shkrim të Autoritetit Kontraktor:

8.1.1 Nuk kryen asnjë veprim (ose mosveprim) me anë të të cilit ndonjëri prej dokumenteve të Projektit do të bëhej i pavlefshëm (duke e tërhequr, duke dhënë njoftim për përfundimin e tij, ose ndryshe), ose të ndryshohej;

ose

8.1.2 Nuk heq dorë, ose nuk mund të mos ushtrojë të drejtat e tij sipas Dokumenteve të Projektit;

Kur dhe për sa kohë që:

(a) Një veprim do të bëhej shkak ose do të kishte gjasa të bëhej shkak që Koncesionari të mos ishte në gjendje të plotësonte detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, ose që do të shtonte detyrimet e Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

(b) Në rastin e një Nënkontrate, asnjë zëvendësim apo propozim ose rrugë alternative veprimi për plotësimin e detyrimeve përkatëse, nuk është miratuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me Klauzolën 4.

8.2 Dërgimi i amendamenteve te Autoriteti Kontraktor

Koncesionari i dërgon Autoritetit Kontraktor, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga bërja e tyre, kopje të vërtetuara të të gjitha marrëveshjeve, amendamenteve ose dokumenteve të tjera të cilat ndryshojnë ose anulojnë një dokument të Projektit, ose një Marrëveshje Financimi të lidhur nga Koncesionari, ose të çdo dokumenti të ri të Projektit, ose të një Marrëveshjeje financimi të lidhur nga Koncesionari.

8.3 Bashkëpunimi i Autoriteti Kontraktor

8.3.1 Autoriteti Kontraktor i ofron Koncesionarit bashkëpunimin e arsyeshëm që mund të kërkohet për realizimin e kësaj Marrëveshjeje nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të ofrojë ndonjë bashkëpunim për ndeqjen e ndonjë shkeljeje të Marrëveshjes të shkaktuar nga Koncesionari ose një palë e Koncesionarit.

8.3.2 Autoriteti Kontraktor merr përsipër që, gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, të bëjë përpjekje të arsyeshme për të ndihmuar Koncesionarin në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me të.

8.3.3 Nëse ndonjë veprim, që kërkohet të kryhet nga Koncesionari në bazë të kësaj Marrëveshjeje, mund të kryhet vetëm nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Kontraktor bie dakord që t'i ndërmarrë hapa të tilla brenda kontrollit të tij të arsyeshëm, ose duke e kryer vetë një veprim të tillë në emër të Koncesionarit, ose me anë të një prokure ose ndonjë të drejte tjetër të dhënë Koncesionarit, për të bërë të mundur që Koncesionari të kryejë një veprim të tillë, me kusht që Autoriteti Kontraktor të ketë të drejtë ligjore për të ndërmarrë një veprim të tillë, ose për të dhënë një prokurë të tillë, dhe që një veprim i tillë të ndërmerret me shpenzimet dhe riskun e Koncesionarit.

8.4 Amendamente në Marrëveshjet e Financimit

8.4.1 Koncesionari nuk i ndryshon Marrëveshjet e Financimit, në ndonjë masë të madhe, për t'iu larguar detyrimeve të tij (apo heq dorë në një masë të madhe, lejon të kalojë ose të mos zbatojë ndonjë të drejtë që mund të ketë) sipas një Marrëveshje Financimi ose të pranojë ndonjë financim tjetër nga ai i parashikuar në Marrëveshjet e Financimit ose nga Aksionerët, pa pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktor, me kusht që Autoriteti Kontraktor të mos refuzojë, ose vonojë dhënien e pëlqimit të tij, përveç kur ka arsye të besohet se një amendament, largim, heqje dorë, kalim, mosveprim, ose financim i tillë mund të pritet të rrisë përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktor ose të ketë një efekt të keq material në:

- (a) Aftësinë e Koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Dokumenteve të Projektit; ose
- (b) Aftësinë e Koncesionarit për të bërë një Rifinancim.

Autoriteti Kontraktor i përgjigjet çdo kërkesë për dhënie pëlqimi, të bërë nga Koncesionari në përputhje me këtë Klauzolë 8.4, brenda 20 (njëzet) ditësh pune. Pranimi i një financimi tjetër nga ai sipas Marrëveshjeve të Financimit, ose nga Aksionerët, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor, dhe çdo ndryshim në një Marrëveshje Financimi, për të cilën nuk ka dhënë pëlqimin Autoriteti Kontraktor që më parë, është shkelje kontrate nga Koncesionari dhe, sipas Klauzolës 8.5, nuk ka asnjë efekt ndaj Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë.

8.4.2 Pavarësisht nga Klauzola 8.4.1, Autoritetit Kontraktor nuk i kërkohet të japë pëlqimin e tij për heqje dorë nga një kusht apo pengesë për tërheqjen e fondeve sipas Marrëveshjeve të Financimit. Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor për çdo heqje dorë nga ndonjë kusht apo pengesë për tërheqjen e parave brenda 5 (pesë) ditësh pune nga tërheqja përkatëse.

8.5 Rifinancimi

- 8.5.1 Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktor, në çdo kohë, pa vonesë dhe pa pagesë, hollësi për rifinancimin, dhe justifikim për supozimet mbi të cilat është bazuar ai dhe çdo material tjetër të rëndësishëm rrethanor që palët e Koncesionarit posedojnë.
- 8.5.2 Koncesionari merr pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor për çdo Rifinancim Kualifikues dhe si Autoriteti Kontraktor ashtu edhe Koncesionari do të veprojnë me mirëbesim në lidhje me çdo Rifinancim.
- 8.5.3 Në rast se ndonjë ndryshim i një Marrëveshje Financimi, jo për arsye që lidhen me Koncesionarin, është një Rifinancim Kualifikues, Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktor për termat dhe kushtet e Rifinancimit siç parashikohet në pikën 8.5.1 më sipër.
- 8.5.4 Koncesionari do të raportojë për çdo Fitim apo Humbje Rifinancimi në rastin e një Rifinancimi në Raportet e tij për Autoritetin Kontraktor të përcaktuara në Marrëveshje dhe do të sigurojë një model financiar të rishikuar nëse ka ndryshime thelbësore që kanë ndodhur si pasojë e rifinancimit.

9. Përfaqësuesit e Palëve

9.1 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor

- 9.1.1 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është një person i autorizuar për të përfaqësuar Autoritetin Kontraktor në lidhje me realizimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 9.1.2 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është kreu i njësisë së zbatimit të Projektit, që krijohet nga Autoriteti Kontraktor për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, ose një person tjetër që caktohet nga Autoriteti Kontraktor në bazë të kësaj Klauzole 9.1.
- 9.1.3 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor ka të drejtë t'i japë një personi tjetër një prokurë për të përfaqësuar Autoritetin Kontraktor brenda një fushëveprimi të caktuar dhe të njoftojë Koncesionarin për dhënien e prokurës pa asnjë vonesë të panevojshme. Aty ku ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje i referohet Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, referimi vlen gjithashtu edhe për personin e autorizuar në këtë mënyrë.
- 9.1.4 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zëvendësojë Përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor në çdo kohë dhe një zëvendësim i tillë hyn në fuqi me marrjen e njoftimit për një zëvendësim të tillë nga Koncesionari.
- 9.1.5 Veprimet ose udhëzimet e Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, për aq sa parashikohen këtu, konsiderohen veprime ose udhëzime të Autoritetit Kontraktor, përveçse kur Autoriteti Kontraktor e njofton Koncesionarin paraprakisht që një veprim ose udhëzim i caktuar nuk është veprim ose udhëzim i Autoritetit Kontraktor.
- 9.1.6 Çdo kërkesë për t'i dhënë informacion ose dokumente Autoritetit Kontraktor, sipas Marrëveshjes, është një kërkesë që dokumente të tilla t'i bëhen të njohura Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, përveçse kur Autoriteti Kontraktor e vë në dijeni Koncesionarin për një person tjetër të cilit i duhen dërguar dokumente të tilla.

9.2 Përfaqësuesi i Koncesionarit

- 9.2.1 Përfaqësuesi i Koncesionarit është një person i autorizuar për të përfaqësuar Koncesionarin në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 9.2.2 Përfaqësuesi i Koncesionarit është Z. Pellumb Salillari ose një person tjetër që caktohet nga Koncesionari në përputhje me këtë Klauzolë 9.2.
- 9.2.3 Koncesionari mund ta zëvendësojë Përfaqësuesin e Koncesionarit, duke i dërguar një njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktor të paktën 10 (dhjetë) ditë pune më parë.
- 9.2.4 Veprimet ose udhëzimet e Përfaqësuesit të Koncesionarit, për aq sa ato parashikohen këtu, konsiderohen veprime ose udhëzime të Koncesionarit, përveç se kur Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor paraprakisht që një veprim ose udhëzim i caktuar nuk është veprimi ose udhëzimi i Koncesionarit.

9.3 Personeli kryesor

Koncesionari dhe Nënkontraktorët, sipas rastit, caktojnë personelin kryesor. Sapo një anëtar i personelit kryesor ndërpret veprimtarinë, në rast vdekjeje apo sëmundje serioze, ose

dorëheqjeje, por, në të gjitha rastet e tjera, përpara përfundimit të emërimit, Koncesionari dhe Nënkontraktorët, sipas rastit, marrin pëlqimin e Autoritetit Kontraktor për anëtarin zëvendësues të personelit kryesor. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë vetëm të mos e japë pëlqimin e tij për emërimin e një anëtarit të personelit kryesor, për shkak se personi nuk ka kualifikimet ose përvojën e nevojshme për të kryer rolin e propozuar. Në mungesë të ndonjë komenti apo kundërshtimi nga Autoriteti Kontraktor, në lidhje me personelin kryesor të propozuar, brenda një periudhe prej 10 (dhjetë) ditësh pune, do të vlerësohet se Autoriteti Kontraktor ka qenë dakord me emërimin e personelit kryesor zëvendësues.

Pjesa 2: Prona

10. Pronësia dhe përdorimi i pronës

10.1 Territori i Projektit

10.1.1 Autoriteti Kontraktor vë në dispozicion të Koncesionarit territorin e Projektit të pastruar nga çdo barrë në, apo maksimumi përpara:



- (a) Datës së Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes; ose
- (b) Në lidhje me pjesën e Territorit të Projektit që kërkohet për të kryer punimet në Urën e lumit Drin, punimet për mbikalimet dhe kryqëzimet dhe punimet për Sheshin e pagimit të taksës, sikundër përcaktohen në Programin e përditësuar dhe të pranuar nga Inxhinieri i pavarur, jo më vonë se maksimumi:
 - (i) Data e fillimit të Punimeve Kapitale; dhe
 - (ii) 6 muaj pas miratimit të Programit të Punimeve Kapitale.

Pavarësisht nga sa më sipër, Autoriteti Kontraktor e lejon Koncesionarin të futet në të gjitha pjesët e Territorit të Projektit, me qëllim për të kontrolluar kushtet e tij dhe për të informuar përgatitësit e Programit, duke filluar nga data e Hyrjes në Fuqi.

Autoriteti Kontraktor garanton se Territori i Projektit vihet në dispozicion i pastruar nga çdo barrë, pa persona të paautorizuar apo të drejta të palëve të treta, përveç atyre barrëve apo të drejtave që u janë dhënë të tretëve, sikundër bëhet e njohur në kategoritë 2 dhe 3 të Shtojcës 9, të të dhënat e vëna në dispozicion, ose siç e kërkon ligji. Çdo shkelje nga Autoriteti Kontraktor i kësaj Klauzolës 10.1.1, ose ekzistenca e çdo barre ose e të drejtave të të tretëve, që nuk janë bërë të njohura te të dhënat e vëna në dispozicion, përbëjnë një ngjarje kompensimi.

10.1.2 Autoriteti Kontraktor i mbyll të gjitha pikat hyrëse dhe dalëse në Autostradë, të përcaktuara si të kategorisë së parë në Shtojcën 9 deri në Datën e Hyrjes në fuqi.

10.1.2A Koncesionari, në lidhje me pikat hyrëse e dalëse në Autostradë, të përcaktuara si të kategorisë së dytë në Shtojcën 9, ndërton pa shpenzime të Autoritetit Kontraktor, rrugë të reja hyrëse e dalëse, si pjesë të punimeve për Mbikalimin dhe Kryqëzimin dhe i mbyll pikat e pakontrolluara hyrëse dhe dalëse, si pjesë të punimeve për mbikalimin dhe kryqëzimin, me kusht që Autoriteti Kontraktor të

ofrojë një asistencë të tillë që të konfirmojë në mënyrë të arsyeshme sigurinë e Koncesionarit në bërjen e një pune të tillë.

- 10.1.2B Në lidhje me pikat hyrëse dhe dalëse në Autostradë, të përcaktuara si të kategorisë së tretë në Shtojcën 9, Autoriteti Kontraktor, brenda 2 (dy) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi dhe pa kosto për Koncesionarin, ose:
- (i) Ndërton rrugë të reja lokale hyrëse e dalëse; ose
 - (ii) Realizon zhvendosjen e nevojshme të popullsisë dhe/ose shpronësimin e tokës në përputhje me një plan për zhvendosjen e popullsisë, i cili përgatitet në përputhje me Standardin e Performancës 5 të IFC-së sa më shpejt që të jetë praktikisht e arsyeshme,

kohë gjatë të cilës pikat hyrëse e dalëse do të qëndrojnë të hapura.

- 10.1.3 Pavarësisht nga detyrimi i Autoritetit Kontraktor sipas Klauzolave 10.1.2 dhe 10.1.2.B më sipër, Koncesionari ka përgjegjësi të vazhdueshme për parandalimin e rihapjes së pikave hyrëse e dalëse në Autostrada, të cilat Autoriteti Kontraktor i mbyll sipas Klauzolës 10.1.2, duke parandaluar hapjen e pikave shtesë të pakontrolluara në Autostradë, pas Datës së hyrjes në fuqi, dhe për mbylljen e çdo pike të pakontrolluar hyrëse dhe dalëse në Autostradë që nuk është përcaktuar as si në kategorinë e parë dhe as si kategorinë e tretë e Shtojcës 9.
- 10.1.4 Autoriteti Kontraktor i jep mundësi Koncesionarit të hyjë e të dalë në Territorin e Projektit dhe e lejon ta përdorë atë territor, pa e trazuar, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës.
- 10.1.5 Pronësia apo të drejtat e tjera ndaj të gjitha pjesëve të Territorit të Projektit i mbeten apo i besohen Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor pranon që, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës, të mos transferojë apo heqë Territorin e Projektit apo ndonjë pjesë të tij, apo ndonjë interes në të, përveç se në përputhje me këtë Marrëveshje.
- 10.1.6 Kostot dhe shpenzimet e marrjes nën kontroll, përfshirë shpronësimin e tokës dhe zhvendosjen e popullsisë, të të gjitha pjesëve të Territorit të Projektit dhe dhënia e të drejtave Koncesionarit, në përputhje me këtë Klauzolë 10, përballohen nga Autoriteti Kontraktor. Përveç se kur kjo Marrëveshje e parashikon ndryshe, pas kthimit të Territorit të Projektit, në përputhje me këtë Klauzolë 10, të gjitha kostot dhe shpenzimet, të lindura në lidhje me Territorin e Projektit, përballohen nga Koncesionari. Autoriteti Kontraktor është dakort se çdo pengesë apo vonesë në kryerjen e kësaj Marrëveshjeje nga ana e Koncesionarit për arsye të shpronësimit nga autoritetet ose palët e treta do të jetë një Ngjarje Lehtësimi.
- 10.1.7 Në varësi të kushteve të kësaj Marrëveshjeje, në Datën e Përfundimit, Koncesionari i kthen Autoritetit Kontraktor Territorin e Projektit, në përputhje me Klauzolën 36 dhe Klauzolën 38.2.

- 10.1.8 Territori i Projektit nuk përdoret nga Koncesionari për ndonjë qëllim tjetër nga ai i realizimit të Projektit, duke respektuar kërkesat e zbatueshme ligjore dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.
- 10.1.9 Të gjitha shpenzimet që dalin për pronësinë e regjistrimit, regjistrimin e tokës se autostrades dhe / ose tokë shtesë në Zyrat Vendore ose të Regjistrimit të Pasurive (ZVRPP) dhe / ose kosto të tjera që rrjedhin nga aktet ligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në lidhje me regjistrimin e pronësisë së kesaj toke, duhet të përmbushen nga Autoriteti Kontraktues.

10.2 Trualli shtesë dhe trualli ekstra

- 10.2.1 Në varësi të Klausolës 21.14 dhe pavarësisht prej saj, nëse Koncesionari kërkon ndonjë truall shtesë për Territorin e Projektit, me qëllim përmbushjen e ndonjërit prej detyrimeve të tij, sipas kësaj Marrëveshjeje, i cili më pas bëhet pjesë e Autostradës, për aq sa Inxhinieri i pavarur vërteton se një Truall i tillë shtesë kërkohej nga Koncesionari për plotësimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, (dhe se detyrimet përkatëse nuk mund të respektohen përmes përdorimit vetëm të Territorit të Projektit ,ose të tokës që aktualisht zotërohet nga Shteti), Autoriteti Kontraktor e ofron një tokë të tillë shtesë sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur. Të gjitha kostot e kërkuara gjatë procesit të përfundimit të tokës shtesë në fillim do të paguheshin nga Koncesionari dhe, në masën që Inxhinieri i Pavarur e ka konfirmuar se një tokë e tillë nuk është e disponueshme si pjesë e Territorit të Projektit, ose përmes përdorimit të tokës në zotërim të shtetit, mund të kërkohej si ngjarje kompensimi. Për shmangien e çdo dyshimi, në rast se Inxhinieri i Pavarur mendon se toka e kërkuar mund të sigurohet ose si pjesë e Territorit të projektit, ose përmes përdorimit të tokës shtetërore, e cila aktualisht nuk është pjesë e Projektit dhe nuk është në zotërim të shtetit, të gjitha kostot e sigurimit të një toke të tillë do të përballohen nga Koncesionari dhe nuk mund të kërkohej si ngjarje kompensimi. Për shmangien e dyshimit, në rast se Inxhinieri i Pavarur konsideron, mbi baza të arsyeshme dhe argumente, se toka e kërkuar është në dispozicion ose si pjesë e Territorit të Projektit ose nëpërmjet përdorimit të tokës shtetërore, në masën që Koncesionari megjithatë zgjedh të përdorë tokën e cila nuk është aktualisht pjesë e Territorit të Projektit dhe nuk është në pronësi të shtetit të gjitha kostot e marrjes së kësaj toke, do të mbulohen nga Koncesionari.
- 10.2.2 Sapo Truall shtesë merret, për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, konsiderohet si rrjedhojë pjesë e Territorit të Projektit për të gjitha qëllimet e kesaj Marrëveshjeje.
- 10.2.3 Kur Koncesionari kërkon të përdorë përkohësisht truall ekstra, përveç Territorit të Projektit dhe Truallit shtesë, me qëllim që të respektojë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, ai përfiton të drejta, ose e siguron miratimin për ta përdorur Truallin ekstra vetëm me shpenzimet dhe riskun e tij dhe me pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor, me kusht që Autoriteti Kontraktor të mos ia refuzojë dhënien e pëlqimit për marrjen e Truallit ekstra, nëse dhe për aq sa Inxhinieri i pavarur vërteton se një Truall i tillë ekstra kërkohej nga Koncesionari përkohësisht për kryerjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha shpenzimet që rrjedhin gjatë procesit që lidhet me fitimin e të drejtave dhe të drejtës për Truall Shtesë do të ienë në gjendje të rifitohen si një Ngjarje

- 10.2.4 Sapo janë marrë të drejtat ose miratimi për të përdorur Truallin ekstra nga Koncesionari, Koncesionari bie dakord që të drejtat ose një përfitim i tillë për të përdorur Truallin ekstra, i cili i mbetet Koncesionarit deri në datën e përfundimit, do t'i transferohen Autoritetit Kontraktor në Datën e Përfundimit.
- 10.2.5 Në varësi nga Klauzola 10.2.3, Autoriteti Kontraktor i jep të gjithë asistencën e nevojshme Koncesionarit për shpronësimin dhe/ose marrjen e Truallit ekstra, megjithatë, Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të bëjë ndonjë shpenzim shtesë.

10.3 **Rruga e Degezimit**

Autoriteti Kontraktor do të sigurojë që Autoriteti Përkatës ofron, operon dhe mirëmban si duhet Rrugët e Degëzimit për në Autostradë në një standard të mjaftueshëm në përputhje me Ligjin, në mënyrë që të sigurojë lëvizjen e lirë dhe qasje të vazhdueshme të trafikut në këto Rrugë Degëzimi në Autostradë.

11. **Pagimi i taksës së rrugës dhe përdorimi i Autostradës**

11.1 **Kërkesat në lidhje me taksën e rrugës**

11.1.1 Koncesionari mbledh dhe mban të ardhurat nga taksa e rrugës.

11.1.2 Koncesionari kryen punimet për ndërtimin e shesheve për pagimin e taksës së rrugës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Seksionin 6.2.2 të Shtojcës 5.

11.1.3 Koncesionari e përdor sistemin e taksës së rrugës menjëherë pas Datës së fillimit të pagimit të taksës së rrugës.

11.2 **Strategjia e taksës së rrugës**

11.2.1 Koncesionari përdor një shesh me dy kahe për pagimin e taksës në afërsi të Tunelit të Thirrës.

11.3 **Vjelja e të ardhurave nga taksa e rrugës**

Koncesionari vjel (i) në monedhën e ligjshme të Shqipërisë, herë pas here, ose (ii) në euro, të ardhurat nga taksa e rrugës në përputhje me këtë Klauzolë 11, Manualin e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes dhe me Seksionin 3.2.5 të Shtojcës 5, ose ndryshe, siç e parashikon ligji, menjëherë pasi vjen data, sipas Klauzolës 11.1.3.

11.4 **Shkalla e taksave**

11.4.1 Shkallët e taksave do t'i nënshtrohen TVSH-së, sikurse parashikohet në ligj.

11.4.2 Koncesionari e vendos në një vend të dukshëm informacionin për shkallët e taksës së rrugës, me qëllim për të informuar përdoruesit, në përputhje me Manualin e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes.

11.4.3 Koncesionari zbaton shkallët e mëposhtme të taksës së rrugës menjëherë pasi fillon data e pagimit të taksave (pa TVSh):



Sheshi i pagimit të taksës së rrugës	Shkalla e taksës së rrugës (euro)
Tuneli i Thirrës	4.17 euro

Taksa e rrugës në lekë është shuma e llogaritur me kursin zyrtar të këmbimit nga euro në lekë të Bankës së Shqipërisë në datën që fillon pagimi i taksës së rrugës.

11.4.4 Shkalla e taksës së rrugës rregullohet në ditën e parë të çdo viti të plotë kalendarik, duke filluar nga viti i dytë i plotë kalendarik.

(a) Shkalla e taksës rregullohet në bazë të formulës së mëposhtme:

$$R_i = R_{\text{td}} \times I$$

Ku:

R_i është shkalla e taksës në euro në vitin i

R_{td} është shkalla e taksës në euro në datën financiare bazë

I është Indeksi, i llogaritur si më poshtë:

$$I = \left([0.25] \cdot \frac{ECPI_i}{ECPI_j} \right) + \left([0.25] \cdot \frac{ECCI_i}{ECCI_j} \right) + \left([0.5] \cdot \frac{LCPI_i \cdot LFXR_i}{LCPI_j \cdot LFXR_j} \right)$$

Ku:

I = Indeksi në vitin i ;

$ECPI_0$ = Euro Indeksi i çmimeve në muajin në të cilën bie data financiare bazë;

$ECPI_i$ = Euro Indeksi i çmimeve në muajin e fundit për të cilën ka të dhëna të disponueshme në datën e llogaritjes;

$EPPI_0$ = Indeksi i BE-së për çmimin e prodhimit në vitin që bie data financiare bazë;

$ECCI_i$ = Indeksi i BE-së për çmimin e prodhimit në vitin e fundit për të cilin ka të dhëna të disponueshme në datën e llogaritjes;

$LCPI_0$ = Indeksi i çmimit të konsumatorit në lekë në muajin në të cilin bie data financiare bazë;

$LCPI_i$ = Indeksi i çmimit të konsumatorit në lekë në muajin e fundit për të cilin ka të dhëna të disponueshme në datën e llogaritjes;

$LXFR_0$ = Norma e kursit të këmbimit nga lekë në euro e Bankës së Shqipërisë në ditën bie data financiare bazë;

$LXFR_i$ = Norma e kursit të këmbimit nga lekë në euro në ditën e fundit për të cilën ka të dhëna të disponueshme në datën e llogaritjes.



- (b) Vlera në lekë e shkallës së rregulluar të taksave të rrugës llogaritet duke këmbyer shkallën e rregulluar të taksës së rrugës në Euro, me kursin zyrtar të këmbimit nga euro në lekë të Bankës Kombëtare, të përdorur në datën e këmbimit; dhe
- (c) Në llogaritjen e shkallës së rregulluar të taksës së rrugës, Koncesionari e rumbullakos vlerën e shkallës së llogaritur të taksës së rrugës në një shifër pas presjes dhjetore, në Euro (0,1 euro) dhe në dhjetë, në lekë (10 lekë).

11.4.4A Në rastin që kursi mesatar i këmbimit gjatë 30 (tridhjetë) ditëve paraprirëse gjatë një viti të Kontratës ndërmjet lekut dhe euros ndryshon me një faktor që e kalon 5% nga kursi i këmbimit që ekzistonte në kohën e rregullimit më të fundit dhe ky ndryshim nuk kthehet përsëri brenda [5%] të normës origjinale të këmbimit brenda 10 ditësh prej saj, Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktor do të rregullojnë Normën e Taksës në përputhje me Klauzolën 11.4.4 deri në maksimumi 3 (tre) përshtatje për vit Kontrate.

11.4.4B Në rast se Koncesionari gjykon si të panevojshme apo dëmtuese për të rregulluar Normën e Taksës sipas Klauzolës 11.4.4 apo Klauzolës 11.4.4A më sipër në një rrethanë të dhënë do të ketë të drejtën të refuzojë të bëjë rregullimin e Normës së Taksës apo të rregullojë Normën e Taksës me një shumë më të vogël se do ta lejoni ndryshe Klauzolat 11.4.4 apo 11.4.4A. Çdo vendim për të pakësuar rregullimet për një periudhë të dhënë do të jetë e pakthyeshme deri në pikën tjetër në të cilën do të shfaqen rregullimet.



11.4.5 Taksa e rrugës kategorizohet dhe taksohet sipas përlogaritjes në Klauzolës 11.4.3 dhe 11.4.4 më sipër, në varësi të klasës së automjetit në bazë të klasifikimit të automjeteve:

Fasha e tarifave	Klasa e Automjetit	Lloji i Automjetit	Koeficienti i taksës së rrugës
1	A	Motoçikleta, motoskutera, dhe automjete me tre rrota	0.50
2	B C D	Automjete për pasagjerë (2 boshte – 4 rrota) Automjete të lehta komerciale dhe mikrobusë (2 akse– 4 rrota) me lartësi deri në 1.90m Mikrobusë dhe makina që tërheqin trailera (2 akse – 4 rrota)	1.00
3	E F	Autobusë (2 akse – 6 rrota) Automjete të vogla komerciale (2 akse – 6 rrota) me lartësi ndërmjet 1.90m dhe 2.70 m	2.25
4	G	Kamionë të mesëm dhe autobusë të rëndë (3 akse), duke përfshirë automjetet komerciale me lartësi mbi 2,70 m	3.25

5	H	Kamionë të rëndë (4 akse dhe më shumë)	4.50
---	---	--	------

11.4.6 Në rastin e një ndryshimi në ligj në lidhje me klasifikimin e automjeteve, dispozitat në 11.4.5 më sipër do të përshtaten, sipas rastit. Koncesionari i propozon Autoritetit Kontraktor për miratim (ky miratim nuk do të refuzohet pa arsye) rregullimet përkatëse në Koefficientët e Taksës së Rrugës për t'u përshtatur me kategorizimin e ri, në një mënyrë të tillë që niveli i ri i të Ardhurave nga Taksat e Rrugës nuk ndryshojnë nga të Ardhurat e Taksave të Rrugës të projektuara në Modelin Financiar. Në rast se do të jetë e nevojshme rrumbullakimi i Koefficientëve të Taksave të Rrugës ndryshimi ndërmjet nivelit të ri të të Ardhurave nga Taksat e Rrugës dhe të Ardhurat e Taksave të Rrugës aktuale të projektuara nuk duhet të kalojnë 0.1% e të Ardhurave të Taksave të Rrugës të projektuara aktuale.

11.5 Regjistrimi i informacionit për taksat



11.5.1 Koncesionari monitoron dhe mban të dhëna të plota dhe të sakta për të gjitha të ardhurat nga taksat e rrugës dhe të dhëna për trafikun dhe e përfshin këtë informacion në raportet mujore dhe raportet e ecurisë vjetore, në përputhje me Klauzolën 21.8.7.

11.5.2 Autoriteti Kontraktor herë pas here (me shpenzimet e veta) i inspekon, monitoron, ose i kontrollon këto të ardhura nga taksat e rrugës dhe të dhënat e trafikut dhe kryen kontrollet të Koncesionari në lidhje me përdorimin e taksës së rrugës, sipas Klauzolës 21.9.

11.6 Metoda e pagesës së taksës së rrugës

11.6.1 Koncesionari pranon format e mëposhtme të pagesës nga përdoruesit:

- (a) Pagesa me para në dorë në lekë ose në euro;
- (b) Pagesa me kartë debiti ose me kartë krediti,

ndërsa opsioni se cila formë pagese do të përdoret, zgjidhet nga çdo përdorues i veçantë.

11.6.2 Koncesionari gjithashtu duhet të pranojë pagesat elektronike me anë të një sistemi elektronik të vjeljes së taksave të rrugës (ETC) të paktën një njëerën korsi të autostradës, e cila duhet të funksionojë në të dy kahet e rrugës. Sistemi ETC i përdorur nga Koncesionari duhet të jetë në përputhje me Direktivën Evropiane 2004/52/KE dhe duhet të minimizojë në maksimumin e mundshëm riskun e mospagimit të taksës. Me qëllim që të pasqyrojë kërkesat e pasjes së një sistemi ETC funksional, Koncesionarit i jepet një periudhë 1 (një) vjeçare, që nga përfundimi paraprak i Punimeve për sheshin e taksës së Koncesionit, përpara se kjo Klauzolë 11.6.2 të bëhet e zbatueshme.

11.7 Përdoruesit e përjashtuar

11.7.1 Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari bien dakord që Lista e Përdoruesve të përjashtuar për të cilën është rënë dakord, e parashikuar në Shtojcën 17, të jetë një

listë e plotë e përdoruesve që lejohen të udhëtojnë në Autostradë pa pagesë dhe që nuk u kërkohet të paguajnë taksën e rrugës, ndërsa të gjithë përdoruesve të tjerë (përveç në rast urgjence) u kërkohet të paguajnë taksën e rrugës.

- 11.7.2 Asnjëra nga palët nuk mund të shtojë ose heqë ndonjë person apo grup njerëzish nga Lista e rënë dakord e Përdoruesve, siç parashikohet në shtojcën 17 të kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak të palës tjetër.

11.8 Përdoruesit e shpeshtë

- a) Koncesionari harton dhe zbaton një skemë zbritjesh për Përdoruesit e shpeshtë brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh që nga Data e Përfundimit të punimeve për sheshin e taksës, skemë e cila duhet të bazohet në të dhënat aktuale dhe të parashikuara të trafikut, të konfirmuara nga Inxhinieri i Pavarur dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Një skemë e tillë për përdoruesit e shpeshtë rishikohet dhe përditësohet në fillim të çdo viti të Kontratës, duke marrë parasysh kushtet e aktuale të trafikut të Autostradës.
- b) Koncesionari do t'i paguajë çdo vit Autoritetit Kontraktor për tre vitet e para nga Data e Përfundimit të Punimeve për Taksat e Rrugës, një shumë prej 120.000 Euro (përfshirë TVSH-në), si pagesa të drejtpërdrejta. Këto pagesa direkte do të bëhen me qëllim minimizimin e ndikimit socio-ekonomik që rrjedh nga futja e Taksave të Rrugës për përdoruesit e shpeshtë lokale.

11.9 E drejta për të nxjerrë të ardhura shtesë

- 11.9.1 Për aq sa lejohet me ligj, Koncesionari mund ta përdorë Autostradën për të nxjerrë të ardhura shtesë, përveç të ardhurave nga taksat e rrugës, duke përfshirë, për të shmangur çdo dyshim, ofrimin e vendpushimeve.
- 11.9.2 Çdo propozim i Koncesionarit për të nxjerrë të ardhura nga Autostrada i nënshtrohet miratimit të Autoritetit Kontraktor.
- 11.9.3 Kur vendpushimet ekzistojnë në Autostradë në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes:
- (a) Përpara datës së hyrjes në fuqi, Autoriteti Kontraktor përcakton se cilat vendpushime do të vazhdojnë të funksionojnë dhe cilat do të hiqen andej;
 - (b) Autoriteti Kontraktor është vetë përgjegjës për heqjen e ndonjë vendpushime ekzistues dhe për kompensimin e pronarëve të tyre;
 - (c) Autoriteti Kontraktor u kërkon të gjitha vendpushimeve ekzistuese të cilat do të mbeten brenda të djathtës së rrugës, marrëveshjen e nënshkruar standarde, siç parashikohet në dispozitat e klauzolës 11.9.3 (d) brenda gjashtë muajve pas Dates së Hyrjes në Fuqi dhe do t'i kërkojë atyre të marrin leje shfrytëzimi dhe licenca të tjera që kërkon ligji jo më vonë se 1 vit pas datës së hyrjes në fuqi [të Marrëveshjes];
 - (d) Autoriteti Kontraktor kërkon që të gjithë operatorët e vendpushimeve ekzistuese, që do të mbeten në territoret ekzistuese, të nënshkruajnë r

Marrëveshje standard me Koncesionarin, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet përkatëse të palëve (pra, detyrimet e operatorit të Pikës së pushimit për të ofruar një nivel të kënaqshëm shërbimi për përdoruesit e mjeteve dhe për t'i paguar një tarifë Koncesionarit; detyrimet e Koncesionarit për të ofruar shërbime në vendpushime, duke përfshirë mirëmbajtjen e trotuareve, largimin e borës, kontrollin e bimësisë, etj.) brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi. Për shmangien e dyshimit, në rast se Zonat e Pushimit të lejuara nuk do të nënshkruajnë marrëveshjen standarde me Koncesionarin, do të konsiderohen automatikisht nga Autoriteti Kontraktor si zonë pushimi e hequr në përputhje me klauzolën 11.9.3 (a).

11.10 Vendpushimet

11.10.1 Duke filluar nga data e kësaj Marrëveshjeje, kur Autoriteti Kontraktor jep leje për krijimin e vendpushimeve të reja, që kanë një ndikim material negativ në aftësinë e Koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij, ose për ushtrimin e të drejtave të tij sipas kësaj Kontrate, dhënia e një lejeje të tillë quhet Ngjarje kompensimi. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor do të diskutojë më parë me Koncesionarin para dhënies së lejes për Zonat e Pushimit dhe sa të jetë e mundur, do të marrë në konsideratë vërejtjet dhe kërkesën e Koncesionarit.



11.10.2 Koncesionari mund të zhvillojë dhe të përfshijë vendpushime, në përputhje me Seksionin 3.1.8.4 të Shtojcës 5 dhe, për shmangien e dyshimeve, çdo e drejtë për truall apo për përdorim të tij, që kërkohet për t'i dhënë mundësi Koncesionarit të kryejë zhvillime të tilla, do të merret me shpenzimet dhe riskun e Koncesionarit.

11.10.3 Të gjitha vendpushimet janë pjesë e Autostradës dhe zhvillimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e vendpushimeve është pjesë e Punimeve dhe Shërbimeve.

11.10.4 Në vartësi të Klauzolës 11.9, Koncesionari ka të drejtë të vendosë tarifa për përdorimin e vendpushimeve nga të tretët.

11.11 Zbatimi i taksës së rrugës

11.11.1 Për sa kohë që Koncesionari përmbush kërkesat e Seksionit 3.2.5 të Shtojcës 5 dhe një përdorues kryen një shkelje, duke mos paguar taksën e rrugës, atëherë Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit kompensim për evazion të taksës së rrugës.

11.11.2 Kompensimi për mospagim të taksës së rrugës është i pagueshëm vetëm në lidhje me shkelje të taksës së rrugës për të cilat ka prova të paraqitura në përputhje me kërkesat e Seksionit 3.2.5 të Shtojcës 5, dhe të raportuara në përputhje me kërkesat e Lidhjes 6 të Shtojcës 5, të cilat i paraqiten Autoritetit Kontraktor nga Koncesionari. Kompensimi për mospagimin e taksave të rrugës është i barabartë me shumën që do të paguante përdoruesi që ka kryer shkeljen, duke mos paguar taksën e rrugës, në përputhje me shkallët e taksës së rrugës që në përdorim në kohën e shkeljes së kryer.

11.11.3 Autoriteti Kontraktor i jep të gjithë ndihmën e arsyeshme Koncesionarit për zbatimin e taksës së rrugës nga përdoruesit, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, ofrimin e pranisë së arsyeshme të poli

efikase ndaj kërkesave të Koncesionarit për ndihmë shtesë në rastin e shkeljeve të taksave rrugore dhe/ose mospagimin e tyre.

- 11.11.4 Për shmangien e çdo dyshimi, dispozitat e kësaj Klauzole 11 (dhe aspektet e Shtojcës 5 të referuara në të) përcaktojnë tërësinë e detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përdorimin e taksës.

Pjesa 3: Ndërtimi

12. Territori i punimeve të Projektit dhe kushtet e tokës

12.1 Hetimi i Territorit të Projektit

- 12.1.1 Pa cenuar përfitimet (të drejtat) e Koncesionarit sipas Klauzolave 10.1 dhe 10.2, Koncesionari garanton se:

(a) Aq sa ishte e mundur, ka inspektuar dhe kontrolluar me sy dhe është bindur se Territori i Projektit dhe mjediset përreth dhe, sipas rasti, të gjitha strukturat apo punimet ekzistuese brenda, sipër, poshtë, në gjithë hapësirën, ose mbi Territorin e Projektit, ose që synohet të përdoren për ndërtimin e ndonjë tuneli;



(b) Është njohur dhe është bindur për natyrën e kushteve klimatike, hidrologjike, ekologjike, mjedisore dhe të përgjithshme të Territorit të Projektit dhe rrethinat e tij, natyrën e tokës dhe nëntokës, duke përfshirë të gjitha kushtet nënsipërfaqësore, pavarësisht nëse ishin të parashikueshme apo jo, formën dhe natyrën e Territorit të Projektit, riskun e dëmtimit apo të dëmit ndaj pronave pranë tij, ose që prekin Territorin e Projektit dhe pronarët e pronave të tilla, natyrën e materialeve (natyrale ose jo) që do të gërmohen, dhe natyrën e projektit, punën, impiantet, dhe materialet e nevojshme për Projektin;

(c) Është bindur në lidhje me:

(i) Mjetet e komunikimit dhe mundësitë për të hyrë e dalë dhe për të përdorur të gjithë Territorin e Projektit dhe mjaftueshmërinë e të drejtave të përdorimit të këtij territori për këto qëllime, sikurse përcaktohet në Klauzolën 10.1; dhe

(ii) Masat mbrojtëse paraprake dhe oraret dhe metodat e punës të nevojshme për të parandaluar ndonjë shqetësim apo ndërhyrje, qoftë publike apo private, që mund të shkaktohet nga të tretët.

- 12.1.2 Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës para Koncesionarit për ndonjë pasaktësi, mosveprim, papërshtatshmëri për ndonjë qëllim, apo për pamjaftueshmëri të ndonjë lloji, cilido qoftë, të ndonjë vrojtimi topografik që Autoriteti Kontraktor i paraqet Koncesionarit. Koncesionari garanton dhe garanton përpara Autoritetit Kontraktor se e ka bërë analizën dhe kontrollin e vet të këtyre vrojtimit dhe se është bindur në lidhje me saktësinë, plotëshmërinë dhe përshtatshmërinë e tyre për këtë qëllim, si dhe për sa i takon kualifikimeve prej ekspertit dhe metodave të përdorura për të bërë këto vrojtime.

se Koncesionari nuk shlyen në asnjë mënyrë ndonjë detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, as nuk ka të drejtë të ngrejë padi ndaj Autoritetit Kontraktor për shkak se vrojtime të tilla topografike janë jo korrekte ose të pamjaftueshme.

- 12.1.3 Deri në Përmbylljen Financiare, në rast të identifikimit me anë të inspektimit dhe sigurimit të provave nga Koncesionari për pasaktësi materiale, mosveprime, paaftësi për çdo qëllim ose pamjaftueshmëri të çdo lloji në anketat e ofruara nga Autoriteti Kontraktor për Koncesionarin deri në atë datë, kjo ngjarje do të reflektohet për të rregulluar shpenzimet e projektuara për ndërtim të parashikuara për Modelin Financiar.

13. Antikitetet

- 13.1 Në rastin e zbulimit të ndonjë antikiteti në Territorin e Projektit, pas datës në të cilën Autoriteti Kontraktor i ka dorëzuar Koncesionarit Territorin e Projektit, ose kur gërmimi për antikitete ka filluar përpara nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, që nuk është përfunduar në kohën e dorëzimit të Territorit të Projektit, Koncesionari do të bindë Nënkontraktorin e Ndërtimit:

13.1.1 Të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme që kërkohen nga ligji në lidhje me antikitetet;

13.1.2 Nëse dëshiron t'i dërgojë një njoftim Autoritetit Kontraktor, sipas Klauzolës 28, bashkë me një njoftim të tillë, i jep edhe njoftime të tjera që u ka dërguar autoriteteve përkatëse, në përputhje me ligjin në të njëjtën kohë me këtë njoftim;

13.1.3 Të ndërmarrë hapa të tilla që mund të kërkohen me ligj nga çdo autoritet përkatës, të cilat mund të përfshijnë ndërprerjen dhe moskryerjen e operacioneve të tilla, që mund të pengojnë gërmimet e antikiteteve, ose që mund të prekin antikitetet në ndonjë mënyrë; dhe

13.1.4 Të marrë të gjitha hapat e nevojshme për të ruajtur antikitetin në të njëjtin pozicion dhe gjendje në të cilën është gjetur.

13.2 Hetimi dhe plani i veprimit

13.2.1 Autoriteti Kontraktor, çdo Autoritet i duhur përkatës dhe çdo person që vepron në emër të secilit prej tyre, ka të drejtë të hyjë dhe dalë në Territorin e Projektit për qëllimet e hetimit për ndonjë antikitet, duke bërë një plan për të trajtuar antikitetin dhe/ose çdo gërmim të lidhur me të, ndërsa Koncesionari i jep asistencën e nevojshme të arsyeshme Autoritetit Kontraktor, çdo Autoriteti të duhur përkatës dhe/ose çdo personi tjetër që vepron në emër të secilit prej tyre, duke përfshirë vënien në dispozicion të fuqisë punëtore dhe të pajisjeve të tij.

13.2.2 Koncesionari respekton kushtet e çdo dispozite, të çdo rezolute, të çdo Autoriteti të duhur përkatës. Gërmimet do të kryhen nën mbikëqyrjen dhe me pjesëmarrjen e Autoritetit Kontraktor, të çdo Autoriteti të duhur përkatës dhe/ose të çdo personi që vepron në emër të tyre.

13.3 Shlyerja e detyrimit



- 13.3.1 Koncesionari bën çmos të sigurojë që Nënkontraktori i ndërtimit të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që të mos jetë e nevojshme të kërkohet zgjatja e periudhës për përfundimin e Punimeve (duke riorganizuar Programin ose ndryshe) si rezultat i gërmimeve në lidhje me antikitetet e zbuluara përpara ose gjatë periudhave të ndërtimit.
- 13.3.2 Nëse ndodh ndonjë vonese në kryerjen e Punimeve si rezultat i gërmimeve, largimit [të antikitetit], ose të ndonjë pune tjetër të nevojshme të kryer në lidhje me antikitetet e zbuluara ose përpara dorëzimit të Territorit të Projektit (kur një punë e tillë nuk është përfunduar përpara dorëzimit të Territorit të Projektit), ose që është zbuluar pas dorëzimit të Territorit të Projektit, atëherë Koncesionari ka të drejtë të bëjë kërkesë për një ngjarje kompensimi.
- 13.3.3 Në të gjitha kohët, pavarësisht nga zbulimi i ndonjë antikiteti, Koncesionari vazhdon të përmbushë pa vonese të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë vazhdimin e punës për kryerjen e të gjitha punimeve apo shërbimeve të tjera.

13.4 Pronësia e antikiteve

Të gjitha antikitetet janë pronë absolute e Autoritetit Kontraktor.

14. Kërkesat mjedisore dhe pëlqimet e nevojshme

- 14.1 Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, Koncesionari vepron në përputhje të plotë me kërkesat e mëposhtme:
- 14.1.1 Të gjitha ligjet e zbatueshme mjedisore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe Standardet e IFC-së për ecurinë e punës, siç janë në datën e paraqitjes së ofertës dhe siç ndryshohen herë pas here;
- 14.1.2 Çdo leje të lëshuar, kusht apo kërkesë mjedisore të vendosur në lidhje me Punimet, sikundër përcaktohet në çdo vlerësim të ndikimit mjedisor apo pëlqim të nevojshëm;
- 14.1.3 Çdo leje, deklaratë detyruese, udhëzim, apo pëlqim me natyrë mjedisore, të dhënë nga një Autoritet përkatës në lidhje me Projektin (ose çdo pjesë të tij); dhe
- 14.1.4 Çdo kërkesë me natyrë mjedisore në kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

(“Kërkesat mjedisore”)

14.2 Parandalimi

Pa cenuar detyrimet sipas Klauzolës 14.1, Koncesionari gjatë gjithë kohës, ndër të tjera:

- 14.2.1 Siguron që ai dhe Nënkontraktorët të përdorin mjete të përshtatshme në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për të parandaluar (kur është e mundur) dhe ndryshe për të minimizuar çdo ndotje që mund t'i shkaktohet mjedisit gjatë hartimit, ndërtimit, financimit, mirëmbajtjes, dhe/ose shfrytëzimit të Autostradës; dhe

14.2.2 Siguron që ai dhe Nënkontraktori i Ndërtimit dhe Nënkontraktorët e tij, të përdorin eksplozivët për kryerjen e Punimeve vetëm kur të jetë absolutisht e domosdoshme dhe pas marrjes së pëlqimit përkatës të nevojshëm.

14.3 Restaurimet

Pa cenuar detyrimet sipas Klauzolës 14.1, Koncesionari në çdo kohë siguron që ai, Nënkontraktori i ndërtimit dhe Nënkontraktorët e tij, pas përfundimit të Punimeve, të rehabilitojnë pjesën e mbetur të Territorit të Projektit, çdo zonë tjetër me instalime në Territorin e Projektit, si edhe zonat ku janë vendosur pajisjet, instrumentet e nevojshme për realizimin e Punimeve dhe çdo zonë tjetër të përdorur nga Koncesionari më parë, duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme, ose në një gjendje të barasvlershme, ose në formën e specifikuar të kërkesat përkatëse të Autoritetit Kontraktor.

14.4 Lejet ekzistuese dhe pëlqimet e nevojshme të Autoritetit Kontraktor

14.4.1 Lejet ekzistuese dhe pëlqimet e nevojshme të Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor i dorëzon Koncesionarit të gjitha lejet ekzistuese dhe pëlqimet e nevojshme të Autoritetit Kontraktor, që përfshihen në të dhënat e vëna në dispozicion, ose përndryshe, përpara kohës kur kërkohen ato leje ekzistuese ose pëlqime të nevojshme të Autoritetit Kontraktor, me qëllim që ai të fillojë një pjesë të Punimeve në përputhje me Programin.

14.4.2 Mosdhënia e lejeve ekzistuese ose pëlqimeve të nevojshme të Autoritetit Kontraktor

Në rastin që Autoriteti Kontraktor nuk e jep një leje ekzistuese ose pëlqimin e nevojshëm të Autoritetit Kontraktor përpara kohës kur kërkohet leja ekzistuese apo pëlqimi i nevojshëm i Autoritetit Kontraktor, me qëllim fillimin e një pjesë të Punimeve në përputhje me Programin, atëherë kjo do të përbëjë një ngjarje kompensimi.

14.4.3 Heqja ose pavlefshmëria e lejeve ekzistuese apo pëlqimeve të nevojshme të Autoritetit Kontraktor.

Në rastin që një leje ekzistuese ose pëlqimi i nevojshëm i Autoritetit Kontraktor hiqet, ndryshohet (jo me kërkesë të Koncesionarit apo një pale të Koncesionarit), pezullohet ose ndryshe deklarohet e pavlefshme, përveçse për shkak të një veprimi të gabuar ose të një mosveprimi të Koncesionarit ose të një pale të Koncesionarit, atëherë kjo përbën një ngjarje kompensimi.

14.4.4 Kërkesë për leje apo pëlqime shtesë

Koncesionari do të jetë përgjegjës për marrjen e të gjitha lejeve shtesë dhe pëlqimet e nevojshme dhe për rregullimin e ndonjë ndryshimi të nevojshëm për çdo leje ekzistuese ose në pëlqimet e nevojshme ndërsa Autoriteti Kontraktues do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të ndihmuar dhe mbështetur Koncesionarin në marrjen e të gjitha lejeve dhe pëlqimeve shtesë të nevojshme, si dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që, në varësi të garantimit nga Koncesionari të plotësimit të gjitha kërkesave dhe formaliteteve të



lëshimin nga ana e Autoritetit përkatës e këtyre lejeve dhe pëlqimeve të nevojshme për Koncesionarin, do të trajtohet me prioritet të duhur dhe pa vonesë nga ana Autoritetet përkatëse, pavarësisht se asgjë në këtë klauzolë nuk do të konsiderohet të jetë një zotim nga Autoriteti Kontraktues duke siguruar që çdo leje shtesë ose Pëlqim i nevojshëm do të merret nga Koncesionari.

14.5 Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social

14.5.1 Autoriteti Kontraktor i ka dhënë Koncesionarit një Vlerësim paraprak të ndikimit mjedisor dhe social (VPNMS-ESIA) në lidhje me Projektin. Në masën që Huadhënësit kërkojnë informacion shtesë, ose që ndryshe kërkohet me ligj, Koncesionari bën hetime shtesë dhe përgatit një VPNMS me shpenzimet e veta. Në varësi të pikës 5.5 të Shtojcës 5, Koncesionari është përgjegjës për çdo masë të përcaktuar në VPNMS-në përfundimtare.

15. Dokumentacioni i Projektit

15.1 Skicat e projektimit

15.1.1 Skicat ekzistuese të projektimit



Koncesionarit i janë dhenë skicat ekzistuese të projektimit si pjesë e dokumentacionit të tenderit. Kjo përfshin projektimin konceptual të urës së re të Drinit në zonën e Kukësit. Koncesionari ka të drejtë t'i modifikojë skicat ekzistuese të projektimit, megjithatë asnjë modifikim i tillë nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë apo tërthortë në rritjen e detyrimeve financiare të Autoritetit Kontraktor apo Qeverisë së Shqipërisë në bazë të kësaj Kontrate, përfshirë përmes rritjeve të kostos së sasive si rezultat i kushteve negative të paparashikuara gjeoteknike .

15.1.2 Skicat e hollësishme përfundimtare të projektimit

- (a) Përveç skicave ekzistuese të projektimit, Koncesionari përgatit Skicat e hollësishme përfundimtare në lidhje me Dokumentacionin e Projektit për urën e re të Lumit Drin dhe çdo punim tjetër teknik të nevojshëm dhe siguron që të gjitha skicat e hollësishme përfundimtare të projektimit të jenë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe të gjitha lejet e nevojshme.
- (b) Koncesionari bën çmos që të gjitha skicat e hollësishme përfundimtare të projektimit të miratohen nga Inxhinieri i pavarur, në përputhje me Klauzolat 15.1.2. (c)-(e). Me miratimin e Inxhinierit të Pavarur, këto skica të hollësishme përfundimtare të projektimit bëhen skicat e hollësishme të miratuara të projektimit.
- (c) Çdo dokumentacion i Projektit i krijuar nga Koncesionari në kuadër të një skice të hollësishme përfundimtare të projektimit i dorëzohet Inxhinierit të pavarur për miratim. Dorëzimit të tyre i bashkëngjitet një opinion i firmosur nga inxhinieri i Koncesionarit, që përmban opinionin e inxhinierit të Koncesionarit në lidhje me përshtatshmërinë e skicave për t'u përdorur nga Projekti. Inxhinieri i pavarur bën komentet e tij në dokumentacionin e

Projektit brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e tij dhe e shënon secilin dokument ose me "Të vazhdojë", "Të vazhdojë me komente" ose "Të paraqitet përsëri". Inxhinieri i pavarur nuk është i detyruar të pranojë çdo opinion të inxhinierit të Koncesionarit, me kusht që Inxhinieri i pavarur të kundërshtojë një dokumentacion të tillë të Projektit vetëm nëse ka gabime ose mungesa, ose kur ndryshe nuk është në përputhje me kërkesat e Punimeve të Autoritetit Kontraktor, propozimet e Koncesionarit për Punimet, praktiken e mirë të këtij sektori ekonomik, ose me standardet. Në rast se ndodh që Inxhinieri i pavarur nuk bën komente për dokumentacionin e Projektit deri në afatin e sipërpërmendur, një dokumentacioni i tillë i Projektit do të konsiderohet se është shënuar me fjalët "Të vazhdohet" nga Inxhinieri i pavarur.

- (d) Në rastin kur dokumentacioni i dorëzuar i Projektit është shënuar me fjalët "Të vazhdohet", ose "Të vazhdohet me komente", Koncesionari ka të drejtë të vazhdojë punën me përgatitjen/finalizimin e skicave përkatëse përfundimtare me hollësi të projektimit, me kusht që në rrethanat kur Dokumentacioni i dorëzuar i Projektit është shënuar me fjalët "Të vazhdohet me komente", Koncesionari t'i zbatojë këto komente.
- (e) Në rastin kur dokumentacioni i dorëzuar i Projektit është shënuar me fjalët "Të dorëzohet përsëri" nga Inxhinieri i pavarur, Koncesionari merr parasysht çdo koment të Inxhinierit të pavarur, duke e ndryshuar përkatësisht dokumentacionin e Projektit. Koncesionari i dërgon menjëherë Inxhinierit të pavarur për miratim dokumentacionin e dorëzuar të Projektit, të ndryshuar, në përputhje me Klauzolën 15.1.2(c), me kusht që afati kohor në Klauzolën 15.1.2(c) të ndryshohet në 10 (dhjetë) ditë pune me qëllim për t'u ridërguar.
- (f) Në rast se Koncesionari gjatë përgatitjes së projektit të hollësishëm të Urës në lumin Drin në përputhje me këtë Klauzoë 15.1.2, përcakton kushte të paparashikuara të këqija gjeoteknike, të cilat ndikojnë në mënyrë materiale në vierësimet e atyre sasive të marrë në konsideratë të cilat janë të lidhura direkt me kushtet tokësore (të hijezuara me të kuqe në Shtojcën 7), ai e njofton Inxhinierin e Pavarur dhe Autoritetin Kontraktor për kushte të tilla, justifikon ndryshimet e kërkuara në projektim dhe ndërtim, dhe vlerëson ndikimet e tyre në sasi të marra në konsideratë të cilat janë të lidhura direkt me kushtet tokësore (të hijezuara me të kuqe në Shtojcën 7). Pasi që hartimi i hollësishëm i Urës në lumin Drin miratohet nga Inxhinieri i Pavarur, sasi të përfundimtare të marra në konsideratë, duke përfshirë rregullime të justifikuara vetëm për ato sasi të referuara të cilat janë të lidhura direkt me kushtet tokësore (të hijezuara me të kuqe në Shtojcën 7), krahasohen me sasisë referencë përkatëse origjinale që përmban Shtojca 7. Nëse kostoja e përgjithshme e rishikuar që rezulton e sasive përfundimtare e certifikuar nga Inxhinieri i Pavarur është më e madhe se sa kostoja e përgjithshme e sasive të referencës së përcaktuara në Shtojcën 7, me të paktën 10%, Koncesionari ka të drejtë të kompensohet me 85% të rritjes totale (për shmangien e dyshimeve, një rritje e tillë e kostove që lindin shprehimisht nga kushtet e paparashikuara të këqija gjeoteknike) të llogaritura me çmime të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.



rasteve kur kjo kosto e rritur nuk do të ishte mbajtur nëse nuk do të ishte për modifikimet në Skicat Ekzistuese të bëra nga Koncesionari në zbatim të Klausolës 15.1.1, këto rritje do të përballohen plotësisht nga Koncesionari.

15.1.3 Skicat e ndërtimit

- (a) Përveç skicave të hollësishme përfundimtare të projektimit dhe pas miratimit të këtyre skicave të hollësishme përfundimtare të projektimit, Koncesionari përgatit të gjitha skicat e tjera të nevojshme të ndërtimit për kryerjen dhe përfundimin e Punimeve, dhe siguron që skica të tilla të jenë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe me pëlqimet e nevojshme.
- (b) Procesi i miratimit të skicave të ndërtimit, me qëllim që Koncesionari të ketë të drejtë të vazhdojë punën për Punimet përkatëse, është i njëjtë si procesi i miratimit i përshkruar në Klausolën 15.1.2 më sipër në lidhje me skicat e hollësishme përfundimtare të projektimit.

16. Ndërtimi

16.1 Koncesionari kryen dhe përfundon Punimet:

- 16.1.1 Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, kërkesat, standardet e Autoritetit Kontraktor, propozimet e Koncesionarit për Punimet dhe praktikatat e mira të sektorit ekonomik të percaktuara nga Hartuesi;
- 16.1.2 Për të arritur datën përkatëse të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës në datën e programuar për përfundimin paraprak të Aspektit përkatës;
- 16.1.3 Për të siguruar marrjen e lejeve të shfrytëzimit të të gjitha Aspektive përkatëse të Autostradës jo më vonë se data përfundimtare e lejes së shfrytëzimit;
- 16.1.4 Duke bërë në çdo kohë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që të mos bëjë diçka që ndikon negativisht në punët e të tretëve (pa kosto shtesë për vete);
- 16.1.5 Për të përdorur ekskluzivisht materialet dhe pajisjet për Punimet, të cilat zgjidhen profesionalisht në përputhje me praktikatat e mira të sektorit ekonomik që përdoren në kohën e Punimeve dhe të punimeve rinovuese, për ndryshime dhe punime mirëmbajtjeje në përputhje me kërkesat dhe standardet e punimeve të Autoritetit Kontraktor.
- 16.1A Autoriteti Kontraktor bën çmos që punëmarrësit dhe sipërmarrësit e tij (përfshirë edhe sipërmarrësit e tretë) gjatë kohës që janë të pranishëm në Territorin e Projektit t'i ofrojnë në çdo kohë asistencë të arsyeshme Koncesionarit dhe të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndikojë negativisht në aftësinë e Koncesionarit për të kryer Punimet apo ofruar Shërbimet, me përjashtim të rastit kur një ndikim i tillë negativ është i paevitueshëm në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

16.2 Financimi i punimeve kapitale

- 16.2.1 Koncesionarit i kërkohet që të kapë datën e përmbylljes financiare jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas datës së kësaj Marrëveshjeje. Autoriteti Kontraktor sipas gjykimit të tij mund të bjerë dakord ta zgjasë këtë periudhë, pas një propozimi me shkrim nga Koncesionari.
- 16.2.2 Koncesionarit i kërkohet t'i japë Autoritetit Kontraktor (i) informacion të përditësuar mujor për ecurinë e financimit të punëve kapitale, dhe (ii) njoftim paraprak me shkrim jo më vonë se 6 (gjashtë) javë përpara, ku të specifikojë datën e parashkuar të Përmbylljes Financiare.
- 16.2.3 Autoriteti Kontraktor e kompenson Koncesionarin kur norma bazë në datën e përmbylljes financiare është më e lartë se norma bazë duke filluar nga shtatë (7) ditët përpara datës së paraqitjes së ofertave prej [*Norma bazë duke filluar nga shtatë ditë përpara datës së paraqitjes së ofertave të futet nga dhënësi i grantit përpara nënshkrimit*] %. Vlera e kompensimit realizohet me anë të një rritjeje proporcionale të subvencionit të Autoritetit Kontraktor.
- 16.2.4 Koncesionari e kompenson Autoritetin Kontraktor kur norma bazë në datën e përmbylljes financiare është më e ulët se norma bazë duke filluar nga shtatë (7) ditët përpara datës së dorëzimit të ofertës prej [*Norma bazë në shtatë ditë përpara datës së dorëzimit të ofertave të futet nga dhënësi i grantit përpara nënshkrimit*] %. Vlera e kompensimit realizohet me anë të një zbritjeje proporcionale në subvencionin e Autoritetit Kontraktor.
- 16.2.5 Në masën që Koncesionari nuk vepron në përputhje me Klauzolën 16.2.2, atëherë çdo kosto shtesë, që i lind si rrjedhojë Autoritetit Kontraktor është e pagueshme nga Koncesionari dhe çdo pagesë që ndryshe duhej të bëhej sipas Klauzolës 16.2.3 do të humbasë.
- 16.2.6 Nëse Koncesionari nuk arrin të sigurojë financimin e nevojshëm sipas Klauzolës 16.2.1, përveç se kur një mospërbushje e tillë është shkaktuar nga një veprim ose mosveprim i Autoritetit Kontraktor ose një ndryshim negativ material që prek tregjet financiare, që nuk është shkaktuar nga Koncesionari, atëherë, kjo Marrëveshjeje përfundon me efekt të menjëhershëm dhe:
- Asnjëra palë nuk i detyrohet palës tjetër ndonjë pagesë në lidhje me një përfundim të tillë;
 - Autoriteti Kontraktor ka të drejtë ta përdorë garancinë e ofertës; dhe
 - Koncesionari është plotësisht përgjegjës për të gjitha kostot e çmobilizimit dhe të gjitha kostot e tjera që mund t'i lindin.

16.3 Inxhinieri i pavarur¹

¹ Kjo klauzolë është subjekt i negociatave të rëndit, duke përfshirë komentet e huadhënësve, dhe naund të ndryshohet në përputhje me rrethanat para datës efektive, në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese. Përcaktimi i detyrimit

16.3.1 Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktor, jo më vonë se brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga nënshkrimi i kontratës së koncesionit, bashkërisht do të përgatisin dokumentacionin e tenderit siç kërkohe për përzgjedhjen e Inxhinierit të Pavarur, një dokumentacion i tillë do të përmbajë por nuk do të kufizohet me:

- (a) Objekti i punës së Inxhinierit të Pavarur i cili do të bazohet në atë që përmbahet në Shtojcën 13 siç amendohet dhe zgjerohet nga Palët;
- (b) Kriteret të cilat do të përzgjidhet Inxhinieri i Pavarur; dhe
- (c) Termat kyc të kontratës për emërimin e Inxhinierit të Pavarur.

16.3.2 Autoriteti Kontraktor e cakton Inxhinierin e pavarur brenda 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe një caktim i tillë bëhet në përputhje me Ligjin e Prokurimeve Publike të Shqipërisë, bazuar në dokumentacionin e miratuar në përputhje me Klauzolën 16.3.1, kërkesat e Klauzolës 16.3.2A dhe gamën e punimeve të parashikuara në Shtojcën 13 ashtu si kjo e fundit mund të amendohet me marrëveshje ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktor bazuar në Klauzolën 16.3.1. Marrëveshja fillestare e Inxhinierit të pavarur bëhet të paktën për një kohë deri në mbarim të periudhës së përgjegjësisë për defektet e punimeve kapitale të parashikuara. Më pas, çdo marrëveshje e Inxhinierit të pavarur duhet të jetë të paktën për një periudhë minimumi 5 (pesë) vjeçare gjatë periudhës së koncesionit.



16.3.2A Inxhinieri i pavarur duhet të ketë përvojë të madhe ndërkombëtare në projekte të ngjashme me këtë Projekt.

16.3.3 Inxhinieri i pavarur i kryen detyrimet e tij në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Inxhinierit të pavarur, e cila përmban detyrat kryesore të Inxhinierit të pavarur të përcaktuara në Shtojcën 13. Përveç dispozitave të përcaktuara në Shtojcën 13, Marrëveshja e Inxhinierit të pavarur përmban (ndër të tjera) kushtet e mëposhtme:

- (a) Kostot e lindura në lidhje me zgjedhjen, caktimin dhe punën e Inxhinierit të pavarur përballohen në pjesë të barabarta nga Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari (duke qenë objekt rikuperimi nga Koncesionari ose Autoriteti Kontraktor, sipas rastit, i kostove të lindura si rezultat i ndonjë veprimi apo mosveprimi i Autoritetit Kontraktor ose Koncesionarit, sipas rastit, në shkelje të kësaj Marrëveshjeje, ose të cilin Autoriteti Kontraktor apo Koncesionari, sipas rastit, e ka kryer si rezultat i ushtrimit të një të drejte të tij, për të cilën kërkohe që Inxhinieri i pavarur të bëjë një konstatim, por që Inxhinieri i pavarur e përcakton si një drejtë të paushtrueshme);
- (b) Inxhinieri i pavarur i plotëson detyrimet e tij për raportim te Autoriteti Kontraktor dhe te Koncesionari drejtpërdrejt dhe njëkohësisht;
- (c) Objekti i shërbimeve dhe shkalla e të drejtave dhe detyrave të Inxhinierit të pavarur janë në përputhje me Shtojcën 13;

kjo fusnota nuk përjashton negociatat e klauzoleve të tjera të Marrëveshjes së Koncesionit të cilat gjithashtu mund të negociohen në masën e lejuar nga dokumentet e procedurës konkurruese.

- (d) Inxhinieri i pavarur i ofron shërbimet e tij në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe këtë e bën në mënyrë të paanshme dhe të pavarur;
- (e) Përpara zgjidhjes së një konflikti, Inxhinieri i pavarur u jep Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit mundësinë të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen përkatëse;
- (f) Në rast se Inxhinieri i pavarur përgatit një raport të rremë ose i jep Autoritetit Kontraktor ose Koncesionarit informacion mashtrues, ose ndryshe kryen shkelje materiale të kushteve të marrëveshjes së Inxhinierit të pavarur, atëherë, Autoriteti Kontraktor mund t'ia prishë marrëveshjen inxhinierit të pavarur, pa asnjë kërkesë ndaj Autoritetit Kontraktor për rimbursim të kostove dhe shpenzimeve; dhe
- (g) Koncesionari ka të drejtë të konsultohet me Inxhinierin e pavarur në lidhje me të gjitha aspektet e çdo çështjeje që ka të bëjë me Punimet ose me ndonjë riparim kapital.

16.3.4 Pas marrjes së raporteve dhe fletëve me informacion nga Inxhinieri i pavarur, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i parashtrijë Koncesionarit mendimet e tij në lidhje me to.

16.3.5 Nëse kjo Marrëveshje kërkon që Inxhinieri i pavarur të japë vendimin, mendimin, pëlqimin, miratimin e tij ose të përcaktojë masat e duhura, në varësi të Klauzolës 16.3.6 më poshtë; një vendim, mendim, pëlqim, miratim ose përcaktim i masave të duhura nga Inxhinieri i pavarur është detyrues për palën përkatëse dhe një palë e tillë duhet të veprojë në përputhje me të.

16.3.6 Nëse ndonjëra nga palët është e pakënaqur me vendimin, mendimin, pëlqimin, ose masat e urdhëruara nga Inxhinieri i pavarur, atëherë një palë e tillë e njofton palën tjetër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune nga marrja e njoftimit përkatës nga Inxhinieri i pavarur, me kusht që në asnjë rrethanë Koncesionari të mos ketë të drejtë të pezullojë, ndalojë, ose ndërpresë në ndonjë mënyrë tjetër Punimet ose riparimin kapital gjatë procesit të zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje të tillë, me përjashtim të punëve që preken drejtpërdrejt nga mosmarrëveshja, si dhe të punëve përfundimi apo kryerja e të cilave varet drejtpërdrejt nga rezultati i zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në rast se njëra palë është e pakënaqur me vendimin e Inxhinierit të Pavarur mund të aplikohet Klauzola 56.

16.3.7 Për shmangien e dyshimeve, Koncesionari nuk shlyen asnjë detyrim ose përgjegjësi e tij, për shkak të mospërmbushjeve nga Inxhinieri i pavarur i detyrimeve të tij në përputhje me Marrëveshjen.

16.3.8 Secila palë do të ketë të drejtën të kërkojë ndërprerjen e emërimit të Inxhinierit të pavarur deri në 3 (tre) herë gjatë Periudhës së Koncesionit. Në rast të një ndërprerjeje të tillë, do të përzgjidhet një zëvendësues i Inxhinierit të Pavarur në përputhje me termat e kësaj Klauzole 16 përpara se kjo ndërprerje të bëhet efektive.

16.4 Materiale të rrezikshme

16.4.1 Në rastin e zbulimit të ndonjë materiali apo substance të rrezikshme, toksike, apo të ndotur nën, sipër dhe/ose në territorin e Projektit, Koncesionari:

- (a) sipas Klausolës 16.4.2, njofton menjëherë Autoritetin përkatës dhe Autoritetin Kontraktor; dhe
- (b) merr të gjitha hapat e nevojshëm për të garantuar sigurinë e personave dhe të pronës.

16.4.2 Koncesionari ndërmerr të gjithë hapat e kërkuar për largimin dhe/ose neutralizimin e materialeve apo substancave të tilla (në përputhje me pëlqimet, standardet dhe ligjet e nevojshme). Për qëllime të largimit dhe/ose neutralizimit të materialeve ose substancave të tilla, Koncesionari e lejon autoritetin përkatës të hyjë në Territorin e Projektit dhe të zbatojë udhëzimet e autoritetit përkatës.

16.4.3 Nëse, gjatë kryerjes së punëve, Koncesionari zbulon ndonjë material apo substancë të rrezikshme, toksike apo të ndotur në Territorin e Projektit, që nuk është sjellë në Territorin e Projektit nga Koncesionari ose nga ndonjë palë e Koncesionarit, dhe nëse nuk ka arsye se si materiale apo substanca të tilla të rrezikshme të zbuloheshin nga Koncesionari:



- (a) Nga të dhënat e vëna në dispozicion; ose
- (b) Para datës që i korrespondon 4 javëve përpara paraqitjes përfundimtarë të ofertave, nga hetimi me sy i Territorit të Projektit nga Koncesionari dhe nga hetimi i ndonjë shenje të jashtme në sipërfaqe,

Atëherë zbulimi i materialeve apo substancave të tilla të paparashikueshme, të rrezikshme, toksike ose të ndotura në Territorin e Projektit përbën një ngjarje kompensimi.

16.5 Rrjetet e infrastrukturës publike

16.5.1 Nëse ndonjë rrjet i infrastrukturës publike nën, sipër dhe/ose në Territorin e Projektit pengon kryerjen e punëve dhe/ose shfrytëzimin e Autostradës dhe/ose kryerjen e riparimit kapital, ose nëse ndonjë prej këtyre aktiviteteve përfaqëson një rrezik material për funksionimin e tyre, Koncesionari (në konsultim dhe me pëlqimin (në rast nevojë), me pronarin ose operatorin përkatës të infrastrukturës publike) siguron që ajo infrastrukturë të vendoset, hiqet dhe/ose rivendoset pa shpenzime nga ana e Autoritetit Kontraktor, por kostoja e vendosjes, heqjes, dhe/ose rivendosjes të tyre përballohet nga Koncesionari.

16.5.2 Në rast se në Territorin e Projektit zbulohet ndonjë infrastrukturë publike gjatë kryerjes së punëve dhe kur një infrastrukturë e tillë publike nuk mund të ishte zbuluar normalisht nga Koncesionari:

- (a) Nga të dhënat e vëna në dispozicion; ose
- (b) Para datës që i korrespondon 4 javëve përpara paraqitjes përfundimtare të ofertave, nga hetimi me sy i Territorit të Projektit nga Koncesionari dhe nga

hetimi i ndonjë shenje të jashtme në sipërfaqe, ose i elementëve të dukshëm strukturorë,

atëherë zbulimi i një infrastrukture të tillë publike të paparashikueshme përbën një ngjarje kompensimi.

16.5.3 të gjitha tokat e kërkuara për këtë rindërtim dhe zhvendosjen dhe largimin e sipërpërmendur Shërbimet Publike do të konsiderohen si Tokë Shtesë në pajtim me Klausolën 10.2.

16.6 Pëlqimet e nevojshme

16.6.1 Për të gjitha këto punë për largimin, instalimin ose zëvendësimin, të përmendura në Klausolat 16.4 dhe 16.5, Koncesionari merr të gjitha pëlqimet e nevojshme dhe paraqit kërkesat e nevojshme për dhënien e pëlqimeve të duhura, të përmbushura përkatësisht, te Autoriteti i duhur përkatës, ose te ndërmarrja e shërbimeve publike (shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm mbështetës, të përmbushur përkatësisht, që mund të kërkohet). Autoriteti Kontraktor do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të ofruar të gjithë ndihmën e nevojshme për Koncesionarin për të marrë lejet e nevojshme. Çdo vonesë e pajustificuar e shkaktuar nga ndonjë autoritet përkatës i duhur në lidhje me ndonjë leje apo pëlqim që do të lëshohet nga ky autoritet përkatës i duhur, objekt i Koncesionarit që përmbush të gjitha kërkesat dhe formalitetet ligjore, do të jetë një Ngjarje Kompensimi ose një Ngjarje Shlyerjeje sipas rastit dhe sipas vendimit të inxhinierit të pavarur.

16.6.2 Nëse një Autoritet Përkatës nuk lëshon një Pëlqim të Nevojshëm brenda periudhës kohore të përcaktuar në Ligj, për sa kohë që:

- (a) Autoriteti Përkatës nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim apo nuk ka kërkuar masa të mëtejshme për tu ndërmarrë përpara dhënies së Pëlqimit të Nevojshëm në përputhje me autoritetin e tij;
- (b) Koncesionari ka zbatuar detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitat përkatëse të Ligjit në kërkesën për Pëlqimin e Nevojshëm përkatës; dhe
- (c) gjatë ndonjë inspektimi zyrtar nga ky Autoritet Përkatës të bërë përpara kërkesës për Pëlqimin e Nevojshëm, Autoriteti Përkatës nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim në përputhje me ligjin duke përcaktuar mos-kryerjen e detyrimeve apo kushteve të nevojshme për lëshimin e Pëlqimit të Nevojshëm,

atëherë kjo do të përbëjë një Ngjarje Kompensimi.

17. Organizimi i Territorit të Projektit

17.1 Bashkëpunimi me sipërmarrës të tjerë

Koncesionari e lehtëson punën që punëmarrësit ose sipërmarrësit e Autoritetit Kontraktor, të çdo Autoriteti përkatës, pale të interesuar dhe të çdo ndërmarrje shërbimesh publike, mund të

kryejnë në Territorin e Projektit, ose në zona pranë Territorit të Projektit dhe për këtë qëllim u lejon atyre hyrje e dalje në Territorin e Projektit, me kusht që kjo gjë të mos i pengojë apo vonojë punët, ndërsa Autoriteti Kontraktor e lehtëson punën e Koncesionarit dhe angazhohet që punëmarrësit, sipërmarrësit e tij (duke përfshirë edhe sipërmarrësit e tretë) dhe, me aq sa ka mundësi, çdo Autoritet përkatës ose Palë e interesuar të bëjë të njëjtën gjë.

17.2 Lehtësimi i trafikut

Koncesionari, (në përputhje me këtë Klausolë dhe Lidhjen 2 të Shtojcës 5), gjatë periudhave të ndërtimit, ose gjatë punimeve të riparimit kapital, merr të gjitha masat e nevojshme të miratuara nga Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e veta, për të lehtësuar trafikun e penguar ose të vonuar nga punimet, duke lehtësuar diversifikimin e trafikut ose përdorimin e rrugëve dytësore, përfshirë devijimin e trafikut në rrugët ekzistuese, ose në rrugë të pashtuara (pasi ka marrë sipas nevojës miratimin paraprak të pronarit apo operatorit të rrugëve të tilla apo të rrugëve të pashtuara, si edhe pëlqimin e nevojshëm) dhe duke përdorur sisteme të përshtatshme të menaxhimit të trafikut, në përputhje me ligjet për paralajmërimin e publikut dhe të makinave që kalojnë, për risqet dhe rreziqet e mundshme të lidhura me punimet.

17.3 Infrastruktura publike

Koncesionari, me shpenzimet e veta, ose instalon ose lidh (sipas rastit) vendin e punimeve dhe Territorin e Projektit me rrjetin e furnizimit të përshtatshëm të infrastrukturës publike. Do të jetë përgjegjësi e Autoritetit Kontraktor për të bërë të mundur ose siguruar mundësinë e ekzistencës së rrjetit kryesor dhe tubacioneve për funksionimin e shërbimeve. Nëse mungesa e rrjeteve kryesore dhe tubacioneve do të shkaktojë shpenzime shtesë për Koncesionarin kjo duhet të konsiderohet si një Ngjarje Kompensimi.

17.4 Personat e paautorizuar

Koncesionari merr të gjitha masat paraprake, për të mos lejuar që personat e paautorizuar të futen në Territorin e Projektit. Gjatë kryerjes së një aktiviteti në Territorin e Projektit, ose në Truallin shtesë ose në Truallin ekstra gjatë periudhave të ndërtimit, Koncesionari i rrethon këto zona që të mos hyjnë njerëz nga publiku. Koncesionari merr të gjitha masat paraprake për të mbajtur personelin dhe pajisjet e tij, dhe angazhohet që secili nga Nënkontraktorët e tij të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake për të mbajtur personelin dhe pajisjet e tyre, brenda Territorit të Projektit, Truallit përkatës shtesë dhe/ose Truallit përkatës ekstra, dhe i mban dhe nuk i lejon ata të futen në tokat që ndodhen pranë.

17.5 Objektet dhe pajisjet

Koncesionari vë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor dhe personave të tjerë, që veprojnë në emër të Autoritetit Kontraktor në Territorin e Projektit, objektet dhe pajisjet e arsyeshme që kërkohen nga Autoriteti Kontraktor për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje, me kusht që ofrimi i objekteve dhe pajisjeve në përputhje me këtë Klausolë 17.5 të mos kërkojë nga Koncesionari të bëjë ndonjë shpenzim shtesë ose të blejë ndonjë objekt apo pajisje shtesë apo të ofrojë ndonjë objekt apo pajisje, kur kjo gjë do të pengonte ose vononte Koncesionarin nga plotësimi i detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes.

17.6 Largimi i mbetjeve

Koncesionari e mban Territorin e Projektit të pastër nga pengesat e panevojshme dhe i magazinon ose i largon të gjitha pajisjet, objektet ose materialet e tepërta. Koncesionari pastron ose largon nga Territori i Projektit çdo mbeturinë, mbetje apo punë të përkohshme që nuk kërkohen më në përputhje me ligjet.

18. Cilësia

18.1 Menaxhimi i cilësisë

18.1.1 Koncesionari përgatit dhe zbaton në lidhje me çdo fazë të Projektit një sistem kontrolli dhe sigurimi të cilësisë në përputhje me procedurën ISO 9001 (ose çdo procedurë tjetër të barasvlershme) dhe praktikat e mira të industrisë, në formën e sistemeve QES, në përputhje me Seksionin 2 të Shtojcës 5. Koncesionari angazhohet që secili nga Nënkontraktorët e ndërtimit dhe Nënkontraktorët e shfrytëzimit të përgatisë, respektojë dhe zbatojë sistemet e cilësisë në përputhje me Seksionin 2 të Shtojcës 5.

18.1.2 Sistemi i sigurimit dhe kontrollit të cilësisë mbulon (ndër të tjera) menaxhimin e përgjithshëm, sistemin e kontrollit, planifikimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e Projektit.

18.1.3 Përpara nisjes së ndonjë pjese të Punimeve apo Shërbimeve, Sistemet përkatëse të cilësisë të përgatitura nga Koncesionari i paraqiten Inxhinierit të pavarur për komente dhe miratim.

18.1.4 Në mungesë të ndonjë komenti apo kundërshtimi nga Inxhinieri i pavarur brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga paraqitja, sistemet e cilësisë quhen të miratuara.

18.1.5 Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, Koncesionari i rishikon herë pas here sistemet QES. Në rastin e ndonjë ndryshimi në sistemet e cilësisë, Klauzolat 18.1.3 dhe 18.1.4 më sipër përdoren përkatësisht në lidhje me miratimin e sistemeve të ndryshuara të cilësisë nga Inxhinieri i pavarur.

18.2 Kontrolli i cilësisë

Autoriteti Kontraktor mundet që, herë pas here, dhe kur zgjedh vetë, me shpenzimet e tij, të bëjë një kontroll të procedurave të kontrollit të cilësisë së Koncesionarit dhe të Nënkontraktorve për të siguruar kontrollin e kryerjes së detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

18.3 Bashkërendimi i projektimit, ndërtimit dhe sigurisë

Koncesionari vepron në përputhje me të gjitha ligjet përkatëse të cilat rregullojnë bashkërendimin e projektimit, ndërtimit dhe sigurisë së Autostradës.

19. Inspektimi, mbikëqyrja dhe raportimi

19.1 Përfaqësuesi teknik

19.1.1 Autoriteti Kontraktor mund të caktojë herë pas here, në përputhje me Klauzolën 19.1.2, një person për të vepruar si përfaqësues teknik dhe për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

- 19.1.2 Koncesionari e pranon se përfaqësuesi teknik mund të caktohet për të kryer funksione të caktuara të Autoritetit kontraktor, dhe e pranon një caktim të tillë, si dhe zëvendësime apo caktime të tjera të njoftuara nga Autoriteti Kontraktor.
- 19.1.3 Gjatë periudhave të ndërtimit, Autoriteti Kontraktor dhe çdo person i caktuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktor (duke përfshirë përfaqësuesin teknik) kanë të drejtë, me shpenzimet e tij, pavarësisht nga detyrimet e Koncesionarit sipas Klauzolës 17.5, të hyjnë në Territorin e Projektit në çdo kohë të arsyeshme dhe të bëjnë kontrolle të rastësishme në Punime. Një kontroll i tillë përfshin ndjekjen e aktivitetit në çdo fazë të punës, çdo procedure testimi, vënien në punë ose certifikimin, me qëllim për të provuar se Koncesionari po vepron në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor (duke përfshirë të përfaqësuesit teknik). Me një veprim të tillë, Autoriteti Kontraktor dhe çdo person i caktuar nga Autoriteti Kontraktor nuk duhet të shkaktojë asnjë shqetësim të paarsyeshëm, i cili mund të vonojë ecurinë e veprimtarive të Koncesionarit, dhe duhet të përmbushë kërkesat e duhura të sigurisë në Territorin e Projektit.
- 19.1.4 Autoriteti Kontraktor dhe Inxhinieri i pavarur gjithashtu kanë të drejtë të ndjekin takimet për ecurinë e punimeve, të cilat zhvillohen ndërmjet Koncesionarit dhe Nënkontraktorët të ndërtimit, dhe të marrin njoftimet përkatëse për kohën dhe vendin e takimeve të tilla.
- 19.1.5 Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, të gjitha dokumentet e përgatitura në lidhje me sa më poshtë, i dorëzohen Përfaqësuesit teknik:
- (a) Skicat e miratuara të ndërtimit;
 - (b) Raportet e Inxhinierit të pavarur për ecurinë e punës;
 - (c) Komentet dhe mendimet e kundërta të Koncesionarit, brenda 5 (pesë) ditësh pune, në lidhje me raportet e Inxhinierit të pavarur për ecurinë e punimeve;
 - (d) Sipas kërkesës, të gjitha kërkesat e një Nënkontraktori, dhe çdo dokument tjetër (duke përfshirë opinionin e Inxhinierit të pavarur) të lidhur me to;
 - (e) Sipas kërkesës, çdo udhëzim teknik, plan testimi dhe kualifikimi;
 - (f) Rezultatet e testeve të kualifikimit (për shembull, testet laboratorikë, rezultatet e vrojtimeve gjeodezike, miratimet e cilësisë, vërtetime të tjera, etj.);
 - (g) Dokumentacionin kualifikues dhe skicat e projektimit, të përditësuara gjatë ndërtimit; dhe
 - (h) Çdo dokument tjetër të pranuar nga Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari paraprakisht dhe/ose siç njoftohet herë pas here nga Përfaqësuesi teknik.
- 19.1.6 Çdo dokument i listuar në Klauzolën 19.1.5 dorëzohet në adresën e Përfaqësuesit teknik brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga përgatitja ose finalizimi i tij, ose brenda një



periudhe të arsyeshme kohe nga marrja e njoftimit të Përfaqësuesit teknik me anë të të cilit keto dokumente kërkohen si të nevojshme.

- 19.1.7 Aktivitetet e Përfaqësuesit teknik përfshijnë gjithashtu edhe ato gjëra që përshkruhen në Klauzolën 21.9.

19.2 Programi

- 19.2.1 Koncesionari përgatit programin në përputhje me kërkesat e Seksionit 6 të Shtojcës 5.

- 19.2.2 Çdo program i paraqitet Inxhinierit të pavarur. Inxhinieri i pavarur e miraton ose e refuzon programin brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e tij, me kusht që Inxhinieri i pavarur ta refuzojë programin vetëm nëse ai nuk përputhet me ligjin, kërkesat e Autoritetit Kontraktor për Punimet, the kërkesat e Seksionit 6 të Shtojcës 5, praktikën e mirë të sektorit ekonomik, me këtë Marrëveshje ose me Standardet. Nëse Inxhinieri i pavarur nuk e refuzon shprehimisht programin deri në datën e mësipërme, një program i tillë konsiderohet se nuk është kundërshtuar nga Inxhinieri i pavarur.

- 19.2.3 Koncesionari merr parasysh çdo koment të Inxhinierit të pavarur dhe e ndryshon programin përkatësisht. Koncesionari e dërgon menjëherë programin e ndryshuar për miratim, në përputhje me Klauzolën 19.2.2, me kusht që periudha kohore e Klauzolës 19.2.2 të ndryshohet në 10 (dhjetë) ditë pune për qëllimet e ridërgimit.

- 19.2.4 Nëse në çdo kohë Autoriteti Kontraktor i dërgon njoftim Koncesionarit se Programi nuk i përmbush kërkesat e Autoritetit Kontraktor, ose se nuk përputhet me përparimin e bërë, Koncesionari i ridërgon një program të rishikuar Autoritetit Kontraktor në përputhje me Klauzolën 19.2, por gjithsesi, Koncesionari nuk lejohet të ndryshojë afatin përfundimtar të Aspektit përkatës, ose afatin përfundimtar të Çertifikatës së Përfundimit në programin e shqyrtuar.

19.3 Periudha e ndërtimit

Përveç të drejtave të tjera që i jepen Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Marrëveshjeje, gjatë ecurisë së periudhave të ndërtimit, Autoriteti Kontraktor ka te drejtë:

- 19.3.1 Të marrë një listë të të gjitha rezultateve të testeve (për disa nga të cilat ai mund ta njoftojë Koncesionarin se dëshiron t'i marrë vetë rezultatet e testeve), dhe çdo raport për përparimin e punës dhe për bashkëpunimin ndërmjet Nënkontraktorët të ndërtimit dhe Inxhinierit të pavarur në lidhje me skicat e projektimit dhe njoftime për forca madhore, ose mospërmbushje të punimeve, të shkëmbyera ndërmjet Koncesionarit dhe/ose Nënkontraktorët e Ndërtimit;
- 19.3.2 Kur Autoriteti Kontraktor e kërkon, të marrë korrespondencën, faturat, vërtetimet, projektimet, rezultatet e testeve, njoftimet dhe çdo komunikim tjetër zyrtar që lidhet me këtë Marrëveshje, të shkëmbyer ndërmjet Koncesionarit, Inxhinierit të pavarur, dhe Nënkontraktorët të ndërtimit, të cilat i nevojiten me qëllim monitorimin e respektimit të kësaj Marrëveshjeje nga Koncesionari;

- 19.3.3 Të hyjë e të dalë në Territorin e Projektit dhe në Truallin ekstra me qëllim vëzhgimin e gjendjes dhe ecurinë e Punimeve dhe ndjekjen e realizimit të ndonjë faze dhe testi të Punimeve;
- 19.3.4 Të marrë pjesë si vëzhgues në takimet rreth ecurisë së punës, që mbahen ndërmjet Koncesionarit dhe/ose Nënkontraktorët të ndërtimit; dhe
- 19.3.5 Të marrë pjesë në inspektimet e zhvilluara përpara dhënies së një Çertifikate Përfundimi paraprake, ose Çertifikate Përfundimi.

20. Përfundimi paraprak dhe përfundimi

20.1 Përfundimi Paraprak

“Përfundimi paraprak” nënkupton në lidhje me çdo Aspekt se:

- 20.1.1 Aspekti është në përputhje me kërkesat e trafikut, sigurisë dhe mjedisit për shfrytëzimin të sigurt;
- 20.1.2 Çertifikata e Përfundimit paraprak, nëse është e aplikueshme, është dhënë nga Autoritetet përkatës për aspektin duke pasur parasysh se disa punime, që lidhen me objektet që nuk kërkohen për shfrytëzimin e sigurt të Autostradës, nuk janë përfunduar ende ose, se pritet t’i nënshtrohen testimit; dhe
- 20.1.3 Autoriteti Kontraktor ka dhënë pëlqimin e tij në lidhje me Manualin e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes për aspektin në fjalë, sipas Klauzolës 21.6.

20.2 Dorëzimi Teknik i Përfundimit Paraprak



- 20.2.1 Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune përpara datës që Koncesionari pret të përfundojë puna në lidhje me një aspekt të Autostradës, me qëllim që të arrijë përfundimin paraprak, Koncesionari përcakton me shkrim një procedurë të dorëzimit teknik dhe njëkohësisht i jep Inxhinierit të pavarur dokumentacionin kualifikues dhe në lidhje me skicat e projektimit, draftin e përditësuar të skicave me ndryshimet e bëra gjatë ndërtimit, duke vënë në dukje statusin e caktuar të punimeve në atë kohë, për qëllime inspektimi. Procedura zyrtare organizohet nga Koncesionari dhe kryhet nga Inxhinieri i pavarur, dhe në të merr pjesë Autoriteti Kontraktor, Përfaqësues teknik, Koncesionari, Nënkontraktori i ndërtimit dhe çdo Autoritet i duhur përkatës i cili ftohet ose prania e të cilit kërkohet me ligj. Koncesionari përfshin bashkë me njoftimin me shkrim të sipërpërmendur edhe çertifikatën e Inxhinierit të pavarur, ku konfirmohet se Punimet që kërkohen për shfrytëzimin e sigurt të Autostradës kanë përfunduar.
- 20.2.2 Pas përfundimit të procedurës së dorëzimit teknik, Inxhinieri i pavarur dhe Autoriteti Kontraktor kanë 10 (dhjetë) ditë pune për vlerësimin e procedurës së dorëzimit teknik dhe për të vendosur nëse Koncesionari i ka përmbushur të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktor për Punimet, ose për të njoftuar Koncesionarin për ndonjë kundërshtim që mund të kenë.

- 20.2.3 Nëse ngrihet ndonjë kundërshtim nga Inxhinieri i pavarur, ose Autoriteti Kontraktor, Koncesionari dhe Inxhinieri i pavarur konsultohen për masat që kërkohen për t'u ndërmarrë për të përmbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktor për Punimet, me qëllim realizimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 20.2.4 Koncesionari realizon masat e përcaktuara në përputhje me Klauzolën 20.2.3 dhe të rekomanduara nga Inxhinieri i pavarur. Koncesionari pastaj mund ta rifillojë procedurën e dorëzimit teknik në përputhje me Klauzolën 20.2.1, me kusht që nëse procedura teknike është rifilluar në përputhje me këtë dispozitë, periudha 15 (pesëmbëdhjetë) ditore sipas Klauzolës 20.2.1 dhe periudha 10 (dhjetë) ditore sipas Klauzolës 20.2.2 të konsiderohen se janë 5 (pesë)ditë pune.
- 20.2.5 Nëse Autoriteti Kontraktor ose Inxhinieri i pavarur nuk paraqesin ndonjë kundërshtim pas procedurave të dorëzimit teknik, të përmendura në Klauzolën 20.2.1 dhe 20.2.4, ose nëse Inxhinieri i pavarur vendos, sipas Klauzolës 20.2.3, se nuk kërkohet të merren masa të tjera për Përfundimin paraprak (përveç çështjes së lëshimit të çertifikatës së përfundimit paraprake), Koncesionari mund të kërkojë nga Autoriteti përkatës dhënien e çertifikatës së përfundimit paraprak.

20.3 Dhënia e Çertifikatës së përfundimit paraprake

- 20.3.1 Koncesionari do të aplikoje për çdo Çertifikatë Përfundimi Paraprake dhe Autoriteti Kontraktor në mënyrë të arsyeshme do të ofrojë ndihmën e nevojshme të kërkuar nga Koncesionari për aplikimin e Çertifikatave.
- 20.3.2 Koncesionari e njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor për datën e çdo inspektim të autoritetit përkatës të parashikuar për t'u bërë përpara dhënies së një lejeje përfundimi paraprake. Autoriteti Kontraktor mund të lejojë çdo inspektim që kërkohet të kryhet nga çdo Autoritet i duhur përkatës, për të vendosur nëse mund të jepet Çertifikata e përfundimit paraprake.
- 20.3.3 Koncesionari e njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor për datën e dhënies së një Çertifikate përfundimi paraprake nga Autoriteti i duhur përkatës.
- 20.4 Asgjë që përmbajnë Klauzolat 20.1, 20.2 ose 20.3, ose që gjendet gjatë në këtë Marrëveshje në lidhje me Përfundimin paraprak, nuk i pakëson apo kufizon në ndonjë mënyrë detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje. Koncesionari e arrin përfundimin paraprak të një aspekti përkatës kur ka marrë një leje të vlefshme për përfundimin paraprak të të gjitha aspekteve në lidhje me atë Aspekt përkatës.
- 20.5 Nëse Inxhinieri i pavarur dhe Autoriteti Kontraktor nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim sipas Klauzolës 20.2.2, ose nëse Inxhinieri i pavarur përcakton, sipas Klauzolës 20.2.3, se nuk kërkohen masa të tjera për arritjen e përfundimit paraprak dhe Autoriteti i duhur përkatës nuk e jep lejen e përfundimit paraprake brenda periudhës së përcaktuar në ligj, me kusht që:
- 20.5.1 Koncesionari t'i ketë përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitat përkatëse të ligjit për të bërë kërkesë për një leje të tillë përfundimi paraprake; dhe



- 20.5.2 Gjatë ndonjë inspektimi zyrtar nga një Autoritet i tillë përkatës përpara kërkesës për lejen e përfundimit paraprak, Autoriteti i duhur përkatës të mos ketë ngritur ndonjë kundërshtim në përputhje me ligjin që parashikon mospërbushjen e detyrimeve apo të kushteve të nevojshme për dhënien e lejes së përfundimit paraprake,

Atëherë kjo quhet Ngjarje kompensimi.

20.6 Përfundimi

Përfundimi përfundimtar në lidhje me çdo aspekt përkatës nënkupton se:

20.6.1 Aspekti ka përfunduar; dhe

20.6.2 Leja efektive e përfundimit është dhënë nga Autoriteti i duhur përkatës.

20.7 Dorëzimi teknik pas Përfundimit

20.7.1 Jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës kur Koncesionari pret që të përfundojnë punimet në mënyrë të tillë që të arrihet Përfundimi final, Koncesionari përcakton me shkrim procedurën e dorëzimit teknik dhe i paraqet menjëherë Inxhinierit të pavarur dokumentacionin kualifikues dhe shtesat në skicat e përditësuara të projektimit me ndryshimet përkatëse të bëra gjatë ndërtimit, për qëllime inspektimi. Kjo procedurë zyrtare organizohet nga Koncesionari dhe kryhet nga Inxhinieri i pavarur, dhe ndiqet nga Autoriteti Kontraktor, Koncesionari, Nënkontraktor i ndërtimit dhe çdo Autoritet i duhur përkatës, i cili ftohet ose prania e të cilit kërkohet me ligj. Koncesionari i bashkëngjit njoftimit me shkrim të përmendur me lart certifikatën e Inxhinieri të pavarur, e cila konfirmon se Punimet janë përfunduar dhe se kushtet e përcaktuara në Çertifikatën e përfundimit paraprak janë përmbushur plotësisht.

20.7.2 Pas përfundimit të procedurës së dorëzimit teknik, Inxhinieri i pavarur dhe Autoriteti kontraktor kanë 10 (dhjetë) ditë pune për vlerësimin e rezultatit të procedurës së dorëzimit teknik dhe për të përcaktuar nëse Koncesionari i ka përmbushur vërejtjet e tyre.

20.7.3 Nëse ngrihet ndonjë kundërshtim nga Inxhinieri i pavarur, ose Autoriteti Kontraktor, Koncesionari dhe Inxhinieri i pavarur konsultohen për masat që kërkohet të ndërmerren për të arritur përfundimin përfundimtar, me qëllim realizimin e Marrëveshjes.

20.7.4 Koncesionari zbaton masat e përcaktuara në përputhje me Klauzolën 20.7.3 dhe të rekomanduara nga Inxhinieri i pavarur. Koncesionari atëherë mund ta rifillojë procedurën e dorëzimit teknik në përputhje me Klauzolën 20.7.1, me kusht që nëse procedura e dorëzimit teknik rifillohet në përputhje me këtë dispozitë, periudha 15 ditore sipas Klauzolës 20.7.1 dhe periudha 10 (dhjetë) ditore sipas Klauzolës 20.7.2 të konsiderohen kështu si 5 (pesë) ditë pune.

20.7.5 Nëse nuk paraqitet ndonjë kundërshtim nga Autoriteti Kontraktor ose Inxhinieri i pavarur pas procedurave të dorëzimit teknik të përmendura në Klauzolat 20.7.1 dhe 20.7.4, ose nëse Inxhinieri i pavarur përcakton sipas Klauzolës 20.7.3 se nuk



kërkohen më masa shitesë për arritjen e përfundimit përfundimtar (përveç dhënies së Lejes së përfundimit), Koncesionari mund të kërkojë nga Autoriteti i duhur përkatës nxjerrjen e Çertifikatës së Përfundimit.

20.8 Nxjerrja e Çertifikatave të përfundimit

- 20.8.1 Koncesionari bën kërkesë për çdo Çertifikatë përfundimi dhe Autoriteti Kontraktor në mënyrë të arsyeshme do të japë ndihmën e nevojshme të kërkuar nga Koncesionari për aplikimin e Çertifikatave.
- 20.8.2 Koncesionari e njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor për datën e inspektimit të Territorit të Projektit nga Autoriteti përkatës, njoftim i cili duhet të bëhet përpara dhënies së një leje përfundimi. Autoriteti Kontraktor mund të marrë pjesë në çdo inspektim, i cili kryhet nga çdo Autoritet i duhur përkatës, për të përcaktuar nëse mund të jepet një Çertifikatë përfundimi.
- 20.8.3 Koncesionari njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor në datën e dhënies së lejes së përfundimit nga Autoriteti i duhur përkatës dhe i jep Autoritetit Kontraktor skicat përfundimtare me ndryshimet përkatëse të bëra gjatë punës.


20.9 Nëse Inxhinieri i pavarur dhe Autoriteti Kontraktor nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim sipas Klauzolës 20.7.2, ose Inxhinieri i pavarur vendos, sipas Klauzolës 20.7.3, se nuk kërkohet të merren masa të tjera për arritjen e Përfundimit Përfundimtar dhe Autoriteti i duhur përkatës nuk e jep miratimin për Çertifikatën e Përfundimit brenda periudhës përkatëse, të parashikuar me ligj, me kusht që:

- 20.9.1 Koncesionari të ketë përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitave përkatëse të ligjit kur ka bërë kërkesë për një Çertifikatën të tillë të Përfundimit; dhe
- 20.9.2 Gjatë inspektimit zyrtar nga një Autoritet i tillë përkatës përpara kërkesës për leje shfrytëzimi, Autoriteti përkatës nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim për nxjerrjen e lejes së shfrytëzimit, në përputhje me ligjin që parashikon mos-përmbushjen e detyrimeve ose të kushteve të nevojshme për lëshimin e Çertifikatës së Përfundimit,

atëherë kjo përbën ngjarje kompensimi.

20.10 Përgjegjësia për defektet

- 20.10.1 Pa cenuar asnjë të drejtë tjetër të Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të riparojë çdo defekt në Punime me shpenzimet e veta, në përputhje me këtë Marrëveshje, gjatë periudhës përkatëse të përgjegjësisë së tij për defektet.
- 20.10.2 Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor menjëherë, por gjithsesi, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga marrja dijeni për ndonjë defekt, dhe sapo të jetë praktikisht e mundur pas kësaj, duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor çdo informacion të mëtejshëm për defektin që Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.
- 20.10.3 Koncesionari në çdo kohë:



- (a) Kryen punët dhe shërbimet me qëllim që të mos përkeqësojë një defekt të njohur;
- (b) Sapo merr dijëni për një defekt, bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të zbutur pasojën e atij defekti; dhe
- (c) Ndërmerr të gjitha hapat për të minimizuar pasojat e çdo defekti të ditur.

20.10.4 Koncesionari është përgjegjës dhe kryen sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur çdo rindërtim, riparim, rehabilitim ose punime të tjera që kërkohen si rrjedhojë e një defekti.

20.10.5 Me përfundimin e një punimi, në përputhje me Klauzolën 20.10.3, Inxhinieri i pavarur vërteton se këto punime janë kryer në përputhje me standardet. Në shkallën që punime të tilla nuk janë përfunduar në përputhje me standardet, Koncesionarit i kërkohet të kryejë punime të tjera derisa të plotësohen standardet.

20A Defektet e fshehta

20A.1 Gjatë periudhës së përgjegjësisë për defektet e fshehta, nëse Koncesionari beson se në atë kohë ka dalë në pah një defekt i fshehtë, me kërkesën e Autoritetit Kontraktor, Koncesionari rregullon defektin e fshehtë (me anë të riparimit ose zëvendësimit, sipas zgjedhjes së Koncesionarit), dhe kostoja e një riparimi apo zëvendësimi të tillë përballohet nga Autoriteti Kontraktor. Në rastet kur Autoriteti Kontraktor nuk i kërkon Koncesionarit të kryejë punimet riparuese për një Defekt të Fshehtë në përputhje me këtë klauzolë, ai do t'i konfirmojë Koncesionarit brenda një periudhë të arsyeshme se si synon të rregullojë Defektin e Fshehtë dhe do të jetë përgjegjës për tu siguruar që këto veprime që kryhen për rregullimin e defektit të përfundojnë.

20A.2 Koncesionari në çdo kohë:

20A.2.1 Kryen punimet dhe shërbimet për të mos e përkeqësuar një defekt të fshehtë; dhe;

20A.2.2 Sapo merr dijëni për një defekt të fshehtë, bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të zbutur pasojën e atij defekti të fshehtë; dhe

20A.2.3 Ndërmerr të gjitha hapat për të minimizuar pasojat e çdo defekti të fshehtë të njohur.

20A.3 Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur menjëherë, por gjithsesi brenda (2) ditësh pune nga marrja dijëni për një defekt të fshehtë, dhe pas kësaj i jep çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me defektin e fshehtë, sipas kërkesës së arsyeshme të Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur. Inxhinieri i Pavarur do të konfirmojë në bazë të këtij informacioni dhe brenda një periudhe të arsyeshme sipas rrethanave të dhëna nëse ky Defekt i Fshehtë ka ndodhur apo jo.

20A.4 Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune pasi merr dijëni për një defekt të fshehtë, Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur një propozim për punime riparuese për ndreqjen e defektit.

20A.5 Jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune pas marrjes së propozimit të Koncesionarit sipas Klauzolës 20A.4, Autoriteti Kontraktor ose e miraton atë me shkrim, ose sugjeron ndryshimet ~~perkatëse~~

në propozimin e Koncesionarit (për zbatimin e këtyre ndryshimeve, Autoriteti Kontraktor jep miratimin e tij për propozimin).

- 20A.6 Nëse Autoriteti Kontraktor sugjeron ndryshime në propozimin e Koncesionarit, Koncesionari brenda 2 (dy) ditësh pune nga marrja e ndryshimeve të sugjeruara ose i pranon këto ndryshime, ose ia kalon propozimin Inxhinierit të pavarur, i cili menjëherë jep një vendim përfundimtar për propozimin.
- 20A.7 Vendimi i Inxhinierit të pavarur sipas Klauzolës 20A.6 është detyrues për palët, përveç kur njëra nga palët e kundërshton atë, në përputhje me Klauzolën 56, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga marrja e vendimit të Inxhinierit të pavarur.
- 20A.8 Inxhinieri i pavarur përcakton koston e kryerjes së punimeve të tilla për riparimin e defektit të fshehtë, në përputhje me propozimin e Koncesionarit në lidhje me çmimet mbizotëruese të referencës për njësi për punë të ngjashme në Shqipëri, të evidentuara nga Manualet. Për të shmangur çdo dyshim, kur Inxhinieri i pavarur vendos se kostoja e punëve është më pak se dyqind mijë euro (200.000 euro) kur mblidhet me koston e të gjitha punimeve të tjera riparuese të fshehura, atëherë defekti nuk kualifikohet si defekt i fshehtë dhe këto kosto përballohen nga Koncesionari.
- 20A.9 Vendimi i Inxhinierit të pavarur, sipas Klauzolës 20A.8, është detyrues për palët, përveç kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga marrja dijani për vendimin e Inxhinierit të pavarur.

Pjesa 4: Ofrimi i Shërbimeve

21. Shfrytëzimi

21.1 Përgatitja e planit të menaxhimit të Projektit

- 21.1.1 Jo më vonë se 40 (dyzet) ditë pune përpara fillimit të çdo viti të kontratës (përveç vitit të parë të Kontratës) gjatë periudhës së Koncesionit, sipas Seksionit 3.2.1 të Shtojcës 5, Koncesionari përgatit dhe i paraqet Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet e kërkuara në lidhje me menaxhimin dhe shfrytëzimin e Autostradës dhe shërbimin që u ofrohet përdoruesve ("Plani i menaxhimit të Projektit").
- 21.1.2 Brenda 20 (njëzet) ditësh pune pas marrjes nga Autoriteti Kontraktor të Planit të Koncesionarit për menaxhimin e Projektit sipas Klauzolës 21.1.1, Palët takohen për të diskutuar planin e propozuar nga Koncesionari për menaxhimin e Projektit. Koncesionari merr parasysh me mirëbesim çdo parashtrim të bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me planin e menaxhimit të propozuar nga Koncesionari. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune pas takimit, Koncesionari i dërgon një njoftim tjetër Autoritetit Kontraktor, ku këto ndryshime i paraqit me mirëbesim në planin e propozuar nga Koncesionari për menaxhimin e Projektit, sipas rastit, për t'i vënë në jetë këto ndryshime ose, nëse nuk kërkohen ndryshime të tilla, konfirmon planin e propozuar nga Koncesionari për menaxhimin e Projektit, ashtu si është paraqitur fillimisht.
- 21.1.3 Jo më vonë se 80 (tetëdhjetë) ditë pune përpara fillimit të çdo viti kontrate, gjatë periudhës së Koncesionit (përveç vitit të parë të periudhës së Koncesionit), Autoriteti

Kontraktor mund t'i japë Koncesionarit një listë me dokumentet që përmbajnë objektivat aktuale të publikuara të Autoritetit Kontraktor në lidhje me shfrytëzimin e Autostradës. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk i jep një listë të tillë, Koncesionari kur vendos synimet e tij, merr parasysh objektivat e publikuara të Autoritetit Kontraktor sikundër ato janë paraqitur në dokumentet, në listat më të fundit që i janë dhëne atij nga Autoriteti Kontraktor. Nëse ndonjë prej këtyre objektivave bie ndesh me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, kushtet e kësaj Marrëveshjeje kanë epërsi, përveç se kur Autoriteti Kontraktor e udhëzon Koncesionarin ta trajtojë atë si një ndryshim të bërë nga Autoriteti Kontraktor, rast në të cilin një ndryshim i tillë trajtohet në përputhje me Klauzolën 32.1. Nëse ndonjë prej objektivave të publikuara kërkon nga Koncesionari të ndryshojë metodat e punës së tij, të parashikuara në planet e zbatimit të punimeve, për kryerjen e ndonjë punimi shtesë, ose për ofrimin e ndonjë shërbimi tjetër që nuk kërkohet në kërkesat e Autoritetit Kontraktor, Koncesionari nuk është i detyruar të respektojë objektiva të tilla të publikuara, përveç se kur udhëzohet ta bëjë këtë si një ndryshim i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

- 21.1.4 Procedurat e menaxhimit të paraqitura me hollësi në dokumentet që përbëjnë Planet Gjeoteknike, sipas përkufizimit në Shtojcën 1 (Përkufizime) të kësaj Marrëveshjeje, në çdo kohë respektojnë kërkesat mjedisore dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

21.2 Periudha e shfrytëzimit

21.2.1 Periudha e shfrytëzimit fillon në:

- (a) Datën efektive në lidhje me Autostradën ekzistuese;
- (b) Datën e përfundimit të punimeve për sheshet e pagimit të taksës, për sa u takon pjesëve të Autostradës që janë pjesë e punimeve për sheshet e taksës;
- (c) Datën e përfundimit të punimeve nga çfarëdo palëe tretë në lidhje me pjesët e Autostradës që janë pjesë e punimeve të të tretëve, të cilat nuk janë përfunduar përpara Datës së hyrjes në fuqi;
- (d) Datën e përfundimit të Aspektit përkatës në lidhje me secilin aspekt;

Pavarësisht se në lidhje me secilën pjesë të Autostrada, periudha e shfrytëzimit nuk fillon përpara se të jetë rënë dakord për procedurat e bashkërendimit me të gjitha autoritetet përkatëse në përputhje me Klauzolën 21.3 dhe Manualin e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Klauzolën 21.5.

(“Periudha e shfrytëzimit”)

- 21.2.2 Koncesionari do të ofrojë shërbimet si dhe ndryshe shfrytëzon dhe mirëmban Autostradën gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit në përputhje me Shtojcën 5, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe procedurat e bashkërendimit.
- 21.2.3 Në ofrimin e shërbimeve dhe, ndryshe, në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës, Koncesionari në të gjitha kohët bën të gjitha përpjekjet e nevojshme për të siguruar që të mos veprojnë në ndonjë mënyrë që të ndikojë negativisht në punimet e të tretëve (pa asnië kosto shtesë nër votën).

21.2.4 Për të shmangur çdo dyshim, Koncesionarit do t'i kërkohet të mobilizohet me qëllim që të jetë gati të fillojë ofrimin e plotë të shërbimeve në lidhje me Autostradën menjëherë në datën e hyrjes në fuqi.

21.3 Procedurat e bashkërendimit

Në çdo datë të programuar të përfundimit paraprak të secilit Aspekt përkatës dhe në datën efektive në lidhje me Autostradën ekzistuese, Koncesionari duhet t'i ketë mbaruar diskutimet me të gjitha autoritetet përkatëse që kanë të bëjnë me Autostradën, ose që preken nga shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e Autostradës dhe duhet ketë përgatitur dhe rënë dakord për procedurat e bashkërendimit në lidhje me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës ndërmjet Autoritetit përkatës (duke përfshirë policinë, shërbimet e zjarrfikësve dhe të ambulancës) dhe Koncesionarit (së bashku "Procedurat e bashkërendimit").

21.4 Procedurat e bashkërendimit ndër të tjera:

21.4.1 Parashikojnë takime periodike ndërmjet palëve përkatëse për të diskutuar çështjet që prekin objektin e Procedurave përkatëse të bashkërendimit;

21.4.2 Përcaktojnë, sipas rastit, procedurat e rëna dakord për menaxhimin e trafikut (duke përfshirë kufizimet e shpejtësisë); trajtimin e çdo rasti të jashtëzakonshëm, duke përfshirë procedurën e qasjes (aksesit) dhe rrugët për shërbimet e urgjencës (policia, zjarrfikëset, dhe shërbimet e ambulancës, shoqëritë e furnizimit me ujë dhe energji elektrike dhe çdo shoqëri tjetër përkatëse e telekomunikacionit); dhe ruajtjen e funksionimit të sigurt të Autostradës dhe sigurinë e përdoruesve, punëmarrësve të Koncesionarit dhe vizitorëve të lejuar në Autostradë;

21.4.3 Përfshijnë procedurën e komunikimit ndërmjet palëve dhe caktojnë një përfaqësues në emër të Koncesionarit për bashkërendimin e punës me Autoritetet përkatëse; dhe

21.4.4 Përcaktojnë procedurat e rëna dakord për ndryshimin e Procedurave të bashkërendimit herë pas here.

21.5 Manuali i Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes

21.5.1 Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor të gjitha manualët e plota të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes (siç është rënë dakord me Autoritetin Kontraktor) në lidhje me Autostradën ekzistuese në datën e hyrjes në fuqi.

21.5.2 Të paktën 3 (tre) muaj përpara datës së programuar të përfundimit paraprak të çdo Aspekti përkatës, Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor manualët e përditësuar të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, duke marrë parasysh përfundimin e Aspektit përkatës.

21.5.3 Procedurat e përshkruara në manualët e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes janë në përputhje me:

(a) Kërkesat e Autoritetit Kontraktor për shërbimet dhe propozimet e Koncesionarit për shërbimet;

(b) Seksionin 3 të

- (c) Sistemet e cilësisë.

21.6 Miratimi i Manualeve të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes

21.6.1 Brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e Manualeve të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes në lidhje me secilin Aspekt përkatës, Autoriteti Kontraktor njofton Koncesionarin se është dakord me Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, ose i dërgon Koncesionarit amendamentet dhe/ose komentet e tij për Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes. Nëqoftëse Autoriteti Kontraktor nuk e dërgon njoftimin deri në afatet e mësipërme, Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes do të konsiderohen se janë pranuar nga Autoriteti Kontraktor.

21.6.2 Nëse Autoriteti Kontraktor ngre ndonjë kundërshtim për të gjitha apo për ndonjë pjesë të Manualeve të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes brenda 20 (njëzet) ditësh pune pas marrjes nga Koncesionari të njoftimit për to, Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari nisin negociatat, me qëllim që të diskutojnë amendamentet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose komentet për Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes.

21.6.3 Nëse:

- (a) Koncesionari bie dakord me komentet ose amendamentet e Autoritetit Kontraktor për Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes; ose
- (b) Palët vendosin për amendamente apo komente të tilla, në përputhje me Klauzolën 21.6.2,

Koncesionari nxjerr një version të rishikuar të Manualeve të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, i cili i përfshin këto amendamente dhe/ose komente sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por gjithsesi përpara datës së përfundimit të Aspektit përkatës.

21.6.4 Në rastin që palët nuk bien dakord për amendamentet përkatëse në Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, Inxhinieri i pavarur vendos për amendamentet përkatëse që do t'u bëhen atyre. Vendimi i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveç se kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e vendimit të Inxhinierit të pavarur.

21.7 Amendamentet në Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes

21.7.1 Përveç se në përputhje me Klauzolën 21.6, ose në lidhje me amendamentet, njoftimet apo variacionet e vogla apo të zakonshme, Koncesionari nuk amendon, modifikon apo ndryshon asnjërin nga Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes pa pëlqimin e Autoritetit Kontraktor.

21.7.2 Koncesionari mundet që në çdo kohë t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor për pëlqimin e tij një amendament, modifikim apo ndryshim në Manualet e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, së bashku me arsyet për një rishikim të tillë. Autoriteti Kontraktor jep pëlqimin e tij apo bën komente për një amendament, modifikim apo rishikim të tillë, në përputhje me procedurat e parashikuara në Klauzolën 21.6.



21.7.3 Në varësi të Klauzolës 21.7.1 dhe 21.7.2, Koncesionari siguron që Manualët e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes të përditësohen rregullisht herë pas here.

21.8 Detyrimet e Koncesionarit

21.8.1 Koncesionari ndërmerr (dhe angazhohet që çdo Nënkontraktor i operacioneve dhe punëmarrësit e tij të ndërmarrin) të gjitha veprimet e nevojshme për të shfrytëzuar dhe mirëmbajtur Autostradën në atë mënyrë që të sigurojë:

- (a) Shfrytëzimin e pandërprerë dhe të sigurt të Autostradës në bazë 24-orëshe;
- (b) Respektimin e Manualeve të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes;
- (c) Që në të gjitha kohët, të mbahet një inventar i kompjuterizuar i të gjithë artikujve që përbëjnë Autostradën dhe që sistemet e monitorimit dhe menaxhimit të mbahen në përputhje me Seksionin 4.2 të Shtojcës 5; dhe
- (d) që Autoritetet përkatëse të mund të kryejnë detyrat e tyre;

me kusht dhe në përputhje me kërkesat për shërbime të Autoritetit Kontraktor, standardet, propozimet për shërbime të Koncesionarit dhe praktikën e mirë të sektorit ekonomik dhe standartet sic përcaktohen nga Projektuesi.

21.8.2 Koncesionari:

- (a) Merr të gjitha masat për të siguruar, në bashkëpunim me Autoritetin përkatës, fluksin e sigurt, të qetë dhe të pandërprerë të trafikut dhe për t'i mbajtur në minimum vonesat e trafikut;
- (b) Kundërvepron sa më shpejt që të jetë e mundur ndaj aksidenteve, emergjencave apo incidenteve të tjerë;
- (c) Minimizon efektet negative të çdo aksidenti, rasti të jashtëzakonshëm apo të incidenteve të tjera; dhe
- (d) Kundërvepron menjëherë dhe me efikasitet në rast të ndonjë incidenti apo rasti të jashtëzakonshëm, që bën të nevojshme evakuimin e çdo korsie të prekur të Autostradës,

në çdo rast, në përputhje dhe në masën e parashikuar në Manualët e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, Procedurat e bashkërendimit dhe në këtë Marrëveshjeje.

21.8.3 Koncesionari, përveç në rastin e një rasti të jashtëzakonshëm apo të një ndodhie të paparashikuar, u jep përdoruesve paralajmërimet e duhura për çdo ndodhi që ndikon në përdorimin nga ana e tyre të Autostradës.

21.8.4 Koncesionari në çdo kohë vepron në përputhje me Manualët e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes dhe shfrytëzon dhe mirëmban Autostradën dhe çdo pjesë të saj, me qëllim që të përmbushë detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje.



- 21.8.5 Pa cenuar Klauzolën 21.8.3, kur një punim për mirëmbajtje, riparim apo punime të tjera bën të nevojshme ndërprerjen apo pezullimin e përdorimit të të gjitha pjesëve të Autostradës, apo mbylljen e Autostradës për një periudhë kohe, Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktor, Autoritetit përkatës, çdo Pale të interesuar dhe të gjithë përdoruesve të prekur, me anë të mjeteve të disponueshme në përputhje me praktikën e mirë të sektorit ekonomik, njoftim paraprak për një gjë të tillë, përveç në një rast emergjence ose të një çrregullimi të vogël në Autostradë. Në rastin e një urgjence, apo të një çrregullimi të vogël në Autostradë, nuk kërkohet ndonjë njoftim paraprak, megjithatë, sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi, jo më vonë se data e inspektimit tjetër javor, Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktor dhe çdo Autoriteti të duhur përkatës procesverbalet e ngjarjes në fjalë.
- 21.8.6 Koncesionari bën në çdo kohë përpjekjet e tij të arsyeshme për të minimizuar shqetësimet që i shkaktohen trafikut në Autostradë.
- 21.8.7 Koncesionari e mat fluksin e trafikut dhe mban dokumente për të dhënat që lidhen me fluksin e trafikut (duke përfshirë numërimin e fluksit të trafikut) në bazë të vazhdueshme në përputhje me Seksionin 3.2.4 të Shtojcës 5. Të gjitha të dhënat e regjistruara në lidhje me fluksin e trafikut mbahen të disponueshme për inspektim nga ana e Autoritetit Kontraktor në çdo kohë. Të dhënat e regjistruara nga matja me sensorë elektronike të vendosur nën shtresën e rrugës i dërgohen Autoritetit Kontraktor në format elektronike, si pjesë e raporteve mujore dhe përfaqësojnë trafikun e regjistruar.
- 21.8.8 Autoriteti Kontraktor mundet që herë pas here të inspektojë, monitorojë, ose kontrollojë pajisje të tilla që regjistrojnë të dhënat e trafikut. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë, ose ka të drejtë të caktojë një palë të tretë, për të instaluar, me shpenzimet e Autoritetit Kontraktor, sistemin e regjistrimit të të dhënave, pajisjet, objektet dhe instrumentet dhe/ose sistemet e veta elektronike të pagimit të taksës, pajisjet dhe objektet e veta, dhe Koncesionari bën të mundur instalimin e këtyre në vende të përshtatshme. Përveç instalimit, heqjes, ose mirëmbajtjes nga Autoriteti Kontraktor ose një palë e tretë, e caktuar nga Autoriteti Kontraktor, objekte të tilla për regjistrimin e të dhënave dhe/ose objekte dhe instrumente të tilla të pagimit të taksës, nuk duhet të shkaktojnë ndërprerjen e ndërtimit, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe fluksit të qetë të trafikut në Autostradë, ndryshe, kjo ndërprerje do të konsiderohet si Ngjarje Lehtësimi.
- 21.8.9 Koncesionari, brenda 24 (njëzet e katër) orësh nga ndodhia e një incidenti që përfshin një vdekje, një lëndim serioz, ose e një incidenti mjedisor, i jep një raport për të Autoritetit përkatës, në përputhje me dispozitat e Lidhjes 6 të Shtojcës 5.
- 21.8.10 Brenda 2 (dy) ditësh pune pas përfundimit të çdo jave që bie në periudhën e shfrytëzimit, Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktor një raport javor për trafikun në përputhje me dispozitat e Lidhjes 6 të Shtojcës 5.
- 21.8.11 Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor një raport vjetor dhe një raport për ecurinë vjetore të punës, në përputhje me dispozitat e Lidhjes 6 të Shtojcës 5.



- 21.8.12 Si pjesë e Manualit të zakonshëm të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur programin e planifikuar të mirëmbajtjes rutinë në përputhje me Seksionin 3.5 të Shtojcës 5 përpara ditës së parë të periudhës me të cilën lidhet një program i tillë i mirëmbajtjes rutinë, në përputhje me Seksionin 3.5 të Shtojcës 5. Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor përpara çdo ndryshimi kur një ndryshim i tillë propozohet për t'u zbatuar në program.
- 21.8.13 Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur një program të riparimeve kapitale (që përfshin një plan trevjeçar të përditësuar të mirëmbajtjes dhe një program vjetor të riparimeve kapitale që lidhen me vitin e ardhshëm, në përputhje me Seksionin 6.3 të Shtojcës 5), jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune përpara ditës së parë me të cilën lidhet programi. Autoriteti Kontraktor mund të komentojë për Programin e riparimeve kapitale brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune pas paraqitjes së Programit të riparimeve kapitale të propozuara. Koncesionari i merr parasysh komente të tilla, me përjashtim të atyre komenteve, marrja parasysh e të cilëve do të çonte në shkeljen e kësaj Marrëveshjeje ose në shkelje të ligjit.
- 21.8.14 Në rastin që Koncesionari dëshiron të bëjë ndonjë amendament në Programin e riparimeve kapitale, Koncesionari u paraqet Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur hollësi të plota për amendamentet e propozuara, të cilat paraqesin opinionin e tij për ndikimin e amendamenteve të propozuara në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës.
- 21.8.15 Autoriteti Kontraktor mund të komentojë për amendamentet e propozuara në Programin e riparimeve kapitale brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga paraqitja e tij. Koncesionari i merr parasysh komente të tilla, përveç rasteve kur marrja parasysh e tyre do të shpinte në shkeljen e kësaj Marrëveshjeje ose në shkelje të ligjit.
- 21.8.16 Versioni i ndryshuar i rënë dakord nga Autoriteti Kontraktor (ose versioni i dërguar ku Autoriteti Kontraktor nuk bën ndonjë koment brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune) bëhet Programi i riparimeve kapitale, duke zëvendësuar versionin e mëparshëm. Për shmangien e dyshimeve, pëlqimi i Autoritetit Kontraktor për Programin e riparimeve kapitale nuk prek detyrën e Koncesionarit për të përmbytur detyrimet e tij sipas Marrëveshjeje përkatësisht dhe në kohë.
- 21.8.17 Në rastin kur ka ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit në lidhje me Programin e riparimeve kapitale, një mosmarrëveshje e tillë fillimisht do t'i dërgohet Inxhinierit të pavarur dhe Inxhinieri i pavarur përcakton amendamentet e duhura në Programin e riparimeve kapitale. Vendimi i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Inxhinierit të pavarur.
- 21.8.18 Koncesionari bën inspektime në kohët që kërkohen sipas kërkesave të shërbimit të Autoritetit Kontraktor, propozimeve për shërbime të Koncesionarit dhe/ose sipas Manualeve të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes.
- 21.8.19 Koncesionari e informon Autoritetin Kontraktor për inspektime të tilla që kryhen në përputhje me Klauzolën 21.8.18 me një njoftim paraprak prej jo më pak se 20 (njëzet)



ditësh pune dhe i jep Autoritetit Kontraktor ose një përfaqësuesi të caktuar prej Autoritetit Kontraktor mundësinë që t'i ndjekë këto inspektime. Koncesionari përgatit raporte përmbledhëse në lidhje me çdo inspektim të listuar, raporte të cilat i dorëzohen Autoritetit Kontraktor brenda 20 (njëzet) ditësh pune pas inspektimeve të tilla.

21.9 Inspektimi dhe kontrollet e Autoritetit Kontraktor

- 21.9.1 Gjatë periudhës së shfrytëzimit, Autoriteti Kontraktor mund të kryejë kontrolle në bazë të rregullt për të rishikuar çdo dokument të përgatitur ose që do të përgatitet, ose çdo të dhëne të mbajtur nga Koncesionari për aktivitetet e tij të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes (përfshirë edhe të ardhurat nga taksa e rrugës), dhe të inspektojë çdo element të Autostradës, me qëllim që të monitorojë kryerjen nga Koncesionari të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.
- 21.9.2 Autoriteti Kontraktor, me njoftimin e Koncesionarit, mund të bëjë kontrollet dhe inspektimet e mëposhtme:
- (a) Kontrolle mujore, tremujore dhe vjetore në bazë të raporteve dhe programeve të paraqitura nga Koncesionari te Autoriteti Kontraktor sipas kësaj Marrëveshjeje, ose në bazë të të dhënave dhe dokumentacionit të vetë Koncesionarit;
 - (b) Inspektime javore ose vjetore të të gjitha aspekteve të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së Autostradës dhe respektimin e kërkesës së pagimit të taksës gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit;
 - (c) Kontrolle dhe inspektime të rastësishme të të gjitha aspekteve të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së Autostradës (duke përfshirë të ardhurat nga taksa), përveç kontrolleve dhe inspektimeve të bëra pas rrethanave të cilat, për mendimin e Autoritetit Kontraktor, kërkojnë të ndërmerret një inspektim, duke përfshirë ndodhjen e një ngjarjeje që shlyen detyrimin dhe/ose të një ngjarje të një force madhore; dhe
 - (d) Inspektime për të kontrolluar punimet riparuese të kryera në lidhje me defektet, shkeljet ose mospërbushjet, inspektime të punimeve dhe të kërkesave për kthimin [e Autostradës] në përputhje me Klauzolën 36, dhe inspektimin e punimeve për rehabilitimin dhe/ose mirëmbajtjen rutinë, ose për riparimet kapitale.
- 21.9.3 Autoriteti Kontraktor i jep Koncesionarit, mundësinë për të ndjekur kontrollet dhe inspektimet në Territorin e Projektit të përmendura më lart, dhe Autoriteti Kontraktor i dërgon paraprakisht njoftim Koncesionarit për një qëllim të tillë jo më vonë se 3 orë më përpara (dhe gjithsesi, përpara orës 13:00 në rastin e njoftimit brenda ditës) gjatë orëve të punës në ditë pune, duke vënë në dukje identitetin e personit përkatës.
- 21.9.4 Shpenzimet e çdo kontrolli apo inspektimi të përmendur më lart në Klauzolën 21.9.2 përballohen nga Autoriteti Kontraktor.



- 21.9.5 Sipas Klauzolës 24.4, nëse në ndonjë kohë, Koncesionari vlerësohet me më shumë se 50 (pesëdhjetë) pikë për ecurinë e punës gjatë periudhës 1 (një) vjeçare, ose me më shumë se 100 (njëqind) pikë për ecurinë e punës në një periudhe 3 (tre) vjeçare atëherë, përveç masave të tjera riparuese që mund të përdoren sipas kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti Kontraktor ose Inxhinieri i pavarur ka të drejtë, me shpenzimet e Koncesionarit dhe pasi t'i ketë dërguar një njoftim Koncesionarit, të rrisë nivelin ose shpeshtësinë e monitorimit, kontrollit, testimit dhe inspektimit të Autostradës dhe plotësimin nga Koncesionari të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, në atë nivel që Autoriteti Kontraktor ose Inxhinieri i pavarur e shohin të arsyeshme.
- 21.9.6 Rritja e shkallës së monitorimit (përveçse kur palët bien dakord ndryshe) fillon 3 (tre) ditë pune pas marrjes nga Koncesionari të njoftimit të përmendur në Klauzolën 21.9.5 dhe vazhdon deri në atë datë kur zbritet ose (sipas rastit) numri i pikëve të ecurisë së punës në lidhje me 3 (tre) muajt paraprake të njëpasnjëshëm të kenë zbritur nën numrin e përmendur në Klauzolën 21.9.5.
- 21.9.7 Pavarësisht nga Klauzola 21.9.6, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i japë fund monitorimit të shtuar më përpara se sa data e përmendur në Klauzolën 21.9.6, kur është i bindur në mënyrë të arsyeshme se Koncesionari është i aftë të kryejë dhe se do t'i kryejë detyrimet e tij kësaj Marrëveshjeje.
- 21.9.8 Aktivitetet e monitorimit të shtuar mund të përfshijnë rritjen e shpeshtësisë së aktiviteteve monitoruese ekzistuese, shtimin e gamës së aktiviteteve monitoruese, vendosjen e personelit monitorues në Territorin e Projektit dhe/ose në automjetet e patrullimit të Nënkontraktorët të shfrytëzimit.
- 21.9.9 Në secilin rast që monitorimi i shtuar kryhet nga Autoriteti Kontraktor, Koncesionari e kompenson Autoritetin Kontraktor për të gjitha kostot e lindura nga një monitorim i tillë i shtuar, të dokumentuara përkatësisht.
- 21.10 Hyrja dhe dalja në Autostradë dhe në Territorin e Projektit gjatë periudhës së shfrytëzimit**
- 21.10.1 Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktor, dhe çdo Autoriteti përkatës mundësinë për të hyrë e dalë në Autostradë, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, ose kur kërkohet me ligj, në përputhje me kërkesat e Autoriteteve përkatëse.
- 21.10.2 Koncesionari i vë në dispozicion Autoritetit Kontraktor dhe Autoritetit përkatës hapësirë zyre dhe ambiente në Qendrën e Kontrollit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, të mevojshme për ushtrimin e përgjegjësive të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose në bazë të ligjit, në përputhje me kërkesat e Autoriteteve përkatëse.
- 21.10.3 Gjatë periudhës së shfrytëzimit, Koncesionari është përgjegjës për marrjen e të gjitha masave parandaluese për të mos lejuar persona të paautorizuar të hyjnë e të dalin në Territorin e Projektit dhe në Qendrën e Kontrollit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes.
- 21.10.4 Autoriteti Kontraktor dhe përfaqësuesi i tij kanë të drejtën të monitorojnë, duke përfshirë edhe përmes përdorimit të Territorit të Projektit, respektimin nga



Koncesionari, çdo Nënkontraktor i shfrytëzimit dhe çdo Nënkontraktor tjetër të Manualit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes.

21.11 Përgjegjësia e Koncesionarit gjatë periudhës së shfrytëzimit

21.11.1 Nëse një rezultat i ndonjë inspektimi, në përputhje me Klauzolën 21.9, tregon se ka ndonjë defekt, shkelje dhe/ose mospërmbushje, sikundër përmendet këtu, Koncesionari, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por gjithsesi brenda një periudhe e cila do t'i bëhet e ditur, ose brenda afatit kohor për të cilin është rënë dakord nga palët, i riparon defektet, shkeljet dhe mospërmbushjet në fjalë, siç kërkohen nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

21.11.2 Në rastin që Koncesionari nuk arrin të rregullojë një nga defektet, brenda kuadrit të rene dakord dhe të percaktuar, shkeljet dhe/ose mospërputhjet e tilla, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të realizojë punimet e nevojshme, ose të sigurojë realizimin e tyre, me shpenzimet e Koncesionarit. Punimet e kryera në këtë mënyrë duhet të jenë në përputhje me Standardet.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i kërkojë shpenzimet dhe kostot e bëra në mënyrë të arsyeshme, të certifikuar dhe të justifikuar, në përputhje me Klauzolën 21.11.2, sipas zgjedhjes së tij, me anë të zbritjes nga një shumë që ndryshe do t'i paguhej Koncesionarit ose, (i) për aq sa ajo shumë ekziston në kohën në fjalë, në bazë të subvencionit të Autoritetit Kontraktor, ose (ii) për aq sa subvencionit të Autoritetit Kontraktor i ka kaluar periudha e vlefshmërisë, në bazë të çdo pagese për rakordimin e deficitit të të ardhurave, (iii) për aq sa nuk ka më shuma të pagueshme për Koncesionarin në atë kohë, me anë të transfertës së të ardhurave nga taksa e rrugës të Autoritetit Kontraktues, por gjithsesi, në çdo rast, në përputhje me Klauzolën 25.10.



21.11.3 Inspektimi i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së Autostradës nga Autoriteti Kontraktor, ose nga çdo person tjetër në emër të tij, nuk i heqin Koncesionarit në asnjë mënyrë detyrimet apo përgjegjësitë e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

21.11.4 Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit në lidhje me defektet e identifikuar dhe që kërkohen të riparohen, sipas kësaj Klauzole 21.11, një mosmarrëveshjeje e tillë fillimisht i referohet Inxhinierit të pavarur dhe Inxhinieri i pavarur përcakton nëse një defekt, shkelje dhe/ose mospërputhje ka ndodhur, si dhe afatin për riparimin e tyre. Vendimi i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë, në përputhje me Klauzolën 56, brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Inxhinierit të pavarur.

21.12 Pronësia e Autostradës

Koncesionari pranon se Territori i Projektit dhe Autostrada (përveç ndonjë pajisjeje të lëvizshme të Operatorit) janë pronë ekskluzive e Autoritetit Kontraktor gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës. Pavarësisht nga kjo Klauzolë 21.12, rreziku i dëmtimit të Territorit të Projektit dhe/ose Autostradës janë përgjegjësi e Koncesionarit, në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

21.13 Autostrada ekzistuese

21.13.1 Koncesionari ofron shërbime në Autostradën ekzistuese nga data e hyrjes në fuqi, në përputhje me Shtojcën 5.

21.13.2 Koncesionari e pranon se nuk mund të mos japë pëlqimin e tij për një kërkesë të Autoritetit Kontraktor, sipas Klauzolës 32, për një ndryshim në Punime apo Shërbime, i cili do ta bënte një punim apo një pjesë të një punimi të një pale të tretë të ishte në përputhje me objektin e Projektit.

21.14 Qendra (t) e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes dhe/ose Sheshi i pagimit të taksës

21.14.1 Koncesionari zhvillon, shfrytëzon dhe mirëmban Qendrën (Qendrat) e Kontrollit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes në përputhje me propozimet e Koncesionarit dhe Shtojcën 5, në veçanti, Seksionin 1.3 të Shtojcës 5 në lidhje me pozicionimin e sheshit të taksës.

Nëse Koncesionari kërkon Truall shtesë ku të ndërtojë Qendrën (Qendrat) e Kontrollit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, atëherë, Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktor një kërkesë, me qëllim që Autoriteti Kontraktor ta sigurojë Truallin shtesë me shpenzimet e Koncesionarit, dhe me kusht që Koncesionari të mos i kërkojë Autoritetit Kontraktor të bëjë ndonjë zhvendosje të popullsisë për sigurimin e Truallit shtesë, Autoriteti Kontraktor bie dakord me një kërkesë të tillë dhe e siguron Truallin shtesë për qëllimet e Qendrës (Qendrat) së Kontrollit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes në kohë dhe sipas ligjit shqiptar për shpronësimet publike, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat. Shpenzimet e bëra nga Koncesionari sipas kësaj Klauzole 21.14.1 mund të kërkohej t'i rikthehen si një Ngjarje kompensimi.

21.14.2 Nëse, për ndonjë arsye, Autoriteti Kontraktor nuk është në gjendje ta sigurojë Truallin shtesë, i cili kërkohet sipas kërkesës së Koncesionarit, në konsultim me Koncesionarin, ai zgjedh dhe siguron truall shtesë të krahasueshëm alternativ për qëllimet e Qendrës (Qendrat) së Kontrollit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes.

21.14.3 Nëse Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari nuk janë në gjendje të bien dakord për truallin shtesë të krahasueshëm alternativ, atëherë çështja vendoset nga Inxhinieri i pavarur dhe vendimi i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveç se kur njëra nga palët e kundërshton atë, në përputhje me Klauzolën 56.

21.14.4 Qendra (qendrat) e Kontrollit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes janë pjesë e punimeve dhe shërbimeve dhe në lidhje me Qendrën (qendrat) e Kontrollit të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, Koncesionari përmbush kërkesat e Autoriteteve përkatëse dhe bashkërendohet me Autoritetet përkatëse, sipas Procedurave të bashkërendimit.

22. Siguria

22.1 Koncesionari angazhohet që palët e Koncesionarit të respektojnë ligjin që rregullon sigurinë në punë dhe që të plotësohen kërkesat në lidhje me sigurinë në punë.

22.2 Koncesionari bashkëpunon në çdo hetim të kryer nga Autoriteti Kontraktor, ose në emër të Autoritetit Kontraktor, në lidhje me shkeljen e sigurisë në punë, ose të sigurisë së veprimtarisë për kryerjen e punimeve ose shërbimeve; dhe:

22.2.1 Bën përpjekje të arsyeshme për t'i dhënë mundësi Autoritetit Kontraktor (dhe/ose çdo Autoriteti përkatës që ka të drejtë të kryejë hetime të tilla) për të marrë në pyetje stafin e Koncesionarit (ose palë të tjera të Koncesionarit) në lidhje me hetimin; dhe

22.2.2 I jep Autoritetit Kontraktor kopje të dokumenteve, të dhënave dhe materialeve të tjera të ngjashme referuese, të cilat Autoriteti Kontraktor ka arsye t'i kërkojë për qëllime të hetimit në pajtim me këtë klauzolë 22, përveç rasteve kur në bazë të ligjit materiale të tilla referuese janë konfidenciale. Autoriteti Kontraktor do të ketë të drejtë për t'i mbajtur këto materiale referuese (ose, siç mund të jetë rasti, kopjet e tyre) për përdorim të mundshëm në hetim.

23. Urgjencat

23.1 Të përgjithshme

23.1.1 Koncesionari e shfrytëzon dhe mirëmban Autostradën në raste urgjencash, në përputhje me standardet e Seksionit 3.3 të Shtojcës 5.

23.1.2 Koncesionari:

(a) Vepron në përputhje me Planin e Veprimit në raste urgjencash të Shtojcës 16 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) I paraqet Autoritetit Kontraktor në çdo datë të raportimit për rastet e urgjencave në Periudhën e Koncesionit një raport, ku jepen me hollësi aktivitetet e operacioneve të urgjencave, të ndërmarra në tremujorin paraprirës.

23.2 Shërbime shtesë dhe alternative

Nëse ndodh një urgjencë në Periudhën e shfrytëzimit, e cila nuk mund të zgjidhet me anë të ofrimit të zakonshëm të shërbimeve, Autoriteti Kontraktor mund të udhëzojë Koncesionarin që të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar ofrimin e shërbimeve të tilla shtesë ose zëvendësuese me qëllim që:

23.2.1 Të zgjidhet urgjenca; dhe

23.2.2 Të rivendoset ofrimi i zakonshëm i shërbimeve sa më shpejt që të jetë e mundur, përveç se kur urgjencë është shkaktuar nga veprimet e Koncesionarit apo të ndonjë pale të Koncesionarit,

me kusht që ofrimi i shërbimeve të tilla ose i shërbimeve zëvendësuese të mos bjerë ndesh me detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që Koncesionari të jetë në gjendje të ofrojë shërbime shtesë ose zëvendësuese.

23.3 Kostot e lidhura me urgjencën

Nëse Koncesionari ofron shërbime shtesë ose zëvendësues në përputhje me klauzolën 23.2, Autoriteti Kontraktor i paguan K

23.3.1 Kostot e tij të arsyeshme shtesë (sipas dispozitave të Klauzolës 32A); dhe

23.3.2 Humbjen e të ardhurave

që Koncesionarit i është shkaktuar si rezultat i ofrimit të shërbimeve të tilla shtesë ose zëvendësuese (përveç se kur urgjenca është shkaktuar nga një veprim ose mosveprim i Koncesionarit ose i një pale të Koncesionarit).

24. Monitorimi i ecurisë së punës

24.1 Raportet e monitorimit të ecurisë së punës

24.1.1 Koncesionari monitoron ofrimin e shërbimeve në përputhje me këtë Marrëveshjeje dhe harton një raport mujor dhe një raport vjetor për ecurinë e punës, në përputhje me Lidhjen 6 të Shtojcës 5.

24.1.2 Nëse për një muaj konkret, pagesat mujore për ecurinë e punës nuk janë regjistruar në mënyrë korrekte në raportin mujor (një "gabim"), raporti mujor modifikohet në mënyrë retroaktive.

24.1.3 Secila nga palët, Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktor njoftojnë njëri tjetrin me shkrim sapo marrin dijeni për një gabim të konstatuar në një raport mujor të caktuar. Menjëherë pas një njoftimi të tillë, palët ndërmarrin të gjitha hapat për të rënë dakord për modifikimet që duhen bërë në raportin mujor. Nëse palët nuk arrijnë një marrëveshje brenda 5 (pesë) ditësh pune nga data e njoftimit, çështja zgjidhet në përputhje me Klauzolën 56.

24.1.4 Procedura në përputhje me Klauzolat 24.1.1 deri në 24.1.3 mund të ndiqet vetëm nëse njëra nga palët jep njoftim, me anë të të cilit kundërshton përmbajtjen e raportit mujor vetëm për një muaj të caktuar, jo më vonë se deri në fundin e muajit të 7-te (shtatë) pas muajit të mbuluar nga raporti mujor në fjalë.

24.1.5 Me marrëveshje të përbashkët, palët mund të bien dakord për përditësimin / modifikimin e Monitorimit të Ecurisë së Punës dhe kriteret e Vlerësimit dhe pikat e lidhura dhe pagesat e Shtojcës 5 për periudhën e operacioneve dhe mirëmbajtjes të parashikuara në Marrëveshje.

24.2 Monitorimi nga Autoriteti Kontraktor

Në çdo kohë gjatë periudhës së shfrytëzimit, dhe me shpenzimet e veta, Autoriteti Kontraktor mund t'i bëjë kontrollin e Koncesionarit, duke përfshirë kontrollin e ofrimit të shërbimeve dhe punimeve, në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe gjatë monitorimit të një ecurie të tillë të punëve, Koncesionari i ofron Autoritetit Kontraktor çdo bashkëpunim që mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme (të tillë si ai i ofrimit të të dhënave të *helpdeskut*, sipas kërkesës, dhe për t'i dhënë mundësi Autoritetit Kontraktor të marrë pjesë në monitorimin e ecurisë së punëve). Autoriteti Kontraktor e informon Koncesionarin për rezultatet e këtyre kontrolleve.

24.3 Moskryerje të punës



Mospërbushja nga Koncesionari e ndonjë standardi të parashikuar në këtë Marrëveshjeje, ose për të cilin është rënë dakord si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje, pasqyrohet në vlerësimin mujor të ecurisë së punës në formën e pikëve për mbylljen e një korsië dhe/ose pikëve për ecurinë e punës, sikundër përcaktohet në Pjesën 7 të Shtojcës 5 të kësaj Marrëveshjeje.

24.4 Përjashtimi nga pagesat për ecurinë e punës mujore

24.4.1 Koncesionari përjashtohet nga vendosja e pagesave për ecurinë e punës mujore:

- (a) në lidhje me atë pjesë të Projektit që përbën tunelin e Thirrës, për një periudhë prej 3 (tre) muajsh nga data e hyrjes në fuqi.
- (b) Në lidhje me kërkesat e shënuara si "Kërkesa për mirëmbajtjen rutinë" në Tabelën 7-1 të Shtojcës 5 për një periudhë 6 (gjashtë) mujore nga data e hyrjes në fuqi, në varësi të konfirmimit nga Inxhinieri i Pavarur të një përjashtimi të tillë sipas çdo rasti.;
- (c) në rastet kur kërkesat e Shtojcës 5 (kërkesat e Autoritetit Kontraktor) të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të plotësohen për shkak të kushteve që janë jashtë kontrollit të tij të menjëhershëm, të shkaktuara nga hyrjet dhe daljet e paautorizuara në Autostradë, një përjashtim i tillë përdoret në lidhje me çdo pikë hyrëse e dalëse kur ajo pikë e paautorizuar hyrëse e dalëse në Autostradë (i) në lidhje me pikat hyrëse e dalëse të caktuara si kategoria 1 ose 3 në Shtojcën 9, është mbyllur nga Autoriteti Kontraktor; dhe (ii) në rastin e pikave hyrëse e dalëse të përcaktuara si kategoria 2 në Shtojcën 9, janë ose duhet të jenë mbyllur nga Koncesionari dhe në të gjitha rastet, në varësi të konfirmimit nga Inxhinieri i Pavarur i një përjashtimi të tillë rast pas rasti; dhe
- (d) në masën e shkaktuar si rezultat i drejtpërdrejtë i çdo veprimi apo mosveprimi të Kontraktorit Palë e Tretë në lidhje me punime të palës së tretë ose një palë e tretë që kryen punime të mëpasme gjeoteknike ose punime rehabilituese gjeoteknike në përputhje me Klauzolën 32A në çdo rast për kohëzgjatjen e tyre dhe siç certifikohen nga Inxhinieri i Pavarur.



Pjesa 5: Pagesa

25. Pagesa

25.1 Të ardhurat nga taksa e rrugës

Koncesionari, sipas Klauzolës 25.5.2, i mban për vete të gjitha të ardhurat nga taksa e rrugës së mbledhura në çdo vit të Kontratës.

25.2 Pagesa për rakordimin e të ardhurave

25.2.1 Autoriteti Kontraktor ofron garanci se Projekti do t'i arrijë të ardhurat e garantuara nga trafiku për secilin vit të Kontratës, sikurse parashikohet në Shtojcën 15 (Garancia e të ardhurave nga trafiku dhe pragu i ndarjes së të ardhurave nga trafiku) dhe shifra përkatëse sikurse parashikohet në Shtojcën 15 për çdo vit të Kontratës. Në fillim nga

ditës së fillimit të përdorimit të rrugës me taksë, do të rregullohet në ditën e parë të atij viti të Kontratës si më poshtë:

- (a) Të ardhurat e garantuara nga trafiku rregullohen bazuar në formulën e mëposhtme:

$$GTR_i = GTR_{\text{td}} \times I$$

Ku:

GTR_i janë të ardhurat e garantuara nga trafiku në euro në vitin i

GTR_{td} janë të ardhurat e garantuara nga trafiku në euro sikurse parashikohen për vitin përkatës të Kontratës në Shtojcën 15 (Të ardhurat e garantuara nga trafiku dhe pragu i ndarjes së të ardhurave nga trafiku)

I është Indeksi, i përllogaritur si më poshtë:

$$I = \left([0.25] * \frac{ECPI_i}{ECPI_0} \right) + \left([0.25] * \frac{ECCI_i}{ECCI_0} \right) + \left([0.5] * \frac{LCPI_i * LFXR_i}{LCPI_0 * LFXR_0} \right)$$

Ku:

I = Indeksi në vitin i ;

$ECPI_0$ = Euro Indeksi i çmimeve në muajin në të cilën bie data e përmbylljes financiare;

$ECPI_i$ = Euro Indeksi i çmimeve në muajin e fundit për të cilën janë të disponueshme të dhënat në datën e llogaritjes;

$EPPI_0$ = Indeksi i BE-së për çmimin e prodhimit në vitin në të cilin bie data financiare bazë;

$EPPI_i$ = Indeksi i BE-së për çmimin e prodhimit në vitin e fundit për të cilin janë të disponueshme të dhënat në datën e llogaritjes;

$LCPI_0$ = Indeksi i çmimit të konsumatorit në lekë në muajin që bie data financiare bazë;

$LCPI_i$ = Indeksi i çmimit të konsumatorit në lekë në muajin e fundit për të cilin janë të disponueshme të dhënat në datën e llogaritjes;

$LXFR_0$ = Kursi i këmbimit të huaj nga leku në euro i Bankës së Shqipërisë në ditën në të cilën bie data financiare bazë;

$LXFR_i$ = Indeksi i çmimit të konsumatorit në lekë në muajin në ditën e fundit për të cilën ka të dhëna të disponueshme në datën e llogaritjes.

- (b) Në llogaritjen e të ardhurave të garantuara të rregulluara nga trafiku, Koncesionari i rrumbullakos të ardhurat e garantuara të llogaritura nga trafiku në euron më të afërt.



- (c) Pragu i ndarjes së të ardhurave nga trafiku rregullohet bashkë me të ardhurat e garantuara nga trafiku, duke përdorur formulën e parashikuar në Klauzolën 25.2.1(a) dhe (b) më sipër, me përjashtim të faktit se duke përdorur formulën, referenca ndaj “Të ardhurave të garantuara nga trafiku” duhet lexuar se i referohet pragut të ndarjes së të ardhurave nga trafiku.
- 25.2.2 Duke nisur nga data e fillimit të përdorimit të rrugës me taksë, nëse të ardhurat aktuale nga trafiku janë më pak se të ardhurat e garantuara nga trafiku për atë periudhë, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit pagesën për rakordimin e deficitit të të ardhurave.
- 25.2.3 Duke nisur nga data e fillimit të përdorimit të taksës së rrugës, nëse të ardhurat aktuale nga trafiku janë më të mëdha se pragu i ndarjes së të ardhurave të trafikut për atë periudhë, Koncesionari i paguan Autoritetit Kontraktor pagesën për rakordimin e suficitit të të ardhurave.
- 25.3 Subvencioni i Autoritetit Kontraktor**
- 25.3.1 Autoriteti Kontraktor do t'i paguajë Koncesionarit Subvencionin e Autoritetit Kontraktor në njëzet e gjashtë pagesa, pagesa e parë do të jete e pagueshme në përvjetorin e dytë të Datës Efektive dhe çdo pagesë do të jete e pagueshme mbi bazë gjashtë mujore sipas Klauzoles 25.3.3 më poshtë.
- (a) Të gjitha shumat që duhen paguar sipas kësaj Klauzole do të paguhet brenda 120 ditësh nga data kur duhen paguar, me supozimin se një faturë për këtë gjë është marrë nga Autoriteti Kontraktor
- 25.3.2 Një pjesë e Subvencionit të Autoritetit Kontraktor e cila mund të pritet të përdoret për mënyra ndryshe nga Pagesat e Shërbimit të Borxhit do të rregullohen në përputhje me Klauzolën 11.4.4, duke filluar me datën e fillimit të shërbimit të borxhit bazuar në Marrëveshjet e Financimit. Pjesa e Subvencionit të Autoritetit Kontraktor për tu rregulluar do të përcaktohet në Mbylljen Financiare dhe do të jetë e barabartë me diferencën ndërmjet Subvencionit të Autoritetit Kontraktor dhe Pagesave të Shërbimit të Borxhit. Për të shmangur dyshimet, nëse Pagesat e Shërbimit të Borxhit janë më të larta se Subvencioni i Autoritetit Kontraktor në çdo vit të dhënë, nuk do të ketë rregullime në bazë të kësaj Klauzole.
- 25.3.3 Pavarësisht nga Klauzola 25.3.1, asnjë kësht i Subvencionit të Autoritetit Kontraktor nuk do të jetë i detyruar të paguhet për sa kohë dhe deri në momentin kur këto Punime sic janë programuar në atë mënyrë që të bëhen detyrim për tu paguar përpara se kështu përkatës i Subvencionit të Autoritetit Kontraktor të jetë kryer, të jenë përfunduar. Për të shmangur dyshimet, një programim i tillë do të marrë parasysh Ngjarjet që shlyen detyrimin, Ngjarjet e Kompensimit dhe Ngjarjet e Forcave Madhore deri në masën që këto kanë shkaktuar ndryshimin e programit përkatës të ndërtimit.
- 25.4 Raportet mujore dhe pasqyrat vjetore të pagesave**
- 25.4.1 Për secilin muaj përkatës, brenda 12 (dymbëdhjetë) ditësh pune nga fundi i çdo muaji, Koncesionari i raportet Autoritetit Kontraktor në raport mujor për pagesat



me Klauzolën 24), që përfshin gjithashtu të dhënat e pagesave për ecurinë mujore të punës dhe regjistrin e të gjitha punimeve kapitale dhe punimeve gjeoteknike të kryera në atë muaj.

25.4.2 Në lidhje me secilin muaj përkatës, brenda dymbëdhjetë (12) ditëve të punës nga fundi i këtij muaji, Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktor një pasqyrë mujore të pagesave ku jepen me hollësi:

- (a) Pagesa e pagueshme e rakordimit të të ardhurave;
- (b) Nuk është përdorur
- (c) Kompensimi i pagueshëm i evazionit të taksës së rruges;
- (d) Pagesa vijuese e pagueshme për punimet gjeoteknike ose për punimet rehabilituese gjeoteknike, në përputhje me Klauzolat 32A.2.10 ose 32A.3.8;
- (e) Çdo rimbursim të duhur për shkak të pasojave të një ngjarje kompensimi dhe/ose një ndryshimi kualifikues në ligj;
- (f) Të dhënat e pagesave për ecurinë mujore të punës;
- (g) Të dhënat për të gjitha të ardhurat shtesë të fituara në përputhje me Klauzolën 11.9, dhe
- (h) Të gjitha shumat që Autoriteti Kontraktor duhet t'i paguajë Koncesionarit



bashkë me një faturë në euro për shumën që Autoriteti Kontraktor duhet t'i paguajë Koncesionarit ose, sipas rastit, një pasqyrë në euro të shumës që Koncesionari i detyrohet Autoritetit Kontraktor.

25.4.3 Jo më vonë se [tre (3)] muaj pas përfundimit të vitit të mëparshëm të Kontrates, Koncesionari duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor një deklaratë vjetore të pagesës në lidhje me Vitin e Kontrates paraardhëse ("Afati i Paraqitjes së Pasqyrave Vjetore të Pagesave") ku jepen me hollësi:

- (a) Pagesa e pagueshme e rakordimit të të ardhurave;
- (b) Nuk është përdorur
- (c) Kompensimi i pagueshëm i evazionit të taksës;
- (d) Pagesa vijuese e pagueshme për punimet gjeoteknike ose për punimet rehabilituese gjeoteknike, në përputhje me Klauzolat 32A.2.10 ose 32A.3.8;
- (e) Çdo rimbursim të duhur për shkak të pasojave të një ngjarje kompensimi dhe/ose një ndryshimi kualifikues në ligj;
- (f) Të dhënat e pagesave për ecurinë mujore të punës;

(g) Të dhënat për të gjitha të ardhurat shtesë të fituara në përputhje me Klausolën 11.9, dhe

(h) Të gjitha shumat që Autoriteti Kontraktor duhet t'i paguajë Koncesionarit

bashkë me një faturë në euro për shumën që Autoriteti Kontraktor duhet t'i paguajë Koncesionarit ose, sipas rastit, një pasqyrë në euro të shumës që Koncesionari i detyrohet Autoritetit Kontraktor, sipas rastit. (për shmangien e dyshimit duke mos përfshirë ndonjë pagese subvencioni të Autoritetit Kontraktor për t'u bërë në përputhje me Klausolën 25.3 më sipër të cilat do të faturohen veçmas).

25.5 Pagesa

25.5.1 Përveç kur Autoriteti Kontraktor i kundërshton pagesat për ecurinë mujore të punës (ose një pjesë të tyre), të paraqitura në raportin mujor, rast në të cilin zbatohen dispozitat e Klausolave 25.6 deri në 25.8, Koncesionari i paguan Autoritetit Kontraktor shumën e llogaritur në përputhje me Seksionin 7 të Shtojcës 5 sipas pagesave për ecurinë mujore të punës në raportin mujor.

25.5.2 Përveç kur Autoriteti Kontraktor e kundërshton shumën (ose një pjesë të saj) që përmban pasqyra vjetore e pagesave (rast në të cilin zbatohen dispozitat e Klausolave 25.6 deri në 25.8):

(a) kur Autoriteti Kontraktor duhet ta paguajë Koncesionarin në përputhje me Klausolat 11.11 dhe 25.2, Autoriteti Kontraktor ia paguan shumën (ose pjesën e padiskutuar të asaj shume) Koncesionarit brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga afati i dorëzimit të pasqyrës vjetore të pagesave; ose,

(b) kur duhet bërë një pagesë nga Koncesionari të Autoriteti Kontraktor në përputhje me Klausolat 25.2 dhe 25.4, Koncesionari ia paguan atë shumë (ose pjesën e padiskutueshme të asaj shume) Autoritetit Kontraktor brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga afati i dorëzimit të pasqyrës vjetore të pagesave.

25.5.3 Kur Autoriteti Kontraktor duhet t'i bëjë Koncesionarit pagesa për kompensimin e evazionit të taksës së rrugës, rimbursimin për pasojat e një ngjarje kompensimi, ose pagesa për rakordimin e deficitit të të ardhurave ose ndonjë pagese tjetër në raportin e pagesave mujore dhe/ose në pasqyrën e pagesave vjetore, pagesa të tilla bëhen në lekë pas këmbimit të shumës në euro të kompensimit të evazionit të taksës së rrugës, rimbursimit për pasojat e një ngjarjeje kompensimi, ose pagesës përkatëse të rakordimit të deficitit të të ardhurave, sikundër tregohet në pasqyrën përkatëse vjetore të pagesave, me kursin zyrtar të këmbimit euro/lek të Bankës së Shqipërisë të përdorur në ditën e pagesës.

25.5.4 Kur Autoriteti Kontraktor duhet t'i bëjë një pagesë Koncesionarit për rakordimin e suficitit të të ardhurave apo një pagese mujore të ecurisë, një pagesë e tillë paguhet në lekë pas këmbimit të shumës në euro të pagesës së rakordimit të suficitit të të ardhurave, sikurse tregohet në pasqyrën përkatëse vjetore të pagesave, me kursin zyrtar të këmbimit euro/lek të Bankës së Shqipërisë të përdorur në ditën e pagesës.



25.6 Shumat e kundërshtuara

25.6.1 Kur Autoriteti Kontraktor e kundërshton një shumë të paraqitur në pasqyrën vjetore të pagesave dhe/ose në pagesës për ecurinë e punës mujore për atë vit konkret të Kontratës:

- (a) Autoriteti Kontraktor e njofton Koncesionarin për mospranimin e tij me shkrim jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga dita që Autoriteti Kontraktor merr pasqyrën vjetore të pagesave, duke deklaruar arsyet dhe çdo evidencë të disponueshme që ka, për të konfirmuar deklaratat e tij, të cilat kundërshtojnë hollësitë e paraqitura në Pasqyrën vjetore të pagesave; dhe
- (b) Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë një vlerë, të paraqitur në Pasqyrën vjetore të pagesave, dhe/ose pagesa mujore e ecurisë së punës pas përfundimit të periudhës së parashikuar në këtë Klauzolë 25.6, me kusht që nëse Autoriteti Kontraktor e kundërshton një vlerë, pas pagesës ose një pagesë për rakordimin e deficitit të të ardhurave ose një pagesë për rakordimin e suficitit të të ardhurave dhe/ose pagesë mujore për ecurinë e punës, ai të mos ketë të drejtë të mbajë apo kompensojë ndonjë pagesë përkundrejt një vlere të tillë të diskutuar, të cilën ndryshe ai do të ishte i detyruar t'ia paguante Koncesionarit, derisa mosmarrëveshja të zgjidhet në përputhje me Klauzolën 56;

25.6.2 Autoriteti Kontraktor mund të mbajë pagesën e vlerës së diskutuar në fjalë, derisa mosmarrëveshja të zgjidhet në përputhje me Klauzolën 25.8, por marrja e çdo pagese nga Koncesionari nuk përbën heqje dorë nga e drejta e Autoritetit Kontraktor për të bërë padi, sipas Klauzolës 25.8.

25.6.3 Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë çdo pjesë të vlerës së parashikuar në Pasqyrën vjetore të pagesave dhe/ose të pagesës të ecurisë mujore, që nuk është kundërshtuar nga Autoriteti Kontraktor.

25.7 Përgjigja e Koncesionarit

Brenda 5 (pesë) ditësh pune nga marrja e njoftimit të Autoritetit Kontraktor sipas Klauzolës 25.6, Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor nëse pranon apo refuzon llogaritjet e ndryshme të vlerës së parashikuar në Pasqyrën vjetore të pagesave dhe/ose pagesat e ecurisë mujore të punës në njoftimin e Autoritetit Kontraktor dhe:

- 25.7.1 nëse Koncesionari i pranon llogaritjet e paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, ose nëse nuk bën komente për to brenda kohës së dhënë, përdoret vlera e paraqitur në Pasqyrën vjetore të pagesave dhe/ose pagesat mujore për ecurinë e punës, të paraqitura në njoftimin e Autoritetit Kontraktor për muajin përkatës; ose
- 25.7.2 nëse Koncesionari nuk është dakord me llogaritjet e paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, mosmarrëveshja zgjidhet ndërmjet palëve në përputhje me Klauzolën 56, në bazë të Klauzolës 25.8.

25.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 25.8.1 Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit në lidhje me vlerën e parashikuar në Pasqyrën vjetore të pagesave dhe/ose të pagesave mujore të ecurisë së punës, një mosmarrëveshje e tillë fillimisht dërgohet te Inxhinieri i pavarur. Vendimi i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, nëse asnjëra nga palët nuk e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Inxhinieri i pavarur.
- 25.8.2 Sapo një mosmarrëveshje në lidhje me një vlerë të caktuar të paraqitur në një Pasqyrë vjetore të pagesave dhe/ose në pagesat e ecurisë mujore të punës zgjidhet me marrëveshje, ose me anë të një vendimi nga Inxhinieri i pavarur:
- (a) (sipas rastit) pagesa për rakordimin e deficitit të të ardhurave, ose pagesa për rakordimin e suficitit të të ardhurave dhe/ose pagesat për ecurinë mujore të punës rregullohen në mënyrë retroaktive për muajin përkatës, i cili ka qenë subjekt i mosmarrëveshjes dhe vlera përkatëse paguhet nga pala përkatëse brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga dita kur mosmarrëveshja është zgjidhur; dhe
 - (b) shuma përkatëse që një palë duhet t'i paguante palës tjetër në bazë të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, prodhon kamatëvonesë që nga data kur kjo vlerë e përcaktuar në Pasqyrën vjetore të pagesave dhe/ose në pagesat për ecurinë e punës mujore duhej të ishte paguar, derisa kjo vlerë të paguhet konkretisht.

25.8.3 Nëse sipas pagesës së një shume të diskutuar, në bazë të Klauzolës 25.8.2, një palë e kundërshton vendimin e Inxhinierit të pavarur, pas zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje të tillë në përputhje me Klauzolën 56, pala që i kërkohet të bëjë pagesën në përputhje me Klauzolën 56 e paguan shumën brenda 20 (njëzet) ditë pune nga dita e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe një shumë e tillë prodhon kamatëvonesë nga data kur duhej të ishte bërë pagesa, deri në ditën që kryhet pagesa e plotë e shumës.

25.9 Tatimi mbi vlerën e shtuar

- 25.9.1 Përveç rasteve kur pa shikohet ndryshe shprehimisht, çdo dhe të gjitha detyrimet dhe shumat sipas kësaj Marrëveshjeje llogariten pa TVSh.
- 25.9.2 Nëse, sipas kësaj Marrëveshjeje, puna që lidhet me transferimin e një aspekti përkatës të Autostradës te Autoriteti Kontraktor është një furnizim i tatueshëm që i nënshtrohet ligjit të TVSh-së, ose ndonjë ligji tjetër të ngjashëm që lidhet me tatimet, shuma e kësaj takse përcaktohet në fatura dhe përfshihet në detyrimin e pagesës së lidhur, kështu që Koncesionari merr shumën e parashikuar në Marrëveshje pas zbritjes dhe pagesës së tatimit. Nëse tatimi përkatës është paguar ndërkohë nga Koncesionari, përpara bërjes nga Autoriteti Kontraktor i pagesës së tatimit te Koncesionari, ose në llogarinë e tij, shumat e parashikuara në këtë Marrëveshje rriten për shkak të tatimit të paguar paraprakisht nga Koncesionari.
- 25.9.3 Referencat në këtë Marrëveshje ndaj kostove të një pale llogariten pas zbritjes së TVSh-së, përveçse kur personi përkatës, të cilit i linden kostot, nuk është dhe nuk do të jetë në gjendje të kërkojë zbritje të TVSh-së në përputhje me ligjet përkatëse. Në një rast të tillë, referencat ndaj kostove të një pale do të llogariten duke përfshirë

TVSh-në, e cila nuk është, ose nuk do të jetë e zbritshme. Nëse TVSh-ja është ose do të jetë e zbritshme, në përputhje me ligjet përkatëse, dhe pala nuk e zbret për ndonjë arsye, atëherë kostot do të konsiderohen si kosto pa TVSh.

- 25.9.4 Autoriteti Kontraktor do të sigurojë që Ligji i TVSH së Shqipërisë do të respektohet në lidhje me këtë Kontratë dhe mosrespektimi nga Autoriteti Kontraktor do të rezultojë në një Ngjarje Kompensuese.

25.10 Kufizimi i kompensimit

Autoriteti Kontraktor nuk e kompenson një shumë që duhet t'i paguajë atij Koncesionari në shlyerje të një shumë të pagueshme në përputhje me këtë Klauzolë 25, për aq sa, kur si rezultat i një kompensimi të tillë, shuma që i paguhet aktualisht Koncesionarit do të pakësohet, për t'i bërë më e vogël se sa shuma e përgjithshme e principalit dhe interesit që Koncesionari u detyrohet Huadhënësve, sipas Marrëveshjeve të Financimit, përpara Pasqyrës tjetër vjetore të pagesave. Në bazë të fjalisë së mëparshme, Autoriteti Kontraktor mund të kompensojë çdo shumë që i detyrohet atij Koncesionari vetëm nëse për këtë është rënë shprehimisht dakord në këtë Marrëveshje dhe nëse lejohet sipas ligjeve.

26. Modeli financiar

26.1 Modeli financiar

- 26.1.1 Jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune pas datës së hyrjes në fuqi, Koncesionari i dërgon Autoritetit Kontraktor një version të shkruar dhe një version elektronik të Modelit financiar, që nga data e hyrjes në fuqi, në dy kopje, të vërtetuara nga një drejtor i Koncesionarit që ka dëgjuar për faktet si të vërteta dhe korrekte. Për shmangien e çdo dyshimi, modeli financiar i dërguar sipas kësaj Klauzole 26.1.1 duhet të jetë identik me modelin financiar të paraqitur nga Koncesionari si pjesë e dokumentacionit të tij të ofertës, duke specifikuar se çdo ndryshim, i bërë në modelin financiar që nga koha e paraqitjes së tij në kuadër të dokumentacionit të tenderit, bëhet i vlefshëm kur një ndryshim i tilla miratohet paraprakisht nga Autoriteti Kontraktor.

- 26.1.2 Si rrjedhojë, Koncesionari i jep leje Autoritetit Kontraktor të përdorë modelin e tij financiar dhe çdo version të mëvonshëm të përditësuar të modelit financiar, duke filluar nga e dërgimit deri në datën e përfundimit të tij, ose në datën e zgjidhjes së plotë të të gjitha kërkesave të ndërsjella që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, që palët mund të kenë ndaj njëra tjetrës, kur një datë e tillë bie pas Datës së Përfundimit, për çdo qëllim që lidhet me këtë Marrëveshje dhe/ose Projekt. E drejta për të përdorur nga kjo Klauzolë 26.1.2 nuk do të transferohet apo delegohet nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të ndonjë personi që marrëveshja mund t'i transferohet në përputhje me Klauzolën 48 dhe pastaj vetëm për qëllime në lidhje me këtë Marrëveshje dhe / ose Projektin. Autoriteti Kontraktor merr përgjegjësinë e plotë për përdorimin e mëvonshëm të modelit dhe ciron Koncesionarin nga çdo përgjegjësi që ndjek këtë përdorim. Versioni i vetëm për t'u përmendur për çfarëdo qëllimi, do të nënshkruhet kopje e printuar sic parashikohet zyrtarisht nga Koncesionari.

Pjesa 6: Ngjarje të jashtme

27. Ngjarje kompensimi

27.1 Në rast se, si rrjedhojë e një ngjarje kompensimi:

- 27.1.1 Koncesionari vonohet në kryerjen e punimeve sipas programit;
- 27.1.2 Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tjera të tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje; ose
- 27.1.3 Koncesionarit i kanë lindur ose do t'i lindin kosto që nuk do t'i kishin lindur, apo nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura që ndryshe do të ishin gjeneruar, po të mos kish ndodhur një ngjarje e tillë kompensimi,

Koncesionari mund të përfitojë një përfitim në formën e:

- 27.1.4 Një shtyrjeje të datës së programuar të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose të datës së programuar të përfundimit të Aspektit përkatës për vonesën e pësuar nga Koncesionari sipas programit të tij;
- 27.1.5 Çlirimit nga përmbushja e detyrimeve të tij për aq sa ato janë prekur nga ndodhja e ngjarjes së kompensimit;
- 27.1.6 Të drejtës për kompensim; dhe/ose
- 27.1.7 Çlirimit nga zgjidhja e kontratës për mospërmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit për aq sa mospërmbushja është shkaktuar ose ka kontribuar materialisht nga ndodhja e ngjarjes së kompensimit.

27.2 Koncesionari përfiton përfitime vetëm sipas Klauzolës 27.1 në rrethana kur ka:

27.2.1 njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për kërkesën e tij për të marrë ndonjë prej këtyre përfitimeve pa vonesa të tepërta, por gjithsesi, jo më vonë se maksimumi:

- (a) 10 (dhjetë) ditë pune pasi Koncesionari ka marrë dijëni për ndodhjen e ngjarjes së kompensimit; ose
- (b) 30 (tridhjetë) ditë pune pas ndodhjes së ngjarjes së kompensimit; dhe

27.2.2 jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune pas dorëzimit të njoftimit të përmendur në Klauzolën 27.2.1:

- (a) I ka dhenë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur një shpjegim të plotë dhe të hollësishëm për ngjarjen e kompensimit dhe përfitimet e kërkuara;
- (b) Në rastin e një vonese, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për kohëzgjatjen e përafërt të kësaj vonese;
- (c) E ka vënë në dijeni Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për çdo informacion tjetër përkatës, që lidhet me një ngjarje kompensimi: dhe

- (d) E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për humbjen e pritshme të të ardhurave, ose për një rritje të kostove që rezultojnë nga një ngjarje kompensimi,

me kusht që, në rast se informacioni i plotë nuk është i disponueshme brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune, Koncesionari të dërgojë një njoftim ku të parashtrijë të gjithë informacionin e disponueshme dhe një njoftim tjetër ku t'u japë informacion të mëtejshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur çdo 10 (dhjetë) ditë pune pas paraqitjes së njoftimit fillestar; dhe

27.2.3 T'i ketë provuar Inxhinierit të pavarur se:

- (a) Ngjarja e kompensimit ka rezultuar ose do të rezultojë në shtyrjen e punimeve, mospërbushjen e detyrimeve të tjera të Koncesionarit, shtimin e kostove, ose mosgjenerimin e të ardhurave nga Koncesionari; dhe
- (b) Koncesionari i ka bërë të gjitha përpjekjet që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Koncesionari në përputhje me praktikën e mirë, ose për të parandaluar apo zbutur pasojat e një ngjarje kompensimi, kështu që, për shmangien e çdo dyshimi, përfitimi i pretenduar i korrespondon vetëm një pjese të pasojave të ngjarjes së kompensimit, e cila nuk mund të ishte parandaluar apo zbutur nga Koncesionari me anë të bërjes së përpjekjeve të tilla të arsyeshme.

27.3 Nëse Koncesionari i ka përmbushur detyrimet e tij të parashikuara në Klauzolën 27.2 dhe Inxhinieri i pavarur e ka bërë një njoftim ku deklaron se ka ndodhur një ngjarje kompensimi dhe se Koncesionarit i duhet hequr përkatesisht përgjegjësia për mospërbushjen e detyrimit të tij, në përputhje me këtë Klauzolë 27, atëherë:

- 27.3.1 Kur është e përshtatshme, data e programuar e përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose data e programuar e përfundimit të Aspektit përkatës shtyhet për një periudhë kohe të përcaktuar nga Inxhinieri i pavarur;
- 27.3.2 nëse Koncesionari ka bërë, ose do të bëjë shpenzime shtesë, ose ka pësuar ose do të pësojë humbje të të ardhurave, që ndryshe nuk do t'i kishte bërë/do t'i kishte gjeneruar, po të mos kish ndodhur një ngjarje e tillë kompensimi, Autoriteti Kontraktor e rimbursion Koncesionarin për shpenzime të tilla dhe/ose humbje të të ardhurave, me qëllim që Koncesionarin ta lerë në një gjendje që nuk është as më e mirë as më e keqe se më parë, dhe shuma e një rimbursimi të tillë do të përcaktohet me anë të përdorimit të modelit financiar;
- 27.3.3 Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij të përfundimit të parakohshëm të kontratës për shkak të mospërbushjeve nga Koncesionari të detyrimeve të tij, shkaktuar nga ngjarja e kompensimit; dhe
- 27.3.4 Autoriteti Kontraktor i ofron Koncesionarit mundësinë e përjashtimit nga detyrimet e tij, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, të cilat përcaktohen nga Inxhinieri i pavarur,

me kusht që, kur Koncesionari ose Autoriteti Kontraktor nuk bien dakord me njoftimin me shkrim, bërë nga Inxhinieri i pavarur në përputhje me këtë Klauzolë 27.3, çdo mosmarrëveshje

të vendoset në përputhje me Klausolës 56. Njoftimi me shkrim i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë, në përputhje me Klausolën 56, brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Inxhinierit të pavarur.

27.4 Nëse Koncesionari nuk i jep Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur informacionin deri në njërin nga afatet e parashikuara në këtë Klausolë 27, ai nuk merr asnjë nga përfitimet e lartpërmendura si rezultat i ngjarjes së kompensimit, derisa një informacion i tillë të jepet, me kusht që Koncesionari të mos marrë përfitimet e Klausolave 27.3.2 deri në 27.3.4 si rrjedhojë e ngjarjes përkatëse të kompensimit për periudhën kohore gjatë të cilës Koncesionari nuk e ka dhënë informacionin e nevojshëm, dhe nuk e ka përmbushur detyrimin e tij për të informuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur brenda afateve kohore të parashikuara në këtë Klausolë 27.

27.5 Koncesionari është i detyruar të njoftojë Autoriteti Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur pa vonesa të panevojshme në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër material në lidhje me një ngjarje kompensimi dhe të njoftojë Autoriteti Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që tregojnë se informacioni i dhënë më parë ka qenë materialisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.

28. Ngjarje të shlyerjes së detyrimit

28.1 Kur si rrjedhojë e një ngjarje që shlyen detyrimin:

28.1.1 Koncesionari nuk është në gjendje të kryejë punimet me qëllim që të mund të sigurojë lejen e përfundimit paraprak ose lejen e përfundimit, në lidhje me një Aspekt, deri në datën e programuar të përfundimit paraprak të Aspektit paraprak, ose në datën e programuar të përfundimit të Aspektit përkatës; ose

28.1.2 Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë ndonjërin prej detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje;

Koncesionari mund të sigurojë një përfitim në formën e:

28.1.3 Shtyrjes të datës së programuar të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose të datës së programuar të përfundimit të Aspektit përkatës, që i përshtatet vonesës së shkaktuar Koncesionarit në bazë të Programit të tij;

28.1.1 Lehtësimit nga detyrimet e tij për aq sa ato janë prekur nga ndodhia e ngjarjes që shlyen detyrimin;

28.1.4 Pas dhënies së lejes së shfrytëzimit paraprak, ose të lejes së shfrytëzimit në lidhje me Aspektin përkatës, në rastin e një ngjarjeje të paparashikueshme lehtësuese, si rezultat i të cilës Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë të gjitha ose një pjesë materiale të detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, për një periudhë më shumë se 2 (dy) javë, ose të ndonjë ngjarje tjetër që shlyen detyrimin, e cila e marrë në tërësi shkakton një vonese prej me shumë se 2 (dy) muajsh (periudhë e cila përfshin çdo ngjarje që shlyen detyrimin që ndodh përpara dhënies së lejes së shfrytëzimit paraprak ose lejes së shfrytëzimit në lidhje me një Aspekt të caktuar përkatës), përfiton heqjen e pagesave për ecurinë më të mirë të punës në lidhje me

Aspektin (Aspektet) që preket ose preken nga ngjarja (ngjarjet) që shlyen detyrimin; dhe/ose

28.1.5 Në formën e shlyerjes nga zgjidhja [e kontratës] për shkak të mospërbushjeve nga Koncesionari të detyrimeve të tij, për aq sa mospërbushja nga Koncesionari i detyrimeve ka ardhur si rrjedhojë e një ngjarje që shlyen detyrimin, ose për të cilin një ngjarje e tillë ka kontribuar në shkallë materiale.

28.2 Koncesionari i merr përfitime të tilla vetëm në rrethanat kur ai:

28.2.1 E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për kërkesën e tij për t'i dhenë ndonjë nga këto përfitime pa vonese, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:

(a) 10 (dhjetë) ditë pune pasi Koncesionari ka marrë dijëni për ndodhjen e një ngjarjeje që shlyen detyrimin; ose

(b) 30 (tridhjetë) ditë pune pas ndodhjes së një ngjarjeje që shlyen detyrimin;

28.2.2 Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas dorëzimit të njoftimit sipas Klauzolës 28.2.1:

(a) I ka dhenë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur një shpjegim të plotë rreth ngjarjes që shlyen detyrimin dhe përfitimeve të kërkuara;

(b) Në rastin e një vonese, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për kohëzgjatjen e vlerësuar të një vonese të tillë; dhe

(c) E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për çdo informacion tjetër përkatës,

me kusht që, nëse informacioni i plotë nuk është i disponueshëm brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune, Koncesionari brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune t'u dërgojë një njoftim Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur ku të paraqesë të gjithë informacionin e disponueshëm dhe t'u dërgojë edhe një njoftim tjetër ku t'u japë informacion të mëtejshëm çdo 10 (dhjetë) ditë pune pas paraqitjes së njoftimit fillestar.

28.2.3 Ka provuar përpara Inxhinierit të pavarur se:

(a) Ngjarja lehtësuese ka rezultuar në shtyrjen e datës së programuar të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose të datës së programuar të përfundimit të Aspektit përkatës, ose në mospërbushjen e detyrimeve të tjera të Koncesionarit; dhe

(b) Koncesionari i ka bërë të gjitha përpjekjet, që mund t'i kërkoen Koncesionarit në mënyrë të arsyeshme, në përputhje me praktikën e mirë të sektorit ekonomik, për të parandaluar ose zbutur pasojat e ngjarjes së paparashikuar lehtësuese kështu që, për shmangien e çdo dyshimi, përfitimi i kërkuar i korrespondon vetëm një pjese të tillë të pasojave të ngjarjes së paparashikuar lehtësuese, e cila nuk mund të ishte parandaluar apo zbutur



28.3 Nëse Koncesionari i ka kryer detyrimet e tij, të parashikuara në Klauzolën 28.2, dhe Inxhinieri i pavarur ka dhenë një njoftim me shkrim ku deklaron se ka ndodhur një ngjarje e shlyerje te detyrimit, dhe përcakton ndihmën e duhur që i duhet dhenë Koncesionarit në përputhje me këtë Klauzolë 28, atëherë:

28.3.1 Sipas rastit, data përkatëse e programuar për përfundimin paraprak të Aspektit përkatës ose data e programuar për përfundimin e Aspektit përkatës shtyhen me një periudhë kohe që përcaktohet nga Inxhinieri i pavarur;

28.3.2 Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij për përfundimin e parakohshëm të kontratës për shkak të mospërbushjeve të detyrimeve nga Koncesionari, në lidhje me një shkelje të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, shkaktuar nga ngjarja e papaparashikuar lehtësuese; dhe

28.3.3 Autoriteti Kontraktor e përjashton Koncesionarin nga detyrimet e tij, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, të cilat përcaktohen nga Inxhinieri i pavarur,

me kusht që, nëse Koncesionari ose Autoriteti Kontraktor nuk bien dakord me njoftimin me shkrim të Inxhinierit të pavarur, dhënë në përputhje me këtë Klauzolë 28.3, çdo mosmarrëveshje të vendoset në përputhje me Klauzolën 56. Njoftimi me shkrim i Inxhinierit të pavarur është detyruar për palët, përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Inxhinieri i pavarur.

28.4 Në rast se Koncesionari nuk u jep informacion Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur deri në njërin nga afatet e parashikuara në këtë Klauzolë 28, ai nuk do të marrë asnjë nga përfitimet e mësipërme që rrjedhin nga ngjarja e papaparashikueshme lehtësuese, derisa të dërgojë një informacion të tillë, me kusht që Koncesionari të mos përfitojë asnjë nga përfitimet e parashikuara në Klauzolën 28.3 më sipër, si rrjedhojë e ngjarjes përkatëse të papaparashikuar lehtësuese, për periudhën gjatë të cilës Koncesionari nuk u ka dhenë informacionin e nevojshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur brenda afateve kohore të parashikuara në këtë Klauzolë 28.

28.5 Koncesionari është i detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur pa vonesa të tepërta, në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër material në lidhje me një ngjarje të papaparashikuar lehtësuese dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që tregojnë se informacioni i dhenë më parë ka qenë materialisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.

28.6 Në rastin që një ngjarje e shlyerje te detyrimit vazhdon, ose pasojat e saj vazhdojnë të mbeten të tilla që:

28.6.1 Në varësi të Klauzolës 28.6.3, vonesa në dhënien e certifikatën e përfundimit paraprak ose certifikatën e përfundimit kalon dymbëdhjetë (12) muaj; ose

28.6.2 Në varësi të Klauzolës 28.6.3, Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë të gjithë ose një pjesë materiale të detyrimeve të tij, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, për një periudhë që i kalon dymbëdhjetë (12) muaj.

Të dyja palët do të takohen për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme që ka të bëjë me të tilla ngjarje të zgjatura shlyerjeje. Nëse të dy palët nuk bien dakord për masën e clirimit të kërkuar brenda tridhjetë (30) ditësh, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Marrëveshjeje në përputhje me Klausolën 37.7.

28.6.3 Në rastin që ngjarja e shlyerje te detyrimit, e përshkruar në pjesën (d) të përkufizimeve, vazhdon ose pasojat e saj vazhdojnë të mbeten të tillë që:

- (a) Vonesa në dhënien e çertifikatës së përfundimit paraparak ose një çertifikatë e përfundimit i tejkalon 6 (gjashtë) muaj; ose
- (b) Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë të gjitha ose një pjesë të rëndësishme të detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshjeje për një periudhë që i tejkalon 6 (gjashtë) muaj,

Të dyja palët do të takohen për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme që ka të bëjë me të tilla ngjarje të zgjatura shlyerjeje. Nëse të dy palët nuk bien dakord për masën e clirimit të kërkuar brenda tridhjetë (30) ditësh, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Marrëveshjeje në përputhje me Klausolën 37.7.

29. Ngjarje të forcave madhore

29.1 Asnjë palë nuk ka të drejtë të bëjë një padi ndaj palës tjetër për shkelje të detyrimeve të saj, sipas kësaj Marrëveshjeje, për shkak të një force madhore, dhe në masën që një ngjarje e forcës madhore e pengon të kryejë detyrimet e veta.

29.2 Përveçse, ashtu si parashikohet në Klausolën 29.8.4, kur asgjë në këtë Klausolë 29 nuk e cenon të drejtën e Autoritetit Kontraktor për të bërë zbritje në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

29.3 Kur ndodh një ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore, pala e prekur e njofton palën tjetër pa vonesa të panevojshme. Njoftimi përfshin hollësitë për ndikimin e kësaj ngjarjeje në detyrimet e palës së prekur dhe për çdo veprim të propozuar për zbutjen e pasojave të saj.

29.4 Pa vonesa të tepërta, pas një njoftimi të tillë, palët konsultohen me njëra tjetrën me mirëbesim dhe bëjnë përpjekje të arsyeshme për të rënë dakord për kushtet e përshtatshme për zbutjen e efekteve të ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore dhe për të lehtësuar realizimin në vijimësi të Marrëveshjes.

29.5 Kur palët nuk bien dakord për kushte të tilla brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e fillimit të ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore, dhe një forcë e tillë madhore vazhdon, ose pasojat e saj vazhdojnë të jenë të tilla sa që pala e prekur nuk është në gjendje t'i përmbushë të gjitha, ose pjesën më të madhe të detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, secila nga palët mund ta zgjidhë këtë Marrëveshjeje, në përputhje me Klausolën 37.7.

29.6 Nëse si rezultat i një ngjarjeje të shkaktuar nga një forcë madhore:

29.6.1 Koncesionari nuk është në gjendje të kryejë Punimet me qëllim që të ketë mundësi të marrë Çertifikatën Përdorimit Paraparak e ose Çertifikatën Përdorimit në lidhje me një Aspekt deri në datën e programuar të përfundimit paraparak të Aspektit përkatës, ose në datën e programuar të përfundimit të Aspektit përkatës: ose

29.6.2 Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tjera të tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje;

Koncesionari mund të marrë një përfitim në formën e:

29.6.3 Një shtyrjeje të datës së programuar të datës së përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose të datës së programuar të përfundimit të Aspektit përkatës, në përputhje me vonesën e pësuar nga Koncesionari sipas programit të tij;

29.6.4 Largimin e detyrimeve të tij për aq sa ato preken nga ndodhja e ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore;

29.6.5 Në rastin e një ngjarjeje të shkaktuar nga forca madhore, e cila bëhet shkas për vonesa në lidhje me dhënien e Çertifikatës së Përdorimit Paraprak, ose Çertifikatës së Përdorimit të një Aspekti përkatës, në formën e pagesës nga Autoriteti Kontraktor ose Koncesionari të rakordimit të deficitit të të ardhurave, ose pagesës së rakordimit të suficitit të ardhurave (sipas rastit), që kërkohet dhe që duhet paguar në lidhje me Aspektin përkatës për periudhën e vonesës së shkaktuar nga ngjarja e forcës madhore;

29.6.6 Në rastin e një ngjarjeje të shkaktuar nga një forcë madhore, e cila e pengon Koncesionarin të përmbushë detyrimet e tij, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, në vijim të marrjes së Çertifikatës së Përdorimit Paraprak ose Çertifikatës së Përdorimit në lidhje me një Aspekt përkatës, në formën e çlirimit prej pagesave për ecurinë mujore të punës; dhe/ose

29.6.7 Çlirimit nga zgjidhja e kontratës për shkak të mospërmbushjeve të detyrimeve të Koncesionarit për aq sa mospërmbushja nga Koncesionari është shkaktuar nga ndodhja e ngjarjes së forcës madhore, ose për të cilin ka kontribuar shumë ndodhja e ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore.

29.7 Koncesionari përfton përfitime të tilla vetëm në rrethana kur:

29.7.1 E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për kërkesën e tij për t'i dhenë ndonjë nga këto përfitime pa vonesa të tepërta, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:

(a) 10 (dhjetë) ditë pune pasi Koncesionari ka marrë dijeni për ndodhjen e një ngjarjeje të forcës madhore; ose

(b) 30 (tridhjetë) ditë pune pas ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore;

29.7.2 Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune pas dorëzimit të njoftimit në përputhje me Klauzolën 29.7.1:

(a) I ka dhenë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur një shpjegim të plotë të ngjarjes së forcës madhore dhe të përfitimeve të kërkuara prej tij;

(b) Në rastin e një vonese, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për kohëzgjatjen e përafërt të një vonese të tillë; dhe

- (c) E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për ndonjë informacion tjetër përkatës,

me kusht që, nëse informacioni i plotë nuk u vihet në dispozicion brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune, Koncesionari t'u dërgojë një njoftim Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur ku të vërë në dukje të gjithë informacionin që disponon, si dhe një njoftim tjetër me informacion të mëtejshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur çdo 10 (dhjetë) ditë pune pas dërgimit të njoftimit fillestar.

29.7.3 I ka provuar Inxhinierit të pavarur se:

- (a) Ngjarja e forcës madhore ka rezultuar në vonesën e datës së programuar të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose të datës së programuar të përfundimit të Aspektit përkatës ose mospërbushjen e detyrimeve të tjera të Koncesionarit; dhe
- (b) Koncesionari i ka bërë të gjitha përpjekjet që mund të kërkohen nga Koncesionari në mënyrë të arsyeshme në përputhje me praktikën e mirë të sektorit ekonomik, për të parandaluar ose zbutur pasojat e ngjarjes së forcës madhore me qëllim që, për shmangien e dyshimit, përfitimi i kërkuar t'i korrespondojë vetëm asaj pjese të pasojave të ngjarjes së forcës madhore, e cila nuk mund të ishte parandaluar apo zbutur nga Koncesionari.

29.8 Nëse Koncesionari i ka përbushur të gjitha detyrimet e tij të parashikuara në Klauzolën 29.7 dhe Inxhinieri i pavarur ka dhenë një njoftim me shkrim ku deklaron se ka ndodhur një forcë madhore, dhe përcakton shlyerjen e duhur të detyrimeve që i duhet dhënë Koncesionarit në përputhje me këtë Klauzolë 29, atëherë:



- 29.8.1 Data e programuar e përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose data e programuar e përfundimit të Aspektit përkatës shtyhet me një periudhë kohe që i përshtatet vonesës së pësuar nga Koncesionari sipas Programit të tij, si rezultat i ngjarjes së forcës madhore;
- 29.8.2 Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij për përfundimin paraprak të kontratës për shkak të mospërbushjeve të detyrimit nga Koncesionari në lidhje me një shkelje të detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje, shkaktuar nga ndodhja e ngjarjes së forcës madhore;
- 29.8.3 Në rastin e një ngjarjeje të forcës madhore, e cila bën që Koncesionari të mos jetë në gjendje të përbushë detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, pas dhënies së lejes së shfrytëzimit paraprak, ose lejes së shfrytëzimit në lidhje me Aspektin përkatës, sipas Klauzolës 34.2.2, Koncesionari ka të drejtë të shlyeje pagesat për ecurinë mujore të punës; dhe
- 29.8.4 Autoriteti Kontraktor i bën Koncesionarit një përjashtim nga detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, i cili është proporcional me natyrën e ngjarjes së forcës madhore,

me kusht që nëse Koncesionari ose Autoriteti Kontraktor nuk pajtohen me njoftimin me shkrim të Inxhinierit të pavarur, dhënë në përputhje me këtë Klauzolë 29.8, çdo mosmarrëveshje të

vendoset në përputhje me Klauzolën 56. Njoftimi me shkrim i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Inxhinierit të pavarur.

- 29.9 Nëse Koncesionari nuk arrin t'i japë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur informacionin deri në një nga afatet e përcaktuara në këtë Klauzolë 29, ai nuk merr asnjë nga përfitimet e mësipërme për shkak të ngjarjes së forcës madhore, derisa një informacion i tillë të jepet, me kusht që Koncesionari të mos marrë përfitimin që rrjedh nga Klauzolat 29.8.2 deri te 29.8.4, si pasojë e ngjarjes përkatëse të forcës madhore, për periudhën kohore në të cilën Koncesionari nuk ka mundur t'u japë informacionin e nevojshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur brenda afateve kohore të parashikuara në këtë Klauzolë 29.
- 29.10 Palët, gjatë gjithë kohës pas ndodhjes së një ngjarjeje të një force madhore, bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të parandaluar apo zbutur efektet e çdo vonese dhe Koncesionari në çdo kohë gjatë të cilës forca madhore vazhdon, ndërmerr të gjitha hapat, në përputhje me praktikën e mirë të sektorit ekonomik, për të kapërcyer apo minimizuar pasojat e ngjarjes së forcës madhore.
- 29.11 Pala e prekur e njofton palën tjetër pa vonesa të tepërta nëse:
- 29.11.1 Ka gjetur ndonjë informacion tjetër të rëndësishëm në lidhje me forcën madhore dhe i jep palës tjetër hollësi për një informacion të tillë, të cilat janë të reja, ose të cilat e bëjnë informacionin e dhenë më parë shumë të pasaktë ose të gabuar; dhe/ose
- 29.11.2 Ngjarja e forcës madhore ka përfunduar ose nuk ushtron më ndonjë ndikim në plotësimin e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes. Pas marrjes së një njoftimi të tillë nga pala e prekur, kjo Marrëveshje vazhdon sipas kushteve që ekzistonin përpara se të ndodhte ngjarja e forcës madhore.

29A Veprimi Material i Pafavorshem Qeveritar

29A.1

Nje "Veprim Material i Pafavorshem Qeveritar" do të ndodhë në qoftë se, Autoriteti Kontraktor ose ndonjë Autoritet Përkatës pas datës së kësaj Marrëveshjeje merr apo deshton të ndërmarre ndonjë veprim të çdo natyre, ose nuk arrin të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose në përputhje me Ligjin (në secilin rast, përveç veprimit të tillë apo mosveprimit të marre nga Autoriteti Kontraktor për të zbutur efektet e shkeljes nga ana e Koncesionarit), efekti i të cilave rrejdh direkt ose indirekt nga koncesionari dhe / ose rezultatet në ndonjë ndryshim të pafavorshem aktual ose të mundshëm në shpenzimet e Koncesionarit (duke përfshirë por jo kufizuar në tatimet) ose të ardhurat apo pozicioni i përgjithshëm ekonomik, duke përfshirë por jo kufizuar në:

- (a) Dështimi që të kryejë ndonjë detyrë ligjërish të detyrueshme ose detyrim ose të zbatojë ndonjë të drejtë ligjore nga Autoriteti Kontraktor apo ndonjë Autoritet Përkatës; dhe / ose
- (b) një ndryshim në Ligj i cili, pas Ndryshimit në regjimin e Ligjit në përputhje me Klauzolën 30 është respektuar, ende ndikon negativisht në aftësinë e Koncesionarit për të ndërmarrë Punimet e Ndërtimit apo operimin dhe mirëmbajtien e autostradës.

me kusht që një ngjarje nuk përbën një Veprim Material të Pafavorshëm Qeveritar në atë masë që ajo mund të parandalohej apo të kapërcehej nga Pala e prekur nëpërmjet ushtrimit të vemendjes dhe të kujdesit të arsyeshëm, sic do të ushtrohej nga një person i matur nën rrethana të ngjashme (standardi i kujdesit të një eksperti të mirë).

29A.2 Nëse ndodh ndonjë Veprim Material Qeveritar i Pafavorshëm, Koncesionari do të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktor duke dhënë hollësitë e arsyeshme të këtij veprimi dhe pasojat e tij të mundshme ekonomike për Koncesionarin. Autoriteti Kontraktor do të ketë 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi me shkrim për të ndrequr situatën e cila rikthen gjendjen e përgjithshme ekonomike të Koncesionarit në atë në të cilën do të ishte nëse ky Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar nuk do të kishte ndodhur. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk do të ndikojnë në ndreqjen e tij brenda kësaj periudhe, Palët do të konsultohen brenda 21 (njëzet e një) ditësh pas skadimit të kësaj periudhe me qëllim arritjen e një zgjidhje të përbashkët të pranueshme për situatën. Në rast se një zgjidhje reciproke nuk kënaqshme nuk është arritur në kuadër të kësaj periudhe 21 (njëzet e një) ditore në lidhje me:

- (a) çdo rregullim i duhur i ngarkuar, pagesë dhe/ose zgjatje afati, i drejtë dhe i arsyeshëm sipas rrethanave; dhe/ose
- (b) çdo lehtësim monetar i drejte dhe i arsyeshëm sipas rrethanave; dhe/ose
- (c) çdo shtyrje e duhur e periudhës së koncesionit,

Marrëveshja mund të ndërpritet nga Koncesionari, në përputhje me Klauzolën 37.6, ku çdo mjet juridik tjetër i parashikuar në këtë Nen nuk do të jetë i mjaftueshëm për të vendosur Koncesionarin në një pozicion ekonomik sa më të mirë sikur të mos kishte ndodhur Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar, duke pasur parasysh obligimet e vazhdueshme të Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje Koncesioni, Dokumentet e Projektit dhe çdo marrëveshje tjetër të parashikuar në këtë Marrëveshje.

Pjesa 7: Ndryshimet

30. Ndryshime në ligj

30.1 Nëse ndodh një ndryshim në ligj i cili nuk është ndryshim cilësues dhe që kërkon nga Koncesionari të ndryshojë ose amendojë projektin, cilësinë ose vëllimin e punimeve apo shërbimeve, Koncesionari paraqet një propozim për ndryshim në përputhje me Klauzolën 32.2.

30.2 Nëse një ndryshim cilësues në ligj ndodh, ose pritet të ndodhë së shpejti, secila nga palët mund të njoftojë palën tjetër dhe Inxhinierin e pavarur me shkrim për efektet e mundshme të një ndryshimi të tillë, duke specifikuar:

30.2.1 Nëse kërkohet zgjidhja nga respektimi i detyrimeve, duke përfshirë detyrimin për të arritur datën e programuar të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose datën e programuar të përfundimit të Aspektit përkatës;

30.2.2 Çdo ndryshim të nevojshëm në Punime apo Shërbime që rezultojnë nga një ndryshim i tillë cilësues në ligj;

- 30.2.3 Nëse kërkohet ndonjë ndryshim në kushtet e kësaj Marrëveshjeje ose të Dokumenteve të tjerë të Projektit;
- 30.2.4 Nëse zbatimi i ndryshimit cilësues në ligj do të rezultojë drejtpërdrejt në një rritje të kostove apo në humbjen e të ardhurave të Koncesionarit;
- 30.2.5 Çdo shpenzim kapital që kërkohet për të zbatuar ndryshimin cilësues në ligj, ose që mund të kursehet;
- 30.2.6 Çdo pëlqim i nevojshëm që do të kërkohet për të zbatuar një ndryshim cilësues në ligj; dhe
- 30.2.7 Mënyrën në të cilën ndryshimi cilësues në ligj mund të prekë çmimet e vëna nga furnitorët e tjerë të shërbimeve të ngjashme me Shërbimet, duke përfshirë firmat e operuara nga aksionerët ose shoqëritë e tyre të lidhura.
- 30.3 Nëse, si rezultat i një ndryshimi cilësues në ligj:
- 30.3.1 Koncesionari nuk është në gjendje të kryejë Punimet me qëllim për të qenë në gjendje të sigurojë Çertifikatën e Përdorimit Paraprak ose Çertifikatën e Përdorimit në lidhje me një Aspekt përkatës deri në datën e programuar për përfundimin paraprak të Aspektit përkatës, ose datën e programuar të përfundimit të Aspektit përkatës;
- 30.3.2 Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë ndonjërin nga detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje; ose
- 30.3.3 Koncesionari i kanë lindur ose do t'i lindin kosto, të cilat ndryshe nuk do t'i kishin lindur, ose nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura, të cilat ndryshe do t'i kishte gjeneruar po të mos kish ndodhur një ndryshim i tillë cilësues në ligj, (duke përfshirë, për shmangien e dyshimeve, rastet kur ky Ndryshim Cilësues në Ligj sjell drejtpërdrejt apo tërthorazi një ndryshim të Kërkesave Mjedisore të përcaktuara në Klauzolën 14),
- Koncesionari mund të përfitojë një përfitim në formën e:
- 30.3.4 Shtyrjes së duhur të datës së programuar të përfundimit paraprak ose datës së programuar të përfundimit në lidhje me një Aspekt përkatës, e cila do të jetë e përshtatshme mjaftueshem për rakordimet dhe performancën e nevojshme;
- 30.3.5 Një amendamenti në Dokumentet e Projektit për të marrë parasysh ndryshimin cilësues në ligj;
- 30.3.6 Të drejtën e kompensimit (duke përfshirë humbjen e fitimit); dhe/ose
- 30.3.7 Zgjidhja nga ndërprerja e kontratës për mospërmbushje të detyrimeve të Koncesionarit.
- 30.4 Koncesionari do të ketë të drejtë për përfitime vetëm në përputhje me Klauzolën 30.3 në rethanat kur:



- 30.4.1 e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për kërkesën e tij për të marrë ndonjë prej këtyre përfitimeve pa vonesa të tepërta, por gjithsesi jo më vonë se 10 (dhjetë) ditësh pune pas hyrjes në fuqi të ndryshimit cilësues;
- 30.4.2 jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditësh pune pas dërgimit të njoftimit të përmendur në Klauzolën 30.4.1:
- (a) i ka dhënë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur një shpjegim të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me ndryshimin cilësues në ligj dhe përfitimet e kërkuara;
 - (b) në rast vonese, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për kohëzgjatjen e përafërt të një vonese të tillë;
 - (c) e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për çdo informacion tjetër të rëndësishëm, që ka të bëjë me ndryshimin kualifikues në ligj; dhe
 - (d) e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për humbjen e pritshme, ose për rritjen e kostove që rezultojnë nga ndryshimi cilësues në ligj,

me kusht që nëse informacioni i plotë nuk është i disponueshëm brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune, Koncesionari të dërgojë një njoftim ku të përcaktojë të gjithë informacionin e disponueshëm, si dhe një njoftim tjetër, ku t'i japë informacion të mëtejshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur çdo 10 (dhjetë) ditë pune pas paraqitjes së njoftimit fillestar; dhe

30.4.3 i ka provuar Inxhinierit të pavarur se:

- (a) Ndryshimi cilësues në ligj ka rezultuar ose do të rezultojë në një vonesë në datën e programuar të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës, ose datën e programuar të përfundimit të Aspektit përkatës, sipas rastit; një rritje të pagesave për ecurinë mujore të punës, në mospërbushjen e detyrimeve të tjera nga Koncesionari, rritjen e kostove, ose në mosgjenerimin e të ardhurave nga Koncesionari; dhe
- (b) Koncesionari ka bërë përpjekje të arsyeshme, në përputhje me praktikën e mirë të sektorit ekonomik për të parandaluar ose zbutur pasojat e ndryshimit cilësues në ligj, kështu që, për të shmangur çdo dyshim, përfitimi i kërkuar i korrespondon vetëm një pjese të pasojave të ndryshimit cilësues në ligj, që nuk do të ishin parandaluar apo zbutur nga Koncesionari me anë të përpjekjeve të tilla të arsyeshme.



30.5 Nëse Koncesionari i ka përbushur detyrimet e tij, të parashikuara në Klauzolën 30.4, dhe Inxhinieri i pavarur i ka dhënë një njoftim me shkrim, ku deklaroi se një ndryshim cilësues në ligj ka ndodhur dhe se Koncesionari duhet të shlyejë përkatësisht detyrimin e tij në përputhje me këtë Klauzolë 30, atëherë:

- 30.5.1 Data e programuar e përfundimit paraprak të Aspektit përkatës ose data e programuar e përfundimit të Aspektit përkatës shtyhen deri në një periudhë kohe, që është proporcionalë me ndryshimin cilësues në ligj;
- 30.5.2 Në varësi të Klauzolës 30.8 dhe 30.10 dhe nëse Koncesionari i kanë lindur ose do t'i lindin shpenzime shtesë, ose ka pësuar ose do të pësojë humbje në të ardhura, të cilat ndryshe nuk do t'i kishte pësuar, apo që do t'i kishte gjeneruar, nëse një ndryshim i tillë cilësues nuk do të kishte ndodhur, Autoriteti Kontraktor e rimbursion Koncesionarin për këto shpenzime dhe/ose të ardhura të munguara (përveç përqindjes së Koncesionarit në shpenzimet kapitale progresive), me qëllim që ta lerë Koncesionarin në një gjendje as më të mirë as më të keqe (duke pasur parasysh kërkesën që Kontraktori do të jetë gjithnjë përgjegjës për përqindjen e Koncesionarit në shpenzimet kapitale progresive), shuma e një rimbursimi të tillë do të vendoset përmes përdorimit të Modelit financiar;
- 30.5.3 Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij për përfundimin e parakohshëm të kontratës për shkak të mospërbushjeve nga Koncesionari të detyrimeve, shkaktuar nga ndryshimi cilësues në ligj; dhe
- 30.5.4 Autoriteti Kontraktor e përjashton Koncesionarin nga detyrimet e tij, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, të cilat janë proporcionale me natyrën e ndryshimit cilësues në ligj,

Me kusht që nëse Koncesionari ose Autoriteti Kontraktor nuk pajtohen me njoftimin me shkrim të Inxhinierit të pavarur, dhënë në përputhje me këtë Klauzolë 30.5, çdo mosmarrëveshje do të vendoset në përputhje me Klauzolën 56. Njoftimi me shkrim i Inxhinierit të pavarur është detyruar për palët, përveç se kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56. Njoftimi me shkrim i Inxhinierit të pavarur është detyruar për palët nëse asnjëra nga palët nuk e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Inxhinieri i pavarur.

- 30.6 Në rase se Koncesionari nuk u jep Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur informacionin deri në njërin prej afateve të parashikuar në këtë Klauzolë 30, ai nuk merr asnjë nga përfitimet e mësipërme si rezultat i ndryshimit cilësues në ligj, derisa një informacion i tillë të jepet, me kusht që Koncesionari të mos marrë asnjë nga përfitimet e Klauzolave 30.5.1 deri në 30.5.4, si pasojë e ndryshimit cilësues përkatës në ligj, për periudhën gjatë së cilës Koncesionari nuk i ka dhënë informacionin e nevojshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur brenda afateve kohore të parashikuara në këtë Klauzolë 30.
- 30.7 Koncesionari është i detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur pa vonesa të tepërta nëse merr dijeni për ndonjë informacion tjetër lidhur me një ndryshim cilësues në ligj dhe e njofton Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e pavarur për ato hollësi të një informacioni të tillë që janë të reja, ose që tregojnë se informacioni i dhenë më parë ka qenë mjaft i pasaktë dhe/ose i gabuar.
- 30.8 Nëse palët bien dakord, ose nëse përcaktohet nga Inxhinieri i pavarur, ose në përputhje me Klauzolën 56, se Koncesionari duhet t'i bëjë të gjitha shpenzimet kapitale të lidhura me ndryshimin cilësues në ligj, Koncesionari bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar financimin e nevojshëm për shpenzime të tilla kapitale, sipas kushteve të pranuar nga Autoriteti Kontraktor dhe Huadhënësit.

30.9 Nëse Koncesionari ka bërë përpjekjet e arsyeshme për të përfutur financim për shpenzime të tilla kapitale shtesë, në përputhje me Klausolën 30.8, por nuk ka mundur t'i sigurojë ato brenda dyzet e pesë (45) ditësh pune nga data e marrëveshjes së palëve, ose përcaktimit sipas Klausolës 56, në varësi të Klausolës 30.10, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit një shumë të barabartë me atë shpenzim kapital (për punën e bërë, siç evidentohet nga një faturë e marrë nga Koncesionari) në përputhje me Klausolën 30.5.2.

30.10 Pjesa e Koncesionarit në shpenzimet kapitale progresive që rrjedh nga pjesa (c) e përkufizimit të ndryshimit kualifikues në ligj përballohet nga Koncesionari. Për pjesën tjetër të shpenzimeve kapitale progresive do të bihet dakord nga palët (ose do të përcaktohen në përputhje me Klausolën 56) dhe i paguhen Koncesionarit në përputhje me Klausolën 30.5.2 dhe Klausolën 25.

31. Ndryshime në standarde

Nëse Autoriteti Kontraktor dëshiron të ndryshojë standardet për të pasqyruar përditësimet, ndryshimet, ose shtesat në këto Standarde, Autoriteti Kontraktor propozon një ndryshim nga ana e tij si Autoritet Kontraktor, në përputhje me Klausolën 32.1.

32. Ndryshime në punimet apo shërbimet

32.1 Ndryshime të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor

32.1.1 Autoriteti Kontraktor mundet që në çdo kohë të kërkojë ndryshime në Punime, Autostradë, ose në Shërbime (duke përfshirë një ndryshim në shkallën e shërbimeve) me anë të një kërkesë me shkrim që ia dorëzon Koncesionarit, ku përcaktohen hollësitë e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Klausolën 32.1.3 ("Njoftimi për ndryshim nga Autoriteti Kontraktor").

32.1.2 Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të kërkojë sa më poshtë bazuar në njoftimin për ndryshim nga Autoriteti Kontraktor:

- (a) Çdo kërkesë sipas të cilës Punimet apo Shërbimet duhen ofruan në një mënyrë që bie ndesh me ligjin apo praktikat e mira të sektorit ekonomik sic përcaktohet nga Projektuesi;
- (b) Ndryshime që kërcënojnë, ose do të kërcënonin seriozisht shëndetin apo sigurinë e personave;
- (c) Ndryshime që do të ndryshonin thellësisht natyrën e Projektit, duke përfshirë natyrën e risqeve dhe standardet;
- (d) Ndryshime që nuk bëjnë pjesë në të drejtat e Autoritetit Kontraktor;
- (e) Ndryshime që do të kërkonin truall shtesë ose truall ekstra (dhe një truall i tillë shtesë ose truall ekstra nuk jepet nga Autoriteti Kontraktor); dhe
- (f) Ndryshime që do të shkaktonin heqjen, pezullimin ose ndryshimin e çdo pëlqimi të nevojshëm ekzistues, ose do të kërkonin një pëlqim të ri të nevojshëm dhe kur nuk ka gjasa të arsyeshme që Koncesionari do të mund

ta merrte pëlqimin e nevojshëm brenda afatit kohor të propozuar për zbatimin e ndryshimit të propozuar nga Autoriteti Kontraktor.

Asgjë në këtë Klauzolë 32.1.2 nuk e pengon Autoritetin Kontraktor nga propozimi i një ndryshimi në këtë Marrëveshje, për të lejuar kryerjen e ndonjë punimi shtesë në Autostradë nga Autoriteti Kontraktor.

32.1.3 Në njoftimin e Autoriteti Kontraktor për ndryshim, Autoriteti Kontraktor deklaron:

- (a) Hollësi të mjaftueshme për ndryshimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, me qëllim që Koncesionari të jetë në gjendje të kryejë një ndryshim tillë të çmuar në kostot dhe të ardhurat e Projektit;
- (b) Nëse ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor kërkon që Autoriteti Kontraktor të paguajë vetë për këtë shpenzim kapital, apo nëse ai pret që Koncesionari të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar financim për një shpenzim të tillë kapital, sikundër parashikohen në Klauzolën 32.1.10; dhe
- (c) Afatin kohor në të cilin Koncesionari duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor një përgjigje dhe ndryshimin e çmuar në kostot dhe të ardhurat e Projektit, por gjithsesi, një afat i tillë nuk duhet të jetë më i shkurtër se 20 (njëzet) ditësh pune pas dorëzimit të njoftimit të Autoritetit Kontraktor për ndryshim.

32.1.4 Koncesionari paraqet një përgjigje sa më shpejt që të jetë e mundur por gjithsesi, jo më vonë se në afatin e paraqitur në njoftimin për ndryshim të Autoritetit Kontraktor. Përgjigja duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- (a) Nëse është e nevojshme që Koncesionari të shlyejë detyrimin për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe nëse një Ndryshim i tillë, i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, bën të nevojshme shtyrjen e datës së programuar të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës apo të datës së programuar të përfundimit të Aspektit përkatës;
- (b) Ndonjë ndryshim të nevojshëm në Punimet apo Shërbimet (duke përfshirë një ndryshim në shkallën e shërbimeve), që rezulton nga një ndryshim i tillë i propozuar nga Autoriteti Kontraktor;
- (c) Nëse është e nevojshme të bëhet ndonjë ndryshim në kushtet e kësaj Marrëveshjeje ose të Dokumenteve të tjera të Projektit;
- (d) Nëse zbatimi i ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor do të rezultojë drejtpërdrejt në një rritje apo humbje të të ardhurave të Koncesionarit;
- (e) Ndonjë shpenzim kapital që mund të nevojitet për zbatimin e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, apo që mund të kursehet, dhe shpenzime të tilla duhet të bazohen në çmimet për njësi të paraqitura në kuadër të dokumentacionit të tenderit të Koncesionarit, ku ekzistojnë çmimet për njësi nër llojin e shpenzimit kapital që rezulton nga ndryshimi i kërkuar nga



Autoriteti Kontraktor, të indeksuar me anë të përdorimit të formulës së mëposhtme:

$$UP_i = UP_0 \times I$$

Ku:

UP_i është çmimi përkatës i përditësuar për njësi që duhet përdorur si bazë për shpenzimet kapitale;

UP_0 është çmimi përkatës për njësi, siç është paraqitur fillimisht; dhe

I është indeksi, i llogaritur si më poshtë: $I = PPI_i / PPI_0$

Ku:

I = Indeksi në vitin i ;

PPI_0 = Indeksi i BE-së për çmimet e prodhimit në të cilin bie data bazë financiare;

PPI_i = Indeksi i BE-së për çmimet e prodhimit në vitin e fundit për të cilin ka të dhëna të disponueshme për llogaritjen e çmimit të përditësuar për njësi.

Kur në dokumentet e tenderit të Koncesionarit nuk është përfshirë ndonjë çmim përkatës për njësi për llojin e shpenzimit kapital që rezulton nga ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, ndryshimi në shpenzimin kapital bazohet në referencën ndaj çmimeve mbizotëruese referencë për njësi për punime të ngjashme në Shqipëri, sikurse botohen herë pas here në Manuale;

- (f) Çdo pëlqim të nevojshëm që do të kërkohej për të zbatuar ndryshimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;
- (g) nëse ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor do të rezultojë ose pritet të rezultojë në një shkelje të kësaj Marrëveshjeje ose, siç mund të jetë rasti, në paaftësinë e Koncesionarit për të përmbushur këtë Marrëveshje;
- (h) mënyrën e propozuar të pranimit të ndryshimeve në kryejën e Punimeve, ndërtimin e Autostradës, ose modifikimet funksionale të shërbimeve që do të preken nga ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor; dhe
- (i) ndonëse subvencioni i Autoritetit Kontraktor vazhdon, nivelin e ri të propozuar të tij, dhe pas përfundimit të subvencionit të Autoritetit Kontraktor, çdo ndryshim të propozuar në të ardhurat e garantuara nga trafiku, pragun e ndarjes së të ardhurave nga trafiku dhe/ose në shkallët e ndryshuara të taksës së rrugës,

me kusht që Koncesionari të mos mund të ngrejë më pas ndonjë padi në lidhje me efektet negative të ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, që nuk ishte përfshirë në përgjigjen e tij.



32.1.5 Sapo Autoriteti Kontraktor merr përgjegjjen e Koncesionarit sipas Klauzolës 32.1.4, palët diskutojnë përmbajtjen e saj dhe bien dakord për:

- (a) Mënyrën për të evidentuar se Koncesionari ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme në lidhje me Nënkontraktorët (duke përfshirë, sipas rastit, marrjen e ofertave konkurruese) për të zbutur çdo rritje dhe për të maksimizuar zbritjet e kostove;
- (b) Mënyrën e përcaktimit të shumës së kërkuar për shpenzimet kapitale;
- (c) Mënyrën e verifikimit se si kostot që do të kursehen si rrjedhojë e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor do të merren parasysh në nivelin e ri të subvencionit të Autoritetit Kontraktor, në të ardhurat e garantuara të trafikut, pragu e ndarjes së të ardhurave nga trafiku dhe/ose në shkallët e ndryshuara të taksës së rrugës, të parashikuara në Klauzolën 32.1.4(i); dhe
- (d) Ndryshimet e nevojshme në kushtet e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë çdo ndryshim në shumën e nivelit të ri të subvencionit të Autoritetit Kontraktor, në të ardhurat e garantuara të trafikut, pragu e ndarjes së të ardhurave nga trafiku dhe/ose në shkallët e ndryshuara të taksës së rrugës (siç kërkohet në përputhje me Klauzolën 32.1.4(i)) që kërkohen për ta lënë Koncesionarin në një gjendje as më të mirë as më të keqe).

32.1.6 Në rast se palët nuk mund të bien dakord për çështjet e paraqitura në Klauzolën 32.1.5, mosmarrëveshja e tyre vendoset sipas Klauzolës 56.

32.1.7 Sapo palët arrijnë një marrëveshje ose, në rastin e mosmarrëveshjeve të vendosura në përputhje me Klauzolën 56, Autoriteti Kontraktor, pa vonesa të tepërta:

- (a) Ose konfirmon me shkrim pëlqimin e tij me kushtet e rëna dakord dhe me kushtet e tjera për zbatimin e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor; ose
- (b) E tërheq njoftimin për ndryshim të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

32.1.8 Në se Autoriteti Kontraktor nuk e konfirmon pëlqimin e tij për kushtet e rëna dakord në lidhje me zbatimin e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor (tani e tutje "Konfirmimi i Autoritetit Kontraktor për ndryshimin") brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga dita e rënies dakord për përmbajtjen e përgjigjes, në përputhje me procedurën e Klauzolës 32.1.5, ose të vendosur në përputhje me Klauzolën 56, njoftimi për ndryshimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor do të konsiderohet se është tërhequr. Në rastin që Autoriteti Kontraktor e tërheq njoftimin për ndryshimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me Klauzolën 32.1.7(b) ose njoftimi për ndryshim nga Autoriteti Kontraktor konsiderohet se është tërhequr në përputhje me këtë Klauzolë 32.1.8, atëherë, nëse Koncesionari i ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Klauzole 32, Autoriteti Kontraktor i rimbursion Koncesionarit kostot e drejtpërdrejta të arsyeshme që i kanë lindur Koncesionarit gjatë kundërvperimit të tij



- 32.1.9 Nëse Koncesionari nuk përdor burimet e tij për të zbatuar ndryshimin, ai vepron në përputhje me praktikën e mirë të sektorit ekonomik, për të nxjerrë përfitimin më të mirë për paratë e shpenzuara nga Autoriteti Kontraktor për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për realizimin e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse.
- 32.1.10 Nëse ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor nuk kërkon financimin e shpenzimit kapital nga Autoriteti Kontraktor, atëherë Koncesionari do të bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të siguruar financimin e nevojshëm për shpenzimet kapitale në lidhje me kushtet e pranueshme në mënyrë të arsyeshme nga Koncesionari dhe Huamarrësit.
- 32.1.11 Nëse Koncesionari i ka bërë përpjekjet e tij të arsyeshme për të siguruar financimin e kërkuar, por nuk ka mundur ta sigurojë atë brenda dyzet e pesë (45) ditësh pune nga data e konfirmimit të ndryshimit nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit një shumë të barabartë me pjesën e shpenzimit kapital për të cilin nuk mund të gjendet financim ose përpara datës që bie dyzet e pesë (45) ditë pune pas datës së konfirmimit të ndryshimit nga Autoriteti Kontraktor, me kusht që palët të bien dakord për:
- (a) Datat e duhura të pagesave nga Autoriteti Kontraktor, që lidhen me vlerat dhe datat përkatëse të vlerave individuale që i duhen paguar Koncesionarit;
 - (b) Çdo kusht që duhet përmbushur me qëllim që të bëhen pagesat dhe mënyrën e verifikimit të kushteve të tilla; dhe
 - (c) Faktin se Autoriteti Kontraktor do t'ia bëjë pagesat Koncesionarit në datat përkatëse të rena dakord, me kusht që jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune përpara datës së duhur:
 - (i) Autoriteti Kontraktor të ketë marrë një faturë; dhe
 - (ii) Autoriteti Kontraktor të ketë marrë prova se kushtet për pagesën përkatëse janë përmbushur.
- 32.1.12 Nëse Koncesionari ka bërë përpjekje të arsyeshme, por nuk ka qenë në gjendje të sigurojë financim për shpenzimin kapital dhe Autoriteti Kontraktor nuk merr përsipër të paguajë shpenzimin kapital, Koncesionari nuk është i detyruar të zbatojë ndryshimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.
- 32.1.13 Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit në lidhje me një ndryshim të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me këtë Klauzolë 32.1, një mosmarrëveshje e tillë fillimisht do t'i dërgohet Inxhinierit të pavarur. Vendimi i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Inxhinieri i pavarur.



32.2 Ndryshimet e propozuara nga Koncesionari

32.2.1 Koncesionari mundet që, në përputhje me këtë Klauzolë 32.2, të propozojë ndryshime në Punimet apo Shërbimet, duke i paraqitur një njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktor (“Njoftimi i Koncesionarit për ndryshim”).

32.2.2 Në njoftimin e tij për ndryshim, Koncesionari bën të ditur:

- (a) Natyrën e ndryshimit të propozuar nga Koncesionari me hollësi të mjaftueshme, me qëllim që t’i japë mundësi Autoritetit Kontraktor të vlerësojë propozimin në mënyrë të kualifikuar;
- (b) Nëse në lidhje me ndryshimin e kërkuar nga Koncesionari është e nevojshme të kërkohet shlyerja e detyrimeve të tij, sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe nëse një ndryshim i tillë nga Koncesionari ka gjasa të shkaktojë vonesa në datën e programuar të përfundimit paraprak të Aspektit përkatës, ose në datën e programuar të përfundimit të Aspektit përkatës;
- (c) Një shpjegim të shkaqeve për të cilat ndryshimi kërkohet nga Koncesionari;
- (d) Një shpjegim të efektit të pritshëm të ndryshimit të kërkuar nga Koncesionari;
- (e) Nëse, ndërsa vazhdon ende subvencioni i Autoritetit Kontraktor, ose kur subvencioni i Autoritetit Kontraktor ka mbaruar, të ardhurat e garantuara nga trafiku duhet të rregullohen për shkak të ndryshimit të kërkuar nga Koncesionari, duke dhënë një justifikim të hollësishëm për rregullimin; dhe
- (f) Nëse është e nevojshme, datën në të cilën Autoriteti Kontraktor është i detyruar të konfirmojë nëse e pranon apo e refuzon propozimin.

32.2.3 Autoriteti Kontraktor e vlerëson me mirëbesim njoftimin e Koncesionarit për ndryshim, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përfshirë, por pa u kufizuar me:

- (a) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Koncesionari në realizimin e Punimeve, shfrytëzimin e Autostradës dhe ofrimin e shërbimeve dhe riskun e çënimit të ecurisë së punës;
- (b) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Koncesionari në marrëdhëniet ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe të tretëve;
- (c) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Koncesionari në gjendjen financiare të Koncesionarit dhe aftësinë e tij për të zbatuar ndryshimin e propozuar nga Koncesionari;
- (d) Opininion e Inxhinierit të pavarur në lidhje me arsyeshmërinë e propozimit të Koncesionarit;
- (e) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Koncesionari në gjendjen e Autostradës në datën e përfundimit dhe



(f) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Koncesionari në risqet dhe kostot e përballuara nga Autoriteti Kontraktor.

- 32.2.4 Palët e diskutojnë brenda 20 ditësh pune njoftimin e Koncesionarit për ndryshim dhe Autoriteti Kontraktor mund të propozojë ndryshime të tjera dhe të pranojë ose të hedhë poshtë njoftimin për ndryshim nga Koncesionari, pa deklaruar ndonjë arsye, me kusht që Autoriteti Kontraktor të mos hedhë poshtë një ndryshim të propozuar nga Koncesionari kur një ndryshim i tillë kërkohet si rezultat i një ndryshimi në ligj. Koncesionari nuk ka të drejtë të kërkojë të shlyeje detyrimet e tij, apo nga ndonjë kompensim, si rezultat i një ndryshimi të kërkuar nga Koncesionari si rezultat i një ndryshimi në ligj, i cili nuk është ndryshim cilësues në ligj.
- 32.2.5 Nëse Autoriteti Kontraktor e pranon njoftimin për ndryshim nga Koncesionari, palët bien dakord për ndryshimet e nevojshme në kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe në dokumentet e tjera të Projektit.
- 32.2.6 Nëse si rezultat i ndryshimit të kërkuar nga Koncesionari, duke përfshirë çdo ndryshim në standardet e propozuara nga Koncesionari, kostot që i linden Koncesionarit, Nënkontraktorët të ndërtimit ose Nënkontraktorët të shfrytëzimit ulen, Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari i ndajnë këto kursime në bazë 50:50. Mekanizmi për t'u përdorur për një ndarje të tillë do të diskutohet dhe bihet dakord ndermjet Palëve.

32A Punimet gjeoteknike

32A.1 Punimet gjeoteknike fillestare

- 32A.1.1 Koncesionari kryen punimet gjeoteknike fillestare, sikundër përcaktohet në Shtojcën 6 dhe në përputhje, me planin gjeoteknik fillestar.
- 32A.1.1A Pavarësisht nga Data e programuar për Përfundimin e Punimeve gjeoteknike fillestare dhe Data e programuar e përfundimit paraprak të punimeve gjeoteknike fillestare, në rastin që ndonjë punim gjeoteknik fillestar nuk është përfunduar deri në datën që përbën Datën e Fillimit të punimeve kapitale + 2 vite, çdo punim shtesë i kërkuar në lidhje me fusha të përcaktuara si pjesë të Punimeve gjeoteknike fillestare që dalin pas datës që është data e Fillimit të Punimeve Kapitale +2 vjet nuk do të konsiderohet ngjarje e jashtëzakonshme gjeoteknike dhe nuk do të kërkohej për t'u përmbushur nga Koncesionari si pjesë e Punimeve gjeoteknike fillestare me shpenzimet dhe riskun e Koncesionarit.

Plani gjeoteknik fillestar

- 32A.1.2 Koncesionari i propozon dhe i paraqet Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin e zbatimit teknik në lidhje me punimet gjeoteknike fillestare ("Plani gjeoteknik fillestar") në një datë jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi.
- 32A.1.3 Brenda 1 (një) muaji nga marrja e planit gjeoteknik fillestar, Autoriteti Kontraktor e njofton Koncesionarin se është dakord me planin gjeoteknik fillestar, ose i dërgon Koncesionarit amendamentet dhe/ose komentet rreth planit gjeoteknik fillestar.



Në se Autoriteti Kontraktor nuk e dërgon njoftimin e tij deri në afatin e mësipërm kohor, plani gjeoteknik fillestar konsiderohet se është pranuar nga Autoriteti Kontraktor.

32A.1.4 Në rast se Autoriteti Kontraktor ngre ndonjë kundërshtim për të gjithë ose për një pjesë të planit gjeoteknik fillestar brenda 1 (një) muaji pas marrjes nga Koncesionari i njoftimit për të, Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari fillojnë negociata për të diskutuar amendamentet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose komentet për planin gjeoteknik fillestar. Për shmangien e çdo dyshimi, konfirmohet se shkaqet për të cilat Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë Planet gjeoteknike fillestare janë se ato nuk përputhen me Marrëveshjen e Koncesionit dhe ligjet e zbatueshme pas Datës së hyrjes në fuqi.

32A.1.5 Në rast se:

- (a) Koncesionari i pranon komentet ose amendamentet e Autoritetit Kontraktor në planin gjeoteknik fillestar; ose
- (b) palët vendosin për këto amendamente ose komente në përputhje me Klauzolën 32A.1.4,

Koncesionari nxjerr një version të rishikuar të Planit gjeoteknik fillestar, në të cilin përfshihen amendamentet dhe/ose komentet e tilla sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur.

Në rastin e mosrënies dakord nga palët për amendamentet përkatëse në Planin gjeoteknik fillestar, Inxhinieri i pavarur, në varësi të dispozitave të Shtojcës 6, përcakton amendamentet e duhura që duhen bërë në të. Vendimi i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveç se kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me Klauzolën 56 brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga marrja e vendimit të Inxhinierit të pavarur.

32A.2 Sistemi i menaxhimit të riskut gjeoteknik

32A.2.1 Koncesionari brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data në të cilën është miratuar plani gjeoteknik fillestar në përputhje me Klauzolën 32A.1, i paraqet Autoritetit Kontraktor një plan në lidhje me sistemin e menaxhimit të riskut gjeoteknik në përputhje me Seksionin 4.2.3.1 dhe Lidhjen 5 të Shtojcës 5.

Punimet dhe planet gjeoteknike të mëpasshme

32A.2.2 Koncesionari:

- (a) brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data në të cilën plani gjeoteknik fillestar është miratuar në përputhje me Klauzolën 32A.1, përgatit dhe i dërgon Autoritetit Kontraktor një plan të kundërveprimeve në raste të jashtëzakonshme për shkaqe gjeoteknike, i cili është pjesë e planit të kundërveprimeve në raste të jashtëzakonshme, në përputhje me Lidhjen 7 e Shtojcës 5: dhe

- (b) brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data në të cilën është miratuar plani gjeoteknik fillestar, në përputhje me Klauzolën 32A.1, i dërgon Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të pavarur një plan menaxhimi të punimeve gjeoteknike (ky plan duhet të jetë i ngjashëm me planet trevjeçare të riparimeve kapitale të përgatitur për të gjithë komponentët e tjerë të Autostradës, në përputhje me Seksionin 6.3.1 të Shtojcës 5);

(veç e veç quhen një “Plan gjeoteknik” dhe së bashku “Planet gjeoteknike”).

32A.2.3 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga marrja e një plani gjeoteknik, Autoriteti Kontraktor e njofton Koncesionarin se pajtohet me planin gjeoteknik, ose i dërgon Koncesionarit amendamentet dhe/ose komentet e tij për planin gjeoteknik. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk dërgon njoftim deri në afatin e mësipërm, Planin gjeoteknik konsiderohet se është miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

32A.2.4 Nëse Autoriteti Kontraktor ngre ndonjë kundërshtim për të gjithë ose një pjesë të Planit gjeoteknik brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune pas marrjes nga Koncesionari të njoftimit për to, Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari fillojnë negociatat për të diskutuar amendamentet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose komentet e Autoritetit Kontraktor për Planin gjeoteknik.

32A.2.5 Në qoftë se:

- (a) Koncesionari i pranon komentet ose amendamentet e Autoritetit Kontraktor në Planin gjeoteknik; ose
- (b) palët vendosin për amendamente ose komente të tilla në përputhje me Klauzolën 32A.2.4,

Koncesionari nxjerr një variant të rishikuar të Planit gjeoteknik përkatës, i cili i përfshin këto amendamente dhe/ose komente sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur.

Në rastin që palët nuk bien dakord për amendamentet përkatëse në Planin gjeoteknik, Inxhinieri i pavarur vendos për amendamentet e duhura që i duhen bërë atij. Vendimi i Inxhinierit të pavarur është detyrues për palët, përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë, në përputhje me Klauzolën 56, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga marrja e vendimit të Inxhinierit të pavarur.

32A.2.6 Në datën 1 ose përpara datës 1 dhjetor të secilit vit të Kontratës, Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktor një plan të përditësuar të menaxhimit të punimeve gjeoteknike, në përputhje me Seksionin 6.3.1 të Shtojcës 5 (por, në çdo rast, përdoret procedura e miratuar në Klauzolën 32A.2.3 deri në Klauzolën 32A.2.5).

Punimet e mëpasshme gjeoteknike

32A.2.7 Në rast se kërkohet të kryen punime të mëpasshme gjeoteknike, Autoriteti Kontraktor organizon një tender të hapur dhe Koncesionari dhe palët e treta lejohen të paraqesin ofertat e tyre.

32A.2.8 Në rast se Koncesionari e fiton tenderin për të kryer punimet e mëpasshme gjeoteknike, pagesa nga Autoriteti Kontraktor për punime të tilla të mëpasshme gjeoteknike bëhet, pavarësisht nga kjo Marrëveshje dhe në përputhje me dokumentacionin e veçantë të nënshkruar në kuadër të tenderit.

32A.2.9 Në rast se një palë e tretë e fiton tenderin për të kryer ndonjërin prej punimeve të mëpasshme gjeoteknike, Koncesionari, i cili është palë në çdo marrëveshje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe palës së tretë, dhe ku ai do të ketë përfitimin e:

32A.2.9 (a) të drejtës për të monitoruar aktivitetin e palës së tretë në Territorin e Projektit; dhe

32A.2.9 (b) garancinë e palës së tretë, në lidhje me defektet në punën e kryer,

i jep ndihmën e arsyeshme Autoritetit Kontraktor dhe palës së tretë, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar me, dhënien e kopjeve të çdo dokumentacioni përkatës palës së tretë.

32A.2.10 Nëse Autoriteti Kontraktor zgjedh të udhëzojë një palë të tretë për të kryer punimet e mëvonshme gjeoteknike dhe punimet e mëvonshme gjeoteknike nuk kanë filluar brenda 6 (gjashtë) muajsh nga koha e parashikuar për fillimin e punës, atëherë Koncesionari mund t'i kryejë vetë punimet vijuese gjeoteknike dhe të kërkojë koston e kësaj pune me anë të një fature dërguar Autoritetit Kontraktor, kosto të cilat duhen miratuar nga Inxhinieri i pavarur në përputhje me preventivin e parashikuar në Shtojcën 7 dhe bazuar në çmimet për njësi, të indeksuara në bazë të formulës të dhënë në Klauzolën 32.1.4(e).

32A.2.11 Të gjitha punimet vijuese gjeoteknike kryhen në mënyrë të kënaqshme për Inxhinierin e pavarur i cili i miraton ato.

32A.3 Punimet gjeoteknike të jashtëzakonshme dhe rehabilituese

32A.3.1 Në varësi të Klauzolës 32A.1.1A, ndodhja e një ngjarjeje gjeoteknike të jashtëzakonshme përbën një shlyerje te detyrimeve.

32A.3.2 Koncesionari e njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor për ndodhjen e një ngjarjeje të jashtëzakonshme gjeoteknike, e cila rezulton në nevojën për të kryer punime gjeoteknike të jashtëzakonshme pastrimi.

32A.3.3 Koncesionari kryen të gjitha punimet e jashtëzakonshme gjeoteknike të pastrimit me shpenzimet e veta dhe Inxhinieri i pavarur i miraton ato (miratim i cili nuk duhet të mos jepet ose vonohet pa arsye) brenda periudhave kohore të përcaktuara në Tabelën 3-2 te gurmës (c) të Seksionit 3.5.3 të Shtojcës 5. Koncesionari, me anë të një fature dërguar Autoritetit Kontraktor, ka të drejtë të kërkojë vlerën, nëse bëhet fjalë, me të cilën koston e punimeve të jashtëzakonshme gjeologjike të pastrimit e kalojnë vlerën prej 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) euro në një periudhë një vjeçare, kosto të cilat duhen aprovuar nga Inxhinieri i pavarur, në përputhje me preventivin e parashikuar në Shtojcën 7 dhe bazuar në çmimet për njësi të paraqitura nga Koncesionari në dokumentet e tij të tenderit, të indeksuara në bazë të formulës së dhënë në Klauzolën

32A.3.4 Inxhinieri i pavarur vlerëson shkakun e ngjarjes së jashtëzakonshme gjeoteknike dhe përgatit një raport për Koncesionarin dhe Autoritetin Kontraktor nëse kërkohen punime të tjera parandaluese, përveç punimeve të kryera në përputhje me Klauzolën 32A.3.3 (“**Punime gjeoteknike rehabilituese**”).

32A.3.5 Nëse kërkohen punimet gjeoteknike rehabilituese, Autoriteti Kontraktor organizon një proces tenderi të hapur dhe Koncesionari dhe palët e treta lejohen të paraqesin ofertat e tyre.

32A.3.6 Nëse Koncesionari e fiton tenderin për të kryer punimet gjeoteknike rehabilituese, pagesa për punime të tilla të mëpasshme gjeoteknike bëhet veçmas nga kjo Marrëveshje dhe në përputhje me dokumentacionin e veçantë të pranuar si rezultat i tenderit.

32A.3.7 Nëse një palë e tretë e fiton tenderin për të kryer punime të tilla gjeoteknike rehabilituese, Koncesionari, që është palë në çdo marrëveshje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe palës së tretë, dhe ku ai ka të drejtë:

32A.3.7 (a) të monitorojë aktivitetin e palës së tretë në Territorin e Projektit; dhe

32A.3.7 (b) të sigurohet nga pala e tretë në lidhje me defektet në punën e bërë,

i jep ndihmën e arsyeshme Autoritetit Kontraktor dhe palës së tretë, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm me, dhënien e kopjeve të çdo dokumentacioni përkatës palës së tretë.

32A.3.8 Nëse Autoriteti Kontraktor e udhëzon një palë të tretë të kryejë punime gjeoteknike rehabilituese dhe punimet gjeoteknike rehabilituese nuk kanë nisur brenda 6 (gjashtë) muajsh nga përfundimi i punimeve të jashtëzakonshme gjeoteknike të pastrimit, atëherë Koncesionari mund t'i kryejë vetë punimet gjeoteknike rehabilituese dhe të kërkojë kostot e një pune të tillë, duke ia faturuar ato Autoritetit Kontraktor, kosto të cilat duhen aprovuar nga Inxhinieri i pavarur në përputhje me preventivin e parashikuar në Shtojcën 7 dhe bazuar në çmimet për njësi të paraqitura nga Koncesionari në dokumentacionin e ofertës së tij, të indeksuara në bazë të formulës së dhënë në Klauzolën 32.1.4(e). Në rast se, në kryerjen e punimeve gjeoteknike rehabilituese, në përputhje me këtë Klauzolë 32A.3.8, kostoja progresive e Koncesionarit për kryerjen e punimeve të tilla gjeoteknike rehabilituese e tejkalon shumë 10 (dhjetë) milion euro, atëherë kjo përbën një mospërbushje të detyrimit nga Autoriteti Kontraktor.

32A.3.9 Inxhinieri i pavarur i inspekton punimet gjeoteknike rehabilituese.

32A.3.10 Të gjitha punimet gjeoteknike rehabilituese kryhen në mënyrë të kënaqshme për të marrë miratimin e Autoritetit Kontraktor.

Pjesa 8: Zhdëmtimi në rast përgjegjësie dhe sigurimi



33. Përgjegjësia dhe premtimi për zhdëmtim

33.1 Koncesionari merr përsipër të kompensojë dëmin, humbjen ose kërkesën për dëmshpërblim të Autoritetit Kontraktor ose të çdo palë të Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë humbje ose kërkesë të bërë nga një palë e tretë, ose nga ndonjë palë e Autoritetit Kontraktor, që nuk vepron në cilësinë e saj si palë e Autoritetit Kontraktor, ndaj Autoritetit Kontraktor, ose e ndonjë pale të Autoritetit Kontraktor, lidhur me plotësimin e detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje, ose me ndonjë veprim apo mosveprim tjetër të Koncesionarit, përveç në rrethana kur dhe në masën që kërkesa për dëmshpërblim vjen nga:

33.1.1 Sjellja e keqe e qëllimshme ose neglizhenca e Autoritetit Kontraktor ose e palës së Autoritetit Kontraktor;

33.1.2 Shkelja nga Autoriteti Kontraktor i kësaj Marrëveshjeje ose e ligjit;

33.1.3 Një kërkesë e një pale të tretë, që lidhet plotësisht me një periudhë përpara datës së kësaj Marrëveshjeje;

33.1.4 Veprimi i Koncesionarit sipas udhëzimeve të përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor dhe/ose përfaqësuesit teknik të Autoritetit Kontraktor dhe kur përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe/ose përfaqësues teknik janë vënë në dijeni nga Koncesionari se veprimi në bazë të këtyre udhëzimeve do të shkaktonte një humbje ose kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj Klauzole 33;

33.1.5 Ndërtimi ose përdorimi i Autostradës plotësisht sipas kësaj Marrëveshjeje, ligjit dhe lejeve ekzistuese.

33.2 Në veçanti, Koncesionari merr përsipër të kompensojë çdo dëm, humbje, ose kërkesë për dëmshpërblim të Autoritetit Kontraktor ose ndonjë pale të Autoritetit Kontraktor si rezultat i:

33.2.1 Një të drejtë për kompensim që rrjedh nga vdekja ose lëndimi personal i një pale të Autoritetit Kontraktor, ose i një pale të tretë;

33.2.2 Një e drejtë për kompensim që rrjedh nga një dëm, shkaktuar një prone të një pale të Autoritetit Kontraktor, një përdoruesi, apo një pale të tretë,

që vjen në çdo rast nga një kërkesë për dëmshpërblim ndaj Autoritetit Kontraktor, ose çdo pale të Autoritetit Kontraktor, në lidhje me ecurinë e plotësimin të detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje, ose me çdo veprim ose mosveprim tjetër të Koncesionarit, përveç në rrethana kur kërkesa ka ardhur si rezultat i një sjelljeje jo të mirë apo neglizhence të Autoritetit Kontraktor apo të një pale të Autoritetit Kontraktor; ose

33.2.3 Një detyrim i Autoritetit Kontraktor ose një pale të Autoritetit Kontraktor, për të paguar çdo penalitet të kërkuar me ligj, me masë administrative, apo ndonjë penalitet apo pagesë tjetër në lidhje me kryerjen ose mosfrimin e shërbimeve ose plotësimin apo mospërbushjen e detyrimeve të tjera të Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje,

Përveç në rrethana kur dhe në masën që kërkesa për dëmshpërblim ka ardhur si rezultat i:

- 33.2.4 Sjelljes së keqe të qëllimshme apo neglizhencës së Autoritetit Kontraktor apo të një pale të Autoritetit Kontraktor;
- 33.2.5 Shkeljes nga Autoriteti Kontraktor i kësaj Marrëveshjeje apo e ligjit;
- 33.2.6 Një kërkesë për dëmshpërblim i një pale të tretë, që lidhet plotësisht me një periudhë përpara datës së kësaj Marrëveshjeje;
- 33.2.7 Veprimet të Koncesionarit në bazë të udhëzimeve të përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor dhe/ose të përfaqësuesit teknik dhe kur përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe/ose përfaqësues teknik janë vënë në dijeni se të vepruarit në bazë të këtyre udhëzimeve do të shpinte në humbjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj Klauzole 33; ose
- 33.2.8 (në lidhje me Klauzolën 33.2.1 dhe 33.2.2, por jo në lidhje me Klauzolën 33.2.3), si rezultat i ndërtimit ose përdorimit të Autostradës plotësisht në përputhje me këtë Marrëveshje, ligjin dhe lejet ekzistuese.

33.3 Kur duket se Autoriteti Kontraktor ka ose mund të ketë të drejtë të kompensohet nga Koncesionari për ndonjë dëm, humbje apo kërkesë për dëmshpërblim në lidhje me të gjithë përgjegjësinë që rrjedh nga një dëm, humbje ose kërkesë e tillë, Autoriteti Kontraktor i jep Koncesionarit të gjitha hollësitë përkatëse të dëmit, humbjes apo kërkesës për dëmshpërblim dhe Koncesionari ka të drejtë:

33.3.1 Ta kundërshtojë kërkesën për dëmshpërblim të Autoritetit Kontraktor me shpenzimet e vetë Koncesionarit; dhe

33.3.2 të ndërmarrë një mbrojtje, kundërshtim, kompromis apo apelim të një kërkesë për dëmshpërblim dhe çdo negociatë të rastësishme,

dhe Autoriteti Kontraktor i ofron Koncesionarit bashkëpunim, qasje dhe asistencë të arsyeshme për qëllimet e shqyrtimit dhe kundërshtimit të një kërkesë të tillë për dëmshpërblim. Autoriteti Kontraktor nuk mund të zgjidhë apo heqë dorë nga ndonjë kërkesë për dëmshpërblim që është objekt i procedurave të parashikuara në këtë Klauzolë 33.3 pa pëlqimin paraprak me shkrim të Koncesionarit.

33.4 Sipas Klauzolës 27, Koncesionari nuk mund të kërkojë ndonjë kompensim nga Autoriteti Kontraktor apo ndonjë palë e Autoritetit Kontraktor, bazuar në faktin se atij i është kërkuar një kompensim në lidhje me ndonjë humbje, dhe/ose kërkesë për dëmshpërblim nga ndonjë person.

33.5 Autoriteti Kontraktor, përveç për atë që është përcaktuar në këtë marrëveshje, do të dëmshpërblejë plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe do të mbajë të padëmtuar Koncesionarin ndaj çdo pretendimi të palës së tretë në bazë të ngjarjeve apo mosveprimeve apo ndonjë rrethanë tjetër të lidhur me Autostradën me origjinë para datës së parë për fillimin e punimeve për autostradën, përveç në rastet kur kërkesat e tilla janë të shkaktuara nga veprime neglizhente ose mosveprimet e Koncesionarit ose ndonjë prej punonjësve të tij, agjentët dhe kontraktorët ose shkelje nga ana e Koncesionarit e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Detyrimi i Autoritetit Kontraktor për të dëmshpërblur Koncesionarin sic prashikohet në këtë Klauzolë 33.5, do të reduktohet në mënyrë proporcionale me masën që veprimet ose mosveprimet

neglizhente te Koncesionarit ose ndonjë prej punonjësve të tij, agjentët dhe kontraktorët kanë kontribuar për kete demtim, humbje, dëm, kosto dhe shpenzime.


34. Sigurimi

34.1 Sigurimi i nevojshëm

34.1.1 Koncesionari blen dhe mban sigurimet e nevojshme në bazë të Shtojcës 12 me kushtet e përcaktuara në Shtojcën 12 dhe këtë Klauzolë 34. Koncesionari ia dërgon kushtet e propozuara të sigurimeve të nevojshme Autoritetit Kontraktor (duke përfshirë kufijtë e shumave të zbritshme, zgjerimet dhe përjashtimet e mbulimit) për t'i parë dhe për të dhënë pëlqim të paktën 20 (njëzet) ditë pune përpara blerjes së një sigurimi të tillë të nevojshëm. Autoriteti Kontraktor, në çdo kohë brenda 10 (dhjetë) ditësh pune, ka të drejtë të kërkojë amendamente në kushtet e propozuara të sigurimeve të nevojshme (duke vepruar me arsye), nëse këto nuk pasqyrojnë kërkesat e Shtojcës 12 ose të kësaj Klauzole 34.

34.1.2 Koncesionari blen dhe mban, dhe siguron që Nënkontraktorët të blejnë dhe mbajnë, të gjitha sigurimet e nevojshme me ligj.

34.1.3 Koncesionari është përgjegjës me shpenzimet e veta për pagesën e të gjitha primeve në lidhje me sigurimet e nevojshme dhe sigurimet e kërkuara me ligj, ndërsa risqet që lidhen me shumat e zbritshme dhe/ose tepricat ose pamjaftueshmërinë e shumës së siguruar përballohen nga Koncesionari. Fakti që Koncesionari është ose jo i detyruar të blejë sigurimin e risqeve të caktuara, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk e cenon palën që përballon pasojat financiare të një risku të tillë.



34.2 Kushtet dhe afatet e sigurimeve të nevojshme

34.2.1 Sigurimet e nevojshme:

- (a) Do të bëhen me siguries të njohur, me emër të mirë, me pëlqimin e Autoritetit Kontraktor, miratim i cili nuk duhet të mos jepet apo vonohet pa pasur arsye;
- (b) Përveç humbjes paraprake së të ardhurave nga sigurimi, sigurimet emërtojnë Autoritetin Kontraktor si të bashkësiguruar me çdo palë tjetër që mban sigurimin;
- (c) Përveç humbjes paraprake së të ardhurave nga sigurimi, sigurimet parashikojnë që të ardhurat nga sigurimi të paguhen në Llogarinë e të ardhurave nga sigurimi;
- (d) Në shkallën maksimale të mundshme, do të parashikojnë mbrojtjen nga ulja e vlerës së dëmit në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor si i bashkësiguruar;
- (e) Përmbajnë një Klauzolë për heqjen dorë nga të drejtat e regresit të siguriesve për rimbursim ndaj Autoritetit Kontraktor dhe palëve të

Autoritetit Kontraktor në shkallën e lejuar nga ligji rregullues dhe kontrata e sigurimit;

- (f) Parashikojnë 30 (tridhjetë) ditë përpara njoftimit me shkrim për anulimin, mosrinovimin apo ndryshimin që i duhet dërguar Autoritetit Kontraktor; dhe
- (g) në lidhje me policat e dëmit fizik, parashikojnë pagesën e çdo të hyre që duhet bërë sipas kësaj Klauzole 34.

34.2.2 Koncesionari bën kërkesë për dëmshpërblim nga sigurimet e nevojshme dhe/ose nga çdo sigurim tjetër që Koncesionari ka në shkallë të disponueshme, për të ulur vlerën e çdo kërkesë të Koncesionarit ndaj Autoritetit Kontraktor, në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Vlera e një kërkesë të Koncesionarit për dëmshpërblim nga Autoritetit Kontraktor, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë edhe në lidhje me një ngjarje kompensimi, ngjarje shlyerje te detyrimeve dhe me një forcë madhore, do të ulet me shumën e përfutur nga Koncesionari në bazë të sigurimeve të nevojshme dhe/çdo sigurimi tjetër që Koncesionari ka, ose nga vlera që Koncesionari duhet të kish marrë nga sigurimi i nevojshëm, dhe/ose nga çdo sigurim tjetër që Koncesionari ka, dhe/ose me çdo vlerë tjetër që Koncesionari do të kish marrë nëse Koncesionari do të kishte bërë kërkesat e duhura për dëmshpërblim nga sigurimet e nevojshme dhe/ose do t'i kishte mbajtur sigurimet në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe sipas kësaj Marrëveshjeje.

34.2.3 Asnjëra nga palët nuk bën asgjë apo nuk le pa bërë asgjë që do të rezultonte në refuzimin nga ana e një siguruasi të Sigurimit të nevojshëm për të paguar një kërkesë për dëmshpërblim në bazë të çdo sigurimi të nevojshëm ku ajo palë është e siguruar, ose e bashkësiguruar, ose një person shtesë i siguruar.

34.3 Dokumentacioni

Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktor:

- 34.3.1 Me kërkesë, kopje të të gjitha policave të sigurimit që lidhen me sigurimet e nevojshme (bashkë me çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me këto polica sigurimi) dhe Autoriteti Kontraktor ka t'i drejtë të inspektojë ato gjatë orëve të zakonshme të punës;
- 34.3.2 Dëshmi se primet e pagueshme sipas të gjitha policave të sigurimit, të lidhura me sigurimet e nevojshme, janë paguar dhe sigurimet e nevojshme janë në fuqi të plotë, në përputhje me këtë Klauzolë 34 dhe Shtojcën 12; dhe
- 34.3.3 Sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi në apo përpara datës së rinovimit, kopje të dokumentit provizor të sigurimit në lidhje me sigurimet e nevojshme.

34.4 Moshlerja dhe mosmbajtja e sigurimeve të nevojshme

- 34.4.1 Nëse Koncesionari është në shkelje të Klauzolës 34.1, Autoriteti Kontraktor mund të paguajë çdo prim të kërkuar për të mbajtur në fuqi sigurimet e përcaktuara në Klauzolën 34.1, ose mund të blejë vetë një sigurim të tillë të nevojshëm dhe në secilin

rast, Kontraktor ka të drejtë t'i rikuperojë këto shuma nga Koncesionari me anë të një kërkesë me shkrim.

- 34.4.2 Asgjë në këtë Klauzolë 34 nuk e detyron Koncesionarin të blejë një sigurim në lidhje me një risk të pasigurueshëm, përveçse kur shkakun që një risk është i pasigurueshëm, është një veprim ose mosveprim i Koncesionarit, ose i një pale të Koncesionarit.

34.5 Risku i pasigurueshëm

- 34.5.1 Nëse një risk, që zakonisht mbulohet nga sigurimet e nevojshme (përveç humbjes së fitimeve) ose nga sigurimet e kërkuara me ligj, që në çdo rast kërkohen sipas kësaj Marrëveshjeje, bëhet i pasigurueshëm, atëherë:

- (a) Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor për një risk që bëhet i pasigurueshëm brenda 5 (pesë) ditësh pune pas marrjes dijeni për të, por gjithsesi të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara mbarimit apo anulimit të një sigurimi ekzistues në lidhje me atë risk;
- (b) Kur të dyja palët bien dakord, ose kur vendoset në përputhje me Klauzolën 56, se risku është i pasigurueshëm dhe se:
 - (i) Bërja e riskut të pasigurueshëm nuk është shkaktuar kryesisht nga veprimi (veprimet) ose mosveprimi (mosveprimet) e Koncesionarit apo të ndonjë pale të Koncesionarit; dhe
 - (ii) Koncesionari ka provuar përpara Autoritetit Kontraktor se Koncesionari dhe një bord drejtorësh të kujdesshëm të një shoqërie që merret me biznese të njëjta ose kryesisht të njëjta PPP-sh në Evropë me atë që operon Koncesionari, në rrethana të njëjta (në mungesë të llojit të shlyerje të detyrimit të parashikuar në këtë Klauzolë 34.5), do të vepronin në mënyrë të arsyeshme dhe në interesin më të mirë të shoqërisë, nëse vendosnin të pushonin së marri me biznese të tilla, si rezultat i bërjes së atij risku i pasigurueshëm, duke marrë parasysh ndër të tjera (dhe pa kufizim) gjasat e ndodhjes së riskut të pasigurueshëm (nëse nuk ka ndodhur ndërkohë), pasojat financiare për një shoqëri të tillë, nëse një risk i tillë i pasigurueshëm do të ndodhte me të vërtetë (ose ka ndodhur) dhe lehtësues të tjerë të pasojave të tilla të cilat mund të ekzistojnë për një shoqëri të tillë,

Atëherë palët mblidhen për të diskutuar mjetet me anë të të cilit risku duhet menaxhuar apo ndarë (përfshirë shqyrtimin e çështjes së vetë-sigurimit ose shtimit të vetë-sigurimit nga secila palë);

- (c) nëse kërkesat e Klauzolës 34.5.1(a) dhe 34.5.1(b) plotësohen, por palët nuk bien dakord për mënyrën e menaxhimit ose të ndarjes së riskut atëherë:
 - (i) vetëm në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë së një pale të tretë, Autoriteti Kontraktor (me zgjedhjen e vet Autoritetit Kontraktor dhe në varësi të Klauzolës 34.5.1(c)(ii)) ose: f x





- (A) i paguan Koncesionarit një shumë të barabartë me shumën për përfundimin e kontratës për shkak të forcës madhore dhe kjo Marrëveshje zgjidhet; ose
 - (B) zgjedh ta lejojë Marrëveshjen të vazhdojë dhe pas kësaj zbatohet Klauzola 34.5.1(c) (ii) në lidhje me një risk të tillë; dhe
- (ii) në lidhje me policat e dëmit fizik, sigurimin e Përgjegjësishë së Palës së Tretë (nëse Autoriteti Kontraktor zgjedh ta lejojë këtë Marrëveshje të vazhdojë në përputhje me Klauzolën 34.5.1(c)(i)(B)), me sigurimin për fillim të vonuar apo ndërprerje të biznesit (por jo humbjen e fitimeve) dhe sigurimet e nevojshme me ligj, kjo Marrëveshje do të vazhdojë dhe me ndodhjen e riskut (por vetëm për sa kohë që një risk i tillë mbetet i pasigurueshëm), Autoriteti Kontraktor (me zgjedhjen e Autoritetit Kontraktor) ose:
- (A) i paguan Koncesionarit rikuperimin e dëmit të barabartë me të ardhurat nga sigurimi, të cilat do të kishin qenë të pagueshme po qe se sigurimi përkatës do të kish vazhduar të ishte i disponueshëm dhe kjo Marrëveshje do të vazhdojë; ose
 - (B) i paguan Koncesionarit një vlerë të barabartë me shumën e përfundimit për shkak të forcës madhore plus (vetëm në lidhje me Sigurimin e Përgjegjësishë së Palës së Tretë) shumën e të ardhurave nga sigurimi, që do të kishin qenë të pagueshme në kohën e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje,
- (d) kur, sipas Klauzolës 34.5.1(c)(i)(B) ose 34.5.1(c)(ii)(A) kjo Marrëveshje vazhdon, atëherë, gjatë kohës që ajo ekziston, subvencioni i Autoritetit Kontraktor zbritet çdo vit për të cilin sigurimi përkatës nuk është mbajtur, në një vlerë të barabartë me primin e paguar (ose që do të ishte paguar) nga Koncesionari në lidhje me riskun përkatës në vitin përpara se ai të bëhej risk i pasigurueshëm (i indeksuar nga data që risku bëhet i pasigurueshëm) dhe, kur subvencioni i Autoritetit Kontraktor ka përfunduar, një ulje e tillë do të përdoret në fakt për të ardhurat e garantuara nga trafiku. Kur risku është i pasigurueshëm për një pjesë të vitit, vetëm ulja e subvencionit të Autoritetit Kontraktor ose të ardhurave të garantuara të trafikut do të përpjesëtohen me numrin e muajve për të cilët risku është i pasigurueshëm; dhe
- (e) kur, sipas Klauzolave 34.5.1(c)(i)(B) ose 34.5.1(c)(ii)(A) kjo Marrëveshje vazhdon, Koncesionari i drejtohet tregut të sigurimeve të paktën çdo 3 (tre) muaj për të konstatuar nëse risku vazhdon të jetë i pasigurueshëm. Sapo Koncesionari merr dijeni se risku nuk është më i pasigurueshëm, Koncesionari blen dhe mban ose prokuron blerjen ose mbajtjen e sigurimit (që duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur) për një risk të tillë në shtesë me këtë Marrëveshjeje.

h

34.6 Padisponueshmëria e kushteve të sigurimit

34.6.1 Palët bien dakord që:

- (a) nëse, me rinovimin e një sigurimi që Koncesionarit i kërkohet të mbajë ose të prokurojë mbajtjen e tij sipas kësaj Marrëveshjeje:
 - (i) një kusht i sigurimit nuk është i disponueshëm për Koncesionarin në tregun botëror të sigurimeve me sigurues me emër të mirë; dhe/ose
 - (ii) primi i sigurimit i pagueshëm për sigurimin, që e përfshin një kusht të tillë të sigurimit, është nga ata kushte të sigurimit që zakonisht nuk përfshihen në sigurimet e blera në tregun botëror të sigurimeve me emër të mirë nga Koncesionarët,

përveç se, në secilin rast, për shkak të një apo më shumë veprimesh apo mosveprimesh të Koncesionarit dhe/ose të një pale të Koncesionarit, atëherë do të përdoret Klauzola 34.6.1(b) ose 34.6.1(c) (sipas rastit);

- (b) nëse është rënë dakord ose është vendosur se do të përdoret Klauzola 34.6.1(a), atëherë, Koncesionari nuk është i detyruar të respektojë detyrimet e tij të Klauzolës 34.1 dhe Klauzolës 34.2 dhe/ose të Shtojcës 12 në lidhje me atë kusht të caktuar të sigurimit dhe Koncesionari nuk do të konsiderohet se ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me mbajtjen e sigurimit të nevojshëm sipas kësaj Marrëveshjeje, si rrjedhojë e mosmbajtjes së sigurimit që përfshin një kusht të tillë siguri, për aq kohë sa rrethanat përkatëse të përshkruara në Klauzolën 34.6.1(a) vazhdojnë të zbatohen për një kusht të tillë të sigurimit;

- (c) për aq sa palët bien dakord (duke vepruar në mënyrë të arsyeshme), ose është vendosur sipas Klauzolës 56, se ekziston mundësia për të gjetur një kusht alternativ, ose për një kusht zëvendësues dhe/ose kushti i sigurimit mund të gjendet nga Koncesionari në tregun botëror të sigurimeve, i cili po të përfshihej në policën përkatëse të sigurimit do ta adresonte plotësisht ose pjesërisht pamundësinë e Koncesionarit për të mbajtur ose prokuruar mbajtjen e policës së sigurimit me kushtin përkatës të sigurimit, me një kosto që Koncesionarët zakonisht janë (në një kohë të tillë) të gatshëm të paguajnë, Koncesionari e mban ose prokuron mbajtjen e sigurimit, duke përfshirë një kusht dhe/ose afat të tillë alternativ ose zëvendësues;

- (d) Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por gjithsesi brenda 5 (pesë) ditësh pune nga marrja dijeni se ka gjasa të përdoret Klauzola 34.6.1(a)(i) dhe/ose Klauzola 34.6.1(a)(ii) (pasi mbaron siguri përkatës që është në atë kohë në fuqi) ose se në fakt përdoren në lidhje me një kusht të sigurimit (pavarësisht nga shkaku për këtë gjë). Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktor një informacion të tillë sipas kërkesës së arsyeshme të Autoritetit Kontraktor në lidhje me padisponueshmërinë e kushtit të sigurimit dhe palët takohen për të



diskutuar njetet me anë të të cilëve një padiponueshmëri e tillë duhet menaxhuar sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur; dhe

- (e) Në rastin kur Klauzola 34.6.1(a) përdoret në lidhje me një kusht sigurimi, (pavarësisht nga arsyet për këtë gjë), Koncesionari i drejtohet tregut të sigurimeve të paktën çdo 3 (tre) muaj për të përcaktuar nëse Klauzola 34.6.1(a) vazhdon të jetë e zbatueshme për kushtin e sigurimit. Sapo Koncesionari mëson se Klauzola 34.6.1(a) ka pushuar së zbatuari për kushtin e Sigurimit, Koncesionari blen dhe mban ose prokuron blerjen dhe mbajtjen e sigurimit (që duhet gjetur sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur) duke përfshirë një sigurim të tillë në përputhje me këtë Marrëveshje.

34.7 Llogaria e të ardhurave nga sigurimi

Në varësi të Klauzolës 34.10, Koncesionari krijon dhe mban gjatë gjithë kohës një llogari për të ardhurat nga sigurimi në emrat e Koncesionarit dhe të Autoritetit Kontraktor dhe, të gjitha të ardhurat nga sigurimi që i paguhen Koncesionarit në bazë të çdo police të dëmit fizik në lidhje me një ngjarje të vetme (ose një seri ngjarjesh të lidhura) në një vlerë që e tejkalon shumën e 4,000,000 (katër milion) euro (e indeksuar) do të paguhet në llogarinë e të ardhurave nga sigurimi. Autoriteti Kontraktor i ofron Koncesionarit bashkëpunimin e nevojshëm për të hapur llogarinë. Të gjitha tërheqjet nga të ardhurat nga sigurimi kërkojnë pëlqimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor në përputhje me Klauzolën 34.10 (me kusht që Autoriteti Kontraktor të konsiderohet se ka dhënë pëlqimin e tij për këto tërheqje nëse nuk i është përgjigjur një kërkesë të Koncesionarit brenda 10 (dhjetë) ditësh pune) dhe, pas ditës së përfundimit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i marrë të ardhurat nga sigurimi pa pëlqimin e Koncesionarit.

34.8 Rehabilitimi dhe pagesa e të ardhurave

Të gjitha të ardhurat nga sigurimi sipas çdo police të dëmit fizik do të përdoren për riparimin, rehabilitimin dhe zëvendësimin e secilës pjesë ose pjesëve të Autostradës në lidhje me të cilat janë marrë të ardhurat dhe do të përdoren dispozitat e Klauzolës 34.9.

34.9 Plani i rehabilitimit

34.9.1 Nëse bëhet një kërkesë për dëmshpërblim sipas një Police të dëmtimit fizik, (the "Incidenti përkatës"):

- (a) Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por gjithsesi brenda 20 (njëzet) ditësh pune pas bërjes së kërkesës, një plan ("Plani i rehabilitimit") të përgatitur nga Koncesionari për kryerjen e punimeve të nevojshme ("Punimet e rehabilitimit") për të riparuar, rehabilituar ose zëvendësuar aktivet të cilat janë subjekt i kërkesës apo kërkesave përkatëse në përputhje me Klauzolën 34.9.1(b);
- (b) Plani i rehabilitimit përcakton:
 - (i) Nëse jo Nënkontraktorët e ndërtimit ose Nënkontraktorët e shfrytëzimit dhe kur nuk kërkohet të bëhet tender në përputhje me

ligjet e prokurimit publik, identitetin e personit të propozuar të realizojë punimet e rehabilitimit; dhe

- (ii) Kushtet dhe afatet e propozuara në të cilat punimet e rehabilitimit duhet të realizohen (duke përfshirë datën kur Autostrada do të bëhet plotësisht e shfrytëzueshme) ose, nëse Koncesionarit i kërkohet me ligj të vazhdojë punën në përputhje me ligjet e prokurimit publik, kushtet dhe afatet kur do të zgjidhet personi i kërkuar për të realizuar punimet e rehabilitimit;
- (c) Autoriteti Kontraktor brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga marrja e Planit të propozuar të rehabilitimit, njofton Koncesionarin nëse Autoriteti Kontraktor:
- (i) E pranon apo jo identitetin e personit të shënuar në Planin e propozuar të rehabilitimit, i cili do të caktohet për të realizuar Punimet rehabilituese; dhe
 - (ii) (duke vepruar në mënyrë të arsyeshme) kërkon informacion shtesë; ose
 - (iii) Pranon apo hedh poshtë, në varësi të përfshirjes së komenteve të Autoritetit Kontraktor (të cilët mund të përfshijnë një propozim për ndryshimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor), kushtet dhe afatet e Planit të propozuar të rehabilitimit;
- (d) Për të vendosur nëse duhet të shprehë pëlqimin e vet për çështjet në bazë të Klauzolës 34.9.1(c) Autoriteti Kontraktor vepron në mënyrë të arsyeshme;
- (e) Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor nuk e jep pëlqimin e tij, apo bën komente për ndonjë pjesë të Planit të propozuar të rehabilitimit, atëherë në njoftimin që ai paraqet në bazë të Klauzolës 34.9.1(c), parashtrohet arsyet apo komentet e tij me hollësi të mjaftueshme, me qëllim që t'i japë mundësi Koncesionarit të kuptojë natyrën dhe shkallën e komenteve dhe të vlerësojë nëse pëlqimi i Autoritetit Kontraktor është refuzuar pa pasur ndonjë arsye. Koncesionari e ndryshon dhe ia riparaqit Planin e rehabilitimit Autoritetit Kontraktor për shqyrtim në bazë të Klauzolës 34.9.1(c) dhe nëse plani prapë nuk miratohet, secila nga palët mund t'ia referojë çështjen Inxhinierit të pavarur për vendim; dhe
- (f) nëse Autoriteti Kontraktor nuk e paraqet njoftimin e tij në bazë të Klauzolës 34.9.1(c) brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga marrja e Planit të propozuar të rehabilitimit, ose kur Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar në mënyrë të arsyeshme ndonjë informacion tjetër nga Koncesionari brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga marrja e Planit të propozuar të rehabilitimit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor e ka refuzuar Planin e propozuar të rehabilitimit. Kur Plani i propozuar i rehabilitimit konsiderohet i refuzuar në bazë të kësaj Klauzole 34.9.1(f), palët takohen për të diskutuar Planin e propozuar të rehabilitimit më e vona, por maksimumi, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga kërkesa e Koncesionarit për një orë të tillë dhe nga marrja



nga Autoriteti Kontraktor e informacionit të mëtejshëm, të kërkuar në bazë të kësaj Klauzole 34.9.1(f), nëse është rasti. Dispozitat e Klauzolave 34.9.1(c)(i), 34.9.1(c)(iii) dhe të Klauzolës 34.9.1(d) zbatohen për pëlqimin apo refuzimin nga Autoriteti Kontraktor të Planit të propozuar të rehabilitimit në një takim të tillë dhe, nëse përsëri ky Autoritet nuk e jep pëlqimin e tij, secila nga palët mund t'ia referojë çështjen Inxhinierit të pavarur për vendim.

34.10 Punimet rehabilituese

34.10.1 Në varësi të faktit nëse Autoriteti Kontraktor e ka dhënë pëlqimin për Planin e rehabilitimit (ose plani është vendosur në përputhje me Klauzolën 56) sipas Klauzolës 34.9, Plani i rehabilitimit miratohet dhe zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- (a) Koncesionari hyn në marrëdhënie kontraktore për të realizuar punimet e rehabilitimit me personin e përcaktuar në Planin e rehabilitimit, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor në bazë të Klauzolës 34.9;
- (b) Përpara Datës së Përfundimit, çdo tepriçë e mbetur në gjendjen e llogarinë e të ardhurave nga sigurimi ("Të ardhurat përkatëse") (bashkë me interesin e lindur) mund të tërhiqen nga Koncesionari nga llogaria e të ardhurave nga sigurimi sipas nevojës, për t'i dhënë atij mundësi të bëjë pagesa në përputhje me kushtet e masave kontraktuale, të përmendura në Klauzolën 34.10.1(a) dhe për të përballuar çdo kosto dhe shpenzim tjetër të arsyeshëm që i ka lindur Koncesionarit, për qëllimin e vetëm të financimit të Punimeve rehabilituese dhe palët do të zbatojnë kërkesat si firmëtarë të llogarisë së të ardhurave nga sigurimi, me qëllim për të realizuar pagesa të tilla. Pas Datës së Përfundimit, Autoriteti Kontraktor mund të tërheqë shumat e mbetura në llogarinë e të ardhurave nga sigurimi me qëllim financimin e donjë punimi rehabilitues;
- (c) Autoriteti Kontraktor bie dakord dhe merr përsipër që, në varësi të respektimit nga Koncesionari të detyrimeve të tij sipas kësaj Klauzole 34, dhe me kusht që Koncesionari të sigurojë që Punimet rehabilituese të kryhen dhe përfundohen në përputhje me masat kontraktuale të përmendura në Klauzolinë 34.10.1(a), ai nuk do të ushtrojë një të drejtë, që ndryshe do të kishte, për ta zgjidhur këtë Marrëveshje për arsye të ngjarjes që u bë shkak i kërkesës për të ardhurat përkatëse;
- (d) Autoriteti Kontraktor merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të asistuar Koncesionarin në kryerjen e Planit të rehabilitimit;
- (e) Pasi Plani i rehabilitimit ka përfunduar dhe Autoriteti Kontraktor ka shprehur kënaqësinë e tij të arsyeshme, dhe në përputhje me Klauzolën 34.10.1(g), Autoriteti Kontraktor e lejon Koncesionarin të tërheqë tepriçën e të ardhurave përkatëse, që është në gjendje në atë kohë në llogarinë e të ardhurave nga sigurimi, e cila nuk është paguar sipas Klauzolës 34.10.1(b), në lidhje me incidentin përkatës, bashkë me interesin e lindur;



- (f) Vetëm Koncesionari është përgjegjës për përballimin e ndonjë mungese në fondet e shpenzuara për kryerjes së Punimeve rehabilituese; dhe
- (g) Kur të ardhurat nga sigurimi duhet të përdoren, në përputhje me këtë Marrëveshje, për të riparuar, rehabilituar ose zëvendësuar ndonjë pjesë të Autostradës, Koncesionari e kryen një punë të tillë në mënyrë të tillë që, pasi puna të ketë përfunduar, të jenë respektuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

34.11 Rritja e primeve të sigurimit

- 34.11.1 Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktor një njoftim me shkrim për kostot faktike të sigurimit, të ndarë sipas kategorisë së sigurimit për çdo vit, sa më shpejt që të jetë e mundur, sapo merr dijeni për to dhe përpara rinovimit të këtyre sigurimeve. Bashkë me një njoftim të tillë, dërgohet edhe një kopje e ofertës së primit dhe çdo informacion tjetër përkatës i marrë nga siguruesit.
- 34.11.2 Nëse në ndonjë kohë, kostot faktike të sigurimit janë më të larta se sa kostot e sigurimit bazë, atëherë Koncesionari mund ta njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe kostoja e rritjes së sigurimit për çdo vit, në varësi të Klauzolës 34.5, do të ndahet si më poshtë:

Rritja mbi kostot e sigurimit bazë	Përqindja e Autoritetit Kontraktor në rritjen e kostove të sigurimit
<50%	0
50 – 100%	50% e rritjes së kostove të sigurimit që e tejkalon rritjen prej 50% të kostove të sigurimit bazë.
>100%	100% të kostove të rritjes së sigurimit bazë që e tejkalon rritjen prej 100% të kostove të sigurimit bazë.

- 34.11.3 Në rastin kur Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për një rritje të kostove të sigurimit, në përputhje me Klauzolën 34.11.2, Autoriteti Kontraktor i paguan këto kosto për muajin që i paraprin muajit kur këto kosto të rritjes së sigurimit u duhen paguar siguruesve.
- 34.11.4 Në rastin që Autoriteti Kontraktor nuk ka dëshirë t'i ndajë kostot e rritjes së sigurimit, në përputhje me Klauzolën 34.11.2, ai mund të kërkojë një ndryshim si ndryshim nga Autoriteti Kontraktor.

Pjesa 9: Çështje të stafit

1

35. Depozita të përgjithshme

35.1 Çështje që kanë të bëjnë me stafin e Koncesionarit

35.1.1 Koncesionari:

- (a) Bën çmos që të gjitha marrëdhëniet e punës të gjithë stafit të përfshirë në Punimet, shfrytëzimin e Autostradës, apo ofrimin e Shërbimeve të jenë në përputhje me dispozitat detyruese të ligjit dhe me praktikën e mirë të sektorit ekonomik. Koncesionari siguron që të gjitha kushtet e kërkuara me ligj dhe nga kjo Marrëveshje të zbatohen në lidhje me një staf të tillë; dhe
- (b) Me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe për të hyrë e dalë në vendin e punimeve apo në Autostradë, angazhon vetëm staf që i plotëson kërkesat e parashtruara në ligj.

35.2 Refuzimi i hyrje-daljeve

35.2.1 Koncesionari mban një listë me identitetet e pjesëtarëve të stafit të angazhuar në shfrytëzimin e Autostradës, ose ofrimin e Punimeve ose Shërbimeve dhe ofron mundësi për hyrje-dalje për personat e kësaj liste, në përputhje me Klauzolën 43.

35.2.2 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për t'i refuzuar hyrje-dalje në Territorin e Projektit ose në Autostradë çdo personi të Koncesionarit të përfshirë në kryerje punësh aty, nëse Autoriteti Kontraktor beson se prania e personave të tillë në Territorin e Projektit, ose në Autostradë, përbën një risk për dëmtimin e shëndetit apo pronës, ose është e padëshirueshme për ndonjë arsye tjetër.

35.2.3 Autoriteti Kontraktor nuk ka nevojë të deklarojë arsyet për një refuzim të tillë, me kusht që nëse nuk i deklaron arsyet e një refuzimi të tillë, ose në qoftë se arsyeja e refuzimit nuk është e justifikuar ose e përshtatshme, ai duhet ta kompensojë Koncesionarin për shtimin e kostove që i lindin Koncesionarit si rrjedhojë e një refuzimi të tillë.



Pjesa 10: Kthimi dhe Përfundimi i Marrëveshjes

36. Kthimi

36.1 Koncesionari ia kthen Autostradën Autoritetit Kontraktor në datën e Përfundimit të vlefshmërisë së kontratës në gjendjen që kërkohet në Kërkesat e kthimit. Dispozitat e Klauzolës 10 dhe Seksionit 8 të Shtojcës 5 do të zbatohen për kthimin e Territorit të Projektit dhe të çdo Trualli ekstra që është akoma në zotërimin e Koncesionarit.

36.2 Jo më vonë se 6 (gjashtë) vjet përpara Datës së përfundimit të vlefshmërisë, Koncesionari:

36.2.1 Kryen vrojtimin fillestar për kthimin me qëllim që të vlerësojë gjendjen e Autostradës dhe t'i paraqesë Inxhinierit të pavarur (ose, kur nuk ka Inxhinier të pavarur, Autoritetit Kontraktor) propozime për përfundimin e punimeve rinovuese gjatë 5 (pesë) viteve në nënputhje me Kërkesat e kthimit; dhe

- 36.2.2 Në bashkërendim me Inxhinierin e pavarur (ose, kur nuk ka Inxhinier të pavarur, me Autoritetin Kontraktor), përgatit një plan vlerësimi të kthimit, i cili do të përdoret për të përcaktuar ecurinë dhe jetën e mbetur të Autostradës.
- 36.3 Vrojtimi fillestar i kthimit identifikon çdo punim rregullues, që mund të nevojitet, me qëllim që Autostrada të arrijë kërkesat e dorëzimit, duke filluar nga Data e Përfundimit të Vlefshmërisë, dhe kostot e vleresuara të kryerjes së punimeve të tilla rregulluese.
- 36.4 Gjatë periudhës jo më herët se 21 (njëzet e një) muaj dhe jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj përpara Datës së Përfundimit të Vlefshmërisë, Autoriteti Kontraktor mund të udhëzojë Inxhinierin e pavarur (ose, kur nuk ka Inxhinier të pavarur, Autoritetin Kontraktor) të kryejë vetë një inspektim të Autostradës për të përcaktuar nëse Koncesionari është duke i përmbushur kërkesat e kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, nëse Kërkesat e kthimit do të arrihen në Datën e përfundimit të vlefshmërisë ("Shqyrtimi fillestar për kthimin").
- 36.5 Në rastin që Inxhinieri i pavarur (ose, kur nuk ka Inxhinier të pavarur, Autoritetin Kontraktor) përcakton punimet rregulluese që kërkohen gjatë 18 (tetëmbëdhjetë) muajve të fundit të Marrëveshjes, atëherë ose:
- 36.5.1 Koncesionari i dërgon Autoritetit Kontraktor brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga shqyrtimi fillestar i kthimit, një dorëzani për ecurinë e punës në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktor (që vepron në mënyrë të arsyeshme) të dhënë nga një institucion i njohur me vlerësim të paktën si BBB- (Standard & Poor) ose ekuivalent, për një vlerë të barabartë me shumën e identifikuar në shqyrtimin fillestar të kthimit ("Dorëzania fillestare e kthimit"); ose
- 36.5.2 Autoritetit Kontraktor do t'i paguhet nga Koncesionari [1/18ta (një e tetëmbëdhjeta)] e shpenzimeve të vleruara kapitale të mbetura, të identifikuara në shqyrtimin fillestar për Kthimin, sipas nevojës, nga të ardhurat nga taksa e rrugës, çdo muaj përpara Datës së Përfundimit të Vlefshmërisë dhe një shumë të tillë do ta mbajë si dorëzani ("Rezerva e kthimit"), me qëllim plotësimin e të gjitha kërkesave për Kthimin.
- 36.6 Në rastin që Koncesionari kryen punë riparuese dhe Inxhinieri i pavarur (ose ku nuk ka inxhinier të pavarur Autoriteti Kontraktor) është i kënaqur, ose:
- 36.6.1 Koncesionari mund ta pakësojë vlerën e Dorëzansë fillestare për Kthimin; ose
- 36.6.2 Autoriteti Kontraktor e shlyen shumën përkatëse nga Rezerva e Kthimit, në një vlerë që Koncesionari mund ta evidentojë se e ka shpenzuar për punimet riparuese. Nëse shumat në Rezervën për Kthimin nuk janë të mjaftueshme për të kryer punimet e nevojshme riparuese, Koncesionari i kryen punime të tilla riparuese me shpenzimet e veta.
- 36.7 Jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj përpara Datës së përfundimit të vlefshmërisë, Koncesionari në bashkëpunim me Inxhinierin e pavarur (ose kur nuk ka Inxhinier të pavarur, Autoritetin Kontraktor), mund ta kryejë vetë Vrojtimin përfundimtar për Kthimin, me qëllim që të përcaktojë se çfarë punimesh rregulluese duhen bërë.



- 36.8 Gjatë periudhës jo më herët se 3 (tre) muaj përpara dhe jo më vonë se 1 (një) muaj përpara Datës së Përfundimit të Vlefshmërisë, Autoriteti Kontraktor mund të udhëzojë Inxhinierin e pavarur (ose kur nuk ka Inxhinier të pavarur, Autoritetin Kontraktor) të kryejë vetë një inspektim të tillë të Autostradës, për të përcaktuar nëse Koncesionari po i respekton kërkesat e kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, nëse Kërkesat për Kthim do të arrihen deri në Datën e Përfundimit të Vlefshmërisë (“Shqyrtimi përfundimtar për Dorëzimin”).
- 36.9 Shqyrtimi përfundimtar për Kthimin përcakton çdo punim riparues të nevojshëm, me qëllim që Autostrada të arrijë Kërkesat për Kthim në Datën e Përfundimit të Vlefshmërisë dhe në bazë të kostos së çmuar për kryerjen e punimeve të tilla riparuese.
- 36.10 Në rastin kur Shqyrtimi përfundimtar për Kthimin përcakton se nuk kërkohen të bëhen punime riparuese, Autoriteti Kontraktor ose ia kthen Koncesionarit Dorëzanimin fillestar për Kthimin, ose i paguan Koncesionarit çdo tepriç nga Rezerva për Kthimin.
- 36.11 Në rastin kur Shqyrtimi përfundimtar për Kthimin përcakton ndonjë punim riparues të nevojshëm për t’u kryer, atëherë, ose
- 36.11.1 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t’i mbajë këto shuma nga çdo shumë që mbahet në Rezervën për Kthimin; ose
- 36.11.2 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë një kërkesë për t’i marrë këto shuma nga Dorëzania fillestare e Kthimit.

Në rastin kur nuk ka shuma të mjaftueshme në Rezervat e Kthimit ose Dorëzania fillestare e Kthimit është e pamjaftueshme, Koncesionari i paguan Autoritetit Kontraktor koston e çmuar të kryerjes së punimeve riparuese, sikundër parashikohet në Shqyrtimin përfundimtar të Dorëzimit, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune pasi kostoja e çmuar është pranuar apo përcaktuar në përputhje me Klauzolën 56.

Pjesa 11: Përfundimi i parakohshëm dhe kompensimi

37. Përfundimi i parakohshëm

37.1 Përfundimi i parakohshëm

- 37.1.1 Përveç përfundimit të vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje në Datën e Përfundimit të Vlefshmërisë së saj, palët mund ta zgjidhin këtë Marrëveshjeje në përputhje me këtë Klauzolë 37.
- 37.1.2 Palët bien dakord se Marrëveshje mund të ndërpritet ose tërhiqet vetëm për shkaqet e shprehura shprehimisht në këtë Klauzolë 37.
- 37.1.3 Përfundimi i parakohshëm i kësaj Marrëveshjeje bëhet pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, kur ato janë të parashikuara shprehimisht në këtë Marrëveshjeje, ose ato që zbatohen pas Datës së përfundimit për shkak të natyrës së tyre.

37.2 Mospërmbushja nga Koncesionari

- 37.2.1 Në varësi të Klauzolës 37.2.2, në rrethanat kur ka ndodhur një mospërmbushje nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të tërhiqet nga kjo Marrëveshjeje

menjëherë pas një njoftimi me shkrim që i bën Koncesionarit (“Njoftimi për mospërbushje të detyrimeve nga Koncesionari”).

37.2.2 Në rastin e një mospërbushje nga Koncesionari, të identifikuar në paragrafët (a), (i), (j), (l) dhe/ose (m) në përkufizimin e këtij mospërbushje, përpara se njoftimi për mospërbushje t’i dërgohet Koncesionarit, Autoriteti Kontraktor i dërgon njoftim Koncesionarit për të korrigjuar mospërbushjen e tij (“Njoftimi për korrigjim”), i cili përmban një përshkrim të mospërbushjeve nga Koncesionari dhe një periudhë për korrigjimin e tij, e cila do të jetë jo më pak se tridhjetë ditë (30) ditë pas dorëzimit të Njoftimit për korrigjim te Koncesionari.

37.2.3 Autoriteti Kontraktor mund të mos i dërgojë Koncesionarit njoftim për korrigjim nëse:

(a) Koncesionari e korrigjon mospërbushjen e tij deri në datën e parashikuar në njoftimin për korrigjim; ose

(b) Në rastin e një mospërbushje nga Koncesionari, të përcaktuar në gërmat (a), (i), (j), (l), dhe/ose (m) të përkufizimit të tyre dhe në varësi të Marrëveshjes së drejtpërdrejtë, Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor brenda periudhës së korrigjimit të parashikuar në Njoftimin për korrigjim një plan të pranueshëm nga Autoriteti Kontraktor për korrigjimin e mospërbushjeve nga Koncesionari dhe Koncesionari pa asnjë vonesë të mëtejshme nis zbatimin e planit në përputhje me kushtet e planit.

37.2.4 Duke qenë objekt i dispozitave të Marrëveshjes së drejtpërdrejtë, nëse në ndonjë kohë, Koncesionari nuk e përmbush planin korrigjues të pranuar nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Klausolën 37.2.3(b) Autoriteti Kontraktor mund t’i dërgojë Koncesionarit një Njoftim për mospërbushje dhe kjo Marrëveshje merr fund në datën e dorëzimit të Njoftimit për mospërbushje te Koncesionari.



37.3 Shkeljet e vazhdueshme

Autoriteti Kontraktor mund ta zgjidhë këtë Marrëveshjeje për shkak të shkeljeve të vazhdueshme, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme (“Shkelje të vazhdueshme”):

37.3.1 Nëse Koncesionari e ka shkelur të njëjtin detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje në të paktën 2 (dy) raste në çdo 6 (gjashtë) muaj të njëpasnjëshëm, Autoriteti Kontraktor mund ta njoftojë Koncesionarin me shkrim (“Paralajmërimi i parë”), duke vënë në dukje:

(a) Detyrimin e shkelur; dhe

(b) Duke e njoftuar se ky është Paralajmërimi i parë në bazë të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(c) Duke deklaruar se kjo është një shkelje e kësaj Marrëveshjeje e cila, nëse do të përsëritej, mund të rezultonte në përfundimin e parakohshëm të Marrëveshjes;


37.3.2 nëse, pas marrjes së Njoftimit të parë, shkelja e konstatuar vazhdon për një periudhë që i tejkalon 20 (njëzet) ditë pune, ose përsëritet në të paktën 2 (dy) raste në një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh në vijimësi, Autoriteti Kontraktor mund të njoftojë Koncesionarin me shkrim ("Paralajmërimi i dytë"), duke përcaktuar:

- (a) detyrimin që është shkelur;
- (b) duke e njoftuar se ky është Paralajmërimi i dytë në bazë të kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (c) duke deklaruar se kjo është një shkelje e kësaj Marrëveshjeje e cila, nëse përsëritet, mund të shpjerë në përfundimin e parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje;

37.3.3 nëse, pas marrjes së Paralajmërimin të dytë, shkelja e përcaktuar vazhdon për një periudhë që i tejkalon 20 (njëzet) ditë pune, ose përsëritet në njërin nga 6 (gjashtë) muajt vijues, Autoriteti Kontraktor mund të njoftojë Koncesionarin se ka ndodhur një shkelje e vazhdueshme dhe në atë rast, zbatohen dispozitat për mospërbushjen e detyrimeve nga Koncesionari, në përputhje me Klauzolën 37.2.

37.3.4 Autoriteti Kontraktor mund të mos dërgojë ndonjë njoftim paralajmërues ose njoftim në lidhje me një shkelje të vazhdueshme për një shkelje e cila:

- (a) Është numëruar më përpara në bërjen e një njoftimi të veçantë paralajmërues apo të ndonjë njoftimi tjetër sipas kësaj Klauzole 37.3; ose
- (b) Mund të shpinte në një rregullim të penalteteve për ecurinë mujore të punës.



37.4

Veprimet e ndaluara

37.4.1 Nëse Koncesionari, ose ndonjë palë e Koncesionarit, kryen një veprim të ndaluar, Autoriteti Kontraktor mundet që, në varësi të Klauzolës 37.4.4, ta zgjidhë këtë Marrëveshje me anë të njoftimit të Koncesionarit ("Njoftim për Zgjidhje [të Marrëveshjes] për një veprim të ndaluar").

37.4.2 Njoftimi për Zgjidhjen e [Marrëveshjes] për një veprim të ndaluar përmban:

- (a) Përshkrimin e veprimit të ndaluar; dhe
- (b) Kur dihet, identitetin e personit që e ka kryer aktin e ndaluar.

37.4.3 Data e Zgjidhjes së Marrëveshjeje është:

- (a) Në rastin e një veprimi të ndaluar të kryer nga Koncesionari, data e Njoftimit të Zgjidhjes për shkak të veprimit të ndaluar; ose
- (b) Në të gjitha rastet e tjera, një datë jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditësh pune pas dorëzimit të Njoftimit të Koncesionarit për Zgjidhje [të Marrëveshjes] për shkak të veprimit të ndaluar.

37.4.4 Në rrethanat e parashikuara në Klauzolën 37.4.3 (b), kjo Marrëveshje nuk përfundon në datën e përcaktuar në Njoftimin për Zgjidhje për shkak të një veprimi të ndaluar kur:

- (a) Personi e ka kryer aktin e ndaluar në mënyrë të pavarur dhe pa dijeninë e Koncesionarit; dhe
- (b) brenda 20 (njëzet) ditësh pune nga data e Njoftimit për Zgjidhje për shkak të veprimit të ndaluar, Koncesionari i provon Autoritetit Kontraktor se kontrata përkatëse ndërmjet një pale të Koncesionarit dhe personit që e ka kryer veprimin e ndaluar është zgjidhur.

37.5 Zgjidhja vullnetare e kontratës nga Autoriteti Kontraktor

37.5.1 Autoriteti Kontraktor mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke e njoftuar me shkrim Koncesionarin ("Njoftim për zgjidhje vullnetare të kontratës"). Njoftimi për zgjidhje vullnetare të kontratës deklaron:

- (a) se Autoriteti Kontraktor po e zgjidh Kontratën në bazë vullnetare; dhe
- (b) data e përfundimit të Marrëveshjes, e cila duhet të jetë një datë jo më vonë se 6 (gjashtë) Muaj pas dërgimit të Njoftimit për zgjidhjen vullnetare të Koncesionarit.

37.6 Mospërmbushja e detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor

37.6.1 Në rrethana kur ka ndodhur një mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, Koncesionari ka të drejtë të tërhiqet nga kjo Marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga marrja dijoni për ndodhjen e mospërmbushjeve nga Autoriteti Kontraktor, me anë të një njoftimi për Autoritetin Kontraktor ("Njoftimi për mospërmbushje nga ana e Autoritetit Kontraktor").

37.6.2 Njoftimi për mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor përmban përshkrimin e mospërmbushjeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, duke vënë në dukje hollësi të arsyeshme.

37.6.3 Data e përfundimit të Marrëveshjes është:

- (a) Në rastin e një mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, të përcaktuar në germën (b) të përkufizimit të tij, data e dorëzimit të njoftimit për mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor; ose
- (b) Në rastin e të gjitha mospërmbushjeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, një datë jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pune pas dorëzimit tek Autoriteti Kontraktor i njoftimit të mospërmbushjeve nga ana e tij.

37.6.4 Në rastin e një mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, të përcaktuar në germën (a) të përkufizimit, Autoriteti Kontraktor mund t'i parandalojë pasojat e tërheqjes dhe kjo Marrëveshje nuk përfundon në datën e përcaktuar në Njoftimin për mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, në rrethanat kur Autoriteti Kontraktor e koncesionari



mospërbushjen nga ana e Autoritetit Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga marrja e njoftimit nga Autoriteti Kontraktor për mospërbushje.

37.7 Përfundimi jo për mospërbushje

Secila nga palët mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje me një njoftim me shkrim dërguar palës tjetër në rrethanat e përcaktuara në Klauzolën 28.6 ose 29.5 dhe në përputhje me Klauzolën 34.5. Autoriteti Kontraktor mund ta përfundojë këtë Marrëveshjeje me një njoftim me shkrim dërguar Koncesionarit ("Njoftim për përfundim jo për mospërbushje"). Në një rast të tillë, Marrëveshja përfundon në datën e dorëzimit të Njoftimit për përfundim jo për mospërbushje, dërguar palës tjetër.

38. Pasojat e përfundimit të parakohshëm

38.1 Vazhdimi i detyrimeve deri në përfundim

Në varësi të ushtrimit nga Autoriteti Kontraktor i të drejtave të tij sipas Klauzolës 41, palët do të vazhdojnë të kryejnë detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga ndonjë njoftim për përfundim derisa përfundimi i kësaj Marrëveshjeje të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e Klauzolës 37.

38.2 Transferimi i aktiveve dhe të drejtave pas përfundimit

Në datën e përfundimit:

38.2.1 Të gjitha të drejtat për hyrje-dalje dhe përdorim të Territorit të Projektit përfundojnë në lidhje me Koncesionarin dhe Autoriteti Kontraktor merr përsipër dhe përfiton të drejtat e Koncesionarit ndaj Territorit të Projektit, përveç se kur Autoriteti Kontraktor i mban këto të drejta në bazë të dispozitave të tjera të Marrëveshjes, gjithmonë me kusht që me transferimin e të drejtave të Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Kontraktor i siguron Koncesionarit hyrje-dalje dhe përdorim të arsyeshëm të Territorit të Projektit që i nevojitet për largimin e personelit, stafit, pajisjeve dhe makinerive;



38.2.2 Nëse njoftimi për përfundim bëhet përpara dhënies së Lejeve të shfrytëzimit për të gjithë aspektet përkatëse, Koncesionari ia dorëzon punimet Autoritetit Kontraktor, i cili merr ato në dorë (duke përfshirë edhe punimet e përkohshme), si dhe të drejtën e Koncesionarit për të gëzuar përdorimin dhe zotërimin e saj, dhe të gjitha impiantet, pajisjet dhe materialet e tjera në Territorin e Projektit, ose në territorin pranë tij do të mbeten në dispozicion të Autoritetit Kontraktor, me qëllim përfundimin e punimeve, pasi Koncesionari të kompensohet për kostot e tyre (në masën që një kompensim i tillë të mos jetë llogaritur më parë dhe të mos llogaritet sipas Klauzolës 39), me kusht që në datën e përfundimit të punimeve, çdo impiant, pajisje apo material tjetër, i transferuar në përputhje me këtë Klauzolë 38.2.2, që nuk është përfshirë në punime, t'i transferohet përsëri Koncesionarit;

38.2.3 Të drejtat e koncesionit të dhëna Koncesionarit në bazë të kësaj Marrëveshjeje (përveç të drejtave të shprehura se do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje), duke përfshirë të drejtën e Koncesionarit për të përdorur dhe shfrytëzuar Autostradën do të marrin fund automatikisht;

- 38.2.4 Autoriteti Kontraktor do të marr dhe vë nën kontroll të gjitha objektet shtesë, ndërtesat, pajisjet, aksesorët, pajisjet e lëvizshme ose aktivet e tjera, duke përfshirë mjetet elektronike, të telekomunikimit ose të reklamës, pajisjet dhe programet e teknologjisë së informacionit (në varësi të Klauzolës 47.2) dhe pajisjet e magazinuara, në pronësi të Koncesionarit, të marra ose të përdorura në lidhje me projektimin, ndërtimin, financimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës;
- 38.2.5 Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor Manualet e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes, së bashku me të gjitha dokumentet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me Projektin dhe të dhënat e për të, të përditësuara gjatë ndërtimit, në shkallën që ato janë finalizuar në kohën e përfundimit, përndryshe skicat siç janë në gjendjen aktuale;
- 38.2.6 Koncesionari bën çmos që përfitimi i të gjitha garancive për pajisjet mekanike dhe elektrike t'i transferohet Autoritetit Kontraktor; dhe
- 38.2.7 Koncesionari bashkëpunon dhe e ndihmon Autoritetin Kontraktor për të siguruar transferimin e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së Autostradës te një palë e tretë kontraktore e caktuar nga Autoriteti Kontraktor për të shfrytëzuar dhe mirëmbajtur Autostradën pas datës së përfundimit.

38.3 Të drejtat e Autoritetit Kontraktor

Në masën që vlera e Projektit në treg është paguar plotësisht dhe në rrethanat kur Marrëveshja është zgjidhur për mospërbushje nga ana e Koncesionarit, Autoritetit Kontraktor do t'i transferohet e gjithë garancinë e mbajtur nga Huadhënësit sipas, ose në bazë të Marrëveshjeve të Financimit, ose të kryerjes së punës nga Koncesionari, Nënkontraktorët e ndërtimit, Nënkontraktorët e shfrytëzimit ose Aksionerët në lidhje me Projektin, dhe Koncesionari do të bëjë, dhe bën të gjitha përpjekjet, që të gjithë personat përkatës të realizojnë ose të sigurojnë dokumente të tilla dhe t'i bëjnë të gjitha këto gjëra siç mund të nevojiten dhe/ose kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktor për të realizuar dispozitat e kësaj Klauzole 38.3.

39 Kompensimi për zgjidhjen e kontratës

39.1 Kompensimi për zgjidhjen e kontratës

- 39.1.1 Nëse kjo Marrëveshje përfundon përpara kohe, pas dërgimit të njoftimit për përfundim të parakohshëm në përputhje me Klauzolën 37, Koncesionari ka të drejtë të marrë shumën e zgjidhjes së kontratës në përputhje me këtë Klauzolë 39.
- 39.1.2 Çdo shumë e zgjidhjes së kontratës, e pagueshme sipas kësaj Klauzole 39, është një pagesë që bëhet për shkak të një detyrimi që rrjedh sipas kësaj Marrëveshjeje. Palët e konsiderojnë të drejtën për të marrë shumën e zgjidhjes së kontratës si të vetmen kërkesë të Koncesionarit ndaj Autoritetit Kontraktor në lidhje me përfundimin e parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjet e Financimit dhe Dokumentet e Projektit.
- 39.1.3 Palët pranojnë se e drejta për përfundimin e parakohshëm dhe pagesën e shumës së zgjidhjes së kontratës, ose, sipas rastit, e drejta për zbritjen e pagesave, është një zgjidhje e mjaftueshme për kërkesat e dyanshme në lidhje me përfundimin e

parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje, çdo Marrëveshjeje të Financimit dhe të Dokumenteve të Projektit, dhe për çdo shkak që rezulton në përfundimin paraprak të kontratës, me kusht që kjo gjë të mos përdoret për kërkesa të tjera të palidhura të palëve:

- (a) Që bëhen përpara Datës së zgjidhjes së kontratës; dhe
- (b) Që nuk ishin marrë në konsideratë në përcaktimin e shumës së zgjidhjes së kontratës.

39.2 **Kompensimi për mospërbushje të Koncesionarit**

39.2.1 Në rrethana kur kjo Marrëveshje zgjidhet pasi i dërgohet Koncesionarit një njoftim për mospërbushje, në përputhje me Klausolën 37.2, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit një shumë për zgjidhjen e kontratës të llogaritur në përputhje me këtë Klausolë 39.2.

39.2.2 Kur zbatohet kjo Klausolë 39.2, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit, përveç ndonjë ndryshimi që Marrëveshja e drejtpërdrejtë do të sigurojë, një shumë të barabartë më shifrën më të ulët të:

- (a) detyrimeve të Huadhënësve, dhe
- (b) vlerës së tregut të Projektit.

39.2.3 Të gjitha shumat e parashikuara të përdorura për përcaktimin e Shumes se Ndërprerjes duhet të llogariten në terma nominalë me çmimet aktuale. Shuma e Ndërprerjes do të rregullohet në momentin e pagesës për të marrë parasysh inflacionin e pritur plus një shtesë prej 1.0%, përveç nëse parashihet ndryshe në Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë, për periudhën ndërmjet datës së llogaritjes dhe datës se pagesës siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje.

39.2.4 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me shumat e llogaritura apo të përcaktuara, në përputhje me këtë Klausolë 39, vendoset në bazë të Klausolës 56.



39.3 **Kompensimi për përfundim për një veprim të ndaluar**

Nëse kjo Marrëveshje përfundon para kohe, pas dhënies së një njoftimi për zgjidhje kontrate për shkak të një veprimi të ndaluar në përputhje me Klausolën 37.4, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit një shumë të barabartë me detyrimet e huadhënësve.

39.4 **Kompensimi për mospërbushje nga ana e Autoritetit Kontraktor ose për zgjidhje vullnetare të kontratës**

Nëse kjo Marrëveshje përfundon para kohe, pas dërgimit të një njoftimi për zgjidhje vullnetare të kontratës në përputhje me Klausolën 37.5, ose të një njoftimi për mospërbushje nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me Klausolën 37.6, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit shumën e zgjidhjes së kontratës për shkak të mospërbushjeve të Autoritetit Kontraktor.

39.5 **Kompensimi si rezultat i zgjidhjes së kontratës jo për mospërbush**

Nëse kjo Marrëveshje përfundohet përpara kohe, pas dhënies së një njoftimi për zgjidhje të kontratës jo për mospërbushje, në përputhje me Klauzolën 37.7, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit shumën e përfundimit për shkaqe madhore.

40. Llogaritja dhe pagesa e kompensimit

40.1 Balancimi i tatimeve

40.1.1 Në varësi të Klauzolës 40.1.2, nëse pagimi i një tatimi (përveç tatimeve të pagueshme nga Koncesionari gjatë ecurisë së zakonshme të punës, që nuk lidhen me këtë Marrëveshje), që do të ishte i pagueshëm, përveç për pagimin e shumës së zgjidhjes së kontratës në përputhje me Klauzolën 39.2, Klauzolën 39.3 ose Klauzolën 39.4, rezulton në një zbritje të shumës për zgjidhjen e kontratës, të marrë faktikisht nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktor ia paguan një shumë të tillë shtesë Koncesionarit për ta vënë Koncesionarin në të njëjtën situatë në të cilën ai do të kishte qenë, nëse nuk do t'i ishte kërkuar të paguante një tatim të tillë në shkallën që ndërkohë nuk është llogaritur në Shumën për zgjidhjen e kontratës.

40.1.2 Nëse, në lidhje me Shumën e zgjidhjes së kontratës, Koncesionari duhet të paguajë ndonjë tatim që duhet balancuar në bazë të Klauzolës 40.1.1, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit shuma të tilla shtesë vetëm nëse Koncesionari ka përbushur detyrimet e mëposhtme:

- (a) Koncesionari e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor pa vonesa të panevojshme por gjithsesi, jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pune përpara datës së duhur të tatimit përkatës, se tatimi duhet paguar, tatim në lidhje me të cilin Koncesionari do të kërkojë, në bazë të kësaj Klauzole 40.1, duke deklaruar hollësitë e tatimit dhe shkaqet për të cilat ai duhet paguar;
- (b) Koncesionari e ka lejuar Autoritetin Kontraktor të negociojë me organin përkatës të cilit i duhet paguar tatimi, në lidhje me shkaqet dhe vlerën e tij;
- (c) nëse Autoriteti Kontraktor e kundërshton të drejtën e përfutimit të tatimit për balancim, ose shumën që është vendosur të balancohet, Koncesionari është i detyruar ta paguajë tatimin, pavarësisht nga kundërshtimi i Autoriteti Kontraktor, në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes; dhe
- (d) Koncesionari e ka paguar tatimin.



40.2 Kufizimet e kompensimit

Përveçse kur është rënë dakord shprehimisht në këtë Marrëveshje, Autoriteti Kontraktor nuk përdor asnjë shumë që i takon Koncesionarit në kompensim të shumës për zgjidhjen e kontratës, së pagueshme në përputhje me Klauzolën 39.3, Klauzolën 39.4 ose Klauzolën 39.5 (por jo të një shume për zgjidhje kontrate të pagueshme në bazë të Klauzolës 39.2), nëse si rezultat i një kompensimi të tillë, shuma që i është paguar faktikisht Koncesionarit në lidhje me zgjidhjen e kontratës do të pakësohej, duke u bërë kështu më e vogël se sa detyrimet e papaguara të Huadhënësve. Në respektim të fjalisë së mëparshme, Autoriteti Kontraktor mund ta kompensojë ato shumë që i duhet paguar Koncesionarit me shumën e zgjidhjes së kontratës.

kontratës, vetëm nëse është rënë dakord për një gjë të tillë shprehimisht në këtë Marrëveshje dhe nëse kjo lejohet sipas ligjeve.

40.3 Metoda e pagesës

40.3.1 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk zgjedh të paguajë një shumë për zgjidhjen e kontratës me këste, sipas Klausolës 40.3.2, ai është i detyruar të paguajë shumën e zgjidhjes së kontratës në një llogari të emëruar nga Koncesionari brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune, jo më vonë se duke filluar nga :

- (a) Data Përfundimtare; dhe
- (b) data në të cilën çdo mosmarrëveshje në lidhje me një shumë të tillë për zgjidhje kontrate është zgjidhur përfundimisht.

40.3.2 Në rrethanat e parashikuara në Klausolën 39.2, Klausolën 39.3 ose Klausolën 39.5 (por jo rrethanat e parashikuara në Klausolën 39.4), Autoriteti Kontraktor mund të zgjedhë të paguajë me këste çdo detyrim ndaj Huadhënësve, që bën pjesë në shumën e zgjidhjes së kontratës, dhe Autoriteti Kontraktor përcakton shumën dhe datat e pagesave të kësteve, me kusht që:

- (a) Shuma dhe data e secilit këst të bëjnë të mundur të paktën pagesën e Huadhënësve në përputhje me Marrëveshjet e Financimit, në rast se nuk do të kish ndodhur përfundimi i parakohshëm;
- (b) E gjithë shuma e zgjidhjes së kontratës, duke përfshirë interesin, paguhet jo më vonë se duket filluar nga:
 - (i) Data e fundi për pagesë të shumave të kërkueshme sipas Marrëveshjeve të Financimit; dhe
 - (ii) Data që vjen 3 (tre) vjet pas datës së përfundimit të kontratës,
- (c) Pjesët e shumës së zgjidhjes së kontratës, data e pagimit të të cilave është shtyrë, do të prodhojnë interes me normën e Borxhit me Përparësi, duke filluar nga data e përfundimit, ndërsa Autoriteti Kontraktor mundet që në çdo kohë ta parapaguajë të gjithë përqindjen e mbetur të shumës së zgjidhjes së kontratës, me kusht që ta bëjë këtë në datën e duhur të pagimit të këstit dhe ta njoftojë Koncesionarin jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pune më përpara; dhe
- (d) E gjithë shuma për zgjidhjen e kontratës të paguhet sa më shpejt që të jetë e mundur, duke marrë parasysh fondet e disponueshme të Autoritetit Kontraktor dhe të gjitha mundësitë e pritshme në mënyrë të arsyeshme të Autoritetit Kontraktor për të përfutur fonde për pagesën e të gjithë shumës së plotë për zgjidhjen e kontratës sa më shpejt që të jetë e mundur.

40.3.3 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk arrin të paguajë ndonjë nga këstet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Klausolën 40.3.2, Koncesionari mund të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumës së mbetur pa



zgjdhjes së kontratës, duke përfshirë interesin e lindur, duke dërguar një njoftim me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga data e marrjes dëjani.

40.3.4 Çdo pagesë e bërë nga Autoriteti Kontraktor për Koncesionarin, në përputhje me Klauzolën 39, paguhet në lekë pas këmbimit në lekë të shumës së pagueshme në euro, duke përdorur kursin zyrtar të këmbimit euro/lek të Bankës së Shqipërisë të përdorur në datën e pagesës. Në rastin që leku nuk ekziston më, atëherë pagesa do të bëhet në euro.

40.4 Informacioni i kërkuar për përcaktimin e shumës së kompensimit

Në përcaktimin e shumës për zgjidhjen e kontratës, Autoriteti Kontraktor mund të mbështetet te çdo certifikatë të dhenë nga Huadhënësit, si një dokument vendimtar për përcaktimin e detyrimeve ndaj Huadhënësve. Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të paguajë një shumë në lidhje me detyrimet ndaj Huadhënësve, e cila e tejkalon shumën e përcaktuar në një certifikatë të dhenë nga Huadhënësit, ku përcaktohen detyrimet ndaj Huadhënësve.

Pjesa 12: Dispozitat përfundimtare

41. Ndërhyrja e Autoritetit Kontraktor

41.1 Nëse Autoriteti Kontraktor beson se ka:

41.1.1 një rrezik serioz për jetën apo shëndetin dhe sigurinë e personave apo sigurinë e Autostradës;

41.1.2 një rrezik serioz ndaj pronës apo mjedisit; ose

41.1.3 një shkelje të detyrës së parashikuar me ligj,

në lidhje me Punimet, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës ose ofrimin e shërbimeve, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrë të arsyeshme në Punimet, shfrytëzimin e Autostradës ose ofrimin e shërbimeve për të larguar një rrezik të tillë.

41.2 Në rastin që Autoriteti Kontraktor dëshiron të ushtrojë të drejtat e tij sipas Klauzolës 41.1, Autoriteti Kontraktor e njofton Koncesionarin me shkrim ("Njoftimi për ndërhyrje") për:

41.2.1 Ndërhyrjen që synon të kryejë;

41.2.2 Arsyet për një ndërhyrje të tillë;

41.2.3 Datën e planifikuar për një ndërhyrje të tillë;

41.2.4 Periudhën e kohës gjatë të cilës mendohet të bëhet një ndërhyrje e tillë sipas mendimit të Autoritetit Kontraktor; dhe

41.2.5 Ndikimin që ajo ndërhyrje ka te Koncesionari dhe aftësia e tij për të kryer punimet, siguruar shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndërhyrjes.



41.3 Pas sigurimit të Njoftimit të Ndërhyrjes, Autoriteti Kontraktor mund të kryejë ndërhyrjen dhe Koncesionarit do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktor me gjithë ndihmën e arsyeshme dhe ndihmen e bashkëpunimin në dispozicion të kërkuar. Nëse ndërhyrja zgjat më shumë se 1 (një) ditë pune nga koha, siç parashikohet në klauzolën 41.2.4 dhe i shkakton Koncesionarit ndonjë humbje dhe shpenzime që duhet të konsiderohen një ngjarje Kompensimi. Në rast se ndërhyrja shkakton vonesa të Koncesionarit në kryerjen e detyrimeve, sipas kësaj Kontrate, atëherë çdo term i lidhur për keto detyrime do të shtrihet si kohëzgjatja e ndërhyrjes.

41.4 Në rastin e një ndërhyrjeje nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Klauzolën 41.3:

41.4.1 Gjatë gjithë ndërhyrjes, Koncesionari nuk është i detyruar të kryejë punime, të shfrytëzojë dhe mirëmbajë Autostradën, ose të ofrojë shërbimet në shkallën që përcaktohet në njoftimin për ndërhyrje;

41.4.2 Autoriteti Kontraktor kryen çdo ndërhyrje në mënyrë të tillë që pas përfundimit të një ndërhyrjeje të tillë, Koncesionari të jetë në gjendje të vazhdojë realizimin e kësaj Marrëveshjeje pa shkaktuar kosto shtesë apo humbje të të ardhurave dhe, në rastin që Autoriteti Kontraktor kryen ndonjë punim si pjesë e kësaj ndërhyrjeje, punime të tilla do të realizohen në përputhje me kërkesat dhe standardet e Autoritetit Kontraktor

41.4.3 Koncesionari ka të drejtë të marrë një shumë të barabartë me pagesën e rakordimit të deficitit të të ardhurave, në të njëjtën mënyrë siç do të ishte marrë nga Koncesionari në rast se ndërhyrja nuk do të ishte bërë, me kusht që, kur ndërhyrja kryhet nga Autoriteti Kontraktor si rrjedhojë e një shkeljeje të detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje, çdo kosto që i lind Autoritetit Kontraktor si pasojë e ndërhyrjes, do t'i paguhet Autoritetit Kontraktor nga Koncesionari; Koncesionari mund të kërkojë dëshmi të tilla të dokumentuara pasi do të kërkojë për të përcaktuar nëse shpenzimet e Autoritetit Kontraktor kane ndodhur.

41.4.4 për çdo ndërhyrje jo të shkaktuara nga Koncesionari, të gjitha kostot për keto ndërhyrje do të plotësohen nga Autoriteti Kontraktor. Nëse ka ndodhur një ndërhyrje e tillë, pas vlerësimit nga Inxhinierit i Pavarur, ngjarja do të konsiderohet si një ngjarje lehtësimi, ose si një Ngjarje Kompensimi.



42. Konfidencialiteti

42.1 Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me dispozita të tilla të Kontratës dhe Shtojcave të kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumenteve të Projektit dhe çdo të dhënë të krijuar dhe mbajtur në përputhje me këtë Marrëveshje që përcaktohen si "sekrete tregtare".

42.2 Klauzola 42.1 nuk zbatohet në rastin kur informacioni që vihet në dispozicion:

42.2.1 U jepet palëve që duhet dhe në shkallën që nevojitet për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

42.2.2 Zakonisht është i disponueshëm, përveç rasteve kur sigurohet si rezultat i shkeljes së detyrimeve në këtë marrëveshje;


42.2.3 Në përputhje me procedurën e Klauzolës 56;

- 42.2.4 Nëse kërkohet sipas ligjit ose rregullave që rregullojnë tregun publik të letrave me vlerë;
 - 42.2.5 U jepet këshilltarëve profesionistë të Koncesionarit;
 - 42.2.6 Huadhënësve apo këshilltarëve të tyre dhe këshilltarëve të tyre të sigurimeve; dhe
 - 42.2.7 Për respektimin e një urdhri të gjykatës apo një urdhri rregullator të një Autoriteti përkatës.
- 42.3 Dispozitat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë pikë, do të mbijetojnë dhe mbeten në fuqi gjate dhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

43. Të dhënat e Koncesionarit

- 43.1 Koncesionari mban dhe ruan të dhëna të plota në lidhje me Autostradën në përputhje me Lidhjen 6 të Shtojcës 5, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me, të dhënat për kostot faktike apo të parashikuara për shfrytëzimin e Autostradës dhe ofrimin e Punimeve dhe Shërbimeve, kostot e ndërtimit, shfrytëzimit dhe financimit për minimumi 5 (pesë) vjet (përveçse kur deklarohet ndryshe në Lidhjen 6 të Shtojcës 5) ose, nëse për një kohë më të gjatë, për periudhën e kërkuar me ligj;

- 43.2 Në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, Koncesionari:



- 43.2.1 I paraqet Autoritetit Kontraktor të dhëna për kostot e shfrytëzimit të Autostradës dhe ofrimin e Punimeve dhe Shërbimeve, të parashikuara në Klauzolën 43.1, duke përfshirë informacion për fondet në dispozicion të Koncesionarit për të mbuluar kosto të tilla në një formë dhe me hollësi të tilla që Autoriteti Kontraktor i kërkon me të drejtë për të monitoruar ecurinë e punës së Koncesionarit në lidhje me këtë Marrëveshje;
- 43.2.2 I mban dhe i ruan veçan nga të dhënat e tjera të dhënat e veçanta për të ardhurat nga palë të treta, të gjeneruara në përputhje me këtë Marrëveshje;
- 43.2.3 I paraqet Autoritetit Kontraktor të dhëna të veçanta për të ardhurat nga palë të treta në atë formë dhe me ato hollësi që Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, me qëllim për të monitoruar realizimin e kësaj Marrëveshjeje nga Koncesionari; dhe
- 43.2.4 E lejon Autoritetin Kontraktor me kërkesën e tij (me njoftim paraprak të arsyeshëm dhe brenda orëve të zakonshme të punës) të hyjë në dhomën ku mbahet të dhëna të tilla për t'i shqyrtuar ato.
- 43.3 Koncesionari i mban të dhënat dhe librat kontabël të tij në përputhje me metodat e kontabilitetit për të treguar, pa kufizim:
- 43.3.1 Numrin e punëmarrësve;
 - 43.3.2 Shumat e paguara Nënkontraktorve;
 - 43.3.3 Të ardhurat e marra nga palë të treta në përputhje me këtë Marrëveshjeje;

43.3.4 Shpenzime të tjera të lindura në lidhje me kryerjen e Punimeve dhe ofrimin e Shërbimeve; dhe

43.3.5 Të dhëna të tjera që Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë me të drejtë për kryerjen e inspektimeve të kostove faktike dhe që parashikohen për qëllimet e Klauzolave 27, 31 dhe 32,

veçmas nga aktivitetet e Koncesionarit, përveç realizimit të kësaj Marrëveshjeje.

43.4 Koncesionari gjithashtu merr përsipër të mbajë:

43.4.1 Çdo të dhënë apo raport që nevojitet të paraqitet apo ruhet në përputhje me ligjin;

43.4.2 Të dhëna të plota për lëndimet në punë apo shkeljet e rregulloreve të sigurisë në punë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje; dhe

43.4.3 Të dhëna për trajnimin e punëmarrësve në lidhje me mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të tyre në punë,

dhe t'ia paraqesë këto të dhëna Autoritetit Kontraktor për kontroll pa vonesa të tepërta.

43.5 Koncesionari merr përsipër ta lejojë Autoritetin Kontraktor (me njoftim të arsyeshëm dhe gjatë orëve të zakonshme të punës) të shqyrtojë dhe bëjë kopje të të gjitha të dhënave të arsyeshme të parashikuara në këtë Klauzolë 43.

43.6 Koncesionari merr përsipër t'i mbajë të dhënat e parashikuara në këtë Klauzolë 43, të cilat ekzistojnë në datën e përfundimit të kontratës për minimumi 5 (pesë) vjet pas datës së përfundimit të kontratës (përveç se kur deklarohet ndryshe në Lidhjen 6 të Shtojcës 5) ose, nëse për një kohë më të gjatë, për periudhën e kërkuar me ligj.

44. **Korrigjimi ekskluziv dhe rikuperimi i dyfishtë**

44.1.1 Në varësi të çdo të drejte tjetër të shprehur të Autoritetit Kontraktor, të parashikuar në këtë Marrëveshje, Autoriteti Kontraktor bie dakord se i vetmi korrigjim, që Autoriteti Kontraktor mund të bëjë në rastin e mosarritjes së Datës së përfundimit paraprak të Aspektit përkatës në Datën e programuar të përfundimit të Aspektit përkatës, është zbritja e kohëzgjatjes së periudhës së shfrytëzimit, ose e një pjese të saj, dhe se çdo mosarritje e tillë nuk do të përbëjë një shkelje të rëndë ose një shkelje të vazhdueshme për qëllimet e përkufizimit të mospërbushjeve të detyrimeve nga Koncesionari.

44.1.2 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje, asnjë palë nuk ka të drejtë të bëjë ndonjë kërkesë ndaj palës tjetër për të njëjtat shkaqe, për aq sa ajo kërkesë është përmbushur sipas një dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje.

45. **Asnjë lidhje apo autorizim**

45.1 Kjo Marrëveshje nuk përfaqëson asnjë lidhje nderinjet Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit.

45.2 Përveç se ku shprehet shprehimisht në këtë Marrëveshje, Koncesionari nuk është i autorizuar të kryejë asnjë veprim ligjor në emër të Autoritetit Kontraktor dhe anasjelltas.

46. Nuk ka të drejta ndaj burimeve publike

46.1 Koncesionari i plotëson detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje me riskun e tij dhe pa ndonjë të drejtë për të përdorur burime të tjera publike (përveç të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje).

46.2 Koncesionari merr përsipër të mos bëjë kërkesë pa pëlqimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor në lidhje me kryerjen e punës sipas kësaj Marrëveshjeje vetë, ose përmes ndonjërit nga Nënkontraktorët, për ndonjë grant nga burimet publike të Republikës së Shqipërisë ose të Bashkimit Evropian (qoftë si performancë financiare ose dorëzani). Koncesionari e garanton Autoritetin Kontraktor se nuk ka bërë kërkesë për ndonjë grant të tillë vetë, ose përmes ndonjërit nga Nënkontraktorët e tij.

46.3 Koncesionari nuk ka të drejtë t'i jepet një pëlqim i tillë sipas Klauzolës 46.2 dhe nëse Autoriteti Kontraktor e jep një pëlqim të tillë, atëherë kjo do të bëhet me kusht që ai t'i zbrësë përkatësisht shumat përkatëse të paguara nga Autoriteti Kontraktor sipas kushteve këtu.

46.4 Kryerja e punës me burime publike nuk nënkupton ofrimin e shërbimeve publike nga autoritetet publike përkatëse, sipas kërkesës, të gjithë individëve privatë dhe subjekteve ligjore drejtpërdrejt në përputhje me ligjin brenda gamës ku autoritete të tilla publike janë të detyruara të ofrojnë shërbime të tilla publike.

47. Të drejtat e pronësisë intelektuale

47.1 Licensa për Koncesionarin

47.1.1 Autoriteti Kontraktor i jep Koncesionarit një licensë jo ekskluzive pa pagesë për qëllimet e Punimeve, shfrytëzimin e Autostradës dhe ofrimin e shërbimeve për një periudhë që fillon nga data e kësaj Kontate deri në datën e përfundimit për të përdorur:

- (a) Skicat ekzistuese; dhe
- (b) Objektet e pronësisë intelektuale që duhen siguruar për realizimin e kontratës nga Koncesionari, në përputhje me Klauzolën 47.2.

47.1.2 Autoriteti Kontraktor e zhdëmton Koncesionarin për çdo dëm të pësuar nga Koncesionari ose Nënkontraktorët e tij, si rezultat i kërkesave për zhdëmtim të palëve të treta të bëra ndaj tyre, në lidhje me përdorimin prej tyre të pronësisë intelektuale në Klauzolën 47.1.1(a), përveç se kur dëmi është shkaktuar nga një shkelje e kësaj Marrëveshjeje nga Koncesionari.

47.2 Licensa për Autoritetin Kontraktor

47.2.1 Koncesionari i jep, dhe nëse ai nuk i ka të drejta të tilla, merr përsipër t'i sigurojë, Autoritetit Kontraktor licensa për të gjitha objektet e pronësisë intelektuale të nevojshme për kryerjen e Punimeve, shfrytëzimin e Autostradës dhe ofrimin e Punimeve dhe Shërbimeve:

- (a) Pa pagesë (përveç tarifave për licensat e pronësisë intelektuale të vendosura nga palë të treta në lidhje me softueret që zakonisht sigurohen në mënyra komerciale);
 - (b) Për shfrytëzimin e Autostradës dhe sigurimin e Punimeve dhe Shërbimeve,
 - (c) Për një periudhë të pakufizuar kohe nga fillimi i përdorimit të objekteve të pronësisë intelektuale për Punimet, Autostradën ose Shërbimet;
 - (d) Jo ekskluzivisht, në lidhje me objektet e pronësisë intelektuale të krijuara në mënyrë të pavarur, dhe të licensuara për përdorim vetëm sipas kësaj Marrëveshjeje, ose ekskluzivisht, në rastin kur objektet e pronësisë intelektuale janë krijuar veçmas për realizimin e kësaj Marrëveshjeje; dhe
 - (e) Për zbatimin e kesaj Marrëveshjeje (përveç softuerit që sigurohet në mënyrë komerciale) në mënyrë të transferueshme, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të mund t'ua japë të drejtën e përdorimit të objekteve të pronësisë intelektuale personave të tjerë ose t'ia transferojë plotësisht të drejtën e tij një personi tjetër.
- 47.3 Koncesionari premtan ta zhëdëmtojë Autoritetin Kontraktor për të gjithë dëmin e pësuar nga Autoriteti Kontraktor, ose nga palët e Autoritetit Kontraktor si rezultat i kërkesave të bëra ndaj tyre nga palët e treta në lidhje me përdorimin e objekteve të pronësisë intelektuale të marra nga Koncesionari në përputhje me Klauzolën 47.2.

48. **Transferimi**

48.1 Përveç në rrethanat kur lejohet shprehimisht sipas kësaj Marrëveshjeje dhe marrëveshjes së drejtpërdrejtë dhe në bazë të të drejtave (interesave) mbi garancinë, asnjë palë nuk ka të drejtë t'ia transferojë ndonjë nga të drejtat e saj një pale të tretë, pa pëlqimin e palës tjetër. Pavarësisht nga sa më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të autorizojë subjekte të tjera shtetërore brenda kontrollit të tij për të ushtruar disa ose të gjitha të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje me kusht që Autoriteti Kontraktor të njoftojë Koncesionarin për një autorizim të tillë dhe që të mos rezultojë asnjë detyrim shtesë për Koncesionarin si rezultat i një autorizimi të tillë.

48.2 Autoriteti Kontraktori i njej dhe i pranon të Interesat e sigurisë (garancitë) që Koncesionari u ka dhenë Huadhënësve në përputhje me Marrëveshjet e Financimit.

49. **Gjuha e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje është bërë në gjuhën angleze dhe shqipe dhe, në rast të ndonjë mospërputhje ndermjet gjuhëve, gjuha angleze do të ketë përparësi.

50. **Dublikata të origjinalit**

Kjo Marrëveshje është bërë në 4 (katër) dublikata origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Secila palë mban 1 (një) dublikatë të origjinalit të kësaj Marrëveshjeje në gjuhën angleze dhe shqipe.

51. Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje përmban një marrëveshje të plotë në lidhje me objektin e realizimit të saj. Kjo Marrëveshje zëvendëson çdo kontratë dhe të gjitha kontratat e mëparshme të palëve, qofshin gojore apo të shkruara në lidhje me objektin e realizimit të saj. Secila nga palët deklaron se në bërjen e kësaj marrëveshjeje nuk është mbështetur në ndonjë siguri të dhënë nga pala tjetër apo nga një palë e tretë, përveçse në sigurinë e parashikuara në të.

52. Njoftimet

52.1 Çdo komunikim dhe të gjitha komunikimet me shkrim të bëra sipas kësaj Marrëveshjeje, ose në lidhje me këtë Marrëveshje, nga secila nga palët, palës tjetër, dërgohet me një nga mënyrat e mëposhtme:

52.1.1 Dorëzim në dorë të komunikimit me shkrim;

52.1.2 email;

52.1.3 faks; dhe/ose

52.1.4 me postë ose me shërbim korrieri.

52.2 Komunikim me shkrim u dërgohet palëve në adresën e mëposhtme:

52.2.1 Kur i dërgohet Autoritetit Kontraktor:

Adresa: []

Faksi: []

Email: []

Për: []

52.2.2 Kur i dërgohet Koncesionarit:

Adresa: []

Faksi: []

Email: []

Për: []

52.3 Çdo komunikim me shkrim do të konsiderohet i dërguar nëse:

52.3.1 Dërgohet personalisht, me dorëzimin e komunikimit me shkrim, kur përfaqësuesi i të adresuarit (pala tjetër) konfirmon pranimin e dokumentacionit të shkruar ose kur përfaqësuesi i të adresuarit refuzon ta pranojë atë;

52.3.2 Dërgohet me email, kur emaili dërgohet në adresën e emailit të palës tjetër dhe kur pala dërguese merr përsëri email ose konfirmon marrjen e tij nga pala tjetër, por kur emaili



nuk është dërguar gjatë një dite pune, ose është dërguar pas orës 4:00 pasdite, në një ditë pune, emaili do të konsiderohet sikur është dërguar në orën 10:00 të mëngjesit të ditës së nesërme të punës;

- 52.3.3 Kur dërgohet me faks, kur faksi është dërguar me sukses (siç konfirmohet me një njoftim nga faksi dërgues) në numrin e faksit të palës tjetër dhe kur faksi nuk është dërguar gjatë një dite pune, ose është dërguar pas orës 4:00 pasdite të një dite pune, faksi do të konsiderohet se është dërguar në orën 10:00 paradite të ditës tjetër të punës;
- 52.3.4 Kur dërgohet me postë ose me shërbim korrieri, kur përfaqësuesi i palës tjetër e ka pranuar dorëzimin e tij, ose kur përfaqësuesi i të adresuarit ka refuzuar të pranojë dorëzimin e njoftimit.
- 52.3.5 Të dyja palët kanë të drejtë të ndryshojnë adresat e tyre (si edhe numrat e faksit dhe adresat e emailit) të dërgimit të njoftimeve. Nëse ndodh kjo gjë, pala tjetër është e detyruar ta dërgojë njoftimin në adresën e porsanjoftuar (faks, email), duke filluar nga dita e parë e punës pas ditës kur ndryshimi i është bërë i njohur palës tjetër.

53. Të pjesshme

- 53.1 Nëse ndonjë dispozitë këtu është, ose bëhet e pavlefshme apo e pazbatueshme, një pavlefshmëri ose pazbatueshmëri e tillë nuk i cenon dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët marrin përsipër të zëvendësojnë dispozitën e pavlefshme dhe të pazbatueshme sa më shpejt që të jetë e mundur me një dispozitë tjetër të vlefshme dhe të zbatueshme, përmbajtja e të cilës është e ngjashme me dispozitën e pavlefshme ose të pazbatueshme.

54. Mbrojtja e të dhënave

- 54.1 Nëse të dhënat personale përpunohen në bazë të Ligjit nr.9887, datë 10 tetor 2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Koncesionari plotëson secilën dhe të gjitha dispozitat që rrjedhin nga ky ligj dhe nëse kërkohet pëlqimi i subjektit të të dhënave, një pëlqim i tillë do të merret me qëllim që të dhënat personale të mund t'i jepen Autoritetit Kontraktor. Shkelja e ligjit në lidhje me menaxhimin e të dhënave personale nga Koncesionari do të konsiderohet shkelje e kësaj Marrëveshjeje dhe Koncesionari do të jetë përgjegjës vetëm në lidhje me shkeljen e ligjit ndaj autoriteteve të lidhura..

55. Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Shqipërisë.

56. Përshkallëzimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 56.1 Nëse lind një mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin e ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, një mosmarrëveshje e tillë në fillim dërgohet për zgjidhje tek përfaqësuesit e palëve si më poshtë:
 - 56.1.1 Në varësi të Klausolës 25.8, fillimi i një mosmarrëveshjeje i njoftohet me shkrim palës tjetër nga pala që e nis atë, duke deklaruar përfaqësuesin e saj të autorizuar që do të merret me mosmarrëveshjen;

- 56.1.2 Pala tjetër i përgjigjet njoftimit të palës së parë brenda 3 (tre) ditësh pune, duke deklaruar përfaqësuesin e saj të autorizuar, i cili do të merret me mosmarrëveshjen;
- 56.1.3 Përfaqësuesit e palëve janë personat që nuk kanë marrë pjesë në mënyrë materiale në ngjarjet që i kanë paraprirë mosmarrëveshjes;
- 56.1.4 Përfaqësuesit e palëve negociojnë mosmarrëveshjen me mirëbesim dhe me qëllimin për ta zgjidhur atë në një mënyrë që t'i përmbahet më mirë frymës dhe qëllimit të saj; dhe,
- 56.1.5 Nëse përfaqësuesit e palëve nuk arrijnë të bien dakord për një zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda tetëmbëdhjetë (18) ditësh pune nga lindja e mosmarrëveshjes, secila nga palët mund ta çojë mosmarrëveshjen për gjykim në arbitrazh.

56.2 Arbitrazhi

56.2.1 Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet me negociata sipas Klauzolës 56.1, secila nga palët mund ta dërgojë mosmarrëveshjen për arbitrazh sipas rregullave të arbitrazhit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Çdo proces arbitrazhi i nisur në përputhje me këtë Klauzolë 56 ("Procesi i Arbitrazhit") do të zhvillohet me pjesëmarrjen e një paneli gjykatësish të arbitrazhit të përbërë nga tre gjykatës ("Gjykata"), nga të cilët njëri emërohet nga Autoriteti Kontraktor, njëri nga Koncesionari. Gjykatësi i tretë caktohet nga dy gjykatësit e tjerë dhe vepron si kryetar gjykate. Vendimi i Gjykatës është i formës së prerë, detyrues dhe i paapelueshëm.

56.2.2 Vendi i arbitrazhit është Viena, Austri, dhe gjuha e arbitrazhit është anglishtja.

56.2.3 Gjykata zbaton kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitat e ligjeve që përdoren herë pas here.

56.2.4 Gjykata ka të drejtë, brenda objektit të një mosmarrëveshjeje ligjore që pritet të zgjidhet, të marrë vendime për masa të ndërmjetme.

57. Amendamentet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me anë të amendamenteve me shkrim të nënshkruara nga të dyja palët.

58. Kostot dhe shpenzimet e palëve

Kur nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, ose në ndonjë dokument tjetër të Projektit, secila palë i përballon vetë të gjitha kostot që i lindin në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të amendamenteve të saj.

59. Konflikti i Marrëveshjeve

Nëse dispozitat e kësaj Marrëveshjeje janë në konflikt me dispozitat e një Marrëveshjeje tjetër ndërmjet palëve në këtë Marrëveshje, në lidhje me të njëjtën objekt, pavarësisht nëse një marrëveshje e tillë është bërë përpara ose pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, kjo

Marrëveshje do të ketë gjithmonë përparësi, përveçse kur palët bien shprehimisht dakord ndryshe me shkrim.

60. Tatimi

Koncesionari i paguan të gjitha tatimet e pagueshme në lidhje me Projektin, tokën për të cilën është dhënë ndonjë interes, shfrytëzimin e Autostradës, dhe të ardhurat ose fitimet e gjeneruara nga Projekti dhe ndonjë tatim tjetër për ndonjë aktiv, tokë apo pasuri, apo interes në tokë, që i është dhënë Koncesionarit në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

61. Interesi në raste mospërbushja të detyrimeve

Në rastin kur njëra nga palët nuk plotëson ndonjë nga detyrimet e veta, palët kanë rënë dakord për një interes për mospërbushje në vlerën e interesit për mospërbushje.

Në emër të Autoritetit Kontraktor:

Në emër të Koncesionarit:

Firma: _____

Firma: _____

Emri: **Sokol Dervishaj**

Emri: **Pëllumb Salillari**

Pozicioni: Përfaqësues me prokurë i "Catalyst Viv General Contracting" LLC

Pozicioni: Ministër i Transportit dhe
Infrastrukturës

Firma _____

Emri: **Pëllumb Salillari**

Pozicioni: Administrator i shoqërisë "Salillari" sh.p.k

Firma: _____

Emri: **L**

Pozicioni: Përfaqësues i ligjor i shoqërisë "Violap Ateve"

Firma: _____

Emri: **Yama Ghulam Dasgupta**

Pozicioni: Administrator i shoqërisë "Yama Ghulam Dasgupta"

Firma: _____

Emri: **Gani Kastrati**

Pozicioni: Administrator i shoqërisë "Kastrati sh.a"

Shtojca 1

Përkufizime

“TDMV” është trafiku ditor mesatar vjetor i shprehur si njësi autovetura udhëtarësh në të dy kahet e lëvizjes.

“Braktisje” është moskryerja e të gjitha punimeve ose e një pjese të konsiderueshme të punimeve të parashikuara në kontratë për një periudhë prej njëzet (20) ditësh pune të njëpasnjëshme.

“Kosto faktike e sigurimit” është kostoja vjetore faktike e primeve të sigurimit që i lindin Koncesionarit për mbajtjen e Sigurimeve të periudhës së shfrytëzimit, pasi të jenë zbritur nga kostot faktike çdo rritje që nuk lind vetëm nga rrethanat që mbizotërojnë në tregun botëror të sigurimeve.



“Të ardhura faktike nga trafiku” janë:

- (a) në vitin e parë të të ardhurave të garantuara nga trafiku, të ardhurat e pritura në euro nga taksa e rrugës gjatë periudhës që fillon me datën e fillimit të përdorimit të rrugës me taksë dhe mbaron në fund të vitit të parë të të ardhurave të garantuara nga trafiku;
- (b) në vitin e fundit të kontratës, të ardhurat e pritura në euro nga taksa e rrugës gjatë periudhës që fillon me fillimin e vitit të fundit të kontratës dhe mbaron në fund të muajit që i paraprin muajit në të cilën bie data e përfundimit të kontratës; dhe
- (c) në të gjitha vitet e tjera të kontratës, të ardhurat e pritura në euro nga taksa e rrugës gjithsej gjatë vitit të Kontraktimit,

në çdo rast, plus kompensimet për evazion takse rruge të pagueshme për Koncesionarin për vitin e kontratës, sipas verifikimeve të kryera nga inxhinieri i pavarur.

“Truall shtesë” është truall që i nevojitet në mënyrë të përhershme Koncesionarit krahas Territorit të Projektit në mënyrë që të realizojë punimet dhe/ose shërbimet.

“Palë e prekur” ka kuptimin që i është caktuar në përkufizimin e ngjarjes së forcës madhore;

“Palë e lidhur” është, kundrejt një shoqërie tregtare, çdo shoqëri e llojit holding (që blen aksionet e shoqërive të tjera) që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare, çdo shoqëri tregtare mbi të cilën ushtrohet kontroll nga ajo shoqëri tregtare ose çdo shoqëri e kontrolluar e një shoqërie të llojit holding (që blen aksionet e shoqërive të tjera) që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare.

“Pasqyrë vjetore e pagesave” është një pasqyrë të cilën Koncesionari e harton dhe ia vë në dispozicion Autoritetit Kontraktues në përputhje me klauzolën 25.4.2.

“Afati i dorëzimit i Pasqyrës vjetore të pagesave” ka kuptimin që i është caktuar në klauzolën 25.4.2.

“Raporti i ecurisë vjetore” është raporti i hartuar në përputhje me Lidhjen 6 të Shtojcës 5.

“Raporti vjetor” është raporti i hartuar në përputhje me Lidhjen 6 të Shtojcës 5.

“Antikitete” janë të gjitha fosilet, antikitetet, strukturat dhe mbetjet e tjera, sende ose gjëra me vlerë ose interes arkeologjik, artistik, gjeologjik dhe/ose monetar, të zbuluara në Kantier.

“Skicat e miratuara të ndërtimit” janë Skicat e ndërtimit të miratuara nga Inxhinieri i pavarur në përputhje me klauzolën 15.1.2.

“Projekti i zbërthyer i miratuar” është Projekti përfundimtar i zbërthyer i miratuar nga Inxhinieri i pavarur në përputhje me klauzolën 15.1.2.

“Situacioni” ka kuptimin që i jepet në Lidhjen 6 të Shtojcës 5. Përfshin të gjitha skicat, llogaritjet, raportet etj. në format elektronik dhe të shtypur në të cilat paraqiten evidencat faktike të miratuara të ndërtimit të përditësuara për të pasqyruar vendndodhjet, madhësitë, materialet e ndërtimit dhe hollësi të tjera të Punimeve të realizuara, duke bërë lidhjen me specifikimet dhe tabelat përkatëse.

“Aspekt” janë Punimet për sheshet e taksës ose çdo element i Punëve kapitale, sipas kontekstit.

“Shoqëri e lidhur” e cilitdo personi është çdo subjekt që e kontrollon personin ose që kontrollon nga personi ose çdo subjekt që kontrollon nga një Shoqëri e lidhur e personit.

“Norma e brendshme e kthimit mbi kapitalin neto në situatën bazë” është Norma e brendshme e kthimit mbi kapitalin më datën e kësaj Kontrate siç paraqitet në Modelin financiar të situatës bazë, në kutizën me numër [].

“Modeli financiar i situatës bazë” është Modeli financiar që ekziston më datën e kësaj Kontrate, i identifikuar si i tillë.

“Kosto e sigurimit bazë” është kostoja vjetore e sigurimeve të periudhës operative për vitin e parë të shfrytëzimit pas nxjerrjes së Certifikates paraprake të përfundimit në formë përfundimtare (e indeksuar).

“Norma bazë” është norma ndërbankare e interesit EURIBOR [për t’u specifikuar në bazë të Modelit financiar të Koncesionarit më Datën e dorëzimit të ofertave], siç paraqitet në Ekranin EURIBOR të Reuters-it¹.

“Dokumentacion i ofertës” është çdo dokument që Koncesionari ka paraqitur si pjesë të ofertës.

“Garancia e ofertës” është garancia prej 250.000 euro që Koncesionari ka paraqitur në përputhje me ofertën dhe shtojcën 2 të Kërkesës për propozim datë 29 Prill 2016.

“Data e paraqitjes së ofertës” është 30 Maj 2016.

“Dokumentacioni i procedurës së tenderit” është kërkesa që ka nxjerrë Autoriteti kontraktues për ofertuesit e mundshëm në lidhje me këtë Projekt.



¹ Vendimi për të përdorur normën EURIBOR, sikurse tregohet në Modelin financiar më Datën e dorëzimit të ofertës, duhet të përkojë me kushtet paraprake të financimit që ka parashikuar Koncesionari (ose që ka marrë nga huadhënësit e mundshëm) në momentin e Dorëzimit të ofertave.

"Ditë pune" është çdo ditë pune pa përfshirë të shtunën, të dielën dhe ditët e festave zyrtare të Shtetit Shqiptar.

"Shpenzim kapital" është shpenzimi i klasifikuar herë pas here sipas Ligjit ose sipas parimeve përgjithësisht të pranura kontabël si investim kapital ose shpenzim kapital.

"Punime kapitale" janë aktivitetet ndërtimore të mëposhtme të cilat janë të nevojshme në lidhje me Autostradën:

- (a) Punime gjeoteknike fillestare;
- (b) Punime në mbikalime dhe kryqëzime;
- (c) Punime për përmirësim të Autostradës; dhe
- (d) Punimet për urën e re mbi lumin Drin.

"Data e fillimit të punimeve kapitale" është Data e hyrjes në fuqi ose, në lidhje me punimet për urën e re mbi lumin Drin, fillim i punimeve më datën e miratuar nëse është shtyrë për pas datës së hyrjes në fuqi sipas pika 4 e Pjesës 6.2.2 të Shtojcës 5.

"Ndryshim në ligj" është ndryshimi ligjor që ndodh pas datës së kësaj Kontrate, pa përfshirë ndryshimet e parashikueshme të ligjit.

"Rrugë konkurrencte" është rruga, me pagesë ose jo, që u jep përdoruesve një alternativë të mundshme dhe të krahasueshme me përdorimin e Autostradës.

"Vlera e kompensimit" është shuma që i rivendos raportet e Normës së brendshme të kthimit mbi kapitalin dhe mbulimit të shlyerjes së borxhit të Koncesionarit në nivelet e paraqitura në Modelin financiar të situatës bazë të audituar.

"Ngjarje kompensimi" është:

- (a) shkelje nga ana e Autoritetit Kontraktues e çdo detyrimi material të parashikuar me këtë Marrëveshje që e bën Koncesionarin të paaftë për të përmbushur detyrimet e parashikuara me këtë Marrëveshje për një periudhë më të gjatë se 5 (pesë) Ditë pune;
- (b) mosdhënia e mundësisë nga ana e Autoriteti Kontraktues për hyrje-dalje në Kantier sipas Klauzolës 10.1;
- (c) zbulimi i një Problemi të trashëguar;
- (d) zbulimi i materialeve të rrezikshme të paparashikueshme sipas Klauzolës 16.4.3;
- (e) zbulimi i sistemeve të infrastrukturës publike të paparashikueshme sipas Klauzolës 16.5.2;
- (f) realizimi i ndonjë ngjarje të parashikuar në Klauzolën 20.5 ose Klauzolën 20.9;
- (g) ndërtimi i një Rruge konkurrencte;



- (h) moskryerja nga ana e Autoritetit Kontraktues e detyrimeve për zhvendosjen e popullsisë dhe shpronësimit sipas Klauzolës 10.1.2 dhe Shtojcës 9;
- (i) miratimi i një kategorie të re Përdoruesish të përjashtuar nga Paguesa e rrugës;
- (j) protesta që ka për pasojë mbylljen e Autostradës ose të një pjese të saj në çdo moment pas Datës së hyrjes në fuqi;
- (k) mbyllja e detyruar e Urës mbi Drin përpara zëvendësimit të saj në përputhje me kushtet e Shtojcës 5 (Kërkesat teknike të Investitorit) të kësaj Kontrate; ose
- (l) çdo ngjarje tjetër që është parashikuar shprehimisht si Ngjarje kompensimi në këtë Kontratë.

"Certifikata e Perfundimit" janë certifikatat e nxjerra në përputhje me ligjet të cilat vërtetojnë përfundimin dhe mundësinë për përdorim të çdo Aspekti përkatës të Autostradës në përputhje me Klauzolën 20.

"Afati përfundimtar për Certifikatën e Perfundimit" është data 15 (pesëmbëdhjetë) muaj pas datës së fundit të përfundimit të programuar të Aspektit përkatës.

"Shoqëria koncesionare" është subjekti për qëllime të veçanta i themeluar nga Koncesionari për t'u bërë Palë e kësaj Marrëveshjeje sipas Klauzolës 2A.1.

"Periudhë koncesioni" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 3.

"Të drejtat e koncesionit" janë e drejta për të projektuar, ndërtuar, përmirësuar, mirëmbajtur dhe shfrytëzuar Autostradën (përfshirë arkëtimin e Taksës së rrugës) dhe për t'i financuar këto aktivitete, e drejta për të shfrytëzuar Autostradën në përputhje me Ligjin dhe me këtë Marrëveshje.

"Ndryshim nga Koncesionari" është ndryshimi i propozuar nga Koncesionari në bazë të klauzolës 32.2.

"Njoftimi për ndryshim nga Koncesionari" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 32.2.1.

"Mosplotësim nga Koncesionari" është:

- (a) shkelja e rëndësishme e detyrimeve të Koncesionarit të parashikuara në këtë Kontratë, që:
 - (i) prek ndjeshëm ecurinë e Punimeve dhe/ose Shërbimeve; ose
 - (ii) prek ndjeshëm aftësinë e Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e parashikuara me ligj; ose
 - (iii) prek ndjeshëm përdorimin e Autostradës nga Autoriteti Kontraktues dhe Përdoruesit;
- (b) Shkelje e vazhdueshme;
- (c) shpallja e likuidimit;



- (d) fillimi i procedurave kundër Koncesionarit të lidhura me paaftësinë paguese;
- (e) mosfillimi i Punimeve nga Koncesionari në përputhje me Programin dhe/ose Shërbimet brenda 3 (tre) muajve nga Data e fillimit të punimeve kapitale;
- (f) Braktisja e Punimeve nga Koncesionari;
- (g) mosrespektimi i një Date të përfundimit paraprak të aspektit përkatës brenda Afatit përfundimtar për Aspektin përkatës;
- (h) mosnxjerrja e Certifikates se Përfundimit për të gjitha Aspektet përkatëse të Autostradës brenda Afatit përfundimtar për Certifikaten e Përfundimit ;
- (i) Koncesionari merr Pikë ecurie të barabarta me ose më të mëdha se 100 (njëqind) në cilëndo periudhë dymbëdhjetë-mujore;
- (j) Koncesionari merr Pikë ecurie të barabarta me ose më të mëdha se 200 (dyqind) në cilëndo periudhë tridhjetegjashtë-mujore;
- (k) Koncesionari nuk paguan një shumë që nuk është objekt mosmarrëveshjeje dhe që është më e madhe se 100.000 € (e indeksuar) për një periudhë prej (30) tridhjetë Ditësh pune pas dorëzimit të kërkesës me shkrim nga Autoriteti Kontraktues;
- (l) Koncesionari nuk blen fillimisht dhe në vazhdimësi Sigurimet e nevojshme sipas klauzolës 34;
- (m) Koncesionari shkel kufizimet e vendosura në klauzolën 4.2 dhe klauzolën 8.5; dhe/ose
- (n) Koncesionari shkel kufizimet e vendosura mbi kalimin ose ndryshimin e kontrollit të parashikuara në klauzolën 5 dhe klauzolën 48.



“Njoftimi për Mosplotësim nga Koncesionari” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 37.2.1.

“Palë koncesionare” është veçmas Koncesionari, Nënkontraktori, Përfaqësuesi i Koncesionarit, inxhinieri i Koncesionarit dhe nëpunësit, punëmarrësit dhe agjentët e tyre dhe çdo Nënkontraktor apo person i punësuar ose i angazhuar nga secili prej tyre.

“Propozime të Koncesionarit” janë:

- (a) Propozime për punime të Koncesionarit; dhe
- (b) Propozime për shërbime të Koncesionarit.

“Përfaqësues i Koncesionarit” është personi i identifikuar për të vepruar si Përfaqësues i Koncesionarit në bazë të klauzolës 9.2.

“Pjesa e Koncesionarit” është ajo pjesë e pagesës së Shpenzimit kapital progresiv që lind nga shkronja “c” e përkufizimit të Ndryshimit cilësues të ligjit të mbuluar nga Koncesionari pa të drejtë marrje pagese nga Autoriteti Kontraktues, e cila llogaritet si vijon:

Shpenzimin kapital progresiv

Pjesa e Koncesionarit

0 € deri në 100.000 €	100%
100.001 deri në 225.000 €	80%
225.001 € deri në 380.000 €	60%
380.001 € deri në 647.500 €	40%
647.501 € deri në 1.147.500 €	20%
1.147.501 € e lart	0%

“Skicat e ndërtimit” janë skicat dhe llogaritjet e hartuara në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktues, në të cilat paraqiten të gjitha dimensionet, llogaritjet dhe hollësitë e nevojshme për t’i dhënë mundësi Koncesionarit të realizojë Punimet.

“Periudha ndërtimore” janë periudhat brenda periudhës së vlefshmërisë së Kontratës gjatë të cilave realizohen Punime kapitale.

“Nënkontratë ndërtimi” është nënkontrata e lidhur ndërmjet Koncesionarit dhe Nënkontraktorit ndërtimor për kryerjen e Punimeve, me ndryshimet dhe zëvendësimet përkatëse të bëra herë pas here në përputhje me këtë Kontratë.

“Nënkontraktori ndërtimor” është [] me seli të regjistruar në adresën: [], i përfaqësuar nga [] si përfaqësues i caktuar dhe autorizuar rregullisht nga Koncesionari ose nga një person tjetër i caktuar me Nënkontratë ndërtimi në përputhje me këtë Kontratë.

“Periudha e vlefshmërisë së Kontratës” është periudha kohore që fillon me Datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate dhe përfundon me Datën e përfundimit të Kontratës.

“Viti i Kontratës” është Viti i plotë kalendarik gjatë Periudhës së vlefshmërisë së Kontratës me kusht që:

- (a) Viti i pare i Kontratës është periudha kohore nga Data e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate deri më 31 dhjetorin e ardhshëm; dhe
- (b) Viti i fundit i Kontratës është periudha kohore nga 1 janari i fundit përpara Datës së përfundimit të Kontratës deri më Datën e përfundimit të Kontratës.

“Ndryshim nga Autoriteti Kontraktues” është ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në bazë të klauzolës 32.1.

“Konfirmimi i Ndryshimit nga Autoriteti Kontraktues” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 32.1.8.

“Njoftim për Ndryshim nga Autoriteti Kontraktues” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 32.1.1.

“Mosplotësim nga Autoriteti Kontraktues” është secili prej ngjarjeve ose fakteve të mëposhtme:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk paguan shuma që nuk janë objekt mosmarrëveshjeje dhe që në vlerë të agreguar janë më shumë se 500.000 € (e indeksuar) ose shuma të

pagueshme në përputhje me klauzolën 25.5 për një periudhë prej (30) tridhjetë Ditësh pune pas dorëzimit të kërkesës me shkrim nga Koncesionari;

- (b) shpronësimi, sekuestrimi ose kërkesa e një pjese me rëndësi materiale të aktiveve të Koncesionarit ose të një Nënkontraktori ose i aksioneve të Koncesionarit;
- (c) vlera progresive e Punimeve rehabilituese gjeoteknike të realizuara nga Koncesionari në bazë të klauzolës 32A.3.8 është më e madhe se dhjetë milion (10.000.000) euro;
- (d) kalim i Kontratës tek të tretë nga Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me klauzolën 48.1; dhe/ose
- (e) shkelje e detyrimeve të Autoritetit Kontraktues parashikuar në këtë Kontratë që e bën të pamundur ose e pengon në mënyrë të konsiderueshme Koncesionarin që të realizojë Punimet dhe/ose Shërbimet për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj.

"Njoftimi për Mosplotësim nga Autoriteti Kontraktues" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 37.6.1.

"Shuma e zgjidhjes së Kontratës për shkak të Mosplotësimit nga Autoriteti Kontraktues" është shuma e barabartë me vlerën agregate të:

- (a) Detyrimeve përpara huadhënësve;
- (b) pagesave për shkurtrim të vendit të punës dhe/ose kostove të tjera të cilat Koncesionari duhet t'i paguajë punëmarrësve të tij si pasojë e përfundimit të kësaj Kontrate në bazë të ligjit (për aq sa këto pagesa janë të arsyeshme dhe janë zbutur nga Koncesionari);
- (c) Kostove të zgjidhjes përpara kohe të nënkontratës;
- (d) shumave që Autoriteti Kontraktues i detyrohet Koncesionarit dhe që janë ende të pashlyera më Datën e përfundimit të Kontratës;
- (e) një shume e cila kur konsiderohet së bashku me dividendët (ose me shpërndarje të ngjashme të fitimit) që Koncesionari i paguan në bazë të Kapitalit të investuar më Datën e përfundimit të Kontratës ose përpara kësaj date duke mbajtur parasysh momentin kur është kryer në fakt kjo pagesë, jep një normë reale të brendshme kthimi mbi Kapitalin e investuar të barabartë me Normën e brendshme të kthimit mbi kapitalin në Modelin Financiar,

MINUS (pa llogaritje të dyfishtë)

- (f) të gjitha tepricat kreditore të llogarive bankare të Koncesionarit më Datën e përfundimit të Kontratës (pa përfshirë Llogarinë e të hyrave nga sigurimi); dhe
- (g) shumat që Koncesionari i detyrohet Autoritetit Kontraktues ose për të cilat Autoriteti Kontraktues do të kishte të drejtë t'i përdorte për kompensim në shlyerje të të drejtave të Koncesionarit në bazë të kësaj Kontrate.



“Pëlqimi i nevojshëm i Autoritetit Kontraktues” është çdo certifikate e perkoheshme apo perfundimtare , pëlqim, licensë, aprovim, lejim ose autorizim, që është i nevojshëm në lidhje me Projektin dhe që duhet lëshuar nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me klauzolën 14.

“Palë e Autoritetit Kontraktues” është veçmas Autoriteti Kontraktues dhe nëpunësit, punëmarrësit dhe agjentët e tij dhe çdo Nënkontraktor apo person i punësuar ose i angazhuar nga secili prej tyre (ku përfshihen edhe Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues dhe Përfaqësuesi teknik, por pa përfshirë Koncesionarin dhe Palët koncesionare).

“Subvencion nga Autoriteti Kontraktues” është subvencioni vjetor i propozuar nga Koncesionari në Dokumentacionin e ofertës dhe që Autoriteti Kontraktues e jep në përputhje me klauzolën 25.3.

“Përfaqësues i Autoritetit Kontraktues” është personi i identifikuar për të vepruar si Përfaqësues i Autoritetit Kontraktues në bazë të klauzolës 9.1.

“Kërkesa të Autoritetit Kontraktues” janë:

- (a) Kërkesat e Autoritetit Kontraktues për punimet; dhe
- (b) Kërkesat e Autoritetit Kontraktues për shërbimet.

“Kërkesat e Autoritetit Kontraktues për shërbimet” janë kërkesat për shërbimet dhe kërkesat për ecurinë të parashikuara në Seksionin 3 të Shtojcës 5.

“Kërkesat e Autoritetit Kontraktues për punimet” janë kërkesat për punimet, kërkesat për riparim kapitali dhe kërkesat për ecurinë të parashikuara në Seksionin 6 të Shtojcës 5.

“Kontroll” i një personi nga një person tjetër është kur ky personi tjetër (i vetëm ose me të tjerë dhe drejtpërdrejt ose tërthorazi) ka shumicën e kapitalit të personit të parë ose nëpërmjet zotërimit të kapitalit aksioner ose nëpërmjet një kontrate ose ka shumicën e votave ose, në kuptim vetëm të klauzolës 48.1 ka të drejtën të emërojë ose largojë anëtarët e këshillit të administrimit ose çdo të drejtë tjetër që ka ose mund të ketë ose sjell të njëjtën pasojë si secili rast sa më lart.

“Shpenzim kapital progresiv” është shuma agregate e të gjitha shpenzimeve kapitale që bëhen si pasojë e shkronjës “c” të përkufizimit të Ndryshimeve cilësuese të ligjit, të cilat janë bërë në përputhje me klauzolën 30.

“Data e transferimit” është data kur bëhet efektivi kalimi i Të drejtave të koncesionit në bazë të klauzolës 2A.1 (Transferimi i të drejtave të koncesionit tek Shoqëria e koncesionit).

“Pagesat e Shërbimit të Borxhit” do të thotë ato pagesa siç kërkohen të bëhen nga Koncesionari për financuesit e tij sipas Dokumenteve të Financimit në secilin Vit Kontrate. Për shmangien e dyshimeve, ky term do të nënkuptojë si pagesat e principalit dhe ato të interesave.

“Kamatëvonesë” është 4% mbi normën ndërbankare të interesit EURIBOR që shfaqet në Ekranin e Reuters EURIBOR në datën kur bëhet i pagueshëm interesi për shkak të mosshlyerjes.

“Defekt” është një defekt i Autostradës.



"Periudha e përgjegjësisë për defektet" është për çdo Aspekt periudha prej 24 (njëzet e katër) muajsh, që fillon më datën e përfundimit paraprak të Aspektit përkatës.

"Marrëveshje e drejtpërdrejtë" është marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues, Koncesionarit dhe Huadhënësve.

"Të dhënat e vëna në dispozicion" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 7.1.

"Ndryshim diskriminues i ligjit" është Ndryshimi i ligjit i cili zbatohet në mënyrë specifike:

- (a) për Projektin dhe jo për projekte të ngjashme;
- (b) për Koncesionarin dhe për asnjë person tjetër;
- (c) për shoqëritë tregtare të angazhuara në projekte të ngjashme me Projektin dhe për asnjë person tjetër; dhe/ose
- (d) për Kërkesat për taksën e rrugës.

"Mosmarrëveshje" është çdo mospërputhje në mendime ose mosmarrëveshje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit që lindin nga Kontrata ose në përputhje me Kontratën (duke përfshirë edhe çështje të lidhura me vlefshmërinë ose interpretimin e Kontratës dhe duke përfshirë edhe mosmarrëveshjet që lindin përpara ose pas përfundimit të Kontratës).

"Shpërndarje" është:

- (a) në mjete monetare ose në natyrë:
 - (i) dividendi ose shpërndarjet e tjera të lidhura me kapitalin aksioner;
 - (ii) zvogëlimi i kapitalit, riblerja ose blerja e aksioneve ose çdo riorganizim apo ndryshim tjetër i kapitalit aksioner;
 - (iii) shlyerja e Borxhit të varur (principali, interesa, pagesa për shlyerje para kohe ose në çfarëdo forme);
 - (iv) shlyerja, huadhënia, organizimi me kontratë ose kalimi i aktiveve ose të drejtave për aq sa (në secilin rast) kjo nuk është bërë në rrjedhën e zakonshme të ushtrimit të aktivitetit tregtar dhe nuk është bërë me kushte tregtare të arsyeshme; ose
 - (v) marrja e çdo përfitimi tjetër që nuk është në kuadër të rrjedhës normale të aktivitetit tregtar dhe jo me kushte tregtare të arsyeshme; ose
- (b) shlyerja përpara kohe e Detyrimeve të kushtëzuara përpara huadhënësve, kur vlera e shlyerjes në fjalë konsiderohet si fitim i jashtëzakonshëm në funksion të llogaritjes së Fitimit të jashtëzakonshëm nga rifinancimi.

"Ura mbi Drin" është Ura e re mbi lumin Drin e cila do të prokurohet dhe ndërtohet nga Koncesionari si pjesë e Segmentit 3 të Autostradës.



"Punimet për urën mbi Drin" janë prokurimi dhe ndërtimi i Urës së re mbi lumin Drin si pjesë e Segmentit 3 të Autostradës.

"Data e përfundimit të Punimeve për urën mbi lumin Drin" është data në të cilën është lëshuar Leja e shfrytëzimit në lidhje me Punimet për urën mbi Drin.

"Data e përfundimit paraprak të Punimeve për urën mbi lumin Drin" është data në të cilën është lëshuar Leja paraprake e shfrytëzimit në lidhje me Punimet për urën mbi Drin.

"Data e përfundimit të programuar të Punimeve për urën mbi lumin Drin" është Data e fillimit të punimeve kapitale + 4 (katër) vjet.

"Data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve për urën mbi lumin Drin" është Data e fillimit të punimeve kapitale + 30 (tridhjetë) muaj (që do të thotë data e hyrjes në fuqi të Certifikates se Përfundimit në lidhje me Punimet për urën mbi lumin Drin.

"Data e hyrjes në fuqi" është data më e vonshme nga sa më poshtë:

- (a) data e përbushjes së kushteve paraprake në përputhje me klauzolën 2.2; ose
- (b) Përmbyllja financiare.

"Punimet pastruese gjeoteknike në rast situatë të jashtëzakonshme" janë punimet që nevojiten në përgjigje të një Situata të jashtëzakonshme gjeoteknike në mënyrë që të rifillohet pa rrezik shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e Autostradës në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

"Datë e raportimit për situatat e jashtëzakonshme" është data 1 shtator, 1 dhjetor, 1 mars dhe 1 qershor (sipas rastit) për çdo vit të Kontratës.

"Raporti inxhinierik" është Dokumenti specifik i Projektit që përmban një raport dhe shtojcat e tij të nxjerra si rezultat i raportit të korrektësisë së informacionit teknik të Autostradës.

"Kërkesa mjedisore" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 14.1.

"Kapitali neto" është kapitali aksioner i Koncesionari.

"Norma e brendshme e kthimit mbi kapitalin"² është, në lidhje me Aksionerët dhe Shoqëritë e lidhura, norma e perzier nominale e kthimit mbi i. Kapitalin neto dhe ii. Borxhin e varur apo financime të tjera të ngjashme që kanë dhënë Aksionerët, gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate duke mbajtur në konsideratë Shpërndarjet e paguara dhe të parashikuara për t'u paguar, e llogaritur duke përdorur Modelin financiar aktual, sikurse përshkruhet në fletën përmbledhëse në kutizën [] të Modelit financiar ose në kutizën që mund të ketë zëvendësuar kutizën [] me miratimin e Autoritetit Kontraktues, pas përditësimit të Modelit financiar në përputhje me Shtojcën 10.

"Gabim" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 24.1.2.

² Ky përkufizim mund të ndryshojë në varësi të strukturës së financimit të Projektit.

“Euro” është monedha e ligjshme e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar Evropian.

“Indeksi i çmimeve të prodhimit i BE-së” është indeksi i çmimeve të prodhimit industrial publikuar nga Eurostat-i ose nëse ky indeks nuk publikohet më, çdo indeks tjetër që e zëvendëson këtë indeks të kostove industriale të prodhimit të BE-së.

“Indeksi i çmimeve në euro” është Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit i Eurozonës (me përbërje të ndryshueshme), publikuar nga Eurostat-i ose nëse ky indeks nuk publikohet më, çdo indeks tjetër i harmonizuar i çmimeve të konsumit i Eurozonës që e zëvendëson këtë indeks.

“Rifinancim i përjashtuar” është:

- (a) Rifinancimi që është marrë plotësisht në konsideratë në Modelin financiar të situatës bazë;
- (b) ndryshimi i trajtimit kontabël ose fiskal;
- (c) shitja e aksioneve të Koncesionarit nga aksionerët, shitja ose kalimi i Borxhit të varur nga aksionerët ose çdo ristrukturim tjetër i Kapitalit të investuar të Koncesionarit;
- (d) rifinancimi që nevojitet në rast faktik ose të mundshëm mosshlyerja e detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjet për financimin; ose
- (e) bashkimi në një kontratë kredie nga Huadhënësit, në rrjedhën e zakonshme të aktivitetit të tyre tregtar, i të drejtave ose interesave të tyre në Marrëveshjet për financimin,



gjithmonë me kusht që Rifinancimi nuk është Rifinancim i përjashtuar nëse zmadhohen detyrimet e Autoritetit Kontraktues në bazë të kësaj Kontrate (në rast përfundimi të Kontratës ose jo).

“Lista e miratuar e përdoruesve të përjashtuar” është lista e parashikuar në Shtojcën 17 (Lista e miratuar e përdoruesve të përjashtuar) të kësaj Kontrate.

“Projektet ekzistuese” është projekt-koncepti ekzistues në lidhje me Urën e re mbi lumin Drin që bën pjesë në të dhënat në dispozicion dhe i është dhënë Koncesionarit në përputhje me klauzolën 7.1.1.

“Ura ekzistuese mbi lumin Drin” është ura ekzistuese mbi lumin Drin që ndodhet nga kilometri 93+930 deri në kilometrin 94+150.

“Autostrada ekzistuese” janë ato pjesë të Autostradës që janë në shfrytëzim menjëherë përpara Datës së hyrjes në fuqi dhe për të cilat Koncesionari do të jetë përgjegjës për t'i shfrytëzuar duke filluar menjëherë nga Data e hyrjes në fuqi.

“Ura ekzistuese” janë urat ekzistuese të identifikuara në planimetrinë ekzistuese të vendosjes së objektit që jepet në Shtojcën 14.

“Leje ekzistuese” janë lejet e renditura në Shtojcën 11 që Autoriteti Kontraktues ka yënë në dispozicion Koncesionarit në përputhje me klauzolat 7.1.1 dhe 14.4.1.

8

“Të ardhurat e pritura në euro nga taksa e rrugës” janë të ardhurat në euro nga taksa e rrugës të cilat Koncesionari do t’i kishte arkëtuar gjatë një Viti kontraktimi nëse të ardhurat nga taksa e rrugës do t’i kishte arkëtuar vetëm në euro gjatë vitit të Kontraktimit në fjalë.

“Data e përfundimit të vlefshmërisë” është data që bie 30 (tridhjetë) vjet pas datës së fillimit të Periudhës së Koncesionit në përputhje me klauzolën 3.

“Truall ekstra” është truall që i nevojitet në mënyrë të përkohshme Koncesionarit krahas Territorit të Projektit dhe/ose Truallit shtesë në mënyrë që të realizojë punimet dhe/ose shërbimet.

“Shqyrtim përfundimtar për kthimin” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 36.8.

“Vrojtim përfundimtar për kthimin” ka kuptimin e parashikuar në Seksionin 8 të Shtojcës 5.

“Përfundim përfundimtar” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 20.6.

“Projekt përfundimtar i zbërthyer” është i gjithë Dokumentacioni i projektit që duhet bërë në përputhje me klauzolën 15.1.2(a).

“Data financiare bazë” është (i) data që bie 6 (gjashtë) muaj pas datës së kësaj Kontrate ose (ii) Data e hyrjes në fuqi, cilado bie më herët.

“Përmbyllje financiare” është data kur përmbushen kushtet që i praprijnë hyrjes në fuqi të Marrëveshjeve të financimit.

“Model financiar” është:

- (a) më datën e kësaj Kontrate, Modeli financiar i situatës bazë; dhe
- (b) pas kësaj date, modeli i përditësuar në përputhje me Shtojcën 10.

“Paralajmërim i parë” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 37.3.1.

“Ngjarje e forcës madhore” është:

- (a) Akti i perendise duke përfshirë por duke mos u kufizuar zjarri, permytja, ose cdo katastrofe tjetër natyrore si, tërmeti, uragani, tornado ose goditja nga meteori ose nga një trup tjetër qiellor;
- (b) lufta, kryengritja, revolucioni, lufta civile, konflikti i armatosur, terrorizmi ose embargoja dhe trazirat civile ose prishja e rendit civil;
- (c) rrezatimi jonizues ose kontaminimi kimik apo biologjik;
- (d) shpërthimet e shkaktuara nga pajisjet supersonike;
- (e) shpërthimi bërthamor ose kontaminimi radioaktiv,

dhe ngjarje të tjera të ngjashme që nuk janë në dorë të asnjërës prej dy palëve dhe që sjellin për pasojë që secila nga të dy Palët (“Pa|a e prekur”) të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.



"Shuma e zgjidhjes së Kontratës për shkak të Forcës madhore" është shuma e barabartë me vlerën agregate të:

- (a) Detyrimeve përpara huadhënësve;
- (b) Kapitalit të investuar minus të gjitha Shpërndarjet e paguara përpara Datës së përfundimit të Kontratës (nëse diferenca është pozitive);
- (c) pagesave për shkurtim të vendit të punës dhe/ose kostove të tjera të cilat Koncesionari duhet t'u paguajë punëmarrësve të tij si pasojë e përfundimit të kësaj Kontrate në bazë të ligjit (për aq sa këto pagesa janë të arsyeshme dhe janë zbutur nga Koncesionari);
- (d) Kostove të zgjidhjes përpara kohe të nënkontratës; dhe
- (e) shumave që Autoriteti Kontraktues i detyrohet Koncesionarit dhe që janë ende të pashlyera më Datën e përfundimit të Kontratës,

MINUS, për aq sa është vlerë pozitive, vlerën agregate (pa llogaritje të dyfishtë) të:

- (a) të gjitha tepricave kreditore të llogarive bankare të Koncesionarit më Datën e përfundimit të Kontratës; dhe
- (b) shumave që Koncesionari i detyrohet Autoritetit Kontraktues ose për të cilat Autoriteti Kontraktues do të kishte të drejtë t'i përdorte për kompensim në shlyerje të të drejtave të Koncesionarit në bazë të kësaj Kontrate.

"Ndryshim i parashikueshëm i ligjit" është ndryshimi i propozuar i ligjit i përfshirë deri më datën tridhjetë (30) ditë përpara dorëzimit të ofertës përfundimtare:

- (a) në një projektligj të qeverisë ose projektligj të paraqitur nga ministria përkatëse për konsultim; ose
- (b) në një propozim në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.

"Vit i plotë kalendarik" është periudha nga data 1 janar deri më datë 31 dhjetor, duke i përfshirë të dyja këto data.

"Marrëveshjet për financimin" janë marrëveshje (pa përfshirë marrëveshjen për sigurimin e Borxhit të varur) në bazë të së cilës Koncesionarit i jepet fond në formë borxhi me përparësi ose kapitali i llojit "te ndermjetem" ose lehtësi financiare borxhi afatshkurter dhe/ose nga burime të tjera të jashtme financimi në lidhje me Projektin (në formë kredie, letër-kredie ose dorëzanie ose në forma të tjera) dhe çdo norme interesi me marrëveshje mbrojtjeje dhe, në çdo rast çdo kontratë garancie duke përfshirë edhe çdo Marrëveshje të drejtpërdrejtë në lidhje me to, në çdo rast të miratuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktues si Marrëveshje financimi në përputhje me klauzolën 8.4 ose siç identifikohet si e tillë në Shtojcën 4.

"Situatë e jashtëzakonshme gjeoteknike" është ngjarja e një incidenti gjeoteknik të paparashikuar (si shkarje dheu që bllokon pjesërisht ose plotësisht karrexhatën) i cili ndikon në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen pa rrezik të Autostradës në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktues.



"Plan në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme për shkaqe gjeoteknike" ka kuptimin e parashikuar në Seksionin 3.3.2 të Shtojcës 5.

"Plan gjeoteknik" është Plani në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme për shkaqe gjeoteknike, Plani për menaxhimin e risqeve gjeoteknike dhe Plani për menaxhimin e punimeve gjeoteknike, veçmas ose të gjithë së bashku.

"Punime rehabilituese gjeoteknike" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 32A.3.4.

"Pagesë për punime rehabilituese gjeoteknike" është çdo pagesë që Autoriteti Kontraktues duhet t'i bëjë Koncesionarit në lidhje me Punimet rehabilituese gjeoteknike të realizuara në bazë të klauzolës 32A.3.8 dhe klauzolës 25.5 të kësaj Marrëveshjeje, e barabartë me koston që i ka lindur Koncesionarit gjatë realizimit të Punimeve rehabilituese gjeoteknike, të certifikuara nga Inxhinieri i pavarur.

"Plan për menaxhimin e risqeve gjeoteknike" ka kuptimin e parashikuar në Seksionin 4.3.2.1 dhe Lidhjen 5 të Shtojcës 5.

"Raportet gjeoteknike të tenderit" janë raportet e vëna në dispozicion të Subjektit ofertues (siç parashikohet në Dokumentacionin e procedurës së tenderit) si pjesë e Të dhënave të vëna në dispozicion, ku jepet një vlerësim i kushteve gjeoteknike dhe gjeologjike të Autostradës, si edhe rekomandime në lidhje me masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut gjeoteknik.

"Punimet gjeoteknike" janë Punimet gjeoteknike fillestare, Punimet gjeoteknike të mëpasshme, Punimet rehabilituese gjeoteknike dhe Punimet pastruese gjeoteknike në rast situatave të jashtëzakonshme.

"Plan për menaxhimin e punimeve gjeoteknike" është plani i hartuar në përputhje me klauzolën 32A.2.2 shkronja "b".

"Praktika e mirë e sektorit ekonomik" është ushtrimi i shkallës së zotësisë, korrektesës, maturisë dhe largpamësisë që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një palë kontraktuese e aftë dhe me përvojë e cila kërkon të përmbushë me mirëbesim detyrimet e veta kontraktore, në respekt të të gjitha ligjeve, e angazhuar në të njëjtën lloj ndërmarrjeje dhe duke punuar në rrethana dhe kushte të njëjta ose të ngjashme.

"Të ardhura të garantuara nga trafiku" janë të ardhurat minimale nga arkëtimi i taksës së rrugës që Autoriteti Kontraktues i garanton Koncesionarit dhe që llogaritet si vijon:

- (a) në vitin 1 të të ardhurave të garantuara nga trafiku, vlera e barabartë me shumën e Koeficienteve mujore të sezonalitetit që nga Data e fillimit të përdorimit të rrugës me taksë deri në fund të vitit 1 të të ardhurave të garantuara nga trafiku, shumëzuar me vlerën përkatëse të specifikuar në Pjesën 1 të Shtojcës 15 (Të ardhurat e garantuara nga trafiku dhe Pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku), të indeksuar në përputhje me klauzolën 25.2;
- (b) në vitin e fundit të Kontratës, vlera e barabartë me shumën e Koeficienteve mujore të sezonalitetit që nga fillimi i vitit të fundit të Kontratës deri në fund të muajit që i paraprin muajit në të cilin bie Data e përfundimit të Kontratës, shumëzuar me vlerën përkatëse të specifikuar në Pjesën 1 të Shtojcës 15 (Të ardhurat e garantuara nga trafiku dhe Pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku), të indeksuar në përputhje me klauzolën 25.2; dhe

- (c) në lidhje me çdo vit tjetër të Kontratës, në përputhje me vlerën e paraqitur në Shtojcën 20 (Të ardhura të garantuara nga trafiku dhe Pragu për ndarjen e të ardhurave) për secilin vit të Kontratës, indeksuar dhe zbatuar në përputhje me Klauzolën 25.2,

dhe për të evituar çdo dyshim, kur viti i Kontraktimit përfundon përpara Datës së fillimit të përdorimit të rrugës me taksë, Të ardhurat e garantuara nga trafiku për atë vit Kontraktimi konsiderohen zero.

“Viti 1 i të ardhurave të garantuara nga trafiku” është viti i Kontraktimit në të cilin bie Data e fillimit të përdorimit të rrugës me taksë..

“Kërkesat për kthimin” janë kërkesat për kthimin e Autostradës të parashikuara në Seksionin 8 të Shtojcës 5.

“Rezerva për kthimin” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 36.5.2.

“Riparim kapital” është çdo mirëmbajtje që i bëhet Autostradës që nuk është Mirëmbajtje rutinë.

“Programi i riparimit kapital” është versioni përfundimtar i programit vjetor të riparimit kapital, i miratuar ose përcaktuar, përkatësisht, në përputhje me klauzolën 21.8.13 ose klauzolën 21.8.16 dhe i hartuar në përputhje me seksionin 6.3 të Shtojcës 5.

“Autostradë” janë të gjitha segmentet e Projektit, duke përfshirë edhe objektet e lidhura ose të nevojshme për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e këtyre segmenteve, ku përfshihen edhe Pajisjet e Subjektit shfrytëzues, Sheshet e taksës/Vendpushimet dhe çdo zonë tjetër shërbimi, Qendra operative e tunelit dhe Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.

“Punime për përmirësim të Autostradës” janë punimet e parashikuara në pikën 3 të seksionit 6.2.2 të Shtojcës 5.

“Data e përfundimit të Punimeve për përmirësim të Autostradës” është data në të cilën është lëshuar Leja e shfrytëzimit në lidhje me Punimet për përmirësim të Autostradës.

“Data e përfundimit paraprak të Punimeve për përmirësim të Autostradës” është data në të cilën është lëshuar Leja paraprake e shfrytëzimit në lidhje me Punimet për përmirësim të Autostradës.

“Data e përfundimit të programuar të Punimeve për përmirësim të Autostradës” është Data e fillimit të punimeve kapitale + 2 (dy) vjet.

“Data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve për përmirësim të Autostradës” është Data e fillimit të punimeve kapitale + 18 (tetëmbëdhjetë) muaj (që do të thotë data e hyrjes në fuqi të Certifikates se Përfundimit në lidhje me Punimet për përmirësim të Autostradës.)

“Standardet e ecurisë të IFC-së” janë “Standardet e IFC-së për ecurinë në lidhje me qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore”, datë 1 janar 2012, të cilat gjenden të botuara në adresën:

http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/topics_ext_content/ifc_external_corporate_site/ifc+sustainability/our+approach/risk+management/performance+standards/environmental+and+social+performance+standards+and+guidance+notes#2012.



"Kosto e rritur e sigurimit" është diferenca ndërmjet Kostos faktike e sigurimit dhe Kostos së sigurimit bazë.

"Inxhinieri i pavarur" është personi ose personat e pavarur me përvojë të huaj dhe shqiptare të cilët caktohen në përputhje me klauzolën 16.3 nga Autoriteti Kontraktues për të mbikëqyrur Punimet dhe të cilët kryejnë detyrat e inxhinierit të pavarur në lidhje me Ndërtimin dhe projektimin e Autostradës në përputhje me dispozitat e Kontratës për inxhinierin e pavarur. Detyrat kryesore të Inxhinierit të pavarur jepen të renditura në Shtojcën 13.

"Kontrata me inxhinierin e pavarur" është kontrata e lidhur në lidhje me realizimin e detyrave të Inxhinierit të pavarur në lidhje me ndërtimin dhe projektimin e Autostradës ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Inxhinierit të pavarur në përputhje me këtë Kontratë.

"Plani gjeoteknik fillestar" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 32A.1.2.

"Punime gjeoteknike fillestare" janë punimet e nevojshme në përputhje me tabelën 1 të Shtojcës 6.

"Data e përfundimit të Punimeve gjeoteknike fillestare" është data në të cilën është lëshuar Leja e shfrytëzimit në lidhje me Punimet gjeoteknike fillestare.

"Data e përfundimit paraprak të Punimeve gjeoteknike fillestare" është data në të cilën është lëshuar Leja paraprake e shfrytëzimit në lidhje me Punimet gjeoteknike fillestare.

"Data e përfundimit të programuar të Punimeve gjeoteknike fillestare" është Data e fillimit të punimeve kapitale + 4 (katër) vjet.

"Data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve gjeoteknike fillestare" është Data e fillimit të punimeve kapitale + 42 (dyzet e dy) muaj (që do të thotë data e hyrjes në fuqi të Certifikates se Përfundimit në lidhje me Punimet gjeoteknike fillestare).

"Dorëzania fillestare për kthimin" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 36.5.1.

"Shqyrtim fillestar për kthimin" ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 36.4.

"Vrojtim fillestar për kthimin" ka kuptimin e parashikuar në Seksionin 8.2 të Shtojcës 5.

"Paaftësia paguese" është, në lidhje me çdo person, i. paaftësia për të përmbushur një ose më shumë detyrime financiare në afatin e shlyerjes ose ii. gjendja në një nivel të tepruar borxhi aq sa aktivet nuk janë më të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet kundrejt të tretëve.

"Llogari e të hyrave nga sigurimi" është llogaria e çelur nga Koncesionari për të mbajtur të hyrat nga Policat e dëmit fizik në përputhje me klauzolën 34.7.

"Kusht sigurimi" është çdo kusht që duhet përfshirë në një policë sigurime sipas klauzolës 34.2 dhe/ose Shtojcës 12 (por pa përfshirë kushtet që kërkohen në lidhje me risqet për të cilat zbatohet klauzola 34.2).

"Punime në mbikalime dhe kryqëzime" janë punimet e parashikuara në pikën 2 të seksionit 6.2.2 të Shtojcës 5.

"Data e përfundimit të Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime" është data në të cilën është lëshuar Leja e shfrytëzimit në lidhje me Punimet në mbikalime dhe kryqëzime.



“Data e përfundimit paraprak të Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime” është data në të cilën është lëshuar Leja paraprake e shfrytëzimit në lidhje me Punimet në mbikalime dhe kryqëzime.

“Data e përfundimit të programuar të Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime” është Data e fillimit të punimeve kapitale + 2 (dy) vjet.


“Data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime” është Data e fillimit të punimeve kapitale + 18 (tetëmbëdhjetë) muaj (që do të thotë data e hyrjes në fuqi të Certificate se Përfundimit në lidhje me Punimet në mbikalime dhe kryqëzime).

“Palë e interesuar” është çdo subjekt shfrytëzues i sistemit elektronik të arkëtimit të taksës së rrugës.

“Njoftimi për ndërhyrje” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 41.2.

“Kapital i investuar”³ janë shumat që Aksionerët i investojnë në funksion të përmbushjes së kësaj Kontrate nga Koncesionari si Kapital neto ose si Borxh i varur.

“Personel kryesor” është:

- 
- (a) drejtori i projektit i emëruar nga Nënkontraktori ose nga një zëvendësues i Sipërmarrësit;
 - (b) çdo person i emëruar si drejtor i projektit teknik; dhe
 - (c) çdo person i emëruar si drejtor për sigurinë, cilësinë dhe mjedisin.

“Defekt i fshehtë” është defekti që bëhet i dukshëm:

- (a) në tunelin e Thirrës, sikurse është më Datën efektive; ose
- (b) në urat ekzistuese, sikurse janë më Datën efektive; ose
- (c) në Punët e të tretëve (për aq sa nuk është ndrequr nga Sipërmarrësi palë e tretë),
- (d) Rruga ekzistuese dhe vija kryesore e autostrades te segmenteve 1.2.3

brenda Periudhës së përgjegjësisë për defektet e fshehta dhe që:

- (i) nuk mund të identifikohet nga Koncesionari gjatë këqyrjes së hollësishme të Të dhënave të vëna në dispozicion ose gjatë kontrollit me sy të Kantierit përpara Datës së dorëzimit të ofertës;
- (ii) nuk ka ardhur si rezultat i mospërmbushjes nga Koncesionari të detyrimeve të tij të parashikuara me këtë Kontratë ose të mosrealizimit të Punëve dhe Shërbimeve në përputhje me Praktikën e mirë e sektorit ekonomik; ose
- (iii) sipas klauzolës 20A.8, është konstatuar nga Inxhinieri i pavarur se ka një kosto riparimi dhe/ose parandalimi më të madhe se 200.000 (dyqind mijë) euro, si

³ Ky përkufizim mund të ndryshojë në varësi të strukturës së financimit të Projektit.

shumatore e mbledhur me koston e të gjitha punimeve riparuese të defekteve të fshehtë,

por që nuk është rezultat i sa më poshtë:

- (a) konsumimi normal; ose
- (b) modifikimet që i bëhen tunelit të Thirrës, urave ekzistuese ose punëve të të tretëve pas Datës së hyrjes në fuqi (duke përfshirë edhe ato që janë rezultat i Mirëmbajtjes rutinë, Riparimit kapital ose Punimeve kapitale).

“Periudha e përgjegjësisë për defektet e fshehta” në lidhje me një Defekt të fshehtë është periudha më e gjatë nga sa më poshtë:

- (a) periudhat e mbetura te garancisë së aktivitetit në bazë të kontratës së ndërtimit të aktivitetit; ose
- (b) 5 (pesë) vjet nga Data e hyrjes në fuqi.

“Ligj” është:

- (a) çdo akt rregullues ligjor i vlefshëm me fuqi të përgjithshme detyruese që është pjesë e legjislacionit shqiptar; dhe/ose
- (b) udhëzimet, metodikat dhe rregulloret e tjera përkatëse objekt i të cilave është Autoriteti Kontraktues ose Koncesionari.

“Problem i trashëguar” është kërkesa apo përgjegjësia mjedisore ose sociale e parashikuar me Ligj që ka ardhur nga një veprim ose mosveprim në lidhje me ndërtimin apo shfrytëzimin e Autostradës përpara Datës së hyrjes në fuqi.

“Lek” është monedha e ligjshme e Republikës së Shqipërisë më datën e kësaj Kontrate.

“Indeksi i çmimeve të konsumit në lekë” është indeksi i çmimeve të konsumit për Shqipërinë i publikuar nga Instituti i Statistikave i Shqipërisë (“INSTAT”).

“Detyrimet përpara huadhënësve”⁴ janë shuma agregate e:

- (a) principalit, interesave (përfshirë edhe interesin për mospermbushje, por vetëm atë të konstatuar përpara zgjidhjes së kësaj Kontrate si rezultat i Mospermbushjes nga Autoriteti Kontraktues), komisioneve bankare dhe kostove dhe shpenzimeve të bëra rregullisht ose që kanë mbetur pa paguar tek Huadhënësit nga ana e Koncesionarit në bazë të marrëveshjeve të financimit deri më Datën e përfundimit të Kontratës (ku përfshihen edhe kostot e pagesave në rast shlyerjeje kredie përpara kohe); dhe
- (b) të gjitha shumave që Koncesionari u detyrohet Huadhënësve për shkak të zgjidhjes përpara kohe të marrëveshjeve mbrojtëse për normën e interesit (ku përfshihen edhe kostot për shlyerje përpara kohe dhe komisionet e angazhimit të pagueshme si rezultat i kësaj) që janë aprovuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktues si



⁴ Ky përkufizim mund të ndryshojë në varësi të strukturës së financimit të Projektit.

Marrëveshje financimi në përputhje me klauzolën 8, me kusht të Koncesionari dhe Huadhënësit t'i zbusin këto vlera për aq sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme,

MINUS (pa e llogaritur dy herë)

- (c) vlerën agregate të të gjitha shumave të pagueshme tek Koncesionari nga Huadhënësit për shkak të zgjidhjes përpara kohe të marrëveshjeve mbrojtëse për normën e interesit që janë aprovuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktues si Marrëveshje financimi në përputhje me klauzolën 8;
- (d) çdo shumë të kaluar në një llogari rezervë për shlyerjen e borxhit të mbajtur në emër ose për llogari të Koncesionarit në bazë të Marrëveshjes së financimit, për të garantuar detyrimet kundrejt Huadhënësve;
- (e) çdo vlerë monetare në dispozicion të Huadhënësve ose çdo vlerë ekuivalente të mjeteve monetare të derdhura në një llogari ose të vëna në dispozicion të Huadhënësve me mënyra të tjera dhe çdo të hyra nga sigurimet (pa përfshirë shumat në Llogarinë e të hyrave nga sigurimi) që janë të pagueshme kundrejt Koncesionarit dhe janë në dispozicion të Huadhënësve, që nuk përdoren për asnjë qëllim tjetër dhe nuk u paguhen të tretëve; dhe
- (f) çdo shumë tjetër që Huadhënësit i detyrohen Koncesionarit.



"Huadhënës" janë institucione krediti ose financiare ose organizma të tjera të ngjashme financiare të angazhuara profesionalisht në dhënien hua të parave, të cilat mund të jenë palë në Masat për financimin, ose mund të kenë të drejta në bazë të Marrëveshjeve për financimin, dhe/ose i japin Koncesionarit financim në formë linje financimi me obligacione, borxhi me përparësi ose kapitali i llojit "te ndermjetem" (dhe masa mbrojtëse) në përputhje me Marrëveshje të tilla për financimin dhe përfshijnë edhe siguruesit që lëshojnë dorëzani për këto linja financimi me obligacione.

"Procedurat e bashkërendimit" janë Procedurat e bashkërendimit që identifikohen ose që duhen ndjekur nga Koncesionari në përputhje me klauzolën 21.3.

"Manuale" janë së bashku manualat e publikuar çdo gjashtë muaj, të miratuar nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë dhe aktualisht të publikuar në faqen e internetit www.transporti.gov.al, si më poshtë:

- (a) Manuali 1 – Prodhimi i materialeve të ndërtimit;
- (b) Manuali 2 – Analiza teknike për punimet e ndërtimit të ndërtesave;
- (c) Manuali 3 – Analiza teknike për punimet e rrugëve, kullim-ujtje dhe hidrocentraleve; dhe
- (d) Manuali 4 – Analiza teknike për punimet dhe instalimet teknologjike,

ose, në rast ndërprerjeje të publikimit të këtyre manualeve, manualat e tjera që do t'i zëvendësojnë ose që për të cilat arrihet marrëveshje mes Palëve që mund të konsiderohen zëvendësues të arsyeshëm.

"Vlera e tregut e Projektit" është

vlera duhet të llogaritet si vijon:

Vlera e tregut = A + B – C, ku:

A = vlera aktuale neto e Të ardhurave nga taksa e rrugës, në bazë të Të ardhurave të garantuara nga trafiku dhe Subvencionit nga Autoriteti Kontraktues që do të kishte marrë Koncesionari që nga Data e ndërprerjes së Kontratës deri në fund të Periudhës së Koncesionit (pa marrë në konsideratë, në këtë kuptim, ndërprerjen përpara kohe të Kontratës) në bazë të Modelit financiar me përditësimet më të fundit.

B = çdo kompensim i pagueshëm Koncesionarit në bazë të kësaj Kontrate si pasojë e një ngjarjeje që ndodh përpara Datës së ndërprerjes së Kontratës.

C = (D1 – D2) + E + F + G, ku:

D1 = kostoja gjithsej më Datën e ndërprerjes së Kontratës për rivendosjen e Koncesionit në standardet dhe specifikimet e parashikuara me këtë Kontratë.

D2 = dëmi nga sigurimi që ka arkëtuar Autoriteti Kontraktues në lidhje me kostot e rivendosjes të përmendura në D1.

E = vlera aktuale neto e kostove për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Koncesionit, përfshirë shpenzimet kapitale që nga Data e ndërprerjes së Kontratës deri në fund të Periudhës së Koncesionit (pa marrë në konsideratë, në këtë kuptim, ndërprerjen përpara kohe të Kontratës) (pa përfshirë kostot e përfshira në D1, më lart) në bazë të Modelit financiar me përditësimet më të fundit.

F = shumat e depozituara ose të kaluara në një llogari rezervë për shlyerjen e borxhit të mbajtur në emër ose për llogari të Koncesionarit në bazë të Marrëveshjes së financimit, për të garantuar detyrimet kundrejt Huadhënësve.

G = çdo vlerë, të papërfshirë në shkronjën "F" më lart, në investime në mjete monetare ose ekuivalente të mjeteve monetare dhe vlera të tjera që në rast garantojnë të drejtat e Huadhënësve dhe janë të arkëtueshme nga Huadhënësit (ose në llogari rezervë ose në një formë tjetër) dhe në çdo rast pa e llogaritur dy herë garancinë për ecurinë që është vënë në dispozicion në përputhje me klauzolën 2.5.

Në kuptim të llogaritjes së vlerës aktuale neto, norma e skontimit është e barabartë me Normën e brendshme të kthimit mbi kapitalin të situatës bazë.

Për të shmangur çdo dyshim, kur llogaritja nxjerr rezultat një shifër me vlerë negative, Vlera e tregut e Projektit është zero.

"Plane zbatimi të punimeve" janë planet e skicuara të punimeve të Koncesionarit që i bashkëlidhen Shtojcës 8, me ndryshimet ose shtesat përkatëse.

"Muaj" është një muaj kalendarik gjatë Periudhës së Koncesionit.

"Pagesa e Performances Mujore" janë pagesat për mbylljen e korsive dhe pagesat për pikë ecurie, siç shtjellohet me hollësi përkatësisht në seksionet 7.3 dhe 7.4 të Shtojcës 5.

"Relacion mujor" është raporti i hartuar çdo muaj nga Koncesionari, ku jepen informacionet e renditura në Lidhjen 6 të Shtojcës 5.



“Koeficiente mujore të sezonalitetit” janë, për çdo muaj, koeficientet e renditura në Pjesën 2 të Shtojcës 15.

“Pëlqim i nevojshëm” është çdo certifikate e perkoheshme ose perfundimtare , pëlqim, licensë, aprovim, lejim ose autorizim, që është i nevojshëm në lidhje me Projektin dhe që duhet lëshuar nga Autoriteti përkatës ose një ndërmarrje infrastrukture publike, që nuk është Pëlqimi i Nevojshëm i Autoritetit Kontraktues në përputhje me klauzolën 14.

“As më mirë dhe as më keq” duhet interpretuar në bazë të:

- (a) të drejtave dhe detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, Dokumenteve të tjera të Projektit dhe Marrëveshjeve për financimin;
- (b) aftësisë në vijimësi të Koncesionarit për të përmbushur detyrimet dhe për të gëzuar të drejtat që lindin sipas kësaj Kontrate, Dokumenteve të tjera të Projektit dhe Marrëveshjeve për financimin;
- (c) kostove dhe Shpenzimeve kapitale që duhen realizuar në lidhje me Ngjarjen përkatëse; dhe
- (d) fitimit të humbur të shkaktuar nga Ngjarja përkatëse,

dhe do të thotë se Koncesionari është vënë në një situatë që nuk është as më mirë dhe as më keq sa i takon:

- (a) kthimit agregat faktik mbi Kapitalin neto dhe Borxhin e varur;
- (b) raportit faktik të mbulimit të kohëzgjatjes së kredisë (LLCR) për çdo periudhë të kohëzgjatjes së Kontratës që vjen pas Ngjarjes përkatëse; dhe
- (c) raportit minimal vjetor të mbulimit të shlyerjes së borxhit (ADSCR) gjatë Periudhës së vlefshmërisë së Kontratës pas Ngjarjes përkatëse,

që do të kishte pasur Koncesionari nëse nuk do të kishte ndodhur Ngjarja përkatëse.

“Njoftimi për përfundim kontrate jo për shkak mosplotësimi” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 37.7.

“Njoftimi për korrigjim” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 37.2.2.

“Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes” janë objektet që duhen zhvilluar, shfrytëzuar dhe mirëmbajtur në përputhje me klauzolën 21.14 të kësaj Kontrate.

“Manualet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes” janë manualet e përgatitur nga Koncesionari në përputhje me klauzolat nga 21.5 deri në 21.7, ku përfshihen ndër të tjera Manuali i kontrollit të cilësisë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen, Manuali i mbrojtjes së shëndetit dhe jetës për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen, Manuali i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes rutinë, Plani i mirëmbajtjes gjatë dimrit, Manuali i kontrollit dhe monitorimit dhe Manuali i menaxhimit mjedisor, siç përshkruhen plotësisht në seksionin 3.1.4 të Shtojcës 5.

“Periudha e shfrytëzimit” është periudha e përshkruar në klauzolën 21.2.1.

“Nënkontratë shfrytëzimi” është nënkontrata e lidhur ndërmjet Koncesionarit dhe Nënkontraktorit të shfrytëzimit për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës, me ndryshimet dhe zëvendësimet përkatëse të bëra herë pas here në përputhje me këtë Kontratë.

“Nënkontraktori i shfrytëzimit” është [] me seli të regjistruar në adresën: [], i përfaqësuar nga [] si përfaqësues i caktuar dhe autorizuar rregullisht nga Koncesionari ose nga një person tjetër i caktuar me Nënkontratë shfrytëzimi në përputhje me këtë Kontratë.

“Sigurimet e periudhës së shfrytëzimit” janë Sigurimet e nevojshme që duhen blerë dhe mbajtur në bazë të Pjesës 2 të Shtojcës 12.

“Pajisjet e Subjektit shfrytëzues” janë pajisjet që përdoren për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen rutinë të Autostradës.

“Pikë ecurie” ka kuptimin e parashikuar në Seksionin 7 të Shtojcës 5.

“Shkelje e vazhdueshme” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 37.3.

“Policat e dëmit fizik” janë Sigurimet e nevojshme që duhen blerë dhe mbajtur në bazë të Pjesës 1.1 dhe Pjesës 2.1 të Shtojcës 12.

“Përfundim paraprak” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 20.1.

“Certifikate Përfundimi paraprake” janë vërtetimet që vërtetojnë mundësinë e hapjes për automjetet të secilit Aspekt përkatës të Autostradës, të lëshuara nga një Autoritet përkatës.

“Norma e brendshme e kthimit mbi kapitalin përpara rifinancimit” është Norma e brendshme e kthimit mbi kapitalin menjëherë përpara datës së kryerjes së Rifinancimit.

“Program” është programi aktual për realizimin e punimeve, i hartuar në përputhje me Seksionin 6.1.5 të Shtojcës 5.

“Veprim i ndaluar” është:

- (a) ofrimi, premtimi për të dhënë ose dhënia e dhuratave, komisioneve ose përparësive Autoriteti Kontraktues ose autoriteteve të tjera për kryerjen ose moskryerjen (në të tashmen ose në të shkuarën) e veprimeve që kanë të bëjnë me fitimin ose realizimin e kësaj Kontrate ose të kontratave të tjera me Autoritetin Kontraktues ose me autoritete të tjera në Republikën e Shqipërisë; dhe/ose
- (b) mashtrimi i rëndë kundër Autoritetit Kontraktues ose një autoriteti tjetër në Republikën e Shqipërisë në lidhje ose jo me këtë Kontratë,

pavarësisht nëse kjo përbën ose jo vepër penale sipas ligjit.

“Njoftimi për përfundim kontrate për veprim të ndaluar” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 37.4.1.

“Projekti” është koncesioni për përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës Milot-Morinë nga Miloti deri në Morinë në Republikën e Shqipërisë dhe kryerja e çdo pjese të Punimeve dhe Shërbimeve gjatë Periudhës së vlefshmërisë së Kontratës dhe financimi i këtyre aktiviteteve.

“Dokumentet e projektit” janë:

- (a) Nënkontratat; dhe
- (b) çdo kontratë tjetër me rëndësi materiale e lidhur nga Koncesionari në funksion të zbatimit të Projektit dhe të identifikuar si të tilla në përputhje me Shtojcën 4.

“Dokumentacion i Projektit” janë skicat, relacionet, formulat, llogaritjet, softuerët dhe çdo dokument dhe e dhënë tjetër që ka lidhje me projektimin, ndërtimin, kolaudimin dhe përfundimin e Punimeve dhe shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës nga këndvështrimi ndërtimor dhe teknik dhe lejet përkatëse për kryerjen e Punimeve dhe Shërbimeve në Autostradë, përfshirë, ndër të tjera, Raportet inxhinierike.

“Plani i menaxhimit të projektit” është plani i vënë në dispozicion në përputhje me seksionin 3.2.1 të Shtojcës 5.

“Propozim për punime ndërtimi” janë propozimet e Koncesionarit në lidhje me Punimet e përfshira në Pjesën 1 të Shtojcës 8.

“Propozim për shërbime shfrytëzimi dhe mirëmbajtjeje” janë propozimet e Koncesionarit në lidhje me Shërbimet e përfshira në Pjesën 2 të Shtojcës 8.

“Sistemet e cilësisë” janë sistemet e menaxhimit të cilësisë të vëna në dispozicion në përputhje me klauzolën 18.1 dhe seksionin 2 të Shtojcës 5.

“Dokumentimi i përbushjes së kriteve” është dokumentacioni në formë elektronike dhe të shtypur, hartuar në bazë të kontrolleve që kërkohen nga planet e marrjes së kampioneve dhe verifikimit të përbushjes së kriteve i miratuar nga Inxhinieri i pavarur, ku vërtetohet përbushja e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

“Ndryshim cilësues i ligjit” është:

- (a) Ndryshimi diskriminues i ligjit;
- (b) një ndryshim specifik i ligjit;
- (c) një ndryshim i ligjit që ndodh gjatë Periudhës së shfrytëzimit dhe që sjell për pasojë një Shpenzim kapital; ose
- (d) një ndryshim i ligjit që sjell për pasojë një TVSH të parimbursueshme në formën e TVSH-së në blerje të cilën e bën si shpenzim Koncesionari për çdo furnizim që merr për ta përdorur vetëm për realizimin e Punimeve ose Shërbimeve ose për të përbushur detyrimet ose parashikimet e kësaj Kontrate (së bashku me TVSH-në në blerje të paguar si pjesë e shpenzimeve të përgjithshme administrative në lidhje me këto aktivitete) për aq sa Koncesionarit nuk i lind e drejta e rimbursimit apo kreditimit nga autoriteti tatimor shqiptar në lidhje me këtë TVSH në blerje.

“Rifinancim kualifikues” është rifinancimi që sjell Fitim të jashtëzakonshëm nga rifinancimi që nuk është Rifinancim i përjashtuar.

“Trafik i regjistruar” është numri i Përdoruesve që paguajnë Taksën e rrugës të regjistruar nga Koncesionari dhe të verifikuar nga Inxhinieri i pavarur në çdo Muaj të Periudhës së vlefshmërisë së Kontratës në përputhje me seksionin 3.2.4 të Shtojcës 5.



“Rifinancim” është:

- (a) çdo shtesë, ndryshim, risi, ripërtëritje ose zëvendësim i Marrëveshjeve për financimin (që nuk është rezultat i një Ndryshimi nga Autoriteti Kontraktues të miratuar në përputhje me këtë Kontratë);
- (b) ushtrimi i të drejtave ose heqja dorë nga ushtrimi i të drejtave, ose ushtrimi i të drejtave të ngjashme në bazë të Marrëveshjes për financimin (që nuk është heqje dorë nga të drejtat ose pëlqim ose ushtrim i të të drejtave që kanë të bëjnë me çështje administrative dhe mbikëqyrëse të përditshme);
- (c) disponimi i të drejtave ose interesave në Marrëveshjet për financimin ose krijimi i të drejtave të pjesëmarrje në lidhje me Marrëveshjet për financimin; ose krijimi ose dhënia e formave të tjera të përfitimit apo interesit në Marrëveshjet për financimin; ose krijimi ose dhënia e të drejtave apo interesit në kontrata, të ardhura apo aktive të Koncesionarit, me garanci ose jo; dhe
- (d) çdo masë tjetër që është marrë nga cilido person, që ka një pasojë të ngjashme me secilën prej atyre të parashikuara në shkronjat nga “a” deri në “c” ose që ka për pasojë kufizimin e mundësisë së Koncesionarit për të kryer ato që parashikohen në shkronjat nga “a” deri në “c”.

“Fitim i jashtëzakonshëm nga rifinancimi” është vlera e barabartë ose më e madhe se zero dhe $(A - B) - C$, ku:

A = vlera aktuale neto e Shpërndarjeve të parashikuara menjëherë përpara Rifinancimit (duke mbajtur në konsideratë efektin e Rifinancimit dhe duke përdorur Modelin financiar, me përditësimet përkatëse (përfshirë edhe në lidhje me ecurinë e Projektit) në mënyrë që të jenë aktuale menjëherë përpara Rifinancimit) që i duhen paguar çdo Personi përkatës gjatë pjesës së mbetur të kohëzgjatjes së Kontratës pas Rifinancimit;

B = vlera aktuale neto e Shpërndarjeve të parashikuara menjëherë përpara Rifinancimit (por pa marrë në konsideratë efektin e Rifinancimit dhe pa përdorur Modelin financiar, me përditësimet përkatëse (përfshirë edhe në lidhje me ecurinë e Projektit) në mënyrë që të jenë aktuale menjëherë përpara Rifinancimit) që i duhen paguar çdo Personi përkatës gjatë pjesës së mbetur të kohëzgjatjes së Kontratës pas Rifinancimit; dhe

C = rregullimet e nevojshme për të rritur Normën e brendshme e kthimit mbi kapitalin para financimit që të arrijë nivelin e parashikuar të Normës së brendshme të kthimit mbi kapitalin për atë fazë të Projektit në përputhje me Modelin financiar.

“Plani i restaurimit” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 34.9.1(a).

“Punime të restaurimit” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 34.9.1(a).

“Aspekt përkatës” janë Punimet për sheshet e taksës ose çdo element i Punëve kapitale, sipas rastit.

“Data e përfundimit të aspektit përkatës” është secila sa më poshtë:

- (a) data e përfundimit të Punimeve për sheshet e taksës;
- (b) data e përfundimit të Punimeve gjeoteknike fillestare;

- (c) data e përfundimit të Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime;
 - (d) data e përfundimit të Punimeve për përmirësim të Autostradës; ose
 - (e) data e përfundimit të Punimeve për urën mbi lumin Drin,
- sipas rastit.

“Afati përfundimtar për Aspektin përkatës” është data 12 (dymbëdhjetë) muaj pas datës së përfundimit paraprak të programuar të Aspektit përkatës.

“Data e përfundimit paraprak të aspektit përkatës” është secila sa më poshtë:

- (a) data e përfundimit paraprak të Punimeve për sheshet e taksës;
 - (b) data e përfundimit paraprak të Punimeve gjeoteknike fillestare;
 - (c) data e përfundimit paraprak të Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime;
 - (d) data e përfundimit paraprak të Punimeve për përmirësim të Autostradës; ose
 - (e) data e përfundimit paraprak të Punimeve për urën mbi lumin Drin,
- sipas rastit.

“Data e përfundimit të programuar të aspektit përkatës” është secila sa më poshtë:

- (a) data e përfundimit të programuar të Punimeve për sheshet e taksës;
 - (b) data e përfundimit të programuar të Punimeve gjeoteknike fillestare;
 - (c) data e përfundimit të programuar të Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime;
 - (d) data e përfundimit të programuar të Punimeve për përmirësim të Autostradës; ose
 - (e) data e përfundimit të programuar të Punimeve për urën mbi lumin Drin,
- sipas rastit.

“Data e përfundimit paraprak të programuar të Aspektit përkatës” është secila sa më poshtë:

- (a) data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve për sheshet e taksës;
 - (b) data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve gjeoteknike fillestare;
 - (c) data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime;
 - (d) data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve për përmirësim të Autostradës; ose
 - (e) data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve për urën mbi lumin Drin,
- sipas rastit.

“Autoritet përkatës” janë agjencitë, autoritetet, organizmat ose personat bashkiakë, kombëtarë, rajonalë ose vendorë që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë dhe/ose kanë autoritet dhe kompetencë në territorin e Republikës së Shqipërisë për të ushtruar tagrat zyrtarë ose të drejta të ngjashme në lidhje me Punimet, Projektin ose Territorin e Projektit.

“Ngjarje përkatëse” është:

- (a) Ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues;
- (b) Ndryshimi cilësues i ligjit;
- (c) Ngjarja e kompensimit; ose
- (d) çdo ngjarje tjetër për të cilën palët bien dakord (ose e cila përcaktohet në përputhje me klauzolën 56) se është një ngjarje që do të sjellë një ndryshim të Të ardhurave nga taksa e rrugës.

“Incident përkatës” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 34.9.1.

“Person përkatës” është Aksioneri ose një prej Palëve të lidhura të tij.

“Të hyrat përkatëse” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 34.10.1.(b)

“Ngjarje e çlirimit nga detyrimi” është:

- (a) zjarri ose shpërthimi ose ngjarje të paparashikueshme të motit ekstrem (duke mbajtur në konsideratë natyrën e rajonit dhe kushtet klimatike që mbizotërojnë në rajon);
- (b) humbja apo dëmi aksidental që u bëhet Punimeve ose Autostradës;
- (c) defekti ose ndërprerja e energjisë, lëndës djegëse ose transportit;
- (d) Situata e jashtëzakonshme gjeoteknike;
- (e) vonesa në Punime për shkak të gërmimit, largimit ose punimeve të tjera të nevojshme të kryera në lidhje me Antikitetet;
- (f) Punime të të tretëve që nuk i përmbushin Specifikimet për punimet e të tretëve;
- (g) greva, mbyllja e objektit nga administratori, ulja e tempit të punës ose çdo mosmarrëveshje tjetër zyrtare ose jo, për aq sa këto ngjarje zhvillohen në të gjithë sektorin përkatës dhe jo vetëm tek Koncesionari ose Pala koncesionare; ose

me kusht që për efekt të çlirimit nga përfundimi i Kontratës në bazë të klauzolës 28.3.2, një ngjarje e tillë të mos jetë shkaktuar nga shkelje të vullnetshme të Koncesionarit (ose një Pale koncesionare) dhe që një ngjarje e tillë të mos jetë shkaktuar apo ndihmuar nga veprimi ose mosveprimi me faj i Koncesionarit (ose i një Pale koncesionare).

“Kërkesë për kualifikim” është dokumenti i qarkulluar nga Autoriteti Kontraktues tek ofertuesit e mundshëm, që mban datën 15 Shkurt 2016 ku paraqiten kriteret që duhen



përbushur për paraqitjen e një oferte në lidhje me Projektin dhe ku jepen kushtet kryesore të Koncesionit.

“Sigurimet e nevojshme” janë sigurimet e identifikuara në Shtojcën 12 që duhen blerë dhe mbajtur në përputhje me klauzolën 34.

“Vendpushimet” janë vendet që duhen mirëmbajtur ose ndërtuar për t’u ofruar Përdoruesve vend për pushim, pije dhe ushqime të shpejta dhe rimbushje të automjetit me lëndë djegëse në përputhje me seksionin 3.1.8.4 të Shtojcës 5 dhe që duhen shfrytëzuar dhe mirëmbajtur në përputhje me Kërkesat për shërbime të Autoritetit Kontraktues.

“Mirëmbajtje rutinë” është puna e kryer gjatë Periudhës së shfrytëzimit, që ka natyrë afatshkurtër ose ciklike dhe është e nevojshme për ta mbajtur Autostradën në gjendje të mirë dhe të parrezikshme pune, ku përfshihen riparimet e vogla të gjithë elementeve të Autostradës, pastrimi, mirëmbajtja e bordit dhe zonës përreth dhe Mirëmbajtja dimërore dhe kontrolllet e kryera së bashku me vrojtimet që shoqërojnë çdo punim sa më lart.

“Pagesë për rakordim të deficitit të të ardhurave” është, për vitin përkatës të Kontratës, vlera e barabartë me: Të ardhurat e garantuara nga trafiku minus Të ardhurat faktike nga trafiku.

“Pagesë për rakordim të suficitit të të ardhurave” është, për vitin përkatës të Kontratës, vlera e barabartë me: 0,6 herë (Të ardhurat faktike nga trafiku minus Pragun për ndarjen e të ardhurave nga trafiku).

“Pagesë për rakordim të të ardhurave” është Pagesa për rakordim të deficitit të të ardhurave ose Pagesa për rakordim të suficitit të të ardhurave, sipas rastit.

“Paralajmërim i dytë” ka kuptimin e parashikuar në klauzolën 37.3.2.

“Interesi mbi garancinë” ka kuptimin e parashikuar në Marrëveshjen e drejtpërdrejtë.

“Segmenti 1 i Autostradës” është pjesa e Autostradës që fillon në kilometrin 0+000 dhe mbaron në kilometrin 25+928.

“Segmenti 2 i Autostradës” është pjesa e Autostradës që fillon në kilometrin 25+928 dhe mbaron në kilometrin 86+172.

“Segmenti 3 i Autostradës” është pjesa e Autostradës që fillon në kilometrin 86+172 dhe mbaron në kilometrin 114+478.

“Normë e borxhit me përparësi” është norma e interesit e pagueshme në bazë të Marrëveshjeve për financimin ose një normë më e ulët për të cilën palët bien dakord.

“Shërbime” janë shërbimet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së Autostradës të parashikuar në Shtojcën 5.

“Aksioner” është personi që zotëron Kapital neto ose Borxh të varur të Koncesionarit.

“Territor i Projektit” është:

- (a) trualli që përbën Autostradën ekzistuese deri në kufijtë e truallit të shpronësuar që përcaktojnë të drejtën përkatëse të kufijve të shpronësuar në pikën 1 të Shtojcës 14,



- (b) trualli që nevojitet për realizimin e Punimeve për urën mbi lumin Drin siç përcaktohet në skicat e përmendura në pikën 2 të Shtojcës 14,
- (c) trualli që nevojitet për realizimin e Punimeve në mbikalime dhe kryqëzime siç përcaktohet në skicat e përmendura në pikën 3 të Shtojcës 14;
- (d) trualli që nevojitet për realizimin e Punimeve për sheshet e taksës në përputhje me klauzolën 21.14 dhe siç përcaktohet në pikën IV të Shtojcës 14; dhe
- (e) trualli që mund të blihet me kalimin e kohës në përputhje me klauzolën 10.2,

që Autoriteti Kontraktues ia vë në dispozicion Koncesionarit për realizimin e Punimeve ose Shërbimeve.

“Ndryshim specifik i ligjit” është një Ndryshim i ligjit që përmend konkretisht ofrimin e shërbimeve ose punimeve të njëjta ose të ngjashme me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë ose zotërimin e aksioneve të shoqërive tregtare aktiviteti kryesor i të cilave është ofrimi i shërbimeve dhe punimeve të ngjashme ose të njëjta me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë.

“Standarde” janë standardet e identifikuara në seksionin 3 të Shtojcës 5 në lidhje me Shërbimet dhe në seksionin 6 të Shtojcës 5 në lidhje me Punimet.

“Nënkontratë” është:

- (a) Nënkontrata e ndërtimit; dhe
- (b) Nënkontrata e shfrytëzimit.

“Nënkontraktor” është:

- (a) Nënkontraktorit ndërtimor; dhe
- (b) Nënkontraktorit i shfrytëzimit.

“Kosto të zgjidhjes përpara kohe të nënkontratës” janë kostot që i kanë lindur ose do t’i lindin në mënyrë të arsyeshme Koncesionarit ose humbjet që ka pësuar Koncesionari në lidhje me Nënkontratat e tij vetëm si pasojë e përfundimit përpara kohe të kësaj Kontrate në lidhje me kostot e mëposhtme të cilat Koncesionari duhet t’u paguajë Nënkontraktorëve:

- (a) kostot e lindura në lidhje me kryerjen e Punimeve, shfrytëzimin e Autostradës ose ofrimin e Shërbimeve për aq sa këto kosto nuk mund të zbuteshin ose parandaloheshin, ku përfshihen:
 - (i) kostot e mallrave ose materialeve të porositura;
 - (ii) shpenzimet e lindura në rrjedhën normale të biznesit me kushte tregu në pritje të ndërtimit të Punimeve ose ofrimit të Shërbimeve;
 - (iii) humbjet e lindura në lidhje me nënkontratat që janë lidhur në rrjedhën normale të biznesit me kushte tregu, të cilat nuk mund të anulohen pa humbje;



- (iv) kostoja e zhvendosjes së pajisjeve të përdorura në lidhje me këtë Kontratë; dhe
 - (v) kostoja e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punëmarrësit e prekur, në bazë të ligjit;
- (b) kostot për t'u rimbursuar të cilat kanë ardhur nga zgjidhja e kontratave të lidhura me kushte të zakonshme për objekte të zakonshme,

ME KUSHT QË

- (c) Koncesionari dhe çdo Nënkontraktor të kenë bërë përpjekje të arsyeshme për minimizimin e kostove të tilla; dhe
- (d) Nënkontraktorit të mos kenë të drejtë për asnjë humbje ose fitim për aq sa është më i madh se fitimi që do të kishte marrë Nënkontraktori në 12 (dymbëdhjetë) muaj pas Datës së përfundimit të Kontratës.

“Borxh i varur” është çdo financim që i jepet Koncesionarit jo në bazë të një Marrëveshjeje për financim, dhe në çdo rast aprovohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues si Borxh i varur ose identifikohet si i tillë në Shtojcën 4.

“Punime gjeoteknike të mëpasshme” janë punimet e identifikuara në Planin për menaxhimin e punimeve gjeoteknike, me përditësimet përkatëse.

“Pagesë për punime gjeoteknike të mëpasshme” është çdo pagesë që Autoriteti Kontraktues duhet t'i bëjë Koncesionarit në lidhje me Punimet gjeoteknike të mëpasshme të realizuara në bazë të klauzolës 32A.2.10 dhe klauzolës 25.5 të kësaj Marrëveshjeje, e barabartë me koston që i ka lindur Koncesionarit gjatë realizimit të Punimeve gjeoteknike të mëpasshme, të certifikuara nga Inxhinieri i pavarur.

“Tatim” është çdo lloj tatim-takse (pa përfshirë TVSH-në) e vjelur në bazë të ligjit herë pas here, pavarësisht nëse është marrë apo jo deri më Datën efektive.

“Përfaqësues teknik” është çdo person i emëruar nga Autoriteti Kontraktues në bazë të klauzolës 19.

“Objekte të përkohshme” janë të gjitha strukturat dhe instalimet e përkohshme të cilat nevojiten për ndërtimin e Autostradës.

“Data e përfundimit të Kontratës” është data më e hershme nga sa më poshtë:

- (a) Data e përfundimit të vlefshmërisë; dhe
- (b) data e përfundimit të kësaj Kontrate e përcaktuar në përputhje me klauzolën 37.

“Njoftim për përfundim të Kontratës” është:

- (a) Njoftimi për Mospërbushje nga Koncesionari;
- (b) Njoftimi për Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktues;
- (c) Njoftim për zgjidhje vullnetare të Kontratës;



- (d) Njoftim për zgjidhje të Kontratës për shkak Veprimi të ndaluar;
- (e) Njoftim për zgjidhje të Kontratës për shkak force madhore; ose
- (f) Njoftimi për zgjidhje të Kontratës jo për shkak mospërmbushje

sipas rastit.

“Shuma e zgjidhjes së Kontratës” është shuma e pagueshme nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me klauzolën 39.

“Sipërmarrës i tretë” është sipërmarrësi i kontraktuar nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e Punimeve të të tretëve.

“Sigurimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta” është sigurimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta që është pjesë e Sigurimeve të nevojshme që duhen blerë dhe mbajtur në bazë të Shtojcës 12.

“Punime të të tretëve” janë të gjitha veprimtaritë dhe punimet ndërtimore të kryera nga Sipërmarrësi i tretë në përputhje me Dokumentet e punimeve të të tretëve.

“Dokumente të punimeve të të tretëve” janë:

- (a) Ndërtim Rruga Kukës – Morinë (dy viadukte) (dublimi) Loti 2 – Kontratë e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit – Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, nr.3680/4 (07.07.2009). dhe
- (b) Ndërtim Rruga Kukës – Morinë (vepra arti të mëdha) (dublimi) Loti 1 – Kontratë e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit – Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, nr.3676/6 (13.07.2009).

“Specifikimet për punimet e të tretëve” janë specifikimet e përfshira në Dokumentet e punimeve të të tretëve.

“Tuneli i Thirrës” është tuneli i Thirrës i identifikuar në planimetrinë ekzistuese të objektit në Shtojcën 14.

“Taksa e rrugës” është taksa që paguajnë Përdoruesit e Autostradës.

“Kompensim për evazion takse rruge” është shuma e barabartë me shumën që përdoruesi që ka kryer një Shkelje të taksës së rrugës do të duhej të paguante në përputhje me Shkallët e taksës së rrugës të zbatueshme në momentin e Shkeljes së taksës së rrugës.

“Shesh i taksës” është zona e përcaktuar e Autostradës, e projektuar dhe ndërtuar enkas për të vendosur objektet e arkëtimit të taksës së rrugës dhe operacionet përkatëse.

“Shkallët e taksës së rrugës” janë shkallët faktike të taksës së rrugës që zbaton Koncesionari.

“Të ardhurat nga taksa e rrugës” janë taksat që Përdoruesit i paguajnë Koncesionarit në përputhje me Kërkesat për taksën e rrugës ose me parashikimet e ndryshme ligjore.

“Kërkesat për taksën e rrugës” janë kërkesat për taksën e rrugës të parashikuara në klauzolën 11 dhe Seksionin 3.2.5 të Shtojcës 5.



“Sistemi i taksës së rrugës” është sistemi i vënë në zbatim nga Koncesionari për të arkëtuar Taksat e rrugës nga Përdoruesit.

“Punime për sheshet e taksës” janë të gjitha veprimtaritë ndërtimore të lidhura me ngritjen e shesheve të taksës të kryera në lidhje me Autostradën në kuadër të Punimeve kapitale në përputhje me seksionin 6.2.2 të Shtojcës 5 dhe veçanërisht në përputhje me seksionin 7.2.2.1 të Shtojcës 5.

“Data e fillimit të punimeve për sheshet e taksës” është Data efektive.

“Data e përfundimit të punimeve për sheshet e taksës” është data në të cilën është lëshuar Leja e shfrytëzimit në lidhje me të pjesët e Autostradës që përbëjnë Punimet për sheshet e taksës.

“Data e përfundimit paraprak të punimeve për sheshet e taksës” është data në të cilën është lëshuar Leja paraprake e shfrytëzimit në lidhje me të pjesët e Autostradës që përbëjnë Punimet për sheshet e taksës.

“Data e përfundimit të programuar të punimeve për sheshet e taksës” është Data e fillimit të punimeve për sheshet e taksës + 8 (tetë) muaj (që është data e hyrjes në fuqi të Certifikates se Përfundimit).

“Data e përfundimit paraprak të programuar të punimeve për sheshet e taksës” është Data e fillimit të punimeve për sheshet e taksës + 6 (gjashtë) muaj (që është data e hyrjes në fuqi të Certifikates se Përfundimit).

“Data e fillimit të përdorimit të rrugës me taksë” është data më e vonshme nga: data në të cilën Koncesionari arrin Datën paraprake e përfundimit të punimeve për sheshet e taksës ose data në të cilën Koncesionari ka përmbushur të gjitha kërkesat e seksionit 7.2.2 të Shtojcës 5.

“Shkelje e taksës së rrugës” është kalimi i Përdoruesit nëpër sheshin e taksës pa paguar Shkallën përkatëse të taksës me mjete të pranueshme pagese.

“Pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku” është:

- (a) në vitin e parë të Kontratës në të cilin përdoret Pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku, vlera e barabartë me shumën e Koeficienteve mujore të sezonalitetit që nga Data e fillimit të përdorimit të rrugës me taksë deri në fund të atij Viti Kontraktimi, shumëzuar me vlerën përkatëse të specifikuar për Prapun e ndarjes së të ardhurave nga trafiku në Pjesën 1 të Shtojcës 15 (Të ardhurat e garantuara nga trafiku dhe Pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku), të indeksuar në përputhje me klauzolën 25.2.1(c);
- (b) në vitin e fundit të Kontratës, vlera e barabartë me shumën e Koeficienteve mujore të sezonalitetit që nga fillimi i vitit të fundit të Kontratës deri në fund të muajit që i paraprin muajit në të cilin bie Data e përfundimit të Kontratës, shumëzuar me vlerën përkatëse të specifikuar për Prapun e ndarjes së të ardhurave nga trafiku në Pjesën 1 të Shtojcës 15 (Të ardhurat e garantuara nga trafiku dhe Pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku), të indeksuar në përputhje me klauzolën 25.2.1(c); dhe
- (c) në lidhje me çdo vit tjetër të Kontratës, në përputhje me vlerën e paraqitur në Shtojcën 15 (Të ardhura të garantuara nga trafiku dhe Pragu për ndarjen e të



ardhurave) për secilin vit të Kontratës, indeksuar dhe zbatuar në përputhje me Klausolën 25.2.1(c),

dhe për të evituar çdo dyshim, kur viti i Kontraktimit përfundon përpara Datës së fillimit të përdorimit të rrugës me taksë, Pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku për atë vit Kontrate konsiderohet zero.

“Gjykatë” ka kuptimin e parashikuar në klausolën 56.2.1.

“I pasigurueshëm” do të thotë, në lidhje me një risk, që:

- (a) nuk ka sigurim të gatshëm në tregun evropiane të sigurimeve tek siguruesit me reputacion dhe pozitë të mirë sa i takon riskut në fjalë; ose
- (b) primi i sigurimit i pagueshëm për të siguruar riskun në fjalë është në nivel të tillë që ky risk në përgjithësi nuk sigurohet në tregun evropian të sigurimeve tek siguruesit me reputacion dhe pozitë të mirë.

“Përdorues” janë përdoruesit e Autostradës.

“TVSH” është tatimi mbi vlerën e shtuar, siç parashikohet me ligj.

“Njoftim për zgjidhje vullnetare të Kontratës” ka kuptimin e parashikuar në klausolën 37.5.1.

“Mirëmbajtja dimërore” janë punimet në lidhje me parandalimin e formimit të akullit dhe largimin e dëborës dhe akullit dhe të gjitha punimet e mirëmbajtjes dhe funksionet e lidhura me to të parashikuara në seksionin 3.4 të Shtojcës 5..

“Punime” janë Punimet kapitale dhe Punimet gjeoteknike (por pa përfshirë Punimet e të tretëve) dhe çdo punim tjetër që mund të nevojitet në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e Autostradës dhe të Objekteve të përkohshme nga Koncesionari.



Shtojca 2

Nuk është përdorur



Shtojca 3

Informacioni që i kërkohet Koncesionarit



Shtojca 4

Dokumentet e Projektit dhe Marrëveshjet për financimin



Shtojca 5

Kërkesat e Autoritetit Kontraktues

Jepen si lidhje më vete të përbëra nga seksionet 1-8 dhe lidhjet 1-6



Shtojca 6

Kërkesat gjeoteknike

Raportet gjeoteknike të tenderit japin një vlerësim të kushteve gjeoteknike dhe gjeologjike të Autostradës, si edhe rekomandime në lidhje me masat e nevojshme për stabilizimin e skarpateve dhe zvogëlimin e rrezikut gjeoteknik. Punimet gjeoteknike fillestare duhet të realizohen në përputhje me vlerësimin dhe kërkesat që jepen në Raportet gjeoteknike të tenderit dhe duhen përcaktuar me hollësi në Planin gjeoteknik fillestar të Koncesionarit.

Raportet gjeoteknike të tenderit dhe planet e lidhura me to⁵ (tetor 2011, korrik & gusht 2015 & Mars 2016) përmbajnë një listë të pikave ku nevojiten masa për stabilizimin e skarpateve. Punimet gjeoteknike fillestare, sikurse përcaktohet, me shtesat dhe ndryshimet përkatëse, në Planin gjeoteknik fillestar të Koncesionarit, janë punimet në të gjitha pikat e identifikuar në tabelën 1, më poshtë (masat më me përparësi). Skarpatet ku propozohen Punime gjeoteknike me nivel përparësie 1 dhe 2, përshkruhen edhe në Raportet dhe planet gjeoteknike të tenderit. Këto skarpate dhe punimet përkatëse përditësohen (duke përfshirë edhe skarpate të identifikuar shtesë të autostradës, që kërkojnë stabilizim) dhe përfshihen, sipas nevojës, në Planin për menaxhimin e punimeve gjeoteknike të Punimeve dhe planeve gjeoteknike të mëpasshme (klauzola 32A.2 e Kontratës së Koncesionit).

Numri i pikave ku ndodhen skarpatet e identifikuar në tabelë 1 është numri minimal i skarpateve që duhen përfshirë në planin e Punimeve gjeoteknike fillestare. Koncesionari duhet të bëjë vetë një vlerësim gjeoteknik të gjithë skarpateve të autostradës, duke marrë në konsideratë gjendjen më të fundit gjeoteknike të tyre. Në varësi të rezultati të këtij vlerësimi, Koncesionari mund të shtojë, në formën e një përditësimi të Planit të punimeve gjeoteknike fillestare, edhe skarpate të tjera të identifikuar si skarpate që kanë nevojë për ndërhyrje të ngutshme. Kostoja shtesë e realizimit të këtyre punimeve nuk rimbursohet nga Autoriteti Kontraktues. Punime të tilla përfundohen në përputhje me dispozitat e klauzulës 32A.1 të Kontratës së Koncesionit për Punimet gjeoteknike fillestare.

Gjithashtu, Punimet gjeoteknike fillestare mund të devijojnë nga objekti i masave të propozuara nga Raportet gjeoteknike të tenderit për cilëndo prej pikave të identifikuar në Tabelën 1. Në këto raste, masat alternative duhet të kenë një efekt pozitiv të paktën të njëjtë me masat e rekomanduara në Raportet gjeoteknike të tenderit dhe çdo ndryshim në çmim që vjen si pasojë duhet të përmendet në Preventivin e parashikuar në Shtojcën 7 të kësaj Kontrate. Në të gjitha rastet, masat gjeoteknike duhet të stabilizojnë skarpatet dhe të zvogëlojnë rrezikun afatgjatë. Inxhinieri i pavarur jep pëlqimin për secilin prej këtyre ndryshimeve të punimeve nëpërmjet aprovimit të Planit gjeoteknik fillestar dhe çdo ndryshim të tij dhe verifikon që objekti dhe kostot e përgjithshme të punimeve të mbeten të njëjta në nivel material.

⁵ a) Raporti gjeologjik / gjeoteknik për segmentet Milot – Rrëshen dhe Kukës – Morinë (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 10/2011).

b) Raporti inxhinierik gjeologjik / gjeoteknik dhe Hartat gjeologjike inxhinierike dhe Plan-vendosjet e rreziqeve të vlerësuara, (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 10/2011).

c) Raporti Teknik i Fazës I (për vlerësimin e rreziqeve dhe masat për zvogëlimin/stabilizimin e rreziqeve) dhe Hartat gjeologjike inxhinierike të përditësuara dhe Plan-vendosjet e përditësuara të rreziqeve të vlerësuara, (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 07/2015).

d) Raport Teknik i Fazës II (për vlerësimin e përditësuar të rreziqeve dhe masat e përditësuara për zvogëlimin/stabilizimin e rreziqeve) (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 08/2015).

e) Raporti Teknik për një përditësim të fokusuar të Punimeve Gjeoteknike Fillestare, Mars 2016 dhe Hartëzimi Gjeologjik Inxhinierik dhe Planet e renditjes së Rreziqeve (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 03/2016).

Plani gjeoteknik fillestar përgatitet, dhe ndryshohet sipas nevojës, në përputhje me klauzolën 32A.1 të Kontratës së Koncesionit dhe jep, të paktën, informacionet e mëposhtme në lidhje me Punimet gjeoteknike fillestare: lloji, shkalla, dimensionet, hollësitë teknike, specifikimet, skicat tip dhe/ose të hollësishme dhe llogaritjet dhe një pasqyrë në përputhje me grafikun kohor të përgjithshëm të Projektit.

Hartimi dhe çdo ndryshim i Planit gjeoteknik fillestar bëhet nga një ekip gjeoteknik i specializuar i përbërë, si minimum, nga një inxhinier gjeolog, një inxhinier gjeoteknik dhe një inxhinier i strukturave, ku secili duhet (i) të jetë i certifikuar ose i regjistruar nga një dhomë përkatëse e akredituar, ose në Shqipëri ose në Evropë ose nga një dhomë tjetër përkatëse që është e pranueshme për Inxhinierin e pavarur; (ii) të ketë të paktën 12 vjet përvojë në projekte të ngjashme me Projektin; dhe (iii) të ketë përvojë specifike në (a) në hartimin e hartave gjeologjike inxhinierike për projektet e infrastrukturës përfshirë projekte me natyrë të ngjashme me Projektin; dhe (b) projektimin e punimeve të stabilizimit të skarpit, punimeve të dherave dhe themeleve për projektet e infrastrukturës përfshirë projekte me natyrë të ngjashme me Projektin.


Ekipi gjeoteknik i viziton të gjitha skarpitet e autostradës dhe sidomos të gjitha pikat ku propozohet të merren masa për stabilizimin e skarpitit-zvogëlimin e rrezikut ose masa të tjera të propozuara nga Raportet gjeoteknike të tenderit dhe mbledh të gjitha informacionet e nevojshme për bërjen e një vlerësimi dhe rekomandimi të shëndoshë dhe të justifikuar.

Tabela 1: Përmbledhje e pikave dhe llojeve të masave më me përparësi të propozuara, Punime gjeoteknike fillestare

Punime gjeoteknike fillestare				
a)	Kilometrazhi i unifikuar (D: djathtas, M: majtas) (kilometri i rrugës siç është) -Kilometri i pjesëve të rrugës është i përafërt-	Kategoria e rrezikut, qershor 2015 & Shkurt 2016	Prioriteti i supozuar	Masat e propozuara, qershor 2015 & shkurt 2016
	19+000 - 19+180 R	5 (Shkurt 2016)	më me përparësi	Largim i elementeve të lira shkëmbore, ndërtim i murit në pjesen e poshtme dhe digave të kontrollit.
2	21+250 - 21+900 M (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi	Pastrim i pritëses kundër prurjeve përgjatë gërryerjes së shpatit. Mur gravitacioni me gabione në pjesen e poshtme nga km. 21+450 deri në km. 21+650 për mbrojtje nga rënia dhe prurjet shkëmbore.
3	22+300 - 22+550 M (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi	Largim i elementeve të lira shkëmbore dhe pastrim i prurjeve shkëmbore. Pastrim i pritëses kundër prurjeve. Zgjatim i murit në gjatësi dhe në lartësi. Pengesë mbrojtëse nga rënia e gurëve. Betonim me beton të spërkatur, ankera në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqen e shpatit të gërryer.
4	27+630 - 27+900 M/D (1+710 - 1+960) (Gërryerje e shpatit)	7 (mund të jetë 1-2 nëse vihen)	më me përparësi	Strukturë ujëkaluese në dalje e tobinës (gërryerje e thellë dhe gërmim nga poshtë) në km. 27+680 majtas (km. 140+140 e rrugës hyrëse në

Punime gjeoteknike fillestare				
a\ a	Kilometraži i unifikuar (D: djathtas, M: majtas) (kilometri i rrugës së është) Kilometri i pjesëve të rrugës është i përafërt.	Kategoria e rrezikut, qershor 2015 & Shkurt 2016	Prioriteti i supozuar	Masat e propozuara, qershor 2015 & shkurt 2016
		re lëvizje)		mbikalim): Mur me gabion dhe mbrojtje nga erozioni i skarpatit me shtresë gurësh të hedhur. Pastrim i prurjeve shkëmbore nga tombina në km. 27+900 nga kanali kullues i majtë. Ndërtim shtrese gurësh të hedhur në shpatin e gërryer në të majtë në kanalet e thella të erozionit. Monitorim-kontroll i rregullt (pika vrojtimi – pjerrësimatës).
5	35+330 - 35+940 M (9+390 – 10+000) (Gërryerje e shpatit)	4	më me përparësi	Veshje me beton në 5 (pesë) bankinat e poshtme nga km. 35+500 deri në km. 35+940. Rrjetë mbrojtëse me ankera (niveli 1 & 2), pengesë mbrojtëse nga rënia e gurëve, largim i elementeve të lira shkëmbore dhe pastrim i prurjeve shkëmbore. Betonim me beton të spërkatur, ankera në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqen e shpatit të gërryer në zonat me probleme. Kontroll dhe monitorim i rregullt. Alternativë: Ndërtimi i një dopiostrehe.
6	36+570 - 36+730 M (10+660 – 10+780) (Gërryerje e shpatit)	4	më me përparësi	Veshje me beton në 4 (katër) bankinat e poshtme. Ankera në shkëmb (niveli 1), pastrim i prurjeve shkëmbore, largim i elementeve të lira shkëmbore, pengesë mbrojtëse nga rënia e gurëve. Betonim me beton të spërkatur, ankera në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqen e shpatit të gërryer në zonat me probleme.
7	41+430 - 41+760 M/D (15+500-15+830) (Gërryerje e shpatit)	5 (mund të jetë 1-2 nëse vazhdojnë lëvizjet)	më me përparësi	Sonda për hetim të terrenit. Projektim stabilizimi rotacional për rrëshqitjet e dheut. Hendek i veshur me beton. Mur me pilota, bankinë në pjesen e poshtme dhe vrima të gjata kullimi. Bankinë në pjesen e poshtme të skarpatit-Mbrojtje kundër brejtjes nga lumi (~200m), hendek i veshur me beton. Monitorim-kontroll i rregullt (pika vrojtimi, pjerrësimatës). Pastrim i prurjeve shkëmbore, riformim skarpati i majtë, shtrese gurësh të hedhur në shpat nga km. 41+340 deri në 41+480.
8	48+750 - 48+870 R (3+920 – 4+040)	5-6	më me përparësi	Linjë betoni për pesë (5) të bankinave më të ulëta, mur me gabion 2m i lartë, pastrim i prurjeve

Punime gjeoteknike fillestare				
a)	Kilometrazhi i unifikuar (D: djathtas, M: majtas) (kilometri i rrugës siç është) -Kilometri i pjesëve të rrugës është i përafërt-	Kategoria e rrezikut, qershor 2015 & Shkurt 2016	Prioriteti i supozuar	Masat e propozuara, qershor 2015 & shkurt 2016
				shkëmbore, hendek i veshur me beton, veshje me mur mbajtës.
9	49+010 - 49+140 R (Gërryerje shpati)	4 (Shkurt 2016)	më me përparësi	Pastrim i prurjeve shkëmbore nga bankinat. Veshje me beton i të gjitha bankinave.
10	50+790 - 51+050 D (5+960-6+320) (Gërryerje shpati)	1-2	më me përparësi	Sonda për hetim të terrenit. Projektim stabilizimi për rrëshqitjet e dheut. Prerje e sipërme. Veshje me beton e bankinave të reja. Mbushje me gëlqere dhe çimento në çarje në shtresa. Beton i spërkatur, ankera në shkëmb dhe vrima drenazhimi. Mur me gabione me pjesen e poshtme me mbushje. Monitorim-kontroll i rregullt (pika vrojtimi, pjerrësimatës). Alternativë: Ndërtimi i një dopiostrehe ~ 100m – 150m të gjatë me mbushje themeli në të dyja anët (mbushje 10m-15m sipër pllakës së betoni).
11	52+490 - 52+520 L (7+660 - 7+690)	4 (Shkurt 2016)	më me përparësi	Ndërtimi i dy digave të kontrollit. Ndërtimi i baseneve të sedimenteve.
12	57+260 - 57+440 D 12+350-12+600 (Gërryerje shpati)	2-3	më me përparësi	Shkallëzim, pastrim i prurjeve shkëmbore, bimësi, bankinë në pjesen e poshtme të skarpatit (dimensionet mbeten për t'u përcaktuar pas këqyrjes së terrenit dhe projektimit). Pastrim i pritësës kundër prurjeve, zhblokim i tubit kullues transversal në km. 57+360. Vrima drenazhimi.
13	Gërryerje shpati djathtas. 63+850 – 63+930	6	më me përparësi	Pastrim i prurjeve shkëmbore nga bankinat. Veshje me beton i të gjitha bankinave.
140	64+260- 64+390 D 19+420-19+550 (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi	Veshje me beton në 3 (tri) bankinat e poshtme. Betonim me beton të spërkatur, ankera në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqen e shpatit të gërryer në zonat me probleme.
151	65+180 - 65+260 D 20+340-20+420	5	më me përparësi	Veshje me beton në 3 (tri) bankinat e poshtme. Betonim me beton të spërkatur, ankera në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqen e shpatit të gërryer në zonat me probleme.
16	Gërryerje shpati djathtas. 65+750 – 66+040	6 (Shkurt 2016)	më me përparësi	Pastrim i prurjeve shkëmbore nga bankinat. Instalimi i barrierës së rënies së gurëve.
172	67+740 - 67+840D 22+900-23+000 (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi	Veshje me beton në 3 (tri) bankinat e poshtme. Betonim me beton të spërkatur, ankera në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqen e

Punime gjeoteknike fillestare				
a\ a	Kilometrazhi i unifikuar (D: djathtas, M: majtas) (kilometri i rrugës siç është) Kilometri i pjesëve të rrugës është i përafërt	Kategoria e rrezikut, qershor 2015 & Shkurt 2016	Prioriteti i supozuar	Masat e propozuara, qershor 2015 & shkurt 2016
				shpatit të gërryer në zonat me probleme. Largim i materialit të rrëshqitshëm.
183	69+840 – 69+940 D 25+000-25+080 (Gërryerje shpati)	4-5	më me përparësi	Shkallëzim në nivelin 1, 2 dhe 3, bimësi (me hidrmbjellje), mbjellje pemësh në shtresat e dëmtuara nga era, mbyllje e çarjeve në shtresa me gëlqere-çimento. Veshje me beton e 2 bankinave të poshtme. Kontroll dhe monitorim i rregullt.
194	 79+670 - 79+780 D 8+570 - 8+690 (Gërryerje shpati)	4-5		Pastrim i prurjeve shkëmbore, largim i elementeve të lira shkëmbore, mur guri (niveli 1) nga km. 8+590-8+680, Ankerë në shkëmb (8+580-8+640), vrima drenazhimi (8+590-8+680), pengesë mbrojtëse nga rënia e gurëve (8+600 – 8+640). Veshje me beton e bankinave. Betonim me beton të spërkatur, ankerë në shkëmb dhe vrima drenazhimi. Ose, në vend të sa më lart (por me kosto më të lartë) rigërmim i skarpatit.
20	86+900 – 87+020 M (Gërryerje shpati)	4	më me përparësi	Rigërmim. Veshje me beton e bankinave të reja.
21	87+020 – 87+200 & 87+330 – 87+520 M (Gërryerje shpati)	4	më me përparësi (e para)	Largim i elementeve të lira shkëmbore, pastrim i prurjeve shkëmbore. Rrjetë mbrojtëse me ankerë (niveli 1), pengesë mbrojtëse nga rënia e gurëve. Veshje me beton e 3 bankinave të poshtme. Betonim me beton të spërkatur, ankerë në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqen e shpatit të gërryer në zonat me probleme. <i>(Veshje me beton e të gjithë bankinave të sipërme)</i>
22	87+200 - 87+330 L (Gërryerje shpati)	1-2 (Shkurt 2016)	Më me përparësi	Gërryerje e shpatit në një kënd të sigurt deri në lartësinë e plotë. Veshje me beton të të gjithë bankinave. Betonim me beton të spërkatur, ankerë në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqen e shpatit të gërryer në zonat me probleme aty ku nevojitet.
23	87+520 – 87+920 M (Gërryerje shpati)	4	Më me përparësi (e para)	Largim i elementeve të lira shkëmbore, pastrim i prurjeve shkëmbore, rrjetë mbrojtëse me ankerë, pengesë mbrojtëse nga rënia e gurëve. Veshje me beton në 3 (tri) bankinat e poshtme. Betonim me beton të spërkatur, ankerë në shkëmb dhe vrima drenazhimi në sipërfaqe

Punime gjeoteknike fillestare				
a\ a	Kilometrazi i unifikuar (D: djathtas, M: majtas) (kilometri i rrugës siç është) -kilometri i pjesëve të rrugës është i përafert-	Kategoria e rrezikut, qershor 2015 & Shkurt 2016	Prioriteti i supozuar	Masat e propozuara, qershor 2015 & shkurt 2016
				shpatit të gërryer në zonat me probleme nga km. 87+670 deri në km. 87+715 & nga km. 87+860 deri në km. 87+900. <i>(Veshje me beton e të gjithë bankinave të sipërme. Alternativa: gërryerja e tre (3) niveleve më të sipërme)</i>
24	87+920 - 88+530 M (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi	Largim i elementeve të lira shkëmbore, pastrim i prurjeve shkëmbore. Veshje me beton e 2 (dy) bankinave të poshtme. Betonim me beton të spërkatur dhe vrima drenazhimi në 2 (dy) nivelet e poshtme. Pastrim i prurjeve shkëmbore, veshje me beton e rrugës ekzistuese (në km. 88+000-88+260), shkallëzim (në km. 88+260). Pastrim i prurjeve shkëmbore, pengesë mbrojtëse nga rënia e gurëve mbi bordurë (nga km. 88+460 – 88+520).
25	88+740 – 88+900 M (Gërryerje shpati)	5-6	më me përparësi	Pastrim i prurjeve shkëmbore, pengesë mbrojtëse nga rënia e gurëve mbi bordurë dhe bankinën e parë. Betonim me beton të spërkatur dhe vrima drenazhimi në 2 (dy) nivelet e poshtme. Ankerat në shkëmb (km. ~88+740-88+900 në dy nivelet e poshtme). Veshje me beton në 3 (tri) bankinat e poshtme.
26	88+900 – 89+080 M (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi (e para)	Largim i elementeve të lira shkëmbore, pastrim i prurjeve shkëmbore, Veshje me beton e 3 (tri) bankinave të poshtme. Betonim me beton të spërkatur dhe vrima drenazhimi në 2 (dy) nivelet e poshtme. Monitorim-kontroll i rregullt (pika vrojtimi dhe pjerrësimatës). <i>(Ankera në shkëmb në nivelet 1 & 2, gardh mbrojtjeje nga rënia e gurëve)</i>
27	89+350 – 89+630 D (Gërryerje shpati)	3	më me përparësi (e para)	Largim i elementeve të lira shkëmbore, pastrim i prurjeve shkëmbore. Veshje me beton e gjithë bankinave. Betonim me beton të spërkatur, ankera në shkëmb dhe vrima drenazhimi ku ka defekt. <i>Rrjetë me ankera (niveli i 1rë), gardh mbrojtës nga rënia e gurëve në bankinën e 1rë)</i>
28	91+150 – 91+320 D (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi	Hendek i veshur me beton. Rishtrim dhe sheshim i materialit të krijuar nga rrëshqitja e dheut në

Punime gjeoteknike fillestare				
a\ a	Kilometrazhi i unifikuar (D: djathtas, M: majtas) (kilometri i rrugës siç është) -Kilometri i pjesëve të rrugës është i përafërt-	Kategoria e rrezikut, qershor 2015 & Shkurt 2016	Prioriteti i supozuar	Masat e propozuara, qershor 2015 & shkurt 2016
			(e para)	vendin ku ndodhet. Bankinë në pjesen e poshtme me gabione. Veshje me beton e të gjitha bankinave të poshtme të shpatit të gërryer. (Rigërmim, bimësi)
29	93+100– 93+300 D (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi (e para)	Ndërtim muri me gurë nën shtyllë. (Rigërmim, bimësi)
30	094+150 - 094+550 M (Gërryerje shpati)	5	më me përparësi (e para)	Veshje e shpatit me rrjetë, largim i elementeve të lira shkëmbore, pastrim i prurjeve shkëmbore, veshje me mur mbajtës, mur në pjesen e poshtme. Veshje me beton e pjesëve të bankinave të gërryera. (Rrjetë me ankera)
31	101+690 - 101+950 M (Mbushje e trupit të rrugës)	4	më me përparësi (e para)	Monitorim, mur gravitacioni në pjesen e poshtme, bimësi, projektim



Shtojca 7

Preventivi

Preventivi i cmimeve i aplikueshëm për Punimet Fillestare Gjeoteknike dhe Urën e Kukësit (tabela të ndara)



NO. 111
TINJAUAN
S2.1

Kategori	Sub-kategori	Nama	Jumlah	Jumlah	Jumlah	Jumlah	Jumlah	Jumlah	Jumlah	Jumlah	Jumlah	S2.1 (Kalmash - Kullés)										S2.2										S2.3b										Kulak - Berta																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																														
												1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100	101	102	103	104	105	106	107	108	109	110	111	112	113	114	115	116	117	118	119	120	121	122	123	124	125	126	127	128	129	130	131	132	133	134	135	136	137	138	139	140	141	142	143	144	145	146	147	148	149	150	151	152	153	154	155	156	157	158	159	160	161	162	163	164	165	166	167	168	169	170	171	172	173	174	175	176	177	178	179	180	181	182	183	184	185	186	187	188	189	190	191	192	193	194	195	196	197	198	199	200	201	202	203	204	205	206	207	208	209	210	211	212	213	214	215	216	217	218	219	220	221	222	223	224	225	226	227	228	229	230	231	232	233	234	235	236	237	238	239	240	241	242	243	244	245	246	247	248	249	250	251	252	253	254	255	256	257	258	259	260	261	262	263	264	265	266	267	268	269	270	271	272	273	274	275	276	277	278	279	280	281	282	283	284	285	286	287	288	289	290	291	292	293	294	295	296	297	298	299	300	301	302	303	304	305	306	307	308	309	310	311	312	313	314	315	316	317	318	319	320	321	322	323	324	325	326	327	328	329	330	331	332	333	334	335	336	337	338	339	340	341	342	343	344	345	346	347	348	349	350	351	352	353	354	355	356	357	358	359	360	361	362	363	364	365	366	367	368	369	370	371	372	373	374	375	376	377	378	379	380	381	382	383	384	385	386	387	388	389	390	391	392	393	394	395	396	397	398	399	400	401	402	403	404	405	406	407	408	409	410	411	412	413	414	415	416	417	418	419	420	421	422	423	424	425	426	427	428	429	430	431	432	433	434	435	436	437	438	439	440	441	442	443	444	445	446	447	448	449	450	451	452	453	454	455	456	457	458	459	460	461	462	463	464	465	466	467	468	469	470	471	472	473	474	475	476	477	478	479	480	481	482	483	484	485	486	487	488	489	490	491	492	493	494	495	496	497	498	499	500	501	502	503	504	505	506	507	508	509	510	511	512	513	514	515	516	517	518	519	520	521	522	523	524	525	526	527	528	529	530	531	532	533	534	535	536	537	538	539	540	541	542	543	544	545	546	547	548	549	550	551	552	553	554	555	556	557	558	559	560	561	562	563	564	565	566	567	568	569	570	571	572	573	574	575	576	577	578	579	580	581	582	583	584	585	586	587	588	589	590	591	592	593	594	595	596	597	598	599	600	601	602	603	604	605	606	607	608	609	610	611	612	613	614	615	616	617	618	619	620	621	622	623	624	625	626	627	628	629	630	631	632	633	634	635	636	637	638	639	640	641	642	643	644	645	646	647	648	649	650	651	652	653	654	655	656	657	658	659	660	661	662	663	664	665	666	667	668	669	670	671	672	673	674	675	676	677	678	679	680	681	682	683	684	685	686	687	688	689	690	691	692	693	694	695	696	697	698	699	700	701	702	703	704	705	706	707	708	709	710	711	712	713	714	715	716	717	718	719	720	721	722	723	724	725	726	727	728	729	730	731	732	733	734	735	736	737	738	739	740	741	742	743	744	745	746	747	748	749	750	751	752	753	754	755	756	757	758	759	760	761	762	763	764	765	766	767	768	769	770	771	772	773	774	775	776	777	778	779	780	781	782	783	784	785	786	787	788	789	790	791	792	793	794	795	796	797	798	799	800	801	802	803	804	805	806	807	808	809	810	811	812	813	814	815	816	817	818	819	820	821	822	823	824	825	826	827	828	829	830	831	832	833	834	835	836	837	838	839	840	841	842	843	844	845	846	847	848	849	850	851	852	853	854	855	856	857	858	859	860	861	862	863	864	865	866	867	868	869	870	871	872	873	874	875	876	877	878	879	880	881	882	883	884	885	886	887	888	889	890	891	892	893	894	895	896	897	898	899	900	901	902	903	904	905	906	907	908	909	910	911	912	913	914	915	916	917	918	919	920	921	922	923	924	925	926	927	928	929	930	931	932	933	934	935	936	937	938	939	940	941	942	943	944	945	946	947	948	949	950	951	952	953	954	955	956	957	958	959	960	961	962	963	964	965	966	967	968	969	970	971	972	973	974	975	976	977	978	979	980	981	982	983	984	985	986	987	988	989	990	991	992	993	994	995	996	997	998	999	1000	1001	1002	1003	1004	1005	1006	1007	1008	1009	1010	1011	1012	1013	1014	1015	1016	1017	1018	1019	1020	1021	1022	1023	1024	1025	1026	1027	1028	1029	1030	1031	1032	1033	1034	1035	1036	1037	1038	1039	1040	1041	1042	1043	1044	1045	1046	1047	1048	1049	1050	1051	1052	1053	1054	1055	1056	1057	1058	1059	1060	1061	1062	1063	1064	1065	1066	1067	1068	1069	1070	1071	1072	1073	1074	1075	1076	1077	1078	1079	1080	1081	1082	1083	1084	1085	1086	1087	1088	1089	1090	1091	1092	1093	1094	1095	1096	1097	1098	1099	1100	1101	1102	1103	1104	1105	1106	1107	1108	1109	1110	1111	1112	1113	1114	1115	1116	1117	1118	1119	1120	1121	1122	1123	1124	1125	1126	1127	1128	1129	1130	1131	1132	1133	1134	1135	1136	1137	1138	1139	1140	1141	1142	1143	1144	1145	1146	1147	1148	1149	1150	1151	1152	1153	1154	1155	1156	1157	1158	1159	1160	1161	1162	1163	1164	1165	1166	1167	1168	1169	1170	1171	1172	1173	1174	1175	1176	1177	1178	1179	1180	1181	1182	1183	1184	1185	1186	1187	1188	1189	1190	1191	1192	1193	1194	1195	1196	1197	1198	1199	1200	1201	1202	1203	1204	1205	1206	1207	1208	1209	1210	1211	1212	1213	1214	1215	1216	1217	1218	1219	1220	1221	1222	1223	1224	1225	1226	1227	1228	1229	1230	1231	1232	1233	1234	1235	1236	1237	1238	1239	1240	1241	1242	1243	1244	1245	1246	1247	1248	1249	1250	1251	1252	1253	1254	1255	1256	1257	1258	1259	1260	1261	1262	1263	1264	1265	1266	1267	1268	1269	1270	1271	1272	1273	1274	1275	1276	1277	1278	1279	1280	1281	1282	1283	1284	1285	1286	1287	1288	1289	1290	1291	1292	1293	1294	1295	1296	1297	1298	1299	1300	1301	1302	1303	1304	1305	1306	1307	1308	1309	1310	1311	1312	1313	1314	1315	1316	1317	1318	1319	1320	1321	1322	1323	1324	1325	1326	1327	1328	1329	1330	1331	1332	1333	1334	1335	1336	1337	1338	1339	1340	1341	1342	1343	1344	1345	1346	1347	1348	1349	1350	1351	1352	1353	1354	1355	1356	1357	1358	1359	1360	1361	1362	1363	1364	1365	1366	1367	1368	1369	1370	1371	1372	1373	1374	1375	1376	1377	1378	1379	1380	1381	1382	1383	1384	1385	1386	1387	1388	1389	1390	1391	1392	1393	1394	1395	1396	1397	1398	1399	1400	1401	1402	1403	1404	1405	1406	1407	1408	1409	1410	1411	1412	1413	1414	1415	1416	1417	1418	1419	1420	1421	1422	1423	1424	1425	1426	1427	1428	1429	1430	1431	1432	1433	1434	1435	1436	1437	1438	1439	1440	1441	1442	1443	1444	1445	1446	1447	1448	1449	1450	1451	1452	1453



Nr.	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Njësi	Sasia	Çmimi njësi (EUR)	Çmimi total (EUR)
PREVENTIV					
0	PUNIMET E PROJEKTIMIT (paguar nga investitor - JO OFERTË PËR KËTË ARTIKULL)				
1.	Projektimi kryesor dhe 'cumber' (gjatë ndërtimit). Çmimi përfshin: - Projekti përfundimtar - Projektim 'cumber' (gjatë ndërtimit me konsolë) - Studim gjeoteknik - rrjetat gjeodetike e projektit - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis - dokumentacioni i projektit të hidrologjisë - dokumentacioni i projektit për provën nën ngarkesë - Studimi i mbikëqyrjes së fshehtë	copë	1,00	0,00	0,00
	PROJEKTIMI - TOTAL			0	0,00
A.	NËNSTRUKTURAT				
1.	PUNIME DHEU (TË DHËNA SIPAS DISIPLINËS GJEOTEKNIKE TË NDARË).				
1.1.	Gërmimi, ngarkimi dhe transporti i materialit të gërmuar të kategorisë III dhe IV për themele për krahë anësorë dhe këmbë ure	m ³	6.899,76	13,05	90.041,80
1.2.	Mbushje e themeleve me material nga gërmimet	m ³	2.400,00	3,38	8.112,00
1.3.	Formimi i pritave dhe pykave të pritave ngjitur me krahët anësorë të urës.	m ³	6.500,00	9,46	61.490,00
1.4.	Formimi i pykave me Zhavorr pas krahut anësor	m ³	2.954,40	17,57	51.908,80
1.5.	Mbulimi i pykave të pritës me gurë të	m ²	600,00	66,22	39.732,00

	gdhendur trashë				
1.6.	Gërmime në shtrat deti pa përdorim eksplozivësh	m ³	7.008,00	2,57	18.010,50
1.7.	Bërthamë e mbushur me gurët e strukturave detare të rëndesës.				
		m ³	26.029,86	9,49	247.023,30
1.8.	Gërmim i tuneleve ose puseve pa përdorim eksplozivësh në gjithë llojet e tokës	m ³	5.849,82	17,62	103.073,80
1.9.	Kompensim shtesë për gërmimin e tuneleve ose puseve në kushte të këqija të tokës (rrjedhje e lartë e ujërave, tokë e ngritur, etj.)	m ³	5.849,00	4,16	24.337,60
1.10.	Kontroll i rrjedhjes së ujërave nëntokësore gjatë gërmimit të tuneleve apo puseve	artikulli	4,00	25.000,00	100.000,00
1.11.	Shpim me rrotullim goditje për vrima me diametër 46 mm për çimentim përforcimi në gjithë llojet dhe kushtet e tokës (para-çimentim i pusit nga sipërfaqja)	m	9,00		
1.12.	Shpim me rrotullim goditje për vrima me diametër 46 mm për çimentim përforcimi në gjithë llojet dhe kushtet e tokës (çimentim në pus gjatë gërmimit të pusit)	m	10,00		
1.13.	Çimentim përforcimi nën presion 0,7MPa deri 3,0MPa në gjithë llojet dhe kushtet e tokës	ton	360		
1.14.	Tuba çeliku dhe aksesore në vrimat e llaçit të cimentos	kg	2,9		
1.15.	Materiale dhe hak pune për përzierjen e bentonitit në llaçin e cimentos	kg	0,1		
1.16.	Materiale dhe hak pune për përzierjen e rrës në llaçin e cimentos	ton	11,4		
	TOTAL PUNIME DHEU				743.730,00

2. PUNIME BETONI

2.1.	Furnizim material, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit të bazamentit C30/20 poshtë themeleve të krahëve anësorë, puseve dhe poshtë pllakave kalimtare.	m ³	76,85	121,62	9.346,30
2.2.	Furnizim material, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit të bazamentit C30/37 për themelet e krahëve anësorë të urës	m ³	731.82	148.65	108.785.00
2.3.	Ndërtimi i puseve të themeleve me diametër				

	9.0 m				
2.3.1.	Furnizim materiali, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit të bazamentit C30/37 për pusët e themeleve Përforcimi është llogaritur veçmas.	m ³	3.815,10	148,65	567.114,6;
2.3.2	Përforcimi i puseve	kg	214.000,00	1,49	318.860,00
2.4	Ndërtimi i mikropilotave RC me diametër Ø40				
2.4	Furnizim materiali, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit të bazamentit C30/37 për themelet e krahëve anësorë dhe këmbëve të urës (pamakët e mikropilotave)	m ³	57,88	148,65	8.603,34
2.4.2.	Transport i pajisjeve, zhvendosje e pajisjeve, gërmim material për pilotat dhe ndërshtresimi dhe përforcimi i betonit të pilotave.	m	9.292,00	70,00	650.440,00
2.43.	Përforcimi i pilotave	kg	56.432,82	1,49	84.084,90
2.5	Furnizim materiali, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit C30/37 për muret e krahëve anësorë dhe krahëve të urës	m ³	1.545,03	209,46	323.622,60
2.6	Furnizim materiali, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit C30/37 për ndërtimin e këmbëve duke përdorur kallëpe betoni rreshqitëse	m ³	2.137,50	220,00	470.250,00
2.7	Furnizim materiali, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit C30/37 për ndërtimin e soletave të tranzicionit prapa krahëve anësorë të urës	m ³	53,16	155,41	8.261,60
2.8	Furnizim materiali, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit C50/60 për ndërtimin e kuadrateve mbajtës	m ³	13,00	608,11	7.905,40
2.9	Furnizim dhe ndërshtresim i përforcimit për të gjithë pjesët e nënstrukturave (përveç puseve)	kg	1.158.672,27	1,35	1.564.207,50
2.10	Mbrojtje me veshje antigeryese (polimerike ose të ngjashme) për të gjithë elementet e betonit të nënstrukturës të ekspozuar ndaj ujit.	m ²	2.200,00	30,00	66.000,00

TOTAL PUNIME BETONI

3.	PUNIME TË TJERA NË NËNSTRUKTURA				
3.1.	Hidroizolim i sipërfaqeve të betonit në kontakt me tokën	m ²	3980,98	12,16	48.408,70
3.2.	Furnizimi, transporti dhe				
3.2.1.	Mbështetëse kupë V8000 kN / H1500 kN / Dx +220 -220mm	copë	4,00	8.783,78	35.135,10
3.2.2.	Mbështetëse kupë V8000 kN Dx +220 -220mm	copë	4,00	8.783,78	35.135,10
3.3.	Ndërtimi i këmbëve ndihmëse RC për ndërtimin me konsolë të superstrukturës	copë	0,00	74.162,16	0,00
3.4.	Shembje, transport dhe depozitim në këmbët ndihmëse	copë	0,00	11.351,35	0,00
	TOTALI PUNIME TË TJERA NË NËNSTRUKTURA				118.679,00
1.	PUNIME DHEU				743.730,00
2.	PUNIME BETONI				4.187.481,40
3.	PUNIME TË TJERA NË NËNSTRUKTURA				118.679,00
	TOTALI PUNIME NË NËNSTRUKTURA				5.049.890,40
B.	SUPERSTRUKTURA				
4.	PUNIME BETONI				
4.1.	Furnizim material, prodhim dhe ndërshtresimi i betonit C40/50 për ndërtimin e superstrukturës së paranderur RC Çmimi përfshin të gjithë skelat dhe kallëpet e nevojshme, furnizimin, montimin, lëvizjen, çmontimin dhe transportimin.	m ³	8.000,00	400,00	3.200.000,00
4.2.	Furnizim material, prodhimi dhe ndërshtresimi i betonit C30/37 për ndërtimin e trotuareve (përfshirë barrierat e sigurisë "New Jersey")	m ³	442,00	140,00	61.880,00

4.3.	Furnizim dhe ndërshtresim i përforcimit për të gjithë elementet e superstrukturës	kg	1.000.000,00	1,35	1.350.000,00
4.4.	Furnizim, instalim, paranderje dhe injektim i kllapave nga çeliku i gradës së lartë së bashku me të gjithë pjesët e kërkuara dhe pajisjet. Çeliku është i cilësisë f02/fz = 1670/1860 N/mm2.	kg	480.000,00	7,79	3.739.200,00
TOTAL PUNIME BETONI					8.351.080,00
5.	PUNIMET PËRFUNDIMTARE DHE PAJISJET E URËS				
5.1.	Vendosja e hidroizolimit mbi sipërfaqet e përgatitura të shtrojës së soletës. Hidroizolimi përfshin veshje me rrëshirë epokside (përdorimi 0,5 kg/m2), kristal kuarci me granulim 0,7 mm (përdorimi 0,7 kg/m2), emulsion bituminoz 2,5 kg/m2, shirita bituminoz 5mm të trasha të vendosura me procedurë të nxehtë.	m ²	7.330,00	22,97	168.370,10
5.2.	Shtresë mbrojtëse me asfalto-beton AB 11s, 4 cm i trashë.	m ²	6.980,00	9,48	66.170,40
5.3.	Shtresë e konsumueshme me stuko ndarese, 4 cm i trashë.	m ²	6.980,00	10,88	75.942,40
5.4.	Mbushja e bashkimeve (2 cm e gjerë) ndërmjet asfaltit dhe bordurës së trotuarit, dhe ndërmjet asfaltit dhe kompensatorëve të bymimit	m	1.410,00	6,76	9.531,60
5.5.	Furnizimi, instalimi dhe mbrojtja antikorrozive e barrierave të sigurisë prej çeliku (mbrojtje antikorrozive për mjedisin C5I dhe C5M galvanizim me të nxehtë + dy shtresa veshje mbrojtëse)	m	0,00	270,27	0,00
5.6.	Furnizimi, përgatitja dhe instalimi i kompensatorëve të bymimit të hidroizoluar me lëvizje +-240mm (si MAGEBA D480)	m	44,00	2.567,57	112.973,00
5.7.	Furnizimi, përgatitja dhe instalimi i repers për monitorimin e deformimit së bashku me lidhjen me rrjetin ekzistues rileyues	copë	24,00	67,57	1.621,68

5.8.	Furnizimi dhe futja e tubave PVC me diametër 100mm në soletën për shërbimet komunale.	m	2.200,00	10,81	23.782,00
5.9.	Furnizimi, transporti dhe ndërshtresimi i granitit 18/26 cm bordurë së bashku me llaçin.	m	2.200,00	81,08	178.376,00
5.10.	Furnizimi dhe futja e ullukëve të kullimit së bashku me tubat e kullimit deri të kolektori kryesor.	copë	60,00	1.621,62	97.297,20
5.11.	Furnizimi dhe futja në beton e tubave të kullimit	m	650,00	202,70	131.755,00
5.12.	Furnizimi dhe futja në beton e kornizave parafabrikat (elementi i skajit)	m	1.200,00	229,73	275.676,00
5.13.	Ndërtimi i soletës së shtrojës ndërmjet krahë shpatet e krahëve anësorë	m ²	310,00	40,54	12.567,40
5.14.	Ngarkesa e testit	LS	1,00	10.000,00	10.000,00
5.15.	Skicat sipas rregulloreve, në 6 kopje	LS	0,00	0,00	0,00
5.16.	Projektimi dhe instalimi i pajisjeve për monitorimin e urës gjatë përdorimit (përforcimi, lagështia, zhvendosja e përgjithshme, lëvizja e kompensatorëve të bymimit, përshpejtimi, tensioni) së bashku me stacionin e energjisë ose furnizimin me energji diellore.	LS	1,00	400.000,00	400.000,00

**PUNIMET PËRFUNDIMTARE DHE PAJISJET E URËS TOTAL
TOTALI PUNIME PËRFUNDIMTARE**

1.564.062,80

**PERMBLEDHJA E PUNIMEVE MBI
SUPERSTRUKTURËN**

4. PUNIME BETONI **8.351.080,00**

5. PUNIMET PËRFUNDIMTARE DHE PAJISJET E URËS **1.564.062,80**

TOTAL PUNIME SUPERSTRUKTURE **9.915.142,80**

TOTAL PERMBLEDHJE		
0.	PROJEKTIMI	
A.	PERMBLEDHJA E PUNIMEVE MBI NËNSTRUKTURË	
1.	PUNIME DHEU	743.730,04
2.	PUNIME BETONI	4.187.481,43
3.	PUNIME TË TJERA NË NËNSTRUKTURA	118.679,03
	TOTALI PUNIME NË NËNSTRUKTURA	5.049.890,41
B.	RIKAPITULLIMI I PUNIMEVE MBI SUPERSTRUKTURË	
4.	PUNIME BETONI	8.351.080,00
5.	PUNIMET PËRFUNDIMTARE DHE PAJISJET E URËS	1.564.062,81
	TOTALI PUNIME NË SUPERSTRUKTURA	9.915.142,81
	TOTAL	14.965.033,31
	TVSH	
	TOTALI ME TVSH	

Vetëm ata artikuj në tabelën e mësipërme të cilët janë hijezuar me të kuqe janë subjekt i rregullimit sipas paragrafit 15.1.2. të Kontratës së Koncesionit

Shtojca 8

Propozimet e Koncesionarit

Pjesa 1: Propozime për punime të Koncesionarit



Pjesa 2: Propozime për shërbime të Koncesionarit



Shtojca 9

Pikat hyrëse-dalëse në Autostradë

Drejtimi: Milot – Morine (Ana e djathte)

Pika 0+000 është fillimi i rrugës pas rrethrotullimit të Milotit

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
1	0+100	100	Zhavorr	Shitës	x			
2	1+000	20	Zhavorr	Shitës	x			
3	2+300	3	Asfalt	Shtëpi			x	
4	2+390	2	Zhavorr	Shtëpi			x	
5	3+000	2	Zhavorr	Shtëpi			x	
6	4+300	100	Asfalt	Shitës	x			
7	4+600	20	Asfalt	Shtëpi-Kafe			x	
8	5+040	70	Asfalt	Stacion karburanti Eida			x	
9	5+300	10	Zhavorr	Rruge dheu	x			
10	5+770	10	Zhavorr	Rruge dheu	x			
11	7+700	100	Asfalt	Shitës		x		
12	8+300	4	Zhavorr	Shtëpi			x	Nuk ka mundësi tjetër për të hyrë në shtëpi
13	8+450	4	Zhavorr	Rrugë		x		
14	8+500	100	Zhavorr	Bar Restorant "Bledi"			x	
15	8+600	8	Zhavorr	Rrugë				Rrugë lidhëse
16	8+700	4	Asfalt	Shtëpi			x	
17	9+900	100	Asfalt	Stacion karburanti "Gulf"			x	
18	10+300			Dalje në drejtimin Peshkopi				
19	11+300	20	Zhavorr	Punishte			x	Ka nevojë për parrmakë
20	11+500	200	Zhavorr	Punishte			x	Ka nevojë për parrmakë

X

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
21	12+550	4	Zhavorr	Shtëpi				
22	12+600	4	Zhavorr	Shtëpi				
23	12+650	4	Zhavorr	Shtëpi				
24	12+700	4	Zhavorr	Shtëpi				
25	12+800	6	Asfalt	Shtëpi				
26	12+900	4	Zhavorr	Shtëpi				
27	13+000	4	Zhavorr	Shtëpi				
28	13+050	3.5	Zhavorr	Shtëpi				
29	13+100	4	Zhavorr	Shtëpi				
30	13+150	50	Zhavorr	Bar Restorant			x	
31	13+200	6	Asfalt	Rrugë fshati				
32	13+250	4	Zhavorr	Shtëpi				
33	13+350	3.8	Beton	Shtëpi				
34	13+600	5.5	Beton	Shtëpi				
35	13+700	2	Zhavorr	Shtëpi				
36	13+800	6	Zhavorr	Gërmimi prerë			x	
37	14+100	20	Asfalt	Hyrja në HECin e ri			x	
38	14+200	82	Asfalt	Dalje nga HECi			x	
39	15+100	6	Zhavorr	Shtëpi				
40	15+600	10	Zhavorr	Dalje nga kantieri			x	
41	16+600		Zhavorr	Dalje për Rubik nga Tirana				
42	16+600		Asfalt	Dalje për Rubik				
43	17+200	6	Zhavorr	Rruge dheu - Shtëpi			x	Hyrje-Dalje për grup Shtëpish
44	17+500	6	Zhavorr	Rruge dheu - Shtëpi			x	Hyrje-Dalje për grup Shtëpish
45	19+100	5.3	Zhavorr	Shtëpi				
46	19+120	6.5	Beton	Shtëpi				
47	19+350	30	Asfalt	Dalje nga Rubik (e dyta)				
48	19+550	6	Asfalt	Rruga e vjetër për Kukës				

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
49	20+150	150	Beton	Stacion karburanti Erando			x	
50	20+350	7	Asfalt	Punime ndërtimi			x	
51	21+400	30	Zhavorr	Fushë	x			
52	21+800	50	Zhavorr	Fushë	x			
53	22+100	6	Zhavorr	Rrugë kantier punimi			x	
54	22+500	100	Zhavorr	Bar - Kafe			x	
55	23+100	4	Asfalt	Rruga për në mbikalim metali			x	
56	23+400	1	Zhavorr	Rruge dheu			x	
57	23+600	80	Zhavorr	Parking për Stacion karburanti			x	
58	24+500	6	Zhavorr	Punime ndërtimi			x	
59	26+800	100		Dalje për Rreshen				
60	27+900	3	Zhavorr	Fushë	x			Prerje parmaku
61	31+700	2	Zhavorr	Fushë	x			Prerje parmaku
62	39+400	6	Zhavorr	Dalje ne River	x			
63	43+100	200	Zhavorr	Fushë			x	Para sacion karburanti "NBT"
64	46+000	120	Asfalt	Stacion karburanti" Kastrati"			x	
65	47+850	50	Zhavorr	Shtëpi	x			
66	49+700	3	Zhavorr	Rruge dheu-Shtëpi	x			
67	50+500	6	Zhavorr	Rruge dheu	x			
68	52+000	2	Zhavorr	Fushë	x			
69	52+600	2	Zhavorr	Në drejtim të lumit	x			
70	53+300	3	Zhavorr	Rrugë fshati	x			
71	54+200	5	Zhavorr	Pronë, furnizim me ujë	x			

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
72	56+100	5.5	Zhavorr	Shtëpi	x			(direkt pas urës)
73	58+300	15	Zhavorr	Fushë	x			
74	59+600		Asfalt	Dalje për Fan				
75	62+900	4	Zhavorr	Punishite	x			
76	66+150	110	Beton	Stacion karburanti" 1111"			x	
77	69+700	4	Zhavorr	Rruge dheu	x			
78	70+600	6	Zhavorr	Shitës	x			Para tunelit
79	77+200	8	Beton	Rruge dheu	x			Prerje parmaku
80	79+400	2	Zhavorr	Rruge dheu	x			Prerje parmaku
81	80+400		Zhavorr	Fushë	x			Prerje parmaku por nuk është larguar
82	85+300	30	Asfalt	Nga njëra anë e korsisë në tjetrën			x	(Interchange do të ndërtohet)
93	85+500	6	Zhavorr	Parking		x		
94	85+600	5	Zhavorr	Fushë		x		
95	86+600	8	Zhavorr	Fushë		x		
96	91+000	6	Asfalt	Lidhje me rrugën e vjetër				
97	91+050	6	Asfalt	Rrugë e shkurtër	x			
98	92+100	4	Zhavorr	Shtëpi në kodër			x	
99	92+450	50	Zhavorr	Bar " Oruci"		x		
100	92+600	4.5	Zhavorr	Bar café		x		
101	92+900	100	Asfalt	Stacion karburanti " Oruci"		x		
102	93+900	6	Zhavorr	Rruga për liqen		x		
103	94+150	100	Beton	Bar-Restorant " DRINI"			x	
104	94+200	1	Asfalt	Nga njëra anë e korsisë në tjetrën	x			Prerje në parmakun e mesëm
105	95+380	4	Zhavorr	Pronë			x	

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
106	95+700	50	Zhavorr	Pronë		x		
107	97+100			Dalje për Kukës				
108	97+500	4	Zhavorr	Shtëpi	x			
109	97+800	80	Zhavorr	Pronë Bar Kafe Muja			x	
110	98+000	6	Asfalt	Rrugë lidhëse				
111	98+200	4	Zhavorr	Pronë	x			
112	98+500	4	Zhavorr	Rrugë lidhëse				
113	98+550	4	Zhavorr	Rrugë lidhëse		x		
114	98+750	4	Zhavorr	Në drejtim të fshatit		x		
115	98+780	4	Zhavorr	Shtëpi		x		
116	98+800	2	Zhavorr	Shtëpi		x		
117	98+900	2	Zhavorr	Shtëpi		x		
118	98+950	50	Zhavorr	Rrugë fshati +Punishte			x	
119	99+100		Zhavorr	Punishte		x		
120	100+000	4	Zhavorr	Rrugë dheu	x			
121	100+600	5.5	Asfalt	Rrugë dheu - Shtëpi		x		
122	102+250	4	Zhavorr	Shtëpi		x		
123	102+300	4.5	Zhavorr	Shtëpi		x		
124	103+450	70	Zhavorr	Parking car		x		
125	104+500	250	Asfalt	Stacion karburanti "Elda"			x	
126	105+000		Zhavorr	Dalje ne Gjegjan				
127	105+600	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
128	106+000	4	Beton	Shtëpi			x	
129	106+200	4.5	Zhavorr	Shtëpi		x		
130	106+400	4	Beton	Pronë			x	
131	106+500	4.5	Zhavorr	Shtëpi		x		
132	106+250	2	Zhavorr	Shtëpi		x		
133	107+250	4	Zhavorr	Dalje ne Bardhoc				
134	107+350	4	Zhavorr	Rruge dheu		x		
135	107+800	2	Zhavorr	Pronë		x		
136	108+500	6	Zhavorr	Bar Restorant "				

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
				JNK"				
137	108+850	120	Beton	Stacion karburanti IP			x	
138	109+200	4	Zhavorr	Pronë		x		
139	109+500	4,5	Zhavorr	Pronë		x		
140	109+900	4	Zhavorr	Rruge dheu		x		
141	111+100	120	Zhavorr	Dalje për Morine			x	
142	111+600	4	Zhavorr	Pronë		x		
143	112+000	6	Zhavorr	Pronë		x		
144	112+300	4	Zhavorr	Pronë		x		
145	112+350	2	Zhavorr	Shtëpi		x		
146	112+550	4	Zhavorr	Shtëpi		x		
147	112+300	4.5	Zhavorr	Rruge dheu	x			
148	113+400	20	Beton	Kafe Restorant Dogana Morine			x	

Drejtimi: Morine Milot

(Ana e djathtë)

Pika 0+000 është menjëherë pas doganës së Morinës (fundi i parmakëve të mesit) =

Ch.113+400

ID	Kilometrazhi	Gjatësia	MATERIALI RRUGOR (NGJITUR ME RRUGEN)	Te con ne	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
1	0+000	4	Zhavorr	Fushë	x			
2	0+100	6	Asfalt	Bar Restorant			x	
3	0+250	4	Asfalt	Dalje nga Bar Restorant			x	
4	0+280	4	Zhavorr	Fushë	x			
5	0+700	50	Asfalt + Zhavorr	Dalje nga Punishte		x		
6	1+400	20	Beton	Bar Restorant " Sylaj" brothers			x	
7	2+000	100	Asfalt	Hyrje dhe dalje e Komunës Terthore			x	

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
8	2+800	250	Beton	Stacion karburanti "Kastrati"			x	
9	3+200	4	Zhavorr	Fushë	x			
10	3+810	6	Zhavorr	Rrugë e vjetër	x			
11	3+900	100	Asfalt	Rrugë fshati		x		
12	5+400	5	Asfalt	Rrugë fshati		x		
13	5+900	100	Zhavorr	Fushë	x			
14	6+500	5	Asfalt	Shtëpi		x		
15	6+550	6	Zhavorr	Shtëpi		x		
16	7+050	4	Zhavorr	Bar Restorant			x	
17	7+900	6	Zhavorr	Fushë	x			
18	8+350	6	Zhavorr	Dalje për Gjegjan		x		
19	8+400	6	Zhavorr	Fushë	x			
20	8+500	6	Asfalt	Dalje		x		
21	8+600	6	Asfalt	Dalje		x		
22	9+000	200	Beton	IP Stacion karburanti			x	
23	10+700	20	Zhavorr	Bar Kafe		x		
24	10+900	4	Zhavorr	Shtëpi		x		
25	12+000	3.5	Zhavorr	Rruge dheu		x		
26	12+600	8	Zhavorr	Rrugë për në fshat		x		
27	14+000	4	Zhavorr	Rrugë për në fshat		x		
28	14+200	4	Zhavorr	Dyqan I vjetër, Shtëpi	x			
29	14+600	6	Zhavorr	Dalje për në fshat		x		
30	15+300	4	Zhavorr	Lidhje me rrugën e vjetër				
31	15+550	4	Zhavorr	Rrugë paralele	x			
32	15+800	150	Beton	"Gulf" Stacion karburanti			x	
33	16+000	8	Asfalt	Hyrje në Kukës		x		
34	19+600	4	Zhavorr	Shtëpi		x		
35	20+100			Hyrje për në				

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
				Kukes				
36	20+300	100	Beton	Stacion karburanti "Oruci"		x		
37	20+450	50	Zhavorr	Bar Kafe		x		
38	20+500	100	Beton	Bar Restorant "Oruci"		x		
39	20+700	100	Zhavorr	Kantier punimi		x		
40	20+900	4	Zhavorr	Kantier punimi		x		
41	21+000	4	Zhavorr	Kantier punimi		x		
42	22+150	4	Zhavorr	Kantier punimi	x			
43	22+200	100	Zhavorr	Kantier punimi	x			
44	22+700	6	Zhavorr	Bar Restorant			x	
45	23+200	4	Zhavorr	Dalje	x			
46	23+400	10	Zhavorr	Lidhje për në rrugën e vjetër				
47	24+600	100	Zhavorr	Fushë	x			
48	27+600	200	Asfalt	Stacion karburanti+Bar kafe			x	
49	27+700	50	Beton	Bar Kafe			x	
50	27+900	100	Asfalt	Shkembimi i Kalimashit		x		
51	36+500	4	Zhavorr	Fushë	x			
52	36+700	100	Zhavorr	Shitës	x			
53	36+900		Asfalt	Hyrja në zyrat e mirëmbajtjes së tunelit				
54	42+600	4	Asfalt	Hyrje dalje në ndërtesë të vjetër	x			
55	43+900	4	Zhavorr	Në drejtim të lumit	x			
56	44+300	4	Zhavorr	Devijim	x			
57	45+400	10	Zhavorr	Shtëpi + Business			x	

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
58	52+100	10	Zhavorr	Dalje për Fan				
59	52+550	200	Zhavorr	Ndërtesë në process ndërtimi			x	Parmaku nuk është larguar
60	53+300	1	Zhavorr	Rrugë fshati			x	
61	54+700	400	Beton	Stacion karburanti "Boci"+Caffe+Restorant			x	
62	57+050	2	Zhavorr	Shtëpi e vjetër	x			
63	62+700	4	Zhavorr	Në drejtim lumi	x			
64	64+200	4	Ëood bridge	Pronë+ Shtëpi	x			
65	65+050	4	Beton bridge	Shtëpi	x			
66	67+100	6	Zhavorr	Fushë	x			
67	69+200		Asfalt	Dalje ne Reps				
68	69+800	200	Beton	Stacion karburanti" NBT			x	
69	79+900	4	Zhavorr	Fushë		x		
70	82+150	4	Zhavorr	Fushë		x		
71	85+500		Asfalt	Dalje për Rreshen				
72	86+700	4	Zhavorr	Në drejtim lumi	x			
73	88+400	100	Zhavorr	Hyrje dalje në HEC			x	
74	89+350	150	Asfalt	Stacion karburanti "Toma"			x	
75	89+550	50	Zhavorr	Rruge dheu-Shtëpi	x			
76	89+850	50	Beton	Bar Restorant			x	
77	90+000	10	Zhavorr	Shtëpi	x			
78	90+100	10	Zhavorr	Shtëpi	x			
79	90+150	10	Zhavorr	Shtëpi	x			
80	90+300	6	Zhavorr	Në drejtim të kodrës	x			
81	90+350	6	Zhavorr	Shtëpi	x			
82	90+550	6	Zhavorr	Rruge dheu+Shtëpi	x			

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
83	90+700	6	Beton	Bar Restorant			x	
84	91+200	50	Zhavorr	Ndërtesë në proces ndërtimi			x	
85	92+200	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
86	92+650	50	Zhavorr	Bar Kafe			x	
87	92+750	8	Asfalt	Shtëpi			x	
88	92+950	6	Beton	Shtëpi			x	
89	93+000	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
90	93+050	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
91	93+100	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
92	93+400	150	Beton	Bolv Oil Stacion karburanti			x	
93	95+600	4	Zhavorr	Në drejtim lumi	x			
94	95+600	100	Zhavorr	Bar Kafe			x	
95	95+700		Asfalt	Dalje ne Rubik				
96	96+400	200	Beton	Bar Restorant			x	
97	97+400	10	Zhavorr	Rruge dheu	x			
98	97+800	100	Zhavorr	Bar Restorant			x	
99	98+600	50	Beton	Bar Kafe			x	
100	98+650	50	Zhavorr	Bar			x	
101	98+800	6	Zhavorr	Fushë	x			
102	98+900	10	Zhavorr	Dalje tëk lumi	x			
103	99+700	4	Zhavorr	Devijim për Shtëpi			x	
104	99+750	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
105	99+850	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
106	99+900	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
107	99+950	6	Asfalt	Shtëpi			x	
108	100+000	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
109	100+200	4	Zhavorr	Shtëpi				
110	100+300	100	Zhavorr	Fushë	x			
111	100+400	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
112	100+450	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
113	100+500	150	Beton	Stacion karburanti (Xhixho)				

ID	Vendndodhja	Gjatësia(m)	Materiali rrugor (ngjitur me rrugën)	Të con në	Kategoria e parë	Kategoria e dytë	Kategoria e tretë	Komente
114	101+700	100	Beton	Kantier punimi	x			
115	102+010	6	Asfalt	Kantier punimi	x			
116	102+450	50	Zhavorr	Kantier punimi	x			
117	102+700	8	Beton	Business			x	
118	102+800	100	Beton	Stacion karburanti "IT Oil"			x	
119	103+100	20	Zhavorr	Kantier punimi			x	
120	104+600	10	Zhavorr	Në drejtim të lumit	x			
121	104+700	8	Zhavorr	Shtëpi			x	
122	106+800	10	Zhavorr	Në drejtim të lumit	x			
123	107+600	30	Zhavorr	Fushë	x			
124	108+400	15	Zhavorr	Fushë	x			
125	108+600	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
126	108+700	30	Zhavorr	Kantier punimi		x	x	
127	108+900			Dalje për Lezha				
128	110+010	6	Asfalt	Shtëpi			x	
129	112+100	4	Zhavorr	Shtëpi			x	
130	112+300	200	Beton	"Kasmi Oil" Stacion karburanti			x	



Shtojca 10

Modeli financiar

Jepet më vete.



Shtojca 11

Lejet dhe licencat ekzistuese

1. Leje Mjedisore për Segmentin 1
2. Leje Mjedisore për Segmentin 2
3. Leje Mjedisore për Segmentin 3



Shtojca 12

Sigurimet e nevojshme

KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURIMIN

Koncesionari merr dhe mban mbulimet e mëposhtme me sigurim, në çdo moment gjatë periudhës së Ndërtimit, nëpërmjet policave dhe nga sigurues dhe risigurues të pranueshëm për Huadhënësit dhe për Autoritetin Kontraktues, sipas kushteve të mëposhtme:

PJESA 1 – SIGURIMET PËR NDËRTIMIN

SIGURIMI I KONCESIONARIT GJATË PERIUDHËS SË NDËRTIMIT

1. Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim

Mbulimi : Punimet e kontratës të realizuara dhe gjatë realizimit materialet dhe punimet provizore, për sa kohë janë në Territorin e Projektit, nga të gjitha rreziqet që shkaktojnë humbje ose dëme materiale.



Shuma e siguruar : Një shumë e mjaftueshme për të paguar kërkesat për dëmshpërblim në bazë të restaurimit dhe jo më të vogël se [•] për qind e Punimeve kapitale [mbetet për t'u përcaktuar nga Koncesionari dhe për t'u aprovuar nga Huadhënësit].

Shumat e zbritshme : Në lidhje me çdo ngjarje të ndodhur, gjatë periudhës së ndërtimit dhe kolaudimit:

- i) Nga tërmeti
Jo më shumë se
1.250.000 €
- ii) nga stuhia, shtrëngata, përmytja,
dëmtimi nga uji, cunami,
shembja e tokës
Jo më shumë se
[•] € [mbetet për t'u
përcaktuar nga
Koncesionari dhe
pranohet nga
Huadhënësit]
- ii) nga çdo shkak tjetër
Jo më shumë se
[•] € [mbetet për t'u
përcaktuar nga

Koncesionari dhe
pranohet nga
Huadhënësit]

- Periudha e mbulimit :** Fillon me Njoftimin për fillimin sipas parashikimeve të bëra në [Nënkontratën e ndërtimit] dhe vazhdon gjatë projektimit, prokurimit, përgatitjes së kantierit, ndërtimit, kolaudimit, vënies në punë dhe deri në vënien në shfrytëzim të plotë, plus [•] muaj periudhë garancie nga Nënkontraktori ndërtimor.
- Person i siguruar :** Koncesionari, Nënkontraktori ndërtimor dhe furnitorët e Koncesionarit dhe të Nënkontraktoreve ndërtimorë.
- Të përgjithshme :**
- a) Mbulimi përfshin kalimin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të mallrave dhe materialeve të marra me prokurim lokal.
 - b) Dëmet do të paguhen në monedhën me të cilën ka lindur kostoja, pra euro, dollar amerikan ose monedha e vendit.
 - c) Siguruesit dhe risiguruesit heqin dorë nga të gjitha të drejtat e regresit (rikthimit) kundrejt secilës prej palëve të specifikuara këtu.
 - d) Përfshin mbulimin për projektimin me defekt, për aq sa ofrohet ky mbulim.
 - e) Shuma e siguruar do të llogaritet me koston e plotë të zëvendësimit dhe do të përfshijë çdo 'material pa pagesë' që i furnizohen Koncesionarit.
 - f) Polica duhet të përfshijë edhe një rubrikë mbi përgjegjësinë ndaj palëve të treta me kufi minimal dëmshpërblimi prej 20.000.000 € qe mbetet për t'u përcaktuar nga Koncesionari dhe pranohet nga Huadhënësit] dhe duhet të përfshijë kryqëzim të plotë të përgjegjësive mes palëve të siguruara.
 - g) Mbulimi CAR do të përmbajë një dispozitë për dëm të fshehtë 50/50.
 - h) Sigurimi do të parashikojë për sa më poshtë:
 - Grevat, turbullirat dhe trazirat civile (SRCC);
 - Kryqëzim i përgjegjësive mes palëve të siguruara;
 - Zgjatje e periudhës së mirëmbajtjes;
 - Grafikon e ndërtimit dhe/ose ngritjes;
 - Punë jashtë orarit, punë gjatë natës, punë gjatë festave zyrtare dhe transport ekspres të mallrave;
 - Objekte në zona tërmeti;
 - Klauzolë 72-orëshe për rreziqet madhore;
 - Largim i ujërave;
 - Testim i makinerive dhe instalimeve;



- Kabllot, tubat dhe objektet e tjera nëntokë;
- Bimët bujqësore, pyjet dhe kulturat;
- Seksionet;
- Kampet & magazina;
- Materiale ndërtimi;
- Masa mbrojtëse në lidhje me reshjet, përmytjet dhe mbulimin nga uji;
- Largimin e inerteve;
- Objektet zjarrfikëse dhe mbrojtjen kundër zjarrit në kantierin e ndërtimit;
- Tranzitin në tokë;
- Riskun e projektuesit;
- Pronat ekzistuese;
- Vibrimet/dobësitë e strukturave mbajtëse;
- Punimet për themel piloti dhe mure mbajtëse;
- Riskun e prodhuesit (për instalimet e/m);
- Impiante dhe pajisje ndërtimi.

Kushte të veçanta

I siguruari merr të gjitha masat përkatëse për të mbrojtur palët e treta nga ndonjë aksident/dëm gjatë realizimit të punimeve.

2. Sigurimi kundër humbjeve të shkaktuara nga përfundimi me vonesë i projektit (ALOP)

- Mbulimi** : Pagesat e lindura pas vonimit në fillimin e operacioneve të Projektit si rezultat i drejtpërdrejt i humbjes ose dëmtimit fizik të mbuluar nga Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim.
- Shuma e siguruar** : Të ardhurat nga taksa e rrugës bruto ose një shumë të paktën e barabartë me shlyerjen e borxhit gjithsej dhe shpenzimet fikse gjatë Periudhës së dëmshpërblimit.
- Periudha e dëmshpërblimit** : 12 muaj nga data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve për sheshet e taksës
- Person i siguruar** : Koncesionari dhe Huadhënësit.
- Shuma e zbritshme** : Jo më shumë se 30 ditë.
- Të përgjithshme** : Mbulimi duhet të mbulojë moslejimin e hyrjes; mbulim për klientët dhe furnitorët, sipas rastit.

3. Të ndryshme

Sigurime të tjera sipas zakonit, dëshirës apo nevojës në përmbushje të kërkesave vendore ose kërkesave të tjera, si sigurimi i përgjegjësisë kontraktore, sigurimi i kompensimit të punonjësve dhe përgjegjësisë së punëdhënësve në lidhje me të gjithë punëtorët e punësuar në ndërtimin e Projektit dhe sigurim i përgjegjësisë për të gjitha automjetet e zotëruara, të marra me qira, të

dhëna me qira, të përdorura ose të marra hua për përdorim në Republikën e Shqipërisë në lidhje me Projektin.

PJESA 2 - SIGURIMET PËR SHFRYTËZIMIN

Koncesionari merr dhe mban mbulimet e mëposhtme me sigurim, në çdo moment gjatë periudhës së Koncesionit, nëpërmjet policave dhe nga sigurues dhe risigurues të pranueshëm për Huadhënësit dhe për Autoritetin Kontraktues, sipas kushteve të mëposhtme:

1. Sigurimi i objekteve të ndërtimit pas përfundimit (CECR)

Mbulimi : Të gjitha aktivet që përbëjnë Projektin, duke përfshirë, ndër të tjera, ndërtesat me çfarë kanë brenda, makineritë, inventarin, pajisjet mbërthyesë, pajisje të tjera të vogla dhe të gjitha pasuritë e tjera vetjake nga "të gjitha rreziqet" e humbjes ose dëmit material, ku përfshihen zjarri, rrufeja, shpërthimi, rreziqet natyrore (përmytja, tërmeti etj.), terrorizmi & sabotimi, grevat, trazirat civile dhe avaria e makinerive.

Shuma e siguruar : Një shumë e mjaftueshme për të kthyer në gjendjen e mëparshme pronën [mbetet për t'u përcaktuar nga Koncesionari dhe pranohet nga Huadhënësit].

Shumat e zbritshme : Jo më shumë se 250.000 € përveç tërmetit, rast në të cilin mund të jetë 1.000.000 €

Person i siguruar : Koncesionari dhe Huadhënësit.

Të përgjithshme : Të përfshijë një klauzolë për heqje dorë nga të drejtat e regresit (rikthimit) nga siguruesit dhe risiguruesit kundrejt secilës prej palëve të specifikuar këtu.

2. Ndërprerja e biznesit (operimit)

Mbulimi : Humbja e të ardhurave si rezultat i drejtpërdrejt i humbjes ose dëmtimit të Porjektit, të mbuluar nga neni 1 më sipër.

Shuma e siguruar : Të ardhurat nga taksa e rrugës bruto ose një shumë të paktën e barabartë me shlyerjen e borxhit gjithsej dhe shpenzimet fikse gjatë Periudhës së dëmshpërblimit.

Periudha e dëmshpërblimit : 12 muaj

Person i siguruar : Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Huadhënësit.

Shuma e zbritshme : Jo më shumë se 30 ditë.



Të përgjithshme : Të përfshijë një klauzolë për heqje dorë nga të drejtat e regresit (rikthimit) nga siguruesit dhe risiguruesit kundrejt secilës prej palëve të specifikuar këtu.

Mbulim për klientët dhe furnitorët, sipas rastit.

3. **Sigurimi i përgjegjesisë ligjore ndaj palëve të treta/publikut/produktet**

Mbulimi : Përgjegjësia ligjore e palëve të siguruara për vdekjen ose dëmtimin trupor të palëve të treta ose për humbjen ose dëmtimin e pasurive të tyre, që lind nga pasja në pronësi, shfrytëzimi, përdorimi ose mirëmbajtja e Projektit.

Kufiri i dëmshpërblimit : Përcaktohet në marrëveshje me Huadhënësit por jo më pak se [•] € [mbetet për t'u përcaktuar nga Huadhënësit kur të afrohet data e përmbylljes financiare] për çdo ngjarje (e shprehur si shumë agregate në lidhje me Përgjegjësinë për produktet dhe risqet e ndotjes).

Shumat e zbritshme : Jo më shumë se 200.000 €

Person i siguruar : Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Huadhënësit.

Të përgjithshme : Të përfshijë:
një klauzolë për heqje dorë nga të drejtat e regresit (rikthimit) nga siguruesit dhe risiguruesit kundrejt secilës prej palëve të specifikuar këtu;
një klauzolë për kryqëzim të përgjegjësive mes palëve të siguruara;
[një klauzolë për vlefshmëri territoriale në të gjithë botën;]
rrjedhje të papritur dhe aksidentale, ndotje dhe kontaminim, dhe kostot e lindura për pastrimin.



3. **Të ndryshme**

Sigurime të tjera,

- a) sipas zakonit apo nevojës në përmbushje të kërkesave vendore ose kërkesave të tjera, si sigurimi i përgjegjesisë kontraktore, sigurimi i kompensimit të punonjësve dhe përgjegjesisë së punëdhënësve në lidhje me të gjithë punëtorët e punësuar në ndërtimin e Projektit ose në lidhje me shfrytëzimin e tij; sigurim i përgjegjesisë për të gjitha automjetet e zotëruara, të marra me qira, të dhëna me qira, të përdorura ose të marra hua për përdorim në Republikën e Shqipërisë në lidhje me Projektin;
- b) që konsiderohen nga Koncesionari si të dëshirueshme ose të nevojshme në kuadër të maturisë, ose që kërkohen nga Huadhënësit ose Autoriteti Kontraktues, si sigurimi i anëtarëve të këshillit të administrimit dhe sigurimi i nëpunësve; ose

- c) në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

TË PËRGJITHSHME

- a) Koncesionari kujdeset që çdo policë e blerë në përputhje me këtë shtojcë të parashikojë:

- i) Kalimin e të drejtave të policave tek Huadhënësit dhe Autoriteti Kontraktues;
- ii) klauzolë për të drejtën e të siguruarit për t'iu drejtuar direkt risiguruesit/për kalimin e të drejtave për fondet nga risigurimi;
- iii) që policat nuk duhen të anulohen, të lihen të skadojnë, të pezullohen apo të ndryshohen lidhur me aspektet materiale pa njoftim paraprak me shkrim (të paktën 30 ditë) Huadhënësve [dhe Autoritetit Kontraktues] dhe pa marrë miratimin e tyre, ose brenda një periudhe më të shkurtër që mund të përcaktohen më pas në lidhje me luftën dhe rreziqet e lidhura;
- iv) që mbrojtja që u jepet Huadhënësve në bazë të policave nuk shfuqizohet nga asnjë veprim apo mosveprim nga ana e Koncesionarit apo e Nënkontraktorëve apo nën-Nënkontraktorëve të tij, për aq sa për këtë mbrojtje konsulenti i sigurimeve ka rënë dakord se është i mundshëm në mënyrë të arsyeshme; dhe
- v) që Autoriteti Konkurrues nuk është përgjegjës përpara siguruesve ose risiguruesve për pagimin e primeve të sigurimit apo për detyrime të tjera të Koncesionarit.

- b) Koncesionari merr dhe u vë në dispozicion Huadhënësve dhe Autoritetit Kontraktues, letërgarancite nga siguruesi/siguruesit dhe brokeri, me formën dhe përmbajtjen e pranueshme për Huadhënësit [dhe Autoritetin Kontraktues], ku trajtohet, ndër të tjera, njoftimi që i bëhet Autoritetit Kontraktues në rast se siguruesit dhe brokerat marrin dijeni për fakte që mund të prekin mbulimin sipas policës, konfirmimi i pagimit të primit dhe çdo ndryshim i mbulimit, marrjes ose shoqërisë së sigurimit.

- c) Çdo policë e bërë në bazë të kësaj shtojce:

- i) mbahet pranë siguruesve dhe risiguruesve të tillë me reputacion, sipas aprovimit të marrë nga Huadhënësit dhe/ose Autoriteti Kontraktues;

- ii) ka formë dhe përmbajtje në përputhje me detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj shtojce, sipas aprovimit që mund të merret nga Huadhënësit dhe/ose Autoriteti Kontraktues dhe

- iii) nuk përfshin asnjë dispozitë për vetësigurim ose për fond të mbajtur në vetësigurim me përjashtim për aq sa parashikohen shumat e zbritshme të përcaktuara në Shtojcën 12.

d) Koncesionari u vë në dispozicion Huadhënësve dhe Autoritetit Kontraktues informacionet që mund t'i kërkohen në mënyrë të arsyeshme (si, ndër të tjera, dokumentet origjinale të policës dhe provë që dëshmon pagimin e primeve.

e) Nëse në çdo moment dhe për çdo arsye sigurimi që kërkohet të mbahet në bazë të kësaj shtojce nuk është i vlefshëm dhe në fuqi, pa cenuar të drejtat e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që prej atij momenti të sigurohet me shpenzimet e Koncesionarit.

f) Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron në mënyrë të arsyeshme që, si pasojë e një ndryshimi me rëndësi materiale në ekspozimin e identifikuar ndaj riskut, ndonjëri prej kushteve, vlerave dhe shumave të zbritshme të sigurimit të marrë në bazë të kësaj shtojce është i pamjaftueshëm ose i papërshtatshëm, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Koncesionari të marrë sigurime të ndryshuara dhe/ose shtesë sipas nevojës për të mbuluar ndryshimin me rëndësi materiale në fjalë.



Shtojca 13

Detyrat kryesore të Inxhinierit të pavarur

Roli i Inxhinierit të pavarur

Inxhinieri i pavarur (IP) kontraktohet nga Autoriteti Kontraktues (AK) për të menaxhuar dhe përmirësuar disa aspekte të caktuara të Kontratës së Koncesionit, kryesisht në lidhje me verifikimin e përmbushjes nga Koncesionari të Kërkesave teknike të Autoritetit Kontraktues (Kërkesat e Investitorit, KI).

Në përgjithësi, roli i Inxhinierit të pavarur duhet të zgjerohet për të mbuluar funksione për cilat Autoriteti Kontraktues nuk është plotësisht i pajisur.

Inxhinierit të pavarur konsulent i kërkohet të ofrojë ekspertizë në të gjitha fushat e Koncesionit pa përjashtim. Çdo aspekt i ecurisë së Koncesionit duhet t'i nënshtrohet certifikimit në bazë të Sistemeve të tij të cilësisë dhe auditimit sa i takon cilësisë në lidhje me rezultatet e Koncesionarit me cilësi të siguar dhe kontrolluar. Për këtë arsye dhe në mbështetje të funksioneve që duhet të kryejë Inxhinieri i pavarur duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm, i cili duhet të zotërojë njohuritë e duhura të fushës. Si minimum, personeli i Inxhinierit të pavarur duhet të përfshijë specialitetet e mëposhtme:

- Kryeinxhinier
- Inxhinier të kontrollit të cilësisë
- Inxhinier të materialeve
- Gjeolog
- Inxhinier gjeoteknik
- Inxhinier strukturor
- Inxhinier trafiku
- Inxhinier mjedisor
- Specialist informatike
- Gjeometër
- Inspektor

Roli i Inxhinierit të pavarur është certifikimi i pavarur punës konform kërkesave dhe që çdo punë bëhet nëpërmjet sigurimit të cilësisë/kontrollit të cilësisë të Koncesionarit, sic mund të jetë e nevojshme herë pas here, në përputhje me udhëzimet ekzekutive të Autoritetit Kontraktues për të konfirmuar dhe/ose korigjuar ecurinë.

Inxhinierit të pavarur mbikëqyr dhe kontrollon, nëpërmjet Sistemeve të veta të cilësisë, ecurinë e Koncesionarit. Inxhinieri i pavarur kryen auditim të kontrollit të cilësisë sipas nevojës (në bazë të variancës statistikore të ecurisë së Koncesionarit), për të konfirmuar certifikatën e përputhshmërisë të Koncesionarit.

Nëse certifikata e Inxhinierit të pavarur për punën e Koncesionarit, si për Koncesionarin ashtu edhe për Autoriteti Kontraktues, thotë se ka mosplotësim, atëherë Sistemet e cilësisë të Koncesionarit duhet të diktojnë që puna të korigjohet/përsëritet.

Më me hollësi, Inxhinieri i pavarur ndërmerr funksionet e mëposhtme:

I-Funksione të përgjithshme

1. kryen kontrole të përgjithshme, auditon dhe asiston në prova ose hetime në lidhje me Punimet ose Shërbimet, duke pasur në çdo moment liri të pakufizuar për të hyrë në çdo territor ose punishte ku prodhohen materiale, në varësi të ndjekjes së të gjitha procedurave përkatëse të sigurisë;
2. mbikëqyr plotësimin nga Koncesionari të dispozitave të Kontratës së Koncesionit, me përshtatjet përkatëse që lejon Kontrata, dhe informon menjëherë Autoritetin Kontraktues dhe Koncesionarin nëse konstatohet mosplotësim;
3. ka liri të pakufizuar hyrjeje në Territorin e Projektit në çdo moment të arsyeshëm gjatë të gjithë Periudhës së Kontratës në mënyrë që të kryejë funksionet e tij;
4. ka të drejtë të hyjë në çdo pronë që përdor Koncesionari për realizimin e Punimeve dhe Shërbimeve, për të kontrolluar ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Projektit dhe për të ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Koncesionari;
5. ka të drejtë të hyjë në çdo moment në çdo pronë të përdorur nga Koncesionari si objekt trajnimi ose punishte dhe në vendet ku përgatitet puna ose nxirren materialet për Projektin, për ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Koncesionari;
6. ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet ku diskutohet ecuria mujore ose me shpeshtësi tjetër në lidhje me Punimet dhe/ose Shërbimet dhe të marrë njoftim në kohën e duhur për këto mbledhje nga Koncesionari;
7. ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të të gjitha skicave, lidhjeve, specifikimeve dhe shtojcave, pas çdo modifikimi që u bën Koncesionari;
8. ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të ndreqë çdo defekt në plotësimin e detyrimeve në bazë të Kontratës dhe të vlerësojë se sa janë korrigjuar këto defekte;
9. ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të largojë nga Territori i Projektit çdo agjent ose punëmarrës të Koncesionarit ose çdo Nënkontraktor të cilitdo nivel, sipas rastit, që, sipas mendimit të Inxhinierit të Pavarur, bën shkelje ose është i paaftë ose tregon pakujdesi në kryerjen siç duhet të detyrave në lidhje me Projektin, ose prania e të cilëve konsiderohet e padëshirueshme në Territorin e Projektit;
10. përgatit një raport të plotë për "kushtet ekzistuese" për të gjithë Autostradën jo më vonë se [2 (dy) muaj] pas emërimit të tij dhe e përditëson këtë raport çdo muaj gjersa Koncesionari të arrijë Përmbylljen financiare. Ky raport përmban vlerësimin e Inxhinierit të pavarur për studimin e korrektësisë teknike të kryer për llogari të Autoritetit Kontraktues si edhe studimin e tij shtesë të korrektësisë teknike, në lidhje me aktivet e Autostradës (shtresat, urat, tuneli i Thirrës, elementet gjeoteknike). Raporti vlerëson si projektin ashtu edhe ndërtimin e këtyre aktiveve, duke përmendur në veçanti rastet e defekteve të fshehta të mundshme që mund të

cenojnë Autostradën gjatë viteve të para të Koncesionit. Inxhinieri i pavarur jep hollësi të mjaftueshme për vlerësimet e tij dhe përfshin arsyetim bindës të mbështetur në dëshmitë e mbledhura në rastet kur argumentet e tij bien ndesh me raportet ekzistuese të studimit të korrektesës teknike. Inxhinieri i pavarur e përditëson raportin çdo muaj duke ruajtur të njëjtin nivel hollësie në çdo version të përditësuar;

11. konsultohet me Palët për çdo çështje që ka të bëjë me Punimet dhe Shërbimet;
12. u jep raporte ose informacione Autoritetit Kontraktues, Huadhënësve madhorë ose palëve të tjera të interesit të projektit, pasi ua paraqet këto raporte dhe informacione Palëve dhe pasi ka marrë në konsideratë komentet e tyre (për aq sa duhet);
13. shqyrton shfuqizimin ose ndryshimin me ndikim negativ të të gjithave ose disave prej Dokumenteve të projektit dhe jep kundërshtimin e vet për këtë nëse është nevoja;
14. sa herë i kërkohet të japë vendim, opinion ose pëlqim apo të shprehë bindjen ose aprovimin e tij ose të kryerje veprime të tjera që mund të prekin të drejtat dhe detyrimet e Palëve të përfshira ("Konstatim"), nëse nuk parashikohet ndryshe, Inxhinieri i pavarur e bën këtë Konstatim sapo ta ketë të mundur dhe në çdo rast brenda afatit të parashikuar në Kontratën e Koncesionit dhe/ose në Kërkesat e Autoritetit Kontraktues sipas çështjes në fjalë dhe i komunikon komentet që mund të ketë në lidhje me këtë Konstatim brenda afatit përkatës;
15. jep vlerësim mospranues për raportet që janë mbështetur në informacione ose të dhëna të gabuara ose që nuk janë në përputhje me këtë Kontratë;
16. ka të drejtë të shikojë, auditojë dhe marrë kopje të evidencave të Koncesionarit në çdo moment;
17. e ndryshon adresën pasi i ka njoftuar Palët e përfshira.

II-Funksione të veçanta në lidhje me Aspektet e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe Kontratën e Koncesionit

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

1. Aprovon dhe jep komente për projekt-versionin e hollësishëm të Manualit të kontrollit të cilësisë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen.
2. Këqyr dhe auditon Sistemin e menaxhimit të cilësisë të Koncesionarit dhe planet e lidhura të cilësisë, përfshirë edhe ato të projektuesve, Nënkontraktorëve dhe furnitorëve të tij, në intervalet që i konsideron të arsyeshme Inxhinieri i pavarur.
3. Shqyrton dokumentacionin e cilësisë në përputhje me dispozitat e klauzolës 18.1.3 të Kontratës së Koncesionit.
4. Aprovon dhe komenton për Sistemet përkatëse të cilësisë të hartuara nga Koncesionari përpara fillimit të çdo pjese të Punimeve ose Shërbimeve dhe përditësimet e tyre gjatë Periudhës së vlefshmërisë së Kontratës.
5. Ka të drejtë të shikojë evidencat e plota të njësisë së dedikuar të monitorim-kontrollit ("Njësia e kontrollit të cilësisë") për Sistemin e menaxhimit të cilësisë të Koncesionarit për informacionet e përditësuara në lidhje me përmbushjen e Kërkesave për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen dhe ecurinë e punimeve të ndërtimit.
6. Merr pjesë së bashku me menaxherin e projektit të Koncesionit në kontrollet zyrtare dhe të parashikuara me grafik të niveleve të shërbimit që zhvillohen rregullisht (siç përcaktohet në seksionin 7 të Shtojcës 5) dhe që realizohen nga Njësia e kontrollit të cilësisë.
7. Bën të ditur se kur duhen ndaluar punimet për të mundësuar që Inxhinieri i pavarur të bëjë këqyrje sidomos për ato gjëra që mund të fshihen nga vazhdimi i punimeve.

Shfrytëzimi dhe Mirëmbajtja e Autostradës

1. Aprovon dhe jep komente për projekt-versionin e hollësishëm të:
 - Manualit të kontrollit të cilësisë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen
 - Manualit të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen
 - Manualit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes rutinë
 - Manualit ose manualeve të kontrollit dhe monitorimit
 - Planit të administrimit mjedisor
2. Bie dakord, shqyrton përditësimet vjetore dhe aprovon ndryshimet për dispozita të posaçme për kërkesat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen në lidhje me tunelet të cilat janë pjesë e Manualit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.
3. Bie dakord për vendndodhjet e propozuara nga Koncesionari për ndërtimin e Qendrës ose Qendrave të kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.
4. Aprovon zbatimin e zgjidhjeve të propozuara të Koncesionarit për mundësimin e kërkesave të komunikimit të pajisjeve dhe instalimeve në Autostradë.
5. Shqyrton dhe aprovon justifikimin e paraqitur nga Koncesionari për devijimin nga afatet e kundërpërgjigjeve për shkak të kushteve të ashpra të motit.
6. Bie dakord dhe këshillon për nevojën dhe kohën e instalimit si edhe për llojin e saktë dhe vendndodhjen e objekteve të menaxhimit të trafikut në rrugë.
7. Bie dakord dhe këshillon për formatin dhe përmbajtjen e të dhënave dhe protokollet e komunikimit që duhet të përdorë Koncesionari për të vënë në dispozicion në mënyrë elektronike vazhdimisht të dhëna dhe statusin e të gjitha pajisjeve të komunikimit rrugor si pjesë e objekteve të menaxhimit të trafikut.
8. Ndhmon Koncesionarin për përgatitjen dhe aprovon procedurat për mbylljen ose kufizimin e të gjitha karrexhatave, korsive të emergjencës dhe bordeve ("Procedurat për mbylljen e korsive").

9. Merr kopje të konfirmimit të pëlqimit të autoritetit përkatës të autostradës që Koncesionari të përdorë një rrugë devijimi në oraret dhe datat e propozuara për shkak të mbylljes së rrugës.
10. Miraton (së bashku me policinë) gamën e shërbimeve në rast aksidenti.
11. Konsultohet me Koncesionarin për instalimin e pikave të përhershme të numërimit të trafikut në segmentin I dhe III të Autostradës.
12. Miraton formën e mbledhjes automatike të statistikave të trafikut në pikat e numërimit të trafikut.
13. Bie dakord për saktësinë e matjes të pajisjeve të matjes së trafikut.
14. Merr pjesë në negociatat ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me instalimin e objekteve/pajisjeve të matjes së ngarkesës për aks, nëse Koncesionari ka detyrimin ose lejohet që të instalojë pajisje të tilla, ku Autoriteti Kontraktues ofron mbështetjen policore për ekzekutimin me forcë të rezultatit të matjeve/verifikimeve të lidhura me këtë pikë.
15. Bie dakord për formën e mbledhjes automatike dhe për saktësinë e matjes të statistikave për ngarkesën për aks të automjeteve.
16. Diskuton dhe jep miratimin për përmbytjen dhe formën e të dhënave dhe protokolleve të komunikimit që duhet të përdorë Koncesionari në mënyrë që pikat e matjes së trafikut dhe të ngarkesës për aks të përpilojnë statistika dhe t'ia transmetojnë ato automatikisht një Qendre të kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.
17. Bashkëpunon me Koncesionarin për projektimin dhe zbatimin e masave për parandalimin e shkeljeve të taksës së rrugës (objekte dhe pajisje).
18. Merr raporte dhe evidenca për çdo situatë të rrezikshme që ndodh gjatë operacioneve të Shesheve të taksës.
19. Merr raporte dhe evidenca për çdo mashtrim të mbetur në tentativë gjatë operacioneve të Shesheve të taksës.
20. Jep miratim për kohën e përfundimit të masave ndreqëse në lidhje me vonesat në sheshet e taksës (kur nuk është afati 7-ditor që kërkohet zyrtarisht).
21. Aprovon ose komenton për Planin në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme për shkaqe gjeoteknike që është përgatitur nga Koncesionari.
22. Merr raportet dhe evidencat e Koncesionarit për situatat e jashtëzakonshme.
23. Konsultohet me Koncesionarin në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të situatave të jashtëzakonshme në varësi të llojit të tyre.
24. Aprovon projekt-versionin e hollësishëm, versionin përfundimtar dhe përditësimet e përvitshme të Planit të mirëmbajtjes gjatë dimrit të Koncesionarit.
25. Bie dakord dhe jep aprovimin për shfrytëzimin e teknologjive të ngjashme ose të përmirësuara që duhen përdorur për matjen gjeodezike të Autostradës.
26. Merr raporte tremujore nga Koncesionari ku përshkruhen me hollësi punimet e realizuara në tremujorin e fundit dhe programet e mirëmbajtjes që propozohen për të ardhmen.
27. Bie dakord për mënyrën e raportimit të parametrave të gjendjes së shtresave të rrugës.
28. Këshillon për hetimet shtesë që duhen kryer në lidhje me kushtet ekzistuese gjeoteknike dhe rreziqet urgjente të mundshme në rastet kur materiali rrëshqitës është më i madh se 200 metra kub.
29. Identifikon bashkërisht me Koncesionarin riparimet e përhershme të shpateve që duhen kryer nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues përpara stinës së ardhshme të shirave.
30. Verifikon sasinë e materialit për rrëshqitje që është më shumë se 200 metra katror (vëllimi matet me matje topografike).
31. Aprovon kohën shtesë të nevojshme për riparimin strukturor të tobinave sipas justifikimit të Koncesionarit.
32. Aprovon dhe auditon programin që po zbatohet për kontrollet e tunelit, mirëmbajtjen pasvepruese dhe atë rutinë (parandaluese) që verifikohet me anë të një programi të plotë vetëkontrolli nga Koncesio

33. Bie dakord dhe shqyrton çdo vit përditësimet e programit të plotë të mirëmbajtjes rutinë dhe riparimit kapital për tunelet e reja.
34. Aprovon ndryshimet që i bëhen programit të mirëmbajtjes parandaluese të Koncesionarit në rast se nuk arrihen objektivat e parashikuar në tabelat 3-5, 3-6 & 3-7 të seksionit 3.5.5 të Shtojcës 5.
35. Bie dakord për Larjen e veshjes së brendshme të tunelit gjatë muajve të dimrit.
36. Bie dakord dhe shqyrton çdo vit shpeshhtësinë e larjes së veshjes së brendshme të tunelit gjatë fazës fillestare të ciklit të shfrytëzimit.

Sistemet e kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit

1. Këshillon për kohën e lejuar për riparimet e defekteve në rastet kur këto riparime janë të nevojshme dhe nuk mund të përfundohen brenda kriterit të paracaktuar prej 24 orësh.
2. Jep këshilla dhe orientime për përcaktimin e intervaleve kohore për kontrollet e përgjithshme të tuneleve.
3. Jep këshilla dhe orientime për kontrollet e strukturave në lidhje me përmbushjen e standardeve shqiptare dhe evropiane dhe të Praktikës së mirë të sektorit ekonomik, si edhe sistemin e menaxhimit të strukturave.
4. Aprovon projekt-propozimin e hollësishëm për zhvillimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës.
5. Aprovon/konfirmon demonstrimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës.
6. Aprovon sistemet e menaxhimit me licencë të blerë.
7. Aprovon programin e kontroll-monitorimit gjeoteknik për vitin e ardhshëm (përfshirë metodikën, format dhe procedurat) që është pjesë e raportit gjeoteknik vjetor.



Punimet kapitale dhe Riparimet kapitale

1. Bashkërendon dhe mbikëqyr Punimet kapitale dhe/ose Riparimet kapitale, që merr përsipër Autoriteti Kontraktues dhe/ose nënkontraktori i Autoritetit Kontraktues gjatë kohëzgjatjes së Koncesionit, të cilave duhet t'u bëjë vend Koncesionari.
2. Jep rekomandime (shitesë) për standardet e projektimit që duhen përdorur në propozimet e reja si edhe në përgatitjen e të gjitha projekteve kryesore përfundimtare të elementeve të Punimeve kapitale nga Koncesionari.
3. Aprovon paketën e plotë të standardeve të projektimit për secilin element të Punimeve që ka përpiluar Koncesionari përpara fillimit të çdo projekti teknike kryesor përfundimtar.
4. Aprovon shmangiet nga standardet dhe normat e konfirmuara të projektimit, si edhe nga projektet paraprake dhe/ose të hollësishme, që mund të jenë me përfitim për Autoritetin Kontraktues dhe për Projektin sa i takon sigurisë rrugore, efikasitetit të shfrytëzimit, ekonomisë në ndërtim dhe mirëmbajtjes, programit të ndërtimit, jetëgjatësisë së përgjithshme, përmbushjes së standardeve të reja ndërkombëtare dhe harmonizimit me BE-në në të ardhmen.
5. Konfirmon miratimin e tij për propozim-projektin me shkrim me t'u arritur marrëveshja për këtë.
6. Shqyrton dhe aprovon shtesat dhe ndryshimet në propozim-projektin e pranuar të paraqitura nga Koncesionari si shtojca përpara fillimit të punës për aspektet e punimeve që preken nga shtojca në fjalë.
7. Kontrollon efektin që kanë Objektet e përkohshme tek struktura e përhershme (por nuk kontrollon Objektet e përkohshme).
8. Aprovon verifikuesin e pavarur të Objekteve të përkohshme.
9. Shqyrton vlefshmërinë e projektit dhe verifikon certifikatat e të gjitha Objekteve të përkohshme.
10. Shqyrton dhe pranon (ose refuzon) projektin e plotë përfundimtar për elementet e Punimeve kapitale që duhet të përfshijnë

11. Kërkon dhe përdor manualin e projektimit si tekst të plotë mbështetës dhe dokument efikas pune.
12. Komenton dhe aprovon programin e punës për projektet teknike të paraqitura nga Koncesionari për të gjitha elementet që përbëjnë Punimet kapitale.
13. Merr, komenton dhe aprovon (ose jo) programin e përditësuar të punës për projektet teknike gjatë rrjedhës së Projektit.
14. Shqyrton propozim-projektet e paraqitura, në konsultim me Autoritetin Kontraktues. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i pavarur:
 - aprovon materialin e paraqitur,
 - jep aprovim të kushtëzuar që kërkon bërjen dhe përfshirjen e rishikimeve në skicat e punës ose
 - refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues dhe/ose kriteret e projektimit.
15. Shqyrton skicat teknike të punës të paraqitura. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i pavarur:
 - aprovon materialin e paraqitur,
 - refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues dhe/ose kriteret e projektimit ose me komentet e bëra nga Inxhinieri i pavarur si pjesë e aprovimit të kushtëzuar të propozim-projektit.
16. Monitoron Punimet në përputhje me Kontratën e Koncesionit sipas klauzolës 16.3.
17. Merr dhe aprovon planin e menaxhimit të trafikut të paraqitur nga Koncesionari përpara fillimit të Punimeve për cilëndo pjesë të Territorit të Projektit që ka ndikim tek përdorimi i rrugëve publike ose private.
18. Aprovon shmangien nga standardet dhe normat në lidhje me specifikimet teknike që është me përfitim për Autoritetin Kontraktues sa i takon sigurisë rrugore, efikasitetit të shfrytëzimit dhe jetëgjatësisë.
19. Merr dhe aprovon planin për menaxhimin e ndërtimit të Punëve kapitale për të gjitha Aspektet e punëve kapitale.
20. Aprovon programin e hollësishëm për projektimin dhe ndërtimin e punimeve për çdo Aspekt të punimeve kapitale të paraqitur nga Koncesionari.
21. Aprovon raportet mujore të ecurisë dhe përditësimet e programit sipas kërkesave.
22. Merr pjesë në procesin vjetor të konsultimeve dhe aprovimeve në lidhje me realizimin e Punimeve kapitale në bazë të datave të paracaktuara të fillimit dhe përfundimit (ose datave të kushtëzuara të fillimit dhe data përkatëse të përfundimit, sipas rastit).
23. Aprovon listën dhe objektin e punimeve fillestare të stabilizimit të shpatit, siç përshkruhet në klauzolën 32.A.1 të Kontratës së Koncesionit dhe Shtojcë 6.
24. Aprovon projektin e hollësishëm të Koncesionarit për ndërtimin e urës së re mbi lumin Drin në bazë të koncept-projektit që ka dhënë Autoriteti Kontraktues. Riskun e projektimit e mban vetëm Koncesionari.
25. Aprovon ose jep "mospasje kundërshtimi" për planet trevjeçare të Riparimeve kapitale dhe programet vjetore të punës të Koncesionarit, në varësi të llojit të komponentit të Autostradës dhe kohës kur bëhen Punimet e riparimeve kapitale gjatë Periudhës së Koncesionit.

Menaxhimi dhe vlerësimi i ecurisë

1. Monitoron dhe raporton për ecurinë e Koncesionarit kundrejt kërkesave kontraktore në bazë të Relacioneve mujore/Relacioneve vjetore të ecurisë (sipas klauzolës 24.1 të Kontratës së Koncesionit), Manualit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes (sipas seksionit 3.1.4 të Shtojcës 5), planit

- për menaxhimin e ndërtimit të Punëve kapitale (sipas seksionit 6.1.5 të Shtojcës 5), planeve trevjeçare të riparimeve kapitale dhe programeve vjetore të riparimeve kapitale (sipas seksionit 6.3.1 të Shtojcës 5), Sistemeve të cilësisë (sipas seksionit 2 të Shtojcës 5) dhe Sistemi i menaxhimit mjedisor (sipas seksionit 5 të Shtojcës 5) që japin informacionet e nevojshme për drejtimin.
2. Ndërmerr auditime të palës së dytë të Sistemeve të cilësisë dhe disa auditime teknike të punimeve faktike.
 3. Ndërmerr auditime teknike të Shërbimeve dhe Punimeve të monitoruara nga Njësia dedikuar e kontrollit të cilësisë e Koncesionarit.
 4. Lehtëson numërimin e periudhave të mbylljes së korsive në rastet e punimeve që janë programuar dhe aprovuar nga Inxhinieri i pavarur.
 5. Ka të drejtë të rrisë, me shpenzimet e Koncesionarit, nivelin ose shpeshtësinë e monitorimit, auditimit, testimit dhe inspektimit të Autostradës dhe respektimit nga Koncesionari të detyrimeve të veta në bazë të kësaj Kontrate, në atë nivel që Autoriteti Kontraktues ose Inxhinieri i pavarur e konsideron të përshtatshëm, sipas klauzolës 21.9.5 të Kontratës së Koncesionit, në rastet kur:
 - a. Koncesionarit i llogariten më shumë se 50 Pikë ecurie në një periudhë njëvjeçare; ose
 - b. më shumë se 100 Pikë ecurie në një periudhë trevjeçare.
 6. Lehtëson numërimin e Pikëve të ecurisë për segmentet/pjesët e Autostradës për të cilat Inxhinieri i pavarur verifikon defektet e identifikuar nga Koncesionari pas shqyrtimit dhe aprovimit të programit përkatës të propozuar për rehabilitimin në mënyrë që të sillen brenda standardeve të pritura të Autostradës.

Kthimi

1. Ndryshon dhe/ose aprovon propozimet për punimet rinovuese që duhen kryer nga Koncesionari në 5 (pesë) vitet e fundit të Kontratës në mënyrë që të përmbushen Kërkesat për kthimin.
2. Ndërmerr bashkërisht me Koncesionarin një inspektim 6 (gjashtë) muaj përpara Datës së përfundimit të vlefshmërisë ("Vrojtimi përfundimtar për kthimin") në mënyrë që të konstatohen se çfarë punimesh rinovuese mbeten pa u bërë.
3. Bashkërendon me Koncesionarin për ndërmarrjen prej tij të një vlerësimi të plotë të gjendjes ("Vrojtimi fillestar për kthimin") dhe përgatit një plan vlerësimi për kthimin që do të përdoret për të përcaktuar ecurinë dhe jetën e mbetur të Autostradës.
4. Mund të udhëzohet nga Autoriteti kontraktues të kryejë një inspektim të Autostradës për të konstatuar nëse Koncesionari po i përmbush apo jo kërkesat e kësaj Kontrate dhe në veçanti nëse do të përmbushen Kërkesat për kthimin brenda Datës së përfundimit të vlefshmërisë ("Shqyrtimi fillestar për kthimin").
5. Shqyrton dhe aprovon planin e vlerësimit për kthimin përpara fillimit të çdo pune nga Koncesionari.
6. Konsultohet me Koncesionarin në lidhje me përditësimin e planit të vlerësimit për kthimin sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet e kushteve të aktiveve të projektit ose të metodikës së vlerësimit të përcaktuara pas inspektimit të Autostradës nga Autoriteti Kontraktues ose nga personi i caktuar prej tij.
7. Shqyrton dhe aprovon procedurat e hollësishme të testimit dhe inspektimit sipas kërkesave të Pjesës 8 të Shtojcës 5 dhe përditësimet e tyre për çdo përvjetor të tyre.
8. Bashkërendon me Koncesionarin të gjitha aspektet e planit të punimeve rinovuese për kthimin.
9. Merr në dorëzim dokumentacionin nga Koncesionari ku bëhet e ditur se Koncesionari i ka përmbushur udhëzimet dhe i ka përmbushur dhe përfunduar detyrimet për çdo ndreqje siç e kërkon legjislacioni shqiptar në lidhje me ato fusha ku është dashur të merren masa ndreqëse për shkak kontaminimi apo derdhjeje lënde djegëse.
10. Identifikon punimet ndreqëse të nevojshme gjatë 18 (tetëmbëdhjetë) muajve të fundit të Kontratës.
11. I asiston Koncesionarit në kryerjen e Vrojtimit përfundimtar për kthimin në mënyrë që të përcaktohen se çfarë punimesh ndreqëse kanë mbetur pa u bërë.

12. Mund të udhëzohet nga Autoriteti kontraktues të kryejë një inspektim të Autostradës për të konstatuar nëse Koncesionari po i përmbush apo jo kërkesat e kësaj Kontrate dhe në veçanti nëse do të përmbushen Kërkesat për kthimin brenda Datës së përfundimit të vlefshmërisë ("Shqyrtimi përfundimtar për kthimin").

Funksione të tjera:

1. Certifikon që Trualli shtesë kërkohet nga Koncesionari për realizimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.
2. Jep opinion për pretendimet e Nënkontraktorëve dhe çdo dokument që lidhet me to.
3. Aprovon dhe komenton Programin fillestar të Koncesionarit (ose shtesat dhe ndryshimet në të).
4. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit paraprak.
5. Kontrollon dhe vërteton se janë përfunduar Punimet e nevojshme për shfrytëzimin pa rrezik të Autostradës.
6. Vlerëson rezultatin e procedurës së dorëzimit teknik dhe konstaton nëse Koncesionari i ka përmbushur të gjitha Kërkesat e Autoritetit Kontraktues për punimet, ose informon Koncesionarin për çdo kundërshtim.
7. Konsulton Koncesionarin me qëllim arritjen e një marrëveshjeje për masat që kërkohet të merren në mënyrë të arrihet përmbushja e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues në rast se ka kundërshtim.
8. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit përfundimtar.
9. Kontrollon dhe vërteton se Punimet janë përfunduar dhe se kushtet e përcaktuara në Certifikaten paraprake të Përfundimit janë përmbushur.
10. Përcakton se çfarë shtesash dhe ndryshimesh duhen bërë në Manualet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes në rast se Palët nuk merren vesh për shtesat dhe ndryshimet e duhura.
11. Përcakton shtesat dhe ndryshimet e duhura në Programin e riparimeve kapitale në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
12. Konstaton nëse ka ndodhur ndonjë defekt, shkelje dhe/ose mosplotësim dhe afatin e ndreqjes në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me defektet e identifikuar dhe të nevojshme për t'u ndrequr.
13. Vendos për Truall shtesë alternativ të ngjashëm nëse Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari nuk mund të merren vesh.
14. Ofron zgjidhje konfliktit në rast Mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me shumën e paraqitur në Pasqyrën vjetore të pagesave dhe/ose Pagesa për ecurinë mujore.
15. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me klauzolën 27 të Kontratës së Koncesionit sa u takon ngjarjeve të kompensimit.
16. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të kompensimit (klauzola 27 e Kontratës së Koncesionit).
17. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me klauzolën 28 të Kontratës së Koncesionit sa u takon ngjarjeve të çlirimit nga detyrimi.
18. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të çlirimit nga detyrimi (klauzola 28 e Kontratës së Koncesionit).
19. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me klauzolën 29 të Kontratës së Koncesionit sa u takon ngjarjeve të forcës madhore.
20. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të forcës madhore (klauzola 29 e Kontratës së Koncesionit).
21. Njoftohet me shkrim për pasojat e mundshme të një Ndryshimi cilësues të ligjit që është bërë ose do të bëhet shumë shpejt.
22. Njoftohet pa vonesë të panevojshme për kërkesën e Koncesionarit për të marrë përfitime pas hyrjes në fuqi të Ndryshimit cilësues të ligjit.

23. I vihet në dispozicion një shpjegim i plotë dhe i hollësishëm dhe dëshmi në lidhje me Ndryshimin cilësues të ligjit dhe përfitimet e kërkuara, kohëzgjatjen e çmuar të vonesës në fjalë, çdo informacion përkatës që ka të bëjë me Ndryshimin cilësues të ligjit dhe humbjen e prituri të të ardhurave ose rritjen e kostove që vjen nga Ndryshimi cilësues i ligjit.
24. Ofron marrje vendimi në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me një Ndryshim të Autoritetit Kontraktues të kërkuar në përputhje me klauzolën 32.1 të Kontratës së Koncesionit (Ndryshime të punimeve dhe shërbimeve).
25. Jep opinion për arsyeshmërinë e propozimeve të Koncesionarit në Njoftimin për ndryshim.
26. Përcakton se çfarë shtesash dhe ndryshimesh duhen bërë në rast se Palët nuk merren vesh për shtesat dhe ndryshimet e duhura në Planin gjeoteknik fillestar.
27. Jep pëlqimin që Koncesionari të propozojë dhe zbatojë në çdo moment ndryshime të Planit gjeoteknik fillestar.
28. Aprovon të gjitha Punimet pastruese gjeoteknike në rast situatë të jashtëzakonshme që janë të nevojshme si pasojë e një Situate të jashtëzakonshme gjeoteknike brenda periudhave kohore të parashikuara në tabelën 3-2 të seksionit 3.5.3 të Shtojcës 5.
29. Vlerëson shkakun e Situatës së jashtëzakonshme gjeoteknike dhe përgatit një relacion për Koncesionarin dhe Autoritetin Kontraktues nëse janë të nevojshme punime parandaluese shtesë ("Punime rehabilituese gjeoteknike").
30. Inspekton të gjitha Punimet rehabilituese gjeoteknike.
31. Ofron marrje vendimi nëse është i nevojshëm Plani i restaurimit dhe kur është i nevojshëm ky plan.
32. Ofron marrje vendimi në përputhje me klauzolën 20A në lidhje me Defektet e fshehta.



Shtojca 14

Territori i Projektit

Territori ekzistues i Autostradës

I. "Kufijtë":

skicat e "Kufijve të territorit ekzistues të Autostradës" të përgatitura nga Autoriteti Kontraktues dhe të vëna në dispozicion të Koncesionarit në harddisk si pjesë e Të dhënave të vëna në dispozicion.

II. Kufijtë e territorit të urës mbi Drin

Kufiri i shpronësimit/e drejta e kalimit sipas skicave përkatëse të projektit të hollësishëm të ardhshëm të Koncesionarit.

III. Kufiri i territorit të mbikalimeve

Kufiri i shpronësimit/e drejta e kalimit përfshirë të gjitha rampat hyrëse dhe dalje dhe deri në zonën ku secili mbikalim bashkohet me rrjetin e rrugëve lokale sipas skicave përkatëse të projektit të hollësishëm të ardhshëm të Koncesionarit.

IV. Kufiri i territorit të shesheve të taksës

Kufiri i shpronësimit/e drejta e kalimit sipas skicave përkatëse të projektit të hollësishëm të ardhshëm të Koncesionarit (përfshirë sigurimin e kabinave shtesë të taksës që pritet të jenë të nevojshme gjatë periudhës së koncesionit sipas parashikimit të trafikut në Autostradë).

Shtojca 15



Pjesa 1

Të ardhurat e garantuara nga trafiku dhe pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku

Viti i të ardhurave të garantuara nga trafiku	Të ardhura të garantuara nga trafiku (shifrat tregojnë të ardhurat vjetore të arkëtuara nga taksa e përdorimit të rrugës, në euro)	Pragu për ndarjen e të ardhurave nga trafiku (shifrat tregojnë të ardhurat vjetore të arkëtuara nga taksa e përdorimit të rrugës, në euro)
1.	7,990,800	9.436.700
2.	8,150,600	9,625,400
3.	8,313,600	9,818,000
4.	8,479,900	10,014,300
5.	8,649,500	10,214,600
6.	8,822,400	10,418,900
7.	8,998,900	10,627,300
8.	9,178,900	10,839,800
9.	9,362,500	11,056,600
10.	9,549,700	11,277,700
11.	9,740,700	11,503,300
12.	9,935,500	11,733,400
13.	10,134,200	11,968,000
14.	10,336,900	12,207,400
15.	10,543,600	12,451,500
16.	10,754,500	12,700,600
17.	10,969,600	12,954,600
18.	11,189,000	13,213,700
19.	11,412,800	13,477,900



h

A I

20.	11,641,000	13,747,500
21.	11,873,900	14,022,500
22.	12,111,300	14,302,900
23.	12,353,600	14,589,000
24.	12,600,600	14,880,700
25.	12,852,600	15,178,400
26.	13,109,700	15,481,900
27.	13,371,900	15,791,600
28.	13,639,300	16,107,400
29.	13,912,100	16,429,500
30.	14,190,400	16,758,100
31.	14,332,300	17,093,300



Pjesa 2

Koeficientët mujorë të sezonalitetit

Muaji	Koeficienti i sezonalitetit
janar	0,055
shkurt	0,055
mars	0,065
prill	0,075
maj	0,072
qershor	0,080
korrik	0,135
gusht	0,172
shtator	0,085
tetor	0,067
nëntor	0,064
dhjetor	0,075



Shtojca 16

Plani në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme



Shtojca 17

Lista e miratuar e përdoruesve të përjashtuar

Këto kategori automjete kur udhëtojnë për punë zyrtare janë të përjashtuara nga detyrimi për të paguar Taksën rrugore:

1. Automjetet e Policisë Rrugore
2. Autoambulancat
3. Automjetet e forcave zjarrfikëse
4. Automjetet ushtarake



Pasqyra e përmbajtjes

1	Hyrje	6
1.1	Përshkrim i Autostradës Milot – Morinë ("Autostrada").....	6
1.2	Përmbledhje e kushteve kryesore të Koncesionit	6
1.3	Informacion mbi strukturën, Shërbimet dhe Punimet e Koncesionit.....	7
2	Sistemi i menaxhimit të cilësisë.....	10
2.1	Hyrje	10
2.2	Menaxhimi i cilësisë	11
3	Kërkesat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen.....	12
3.1	Kërkesa të përgjithshme.....	12
3.1.1	Koncepti.....	12
3.1.2	Objekti i shërbimeve.....	12
3.1.3	Përshkrimi i Shërbimeve që kërkohen	12
3.1.4	Manualet	14
3.1.5	Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes	16
3.1.6	Sistemi i komunikimit për situata të jashtëzakonshme	17
3.1.7	Infrastruktura mbështetëse.....	19
3.1.8	Të ndryshme	20
3.2	Kërkesat për shfrytëzimin e rregullt	22
3.2.1	Hyrje	22
3.2.2	Shfrytëzimi i Qendrës së kontrollit të trafikut	22
3.2.3	Shfrytëzimi i objekteve të menaxhimit të trafikut	23
3.2.4	Matja e trafikut.....	25
3.2.5	Shfrytëzimi i shesheve të taksës	27
3.2.6	Ngarkesat jo normale.....	30
3.3	Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja në ngjarje të jashtëzakonshme.....	32
3.3.1	Hyrje	32
3.3.2	Situatat e jashtëzakonshme	32
3.3.3	Trajtimi i incidenteve.....	33
3.4	Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja në stinën e dimrit.....	35
3.4.1	Hyrje	35
3.4.2	Heqja e dëborës.....	36
3.4.3	Mbajtja nën kontroll e akullit.....	37
3.5	Kërkesat për mirëmbajtjen rutinë.....	37
3.5.1	Hyrje	37
3.5.2	Mirëmbajtja e shtresave të rrugës	38
3.5.3	Shtatet, punimet gjeoteknike dhe mirëmbajtja e bordit të paasfaltuar	39
3.5.4	Mirëmbajtja e strukturave.....	43
3.5.5	Mirëmbajtja e tunelit.....	49
3.5.6	Mirëmbajtja e drenazhimit	57
3.5.7	Mirëmbajtja e objekteve të sheshit të taksës.....	59
3.5.8	Mirëmbajtjes e sinjalizimit	60
3.5.9	Mirëmbajtja e objekteve elektrike/mekanike të rrugës	61
3.5.10	Objektet e sigurisë dhe gardhet rrethuese të rrugës	65
3.5.11	Mbajtja në kontroll e bimësisë.....	66
4	Kërkesat e kontrollit dhe monitorimit.....	69
4.1	Kërkesat për kontrollin	69

4.1.1	Hyrje	69
4.1.2	Kontrollet për sigurinë	69
4.1.3	Kontrollet teknike të hollësishme sistematike	69
4.2	Kërkesat për sistemin e monitorimit dhe menaxhimit	78
4.2.1	Hyrje	78
4.2.2	Inventari	78
4.2.3	Sistemet e menaxhimit të infrastrukturës	78
5	Kërkesat mjedisore dhe sociale	81
5.1	Hyrje	81
5.2	Sistemi i menaxhimit mjedisor dhe social	81
5.3	Vlerësimi i efektit mjedisor dhe social	83
5.4	Çështjet mjedisore dhe sociale të trashëguara	83
5.5	Çështjet mjedisore dhe sociale aktuale	83
6	Kërkesat për Punimet kapitale dhe Riparimet kapitale	90
6.1	Dispozita të përgjithshme	90
6.1.1	Hyrje	90
6.1.2	Standardet e projektimit	90
6.1.3	Shqyrtimi dhe miratimi i projekteve	91
6.1.4	Standardet e ndërtimit	94
6.1.5	Metodika dhe programi i projektimit dhe ndërtimit	95
6.2	Kërkesat për punimet kapitale	96
6.2.1	Hyrje	96
6.2.2	Punimet kapitale	96
6.3	Kërkesat për riparimin kapital	98
6.3.1	Hyrje	98
6.3.2	Punimet e riparimit kapital	99
6.3.3	Punimet për kthimin	100
7	Menaxhimi dhe vlerësimi i ecurisë	100
7.1	Hyrje – monitorimi i ecurisë	100
7.2	Sistemi i menaxhimit dhe vlerësimit të ecurisë	101
7.2.1	Projektimi dhe ndërtimi	101
7.2.2	Shërbimet (shfrytëzimi dhe mirëmbajtja)	101
7.2.3	Riparimi kapital	102
7.2.4	Standardet mjedisore/sociale	102
7.3	Sistemi me Pikë për mbylljen e korsive	102
7.3.1	Përkuftizime	102
7.3.2	Përcaktimi i Pikëve për mbylljen e korsive dhe zbritjet për mbylljen e korsive	102
7.4	Sistemi i Pikëve të ecurisë	103
7.4.1	Grafiku i pikëve	103
8	Kërkesat për kthimin	110
8.1	Hyrje	110
8.2	Vrojtimi fillestar për kthimin dhe Plani i vlerësimit për kthimin	111
8.3	Kriteret e testimit dhe kontrollit për Vrojtimin fillestar për kthimin	
8.4	Plani i punimeve rinovuese për kthimin	

8.5	Kërkesat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen.....	112
8.6	Kërkesat për kthimin për komponentët e Autostradës.....	112
8.6.1	Sipërfaqet e shtruara	112
8.6.2	Strukturat	112
8.6.3	Punime gjeoteknike.....	113
8.6.4	Tunelet.....	115
8.6.5	Elementet mekanike dhe elektrike.....	116
8.6.6	Elemente të tjera	117
SHTOJCA 1		119
DOKUMENTACIONI I CILËSISË.....		119
Dokumentacioni i cilësisë i sugjeruar për Koncesionarin		119
Dokumentacioni i cilësisë për Subjektin nëpërgjegjësis për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës (“Subjekti shfrytëzues”)		121
Dokumentacioni i cilësisë për Projektuesin nëpërgjegjësis për përgatitjen e projekteve teknike të Rrugës (“Projektuesi”).....		123
Dokumentacioni i cilësisë për Nënkontraktorin përgjegjësis për ndërtimin e Rrugës (“Nënkontraktori”)		125
Dokumentacione të tjera për cilësinë		127
SHTOJCA 2		128
SIGURIA DHE MENAXHIMI I TRAFIKUT GJATË PUNIMEVE, MIRËMBAJTJES (RUTINË, NË SITUATA TË JASHTËZAKONSHME OSE DIMËRORE) DHE RIPARIMEVE KAPITALE.....		128
1.	Të përgjithshme.....	128
2.	Masat për sigurinë dhe menaxhimin e trafikut	128
3.	Mbylljet e korsive.....	128
4.	Mbylljet e Autostradës dhe rrugët alternative	129
5.	Automjetet e shpëtimit	129
6.	Informimi	129
7.	Niveli i shërbimit.....	130
8.	Evidencat dhe raportimi	130
SHTOJCA 3		131
EVIDENTIMI I DEFEKTEVE.....		143
1. Evidentimi i defekteve		143
1.1	Defektet e kategorisë I	143
1.2	Defekte të tjera	143
1.3	Lista e defekteve të komponentëve të Autostradës të raportuar gjatë kontrollit të hollësishtëm	143
SHTOJCA 4		148
KONTROLI DHE MONITORIMI GJEOTEKNIK		148
1.	Të përgjithshme	148
2.	Kontrollet.....	148
3.	Kontrollet rutinë.....	
4.	Kontrollet në situata të jashtëzakonshme.....	

5.	Kontrollet e hollësishme në terren	149
6.	Monitorimi i lëvizjeve	149
7.	Monitorimi i reshjeve.....	150
8.	Hetimet gjeoteknike të tokës.....	150
9.	Instrumentet dhe matjet	150
10.	Vlerësimi i rezultateve dhe identifikimi/përditësimi i rreziqeve	150
11.	Paraqitja e dokumenteve.....	150
12.	Kostot.....	150
13.	Standardet për kontrollin, monitorimin dhe punimet gjeoteknike	151
SHTOJCA 5		152
KËRKESAT PËR EVIDENCAT DHE RAPORTIMIN.....		152
Pjesa 1: Evidencat		152
1.	Periudha e mbajtjes së projekteve	152
2.	Ndërtimi	153
3.	Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja	154
4.	Proceset ligjore.....	155
5.	Kërkesa shtesë.....	155
Pjesa 2: Raportet.....		156
1.	Projektimi dhe ndërtimi.....	156
2.	Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja.....	157
3.	Informacione të tjera shtesë.....	159
SHTOJCA 6		160
PLANI NË KUNDËRPËRGJIGJE TË SITUATAVE TË JASHTËZAKONSHME PËR SHKAAQE GJEOTEKNIKE		160
1.	Kërkesa të përgjithshme.....	160
2.	Defektet e menjehershme.....	160
3.	Defektet ekzistuese	161

Lista e Tabelave

Tabela 3-1: Parametrat vlerësues për mirëmbajtjen e shtresave të rrugës.....	38
Tabela 3-2: Standardet e mirëmbajtjes për shpatet dhe punimet gjeoteknike	40
Tabela 3-3: Klasifikimi i gjendjes së strukturave.....	43
Tabela 3-4: Nivelet e ecurisë së urave.....	45
Tabela 3-5: Klasifikimi i gjendjes për tunelin (vetëm elementet strukturore)	51
Tabela 3-6: Respektimi i rekomandimeve të prodhuesit në lidhje me pajisjet e monitorim-vlerësimit të tunelit	52
Tabela 3-7: Nivelet e ecurisë së tunelit	52
Tabela 3-8: Kërkesat e ecurisë për bimësinë.....	
Tabela 4-1: Kontrollet teknike	

Tabela 7-1: Pikët e ccurisë	105
Tabela 8-1: Jetëgjatësia e mbetur e elementeve strukturore.....	113
Tabela 8-2: Kërkesat për kthimin për Punimet gjeoteknike	113
Tabela 8-3: Jetëgjatësia e mbetur e elementeve të tjera	117



KËRKESAT TEKNIKE TË AUTORITETIT KONTRAKTUES

I Hyrje

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ("MTI") e Republikës së Shqipërisë ("Shqipëria") ftoi ofertuesit e mundshëm (veçmas, "Ofertues i mundshëm") për realizimin dhe përfundimin e një koncesioni për shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e autostradës Milot – Morinë ("Koncesioni").

1.1 Përshkrimi i Autostradës Milot – Morinë ("Autostrada")

Autostrada është pjesë e rrjetit të rrugëve kombëtare. Duke lidhur Milotin, rreth 60 km në verilindje të Portit të Durrësit në detin Adriatik, me Morinën në kufirin me Kosovën, kjo rrugë formon segmentin qendror të autostradës Shqipëri-Kosovë, që lidh Tiranën dhe Durrësin me Kosovën.

E ndërtuar në disa faza, Autostrada përbëhet nga tre segmente, ndërtuar sipas standardeve të ndryshme inxhinierike:

Segmenti I: segmenti Milot – Rrëshen (26 km) është një rrugë me një karrexhatë dhe dy korsi, e financuar nga Banka Botërore, IDA dhe Fondi i OPEC-ut. Në Milot Autostrada lidhet me rrugën veri-jug Tiranë-Shkodër, e cila lidh kryeqytetin e Shqipërisë me kufirin me Malin e Zi.

Segmenti II: segmenti Rrëshen - Kalimash (60.3 km) është një superstradë me katër korsi, që kalon në terren malor, e ndërtuar nga konsorciumi "Bechtel-Enka", nga prilli i vitit 2007 deri në qershor 2009, me fonde nga buxheti i shtetit. Ky segment përfshin tunelin e Thirrës, një tunel i gjatë 5,6 km dhe i përbërë nga dy galeri paralele.

Segmenti III: segmenti Kalimash – Morinë (28.2 km) është një rrugë e përfunduar në vitin 2011, që kryesisht përbëhet nga dy karrexhata dhe katër korsi me përjashtim të shtatë urave të shkurtra që janë me dy korsi.

Autostrada përfshin këto mbikalime dhe kryqëzime: Milot, Rubik, Rrëshen, Rept, Thirrë dhe Kukës.

Qeveria e Shqipërisë është duke zbatuar/planifikuar punime ndërtimi në i. kryqëzimin në Fushë-Milot (në km 0), që lidh Autostradën me rrugën Tiranë-Shkodër dhe ii. dublimin e 7 urave në segmentin III të Autostradës e organizuar në dy lote ndërtimi [nga këto, 5 ura priten të përfundojnë në Datën e hyrjes në fuqi dhe 2 menjëherë më pas].

1.2 Përmbledhja e kushteve kryesore të Koncesionit
Koncesionari do të jetë përgjegjës për:

- a) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës;
- b) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tunelit të Thirrës;
- c) shfrytëzimin e një sistemi të taksës së rrugës dhe mbledhjen e të ardhurave nga taksa e rrugës; dhe
- d) punimet për stabilizimin e shpatit dhe masat mbrojtëse.

Krahas kërkesave për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen, më lart, Koncesionari është i detyruar të ndërmarrë punimet e mëposhtme të rehabilitimit dhe zgjerimit:

- e) ndërtimi i sheshit të taksës të Tunelit të Thirrës;
- f) vendosja e gardhit rrethues përgjatë segmenteve me dy karrexhata të Autostradës;

g) vendosja e ndriçimit në të gjitha kryqëzimet;

h) ndërtimi/përmirësimi i këtyre mbikalimeve dhe kryqëzimeve: mbikalimi Kalimash, mbikalimi Mamëz, mbikalimi Gjegjan, mbikalim Bardhoc, përmirësimi në km. 109+900&110+390, mbikalimi Morinë, mbikalimi Rexhal dhe rrethrotullimi në km 114+540 [përshkrimi i konfigurimit dhe karakteristikat kryesore të çdo mbikalimi jepen në seksionin 7 të Raportit inxhinierik, si edhe në Shtojcën VII të tij];

i) zbatimi i disa masave të caktuara zbutëse mjedisore [përshkrimi i masave të sugjeruara për të trajtuar çdo çështje mjedisore si ndotja i tokës, menaxhimi i ujërave të bardha, ndotja akustike, mjedisi i gjallesave etj. jepet në dokumentacionin e Projektit];

k) ndërtimi i një ure të re në Kukës, në bazë të koncept-projektit dhe specifikimeve që Autoriteti Kontraktues i ka vënë në dispozicion Koncesionarit gjatë procesit të tenderit;

l) masat korrigjuese në ura, përfshirë edhe rehabilitim e urës ekzistuese mbi lumin Drin, vetëm për aq sa konsiderohet e nevojshme për të përmbushur kërkesat për ecurinë të përcaktuara në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5 deri në përfundimin e urës dhe kalimin e trafikut tek kjo urë [informacioni diagnostikues për gjendjen e urave ekzistuese së bashku me masat korrigjuese të rekomanduara jepen në seksionin 4.1 të Raportit inxhinierik dhe shtojcën I të tij]; rekomandimet specifike për urën ekzistuese mbi lumin Drin jepen në shtojcën I të Lidhjes I]

m) përmirësim i të gjitha lidhjeve të lejuara me Autostradën, si edhe i pikave të palejuara hyrëse-dalëse në Autostradë (kategoria 2 sipas Shtojcës 9), konform Standardeve shqiptare të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve, në mënyrë që në çdo rast të sigurohen kushte të njaftueshme të hyrje-daljes sa i takon gjatësisë së korsisë, sinjalistikës dhe elementeve të tjera projektuese duke mbajtur në konsideratë rrezet, pjerrësinë, shpejtësinë e projektuar dhe çdo parametër tjetër që ndikon tek shikueshmëria dhe siguria; dhe

n) ndërtimin e një ure për këmbësorë në Kukës, sa bashku me masat e tjera të sigurisë [përshkrimi i specifikimeve përkatëse dhe një ideje për zgjidhje jepet në seksionin 5.1 të Raportit inxhinierik.]

1.3 Informacioni mbi strukturën, Shërbimet dhe Punimet e Koncesionit

Detyrimet e mësipërme për shfrytëzimin, mirëmbajtjen, përmirësimin dhe punimet e reja janë përfshirë në kontratën e koncesionit. Në këtë strukturë transaksioni, Koncesionari duhet të ofrojë Shërbimet dhe të ndërmarrë Punimet gjatë një periudhe koncesioni të përcaktuar për 30 vjet, ndërsa Qeveria e Shqipërisë garanton një prag minimal të ardhurash nga trafiku për çdo vit të Koncesionit dhe paguan një subvencion shtesë. Shërbimet përbëhen nga Shfrytëzimi dhe Mirëmbajtja rutinë, si edhe shfrytëzimi i një sistemi të taksës së rrugës.

Sistemi i taksës së rrugës parashikohet, hë për hë, të përfshijë një pikë të pagimit të taksës së rrugës në afërsi të tunelit të Thirrës. Pika e propozuar për sheshin e taksës është në lindje të tunelit, në km:80+712 sipas Studimit përkatës për trafikun dhe taksën e rrugës. Nëse Koncesionari merr orientime ose kërkon ta vendosë diku tjetër sheshin e taksës, kjo duhet të bëhet në përputhje me procesin e parashikuar në klauzolën 10.2 dhe 21.14. Vendimi përfundimtar për vendndodhjen e saktë dhe projektin e sheshit të taksës do të merret bashkërisht me Qeverinë dhe Koncesionarin në bazë të propozimit të Koncesionarit .

Punimet përbëhen nga Punimet kapitale dhe nga Riparimet kapitale për të gjithë Autostradën. Më poshtë jepet një përshkrim i Shërbimeve dhe Punimeve që kërkohet të realizohen:

Shërbime të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes (rutinë)

Vitet aktive: 1-30

Lista e detyrave:

Shfrytëzim dhe mirëmbajtje rutinë e të gjithë Autostradës, përfshirë edhe shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen në ngjarje të jashtëzakonshme dhe gjatë stinës së dimrit: kontroll dhe monitorim i vazhdueshëm i të gjithë komponentëve infrastrukturorë; dhe zhvillim dhe shfrytëzim i sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës të Autostradës (për sipërfaqen e shtruar, urat dhe elementet gjeoteknike), përfshirë hartimin e planeve shumëvjeçare (3-vjeçare) dhe programeve vjetore të zbatimit për punimet e mirëmbajtjes rutinë dhe riparimit kapital.

Punime kapitale:

Vitet aktive: 1-4

Lista e punimeve:

- a) Punime gjeoteknike fillestare në pika specifike të identifikuara nga Autoriteti Kontraktues në Shtojcën 6 të Kontratës së Koncesionit; (vitet 1-4)
- b) Ndërtimi i mbikalimeve dhe i elementeve të tjera gjeometrike: mbikalimi Kalimash, mbikalimi Mamëz, mbikalimi Gjegjan, mbikalimi Bardhoc, përmirësimi në km. 109+900 dhe 110+390, mbikalimi Morinë, mbikalimi Rexhal dhe rrethrotullimi në km. 114+540 [përshkrimi i konfigurimit dhe karakteristikat kryesore të çdo mbikalimi jepen në seksionin 7 të Raportit inxhinierik, si edhe në Shtojcën VII të tij]; (vitet 1-3)
- c) Përmirësimet e komponentëve të ndryshëm të Autostradës (vitet 1-2):
 - Masa korigjuese për urat në mënyrë që të përmbushin kërkesat për ecurinë të përcaktuara në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5, në përputhje me informacionin diagnostikues dhe masat e rekomanduara korigjuese që jepen në seksionin 4.1 të Raportit inxhinierik dhe Shtojcës I të tij;
 - Rehabilitim i urës ekzistuese mbi lumin Drin për aq sa konsiderohet e nevojshme që të përmbushin kërkesat për ecurinë të përcaktuara në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5 dhe siç përcaktohen më tej në Shtojcën I të Shtojcës I të Raportit inxhinierik;
 - Projektim dhe ndërtim i sheshit të taksës;
 - Vendosje e gardhit rrethues përgjatë segmenteve me dy karrexhata të Autostradës me përjashtim të pikave të palejuara hyrëse-dalëse në Autostradë (kategoria 2 dhe 3 e Shtojcës 9), zonat e mbikalimeve, pjesët ku duhen ndërtuar mure mbajtëse dhe muret pjesët ku hapja e shpatit për rrugën ka lartësi më të madhe se 35m;
 - Vendosje e ndriçimit në të gjitha mbikalimet;
 - Përmirësim i të gjitha lidhjeve anësore të lejuara me Autostradën, si edhe i pikave të palejuara hyrëse-dalëse në Autostradë (kategoria 2 sipas Shtojcës 9), konform Standardeve shqiptare të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve, në mënyrë që në çdo rast të sigurohen kushte të mjaftueshme të hyrje-daljes sa i takon gjatësisë së korsisë, sinjalistikës dhe elementeve të tjera projektuese duke mbajtur në konsideratë rrezet, pjerrësinë, shpejtësinë e projektuar dhe çdo parametër tjetër që ndikon tek shikueshmëria dhe siguria;
 - Projektim dhe ndërtim i një ure për këmbësorë në zonën e Kukësit në një vend ku sigurohet mundësi e volitshme dhe e parrezikshme përdorimi për banorët (një pikë e rekomanduar jepet në seksionin 5.1 të Raportit inxhinierik në km:95+720, duke mbajtur në konsideratë parametrat e hapësirës së parkimit, distancës nga shëtitorja e qytetit dhe distancën nga plazhi)

Karakteristikat kryesore të urës për këmbësorë:

Lloji i strukturës së trupit – qepratë metalike me kapacitet mbajtës të mjaftueshëm

Gjatësia e përafërt - 30 m

Lartësia e parapetit – 2,5 m

Gjerësia – 1,5 m;

- Vendosje e një sistemi për menaxhimin e trafikut dhe Qendrës së Kontrollit.
- b) Ndërtimi i urës së re mbi lumin Drin, në bazë të koncept-projektit të vënë në dispozicion dhe në përputhje me specifikimet për standardet minimale të projektit të hollësishëm teknik që do të kryhet nga Koncesionari, duke mbajtur në konsideratë çdo risk teknik për shkak të kushteve gjeoteknike faktike të zonës; të kryhen brenda katër (4) vjetëve.

Riparime kapitale:

Vitet aktive: 3-30

Lista e punimeve:

- a) Mirëmbajtje periodike dhe rehabilitim/zëvendësim i elementeve të Autostradës;
- b) Punime për kthimin.

Të gjitha projektet teknike dhe punimet që duhen realizuar nga Koncesionari duhet të projektohen në përputhje me "Standardet shqiptare të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve, SSHPNRR, manuali shqiptar për projektimin e rrugëve" dhe eurokodet dhe euronormat (EN) përkatëse në rastet kur standardet shqiptare nuk e trajtojnë një fushë të veçantë projektimi ose ndërtimi.

2 Sistemi i menaxhimit të cilësisë

2.1 Hyrje

Koncessionari duhet të vërë në shfrytëzim një Sistem të menaxhimit të cilësisë konform ISO 9001:2008. Sistemi i menaxhimit të cilësisë duhet të përshkruajë administrimin, organizimin, përgjegjësitë, procedurat, proceset, burimet dhe programin për projektimin, prokurimin, adërtimin, kolaudimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës.

Koncessionari duhet të paraqesë një Manual të kontrollit të cilësisë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen, ku të trajtohen:

- Organizimi dhe përgjegjësitë e propozuara për shfrytëzimin e rregullt të Autostradës dhe për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen në ngjarje të jashtëzakonshme dhe gjatë stinës së dimrit, sipas kërkesave të parashtruara përkatësisht në seksionet 3.2, 3.3 dhe 3.4 të kësaj Shtojce 5;
- Organizimi dhe përgjegjësitë e propozuara për inspektimin, marrjen e kampioneve dhe testimin e materialeve dhe punimeve për mirëmbajtjen rutinë të Autostradës, sipas kërkesave të seksionit 3.5 të kësaj Shtojce 5;

Koncessionari duhet të përgatisë edhe një Manual të cilësisë së projektimit dhe ndërtimit, ku parashtrihen:

- Organizimi dhe përgjegjësitë e propozuara për inspektimin, marrjen e kampioneve dhe testimin e materialeve dhe punimeve;
- Detaje të hollësishme për objektet dhe pajisjet që do të përdoren për testimin e materialeve në vend dhe në laborator;
- Inspektimi, testimi dhe certifikimi i materialeve për punimet në proces, përpara mbulimit dhe pas përfundimit;
- Shpeshësia e marrjes dhe testimit të kampioneve

për të gjitha punimet (ndërtime të reja dhe riparime kapitale) që do të kryhen gjatë Periudhës së Koncesionit (shih seksionin 6. 2 të kësaj Shtojce 5).

Jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara datës më të cilën Koncessionari do të fillojë të arkëtojë taksën e Autostradës, Autoritetit Kontraktues dhe Inxhinierit të pavarur i paraqitet për aprovim një projekt-version i hollësishëm i të dy manualeve.

Komentet e marra nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose Inxhinieri i pavarur brenda 3 (tre) javëve pas paraqitjes duhet të marrin përgjigje nga Koncessionari dhe versionet përfundimtare të të dy manualeve duhet të paraqiten për "mospasje kundërshtimi" pranë Autoritetit Kontraktues të paktën 1 (një) muaj përpara datës më të cilën Koncessionari do të fillojë të arkëtojë taksën e Autostradës.

Në fund të Periudhës së Koncesionit këto dokumente bëhen pronë e Autoritetit Kontraktues.

Inxhinierit të pavarur duhet t'i jepet mundësi e plotë për të kqyrur dhe audituar Sistemin e menaxhimit të cilësisë të Koncesionarit dhe planet e lidhura të cilësisë, përfshirë edhe ato të projektuesve, Nënkontraktorve dhe furnitorëve të tij, në intervalet që i konsideron të arsyeshme Inxhinieri i pavarur.

Koncessionari duhet të emërojë një Drejtor cilësie për Projektin.

2.2 Menaxhimi i cilësisë

Koncesionari vendos një Sistem të menaxhimit të cilësisë sipas këtyre kërkesave të përgjithshme:

1. Koncesionari i paraqet Inxhinierit të pavarur dokumentacionin e cilësisë në përputhje me dispozitat e klauzolës 18.1.3 të Kontratës së Koncesionit. Kërkesat dhe parimet që zbatohen për dokumentacionin e cilësisë parashtrihen në seksionet në vijim.
2. Sistemi i menaxhimit të cilësisë i Koncesionarit duhet të përfshijë një Njësi të dedikuar të monitorim-kontrollit ("Njësia e kontrollit të cilësisë"), e cila duhet të mbajë evidenca të plota në mënyrë që Koncesionari, Inxhinieri i pavarur dhe Autoriteti Kontraktues të kenë mundësi të shohin informacione të përditësuara në lidhje me përmbushjen e Kërkesave për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen dhe ecurinë e punimeve të ndërtimit.

Më konkretisht, Koncesionari është i detyruar të ngrejë brenda strukturës së vet organizative një njësi të veçantë me personel të kualifikuar, detyra e të cilëve është të verifikojnë vazhdimisht shkallën e përmbushjes nga Koncesionari të niveleve të kërkuara të Shërbimit. Njësia e kontrollit të cilësisë është gjithashtu përgjegjëse për ndërmarrjen e testimeve të kontrollit të cilësisë që janë të nevojshme për ndërtimet e reja, punimet përmirësuese, riparimet kapitale dhe punimet në rast situatë të jashtëzakonshme.

Kjo njësi është përgjegjëse për krijimin dhe paraqitjen e informacioneve të nevojshme nga Koncesionari në mënyrë që të përmbushë kërkesat për evidencat dhe raportimin, të parashikuara në Lidhjen 5 të kësaj Shtojce 5. Në përgjithësi, kjo Njësi do të jetë përgjegjëse për mbajtjen në çdo kohë të informacioneve të hollësishme dhe të plota për gjendjen e të gjithë Autostradës dhe për të vënë në dispozicion të niveleve drejtuese të Koncesionarit të gjitha informacionet që mund të jenë të nevojshme për të menaxhuar dhe mbajtur me efikasitet këtë informacion. Njësia e kontrollit të cilësisë është gjithashtu e detyruar të kryejë, në bashkëpunim me Menaxherin e projektit të Koncesionit dhe Inxhinierin e pavarur, kontrollet zyrtare dhe të parashikuara me grafik të niveleve të shërbimit që do të zhvillohen rregullisht, siç përcaktohet në seksionin 7 të kësaj Shtojce 5.

Përmbushja (mospërmbushja) e kërkesave për nivelin e shërbimit nga Koncesionari do të raportohet nga Njësia e kontrollit të cilësisë sipas parashikimeve të seksionit 7 të kësaj Shtojce 5.

3. I gjithë Dokumentacioni i cilësisë duhet të tregojë pikat në të cilat puna ose aktiviteti nuk mund të vazhdojë pa autorizimin e dokumentuar nga personi i caktuar sipas përcaktimit në udhëzimin përkatës të punës, metodikën, planin e kontrollit dhe testimit, planin e shqyrtimit të projektit, planin e verifikimit të projektit, manualin e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes apo dokumentet e tjera të kontrollit ("Nderprerjet e Punimeve"). Inxhinierit të pavarur i duhet dhënë mundësia të bëjë të ditur se ku duhen Nderprerjet e Punimeve; kjo ka rëndësi sidomos për ato gjëra që mund të fshihen nga vazhdimi i punimeve nga Koncesionari dhe për të cilat Inxhinierit të pavarur i duhet të verifikojë shprehimisht nëse janë plotësuar kriteret.

Dokumentacioni i sugjeruar i cilësisë jepet në Lidhjen 1 të kësaj Shtojce 5.

3 Kërkesat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen

3.1 Kërkesa të përgjithshme

3.1.1 Koncepti

Kërkesat për shërbimin e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes quhen këtej e tutje si Standarde shërbimi. Koncesionari është përgjegjës për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për arritjen dhe ruajtjen e Standardeve të përcaktuara të shërbimit gjatë të gjithë periudhës së koncesionit. Standardet mbulojnë një larmi aktiviteteve të nevojshme për arritur dhe ruajtje kushte të pranueshme dhe të sigurta shfrytëzimi për përdoruesit e rrugës, përfshirë shumë aktivitete të lidhura me menaxhimin dhe mirëmbajtjen, vlerësimin periodik të Autostradës sipas kontratës dhe kryerjen e riparimeve kapitale. Standardet duhet të përmbushen vazhdimisht gjatë të gjithë periudhës së koncesionit ndërsa Kërkesat për kthimin duhen përmbushur në fund të Kontratës.

Standardet përfshijnë kërkesat për shfrytëzimin e përditshëm në vazhdimësi në çdo orë të ditës dhe natës dhe çdo ditë të javës, përfshirë edhe kërkesat për situatat e jashtëzakonshme në lidhje me trajtimin e incidenteve dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme për të mbështetur forcat e policisë, forcat zjarrfikëse, auto-ambulancat, autoritetet e qeverisjes vendore, shërbimet mjedisore dhe të gjitha palët e lidhura me procedurat e koordinimit të vendosura në përputhje me klauzulën 21.3.

Ecuria e Standardeve do të tregohet nëpërmjet një regjimi të plotë vëzhgimorimi ("Njësia e kontrollit të cilësisë" shih seksionin 2 të kësaj Shtojce 5) dhe mbijshqyrimeve nga Autoriteti Kontraktues (ose nga një organ që vendos të caktojë Autoriteti Kontraktues si përfundues të tij) dhe nga inxhinjeri i pavarur. Mospërmbushja e Standardeve sjell zbatimin e Pagesave të kryerjes së punëve siç përshkruhet në seksionin 7 të kësaj Shtojce 5.

3.1.2 Objekti i shërbimeve

Shërbimet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes do të përfshijnë ato aktivitete, përfshirë edhe vjeljen e taksës së rrugës, që janë të nevojshme për të siguruar gatishmëri të vazhdueshme në të paktën një kors për secilin kah lëvizjeje në çdo segment të Autostradës ekzistuese, si edhe në çdo segment të ri që përfundohet kryesisht dhe hapet për përdorim nga automjetet, në çdo orë të ditës dhe natës dhe në çdo ditë të javës, me përjashtim të ngjarjeve të jashtëzakonshme, mbylljeve të përkohshme të aprovuara për mirëmbajtje dhe ngjarjeve të forcave madhore. Shërbimet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes përbëhen nga sa më poshtë:

- Aktivitetet e shfrytëzimit që konsistojnë në të gjitha ato aktivitete, përfshirë edhe vjeljen e taksës së rrugës, në Autostradë, që janë të nevojshme për të plotësuar Kërkesat e shërbimit të përfshira në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5, dhe Kërkesat për kthimin të përfshira në seksionin 8 të kësaj Shtojce 5.
- Aktivitetet e mirëmbajtjes që konsistojnë në të gjitha ndërhyrjet në Autostradë që duhen kryer nga Koncesionari për të arritur dhe mbajtur Kërkesat për shërbimin të përfshira në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5 dhe Kërkesat për kthimin të përfshira në seksionin 8 të kësaj Shtojce 5, si edhe përfshirë të gjitha aktivitetet e lidhura me kontrollin, monitorimin dhe vlerësimin e Autostradës, të përfshira në seksionin 4 të kësaj Shtojce 5 dhe riparimet kapitale të përfshira në seksionin 6 të kësaj Shtojce 5.
- Monitorimi dhe raportimi i këtyre aktiviteteve në përputhje me Kërkesat për shërbimin për çdo aktivitet dhe seksionin 7 të kësaj Shtojce 5.

3.1.3 Përshkrimi i Shërbimeve që kërkohen

Gjatë projektimit, planifikimit dhe realizimit të të gjitha Shërbimeve dhe Punimeve që shoqërojnë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës, Koncesionari men të gjitha masat dhe kryen të gjitha veprimet (përfshirë, ndër të tjera, organizimin e vetes, përdorimin e masave dhe standardeve, ndjekjen e procedurave dhe angazhimin dhe menaxhimin e Nënkontraktorve, agjentëve dhe punonjësve) në atë mënyrë që:

- a) të sigurojë mbrojtjen nga rreziku të përdoruesve të Autostradës dhe të punëtorëve dhe personave të tjerë në Autostradë;
- b) t'i japë mundësi Autoritetit Kontraktues të përmbushë detyrat dhe funksionet që ia jep ligji dhe të mos i pengojë të tjerët të cilëve ligji u ngarkon detyra dhe funksione në lidhje me Autostradën në kryerjen e këtyre detyrave dhe funksioneve;

dhe, në varësi të shkronjës "a" dhe "b" të sigurojë që:

- të minimizohen vonesat e përdoruesve të Autostradës dhe të rrugëve që lidhen me të;
- të minimizohet risku i pasojave të padëshirueshme tek njëdisi dhe tek gëzimi i pronës nga pronarët dhe përdoruesit e tokave ngjitur me Autostradën dhe me rrugët dhe objektet e lidhura me Autostradën;
- t'u jepet përgjigje sa më e shpejtë të gjitha aksidenteve dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe të minimizohen të gjitha pasojat e padëshirueshme të tyre;
- të minimizohet dëmi, shqetësimi ose shkatërrimi i pasurive të të tretëve;
- publiku të trajtohet me mirësjelljen dhe konsideratën e duhur;
- t'u jepen përdoruesve të gjitha informacionet i duhure dhe paralajmërime për ngjarje ose çështje që prekin Autostradën në mënyrë që t'u jepet mundësia të minimizojnë çdo pasojë të padëshirueshme që mund të kenë për ata këto ngjarje apo çështje;
- t'u jepet përdoruesve të publikut dhe të tjerëve mundësia për të sjellë në vëmendje të Koncesionarit çdo çështje që prek mundësinë e Koncesionarit për të plotësuar këto kërkesa për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen;
- të mbliidhen dhe shpërndahen të dhëna për trafikun dhe taksën e rrugës dhe të dhëna që lidhen me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës dhe ngjarjen në Autostradë, në mënyrë që Autoriteti Kontraktues dhe personat ose organet e tjera të cilëve ligji i ka ngarkuar detyra ose funksione në lidhje me Autostradën ose rrugët ngjitur të kenë mundësi t'i përmbushin këto detyra dhe funksione;
- Autostrada të shfrytëzohet, mirëmbahet (dhe sipas rastit të projektohet dhe përmirësohet) dhe t'i kthehet Autoritetit Kontraktues në përputhje me kërkesat e sa më poshtë:

Pjesa (seksioni) 2 i kësaj Shtojce 5

Pjesa (seksioni) 3 i kësaj Shtojce 5

Pjesa (seksioni) 4 i kësaj Shtojce 5

Pjesa (seksioni) 5 i kësaj Shtojce 5

Pjesa (seksioni) 6 i kësaj Shtojce 5

Pjesa (seksioni) 7 i kësaj Shtojce 5

Pjesa (seksioni) 8 i kësaj Shtojce 5

Shtojca 1: Dokumentacioni i cilësisë

Shtojca 2: Siguria dhe menaxhimi i trafikut gjatë punimeve dhe mirëmbajtjes

Shtojca 3: Evidentimi i defekteve

Shtojca 4: Kontrolli dhe monitorimi gjeoteknik

Shtojca 5: Kërkesat për evidencat dhe raportimin

Shtojca 6: Plani në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme për shkaqe gjeoteknike

Koncessionari mban dhe shfrytëzon Autostradën [çdo pjesë të saj] në përmbushje të Kërkesave për shërbimin që lidhen me atë pjesë sikurse parashikohet në këtë Shtojcë dhe siguron përmbushjen e Kërkesave për kthimin të seksionit 8 të kësaj Shtojcë 5.

Kërkesat për strukturën e shërbimit

Për çdo element të Standardeve të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të paraqitur këtu më poshtë përdoret e njëjta strukturë, si vijon:

- Përshkrimi i detyrës
- Kërkesat
- Koha e përgjigjes

Pagesat e Performances

Nëse nuk plotësohen Standardet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të përshkuara në seksionin 3 të kësaj Shtojcë 5, vendosen Pagesat e Performances .

Për Standardet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e rregullt, shfrytëzimin në ngjarje të jashtëzakonshme dhe shfrytëzimin gjatë stinës së dimrit, Pagesat e Performances do të vendosen në bazë të përmbushjes së kërkesave minimale dhe kohës së përgjigjes, siç përshkruhet në seksionet 3.2, 3.3 dhe 3.4 të kësaj Shtojcë 5.

Për standardet që kanë të bëjnë me Mirëmbajtjen rutinë Pagesat e Performances do të vendosen kur defektet nuk ndiqen brenda afateve të përcaktuara në seksionin 3.5 të kësaj Shtojcë 5 ose për moskryerjen e një riparimi permanent kur nuk është rënë dakord për një periudhë riparimi me Autoritetin Kontraktues. Pagesat e Performances fillojnë të llogariten duke filluar nga koha kur duhej të ishte riparuar defekti ose kur duhej të ishte përmbushur afati i kundërpërgjigjes.

Pagesat e Performances vendosen edhe nëse testimi dhe raportimi nuk janë kryer siç duhet.

Pagesat e Performances vilen sipas tabelës 7-1 të seksionit 7 të kësaj Shtojcë 5.

3.1.4 Manualet

Jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara datës më të vjetër koncessionari do të fillojë të arkëtojë taksën e Autostradës, Autoritetit Kontraktues dhe Inzhinierit të pavarur i paraqitet për aprovim një projekt-version i hollësishëm i manualeve të mëposhtme:

- Manuali i kontrollit të cilësisë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen
- Manuali i mbrojtjes së shëndetit dhe jetës për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen
- Manuali i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes
- Manuali ose manualët e kontrollit dhe monitorimit
- Plani i menaxhimit mjedisor dhe social

Komentet e marra nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose Inzhinieri i pavarur brenda 3 (tre) javëve pas paraqitjes duhet të marrin përgjigje nga Koncessionari dhe versionet përfundimtare e secilit manual duhet të paraqiten për "mospasje kundërshtimi" pranë Autoritetit Kontraktues të paktën 1 (një) muaj nënara datës më të cilën Koncessionari do të fillojë të arkëtojë taksën e Autostradës.

Në fund të Koncesionit këto dokumente bëhen pronë e Autoritetit Kontraktues.

3.1.4.1 Manuali i kontrollit të cilësisë

Manuali i kontrollit të cilësisë hartohet në përputhje me seksionin 2 të kësaj Shtojce 5.

3.1.4.2 Manuali i mbrojtjes së shëndetit dhe jetës

Manuali i mbrojtjes së shëndetit dhe jetës hartohet në përputhje me rregulloret shqiptare për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës, Standardet e ecurisë të IFC-së të vitit 2012 dhe Praktikën e mirë të sektorit ekonomik në Evropë, duke parashikuar (sa më poshtë shërben vetëm si orientim):

- politikën e Koncesionarit për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës,
- organizimin dhe përgjegjësitë,
- emërimin e një nëpunësi sigurie (nëpunësi për parandalimin e aksidenteve),
- trajnime të stafit,
- kërkesat për ndërtim të parrezikshëm,
- procedurat e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut,
- masa për magazinimin dhe trajtimin e materialeve të rrezikshme,
- objektet e shërbimeve mjekësore dhe të kujdesit social në terren,
- procedurat për situatat e jashtëzakonshme,
- menaxhimin e trafikut dhe kufizimet e shpejtësisë.

3.1.4.3 Manuali i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes

Manuali i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes duhet të përflshijë:

- Procedurat e bashkëndimit në lidhje me shfrytëzimin e Autostradës, të hartuara dhe miratuara në përputhje me klauzolën 21.3 të Kontratës së Koncesionit;
- Procedurat e hollësishme për shfrytëzimin e Autostradës, në veçanti në lidhje me:
 - Menaxhimin e trafikut dhe kufizimet për trafikun permanent dhe të përkohshëm;
 - Procedurat për situatat e jashtëzakonshme, përfshirë mbylljen e korsive në rast situatave të jashtëzakonshme ose incidentit (Plani në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme);
 - Shfrytëzimin pa rrezik të Autostradës dhe sigurinë e Përdoruesve, punëmarrësve të Koncesionarit dhe vizitorëve të lejuar në Autostradë në përputhje me Manualin e mbrojtjes së shëndetit dhe jetës;
 - Hollësi për kërkesat për raportim të rregullt.
- Udhëzimet për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e komponentëve të Autostradës, përfshirë komponentët strukturorë dhe jostrukturorë, impiantet dhe pajisjet;
- Procedurën për planifikimin e punimeve për mirëmbajtjen rutinë dhe riparimet kapitale, përfshirë edhe mbylljet e korsive të planifikuara për këto punime.

Manuali i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes duhet të bëjë qartë dallimin ndërmjet dispozitave që zbatohen për periudhat e shfrytëzimit të rregullt dhe mirëmbajtjes rutinë dhe periudhat e punimeve (ndërtimeve të reja dhe/ose riparime kapitale).

- Për periudhën e shfrytëzimit të rregullt dhe mirëmbajtjes rutinë, Koncesionari përshkruan masat e hollësishme për menaxhimin e trafikut që janë të nevojshme për gamën e plotë të operacioneve, mirëmbajtjes dhe aktiviteteve në situata të jashtëzakonshme gjatë kësaj periudhe.
- Për periudhat e punimeve dhe përpara çdo ndërtimi të ri ose riparimi kapital, Koncesionari përshkruan masat e hollësishme për menaxhimin e trafikut që janë të nevojshme për gamën e plotë të aktiviteteve të ndërtimit dhe aktiviteteve në situata të jashtëzakonshme gjatë kësaj periudhe.

Manuali duhet të përfshijë skicat e vendosjes për të gjitha rastet tipike të parashikueshme (të rregullta dhe të jashtëzakonshme) duke treguar qartë vendndodhjen e të gjitha tabelave dhe koneve etj. dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në ndriçim, vijëzime në rrugë, kufizime të shpejtësisë etj. Gjithashtu, manuali duhet të përmbajë metodikën ku përshkruhet procedura për zbatimin pa rrezik dhe heqjen e të gjitha masave të përkohshme të menaxhimit të trafikut. Gjithashtu, në të përcaktohet procedura e bashkërendimit ndërmjet Koncesionarit, Autoritetit Kontraktues, shërbimeve të ndërhyrjes së shpejtë si policia dhe forcat zjarrfikëse dhe palëve të tjera të interesit për të siguruar që të gjitha palët të konsultohen dhe këshillohen si duhet për punimet në një kohë të mjaftueshme përpara fillimit të punimeve. Planet e veprimtimit që do të përcaktohen duhet të aprovohen nga autoritetet policore dhe të forcave zjarrfikëse.

Manuali duhet të identifikojë edhe ato fusha ku nevojitet bashkëpunimi i Autoritetit Kontraktues dhe kompetencat që ia ka caktuar ligji. Në të përshkruhet mënyra me të cilën Koncesionari bashkëpunon me Autoritetin Kontraktues në funksion të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së Autostradës.

Në fund, Manuali i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes duhet të ketë një parashikim të veçantë për kërkesat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen në lidhje me tunelet, përfshirë edhe aspekte të tilla si mallrat e rrezikshme. Për çdo tunel, Koncesionari duhet të kujdeset që të ketë procedura të qarta dhe përgjegjësi të caktuara qartë në lidhje me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tunelit dhe menaxhimin e trafikut në tunel për të siguruar kundërpërgjegje të shpejtë dhe të bashkërenduar kundër situatave të jashtëzakonshme. Për këto procedura duhet rënë dakord me Inxhinierin e pavarur dhe ato duhen shqyrtuar dhe përditësuar çdo vit. Koncesionari duhet të përcaktojë edhe procedura për shqyrtimin e efektivitetit dhe mjaftueshmërisë së këtyre procedurave dhe përgjegjësisë pas një situatë të jashtëzakonshme. Për çdo ndryshim që propozohet t'u bëhet procedurave dhe përgjegjësisë duhet rënë dakord me Inxhinierin e pavarur.

3.1.4.4 Manuali ose manualët e kontrollit dhe monitorimit

Manuali ose manualët e kontrollit dhe monitorimit për të gjithë komponentët e Autostradës hartohen në përputhje me seksionin 4 të kësaj Shtojcë 5. Manuali ose manualët duhet të përmbajnë udhëzime për inspektimin, testimin rutinë dhe monitorimin e gjendjes dhe ecurisë së komponentëve të Autostradës, përfshirë edhe hollësi në lidhje me zhvillimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ndryshme të monitorimit dhe menaxhimit të komponentëve të veçantë të Autostradës.

3.1.4.5 Plan i menaxhimit mjedisor dhe social

Manuali ose manualët e menaxhimit mjedisor hartohen në kuadër të Sistemit të Menaxhimit Mjedor dhe Social, si shtesë ndaj planeve të veprimtimit të propozuara në përputhje me seksionin 5.2 të Shtojcës 5. Sugjerohet të trajtohen sa më poshtë: politika mjedisore, procedurat e zbuljes së efekteve negative, procedurat e monitorimit, procedurat e shqyrtimit dhe auditimit dhe procedurat për konsultimin dhe informimin e publikut.

3.1.5 Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes

Koncesionari duhet të sigurojë një Qendrë kontrolli të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, me personel të trajnuar, sisteme komunikimi dhe objekte të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat dhe afatet e përgjigjes të të gjitha aktiviteteve të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të gjithë komponentëve të Autostradës. Në veçanti, Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes do të përdoret për të përmbushur kërkesat për menaxhimin dhe kontrollin e trafikut, kundërpërgjegjen për situatat e jashtëzakonshme dhe incidentet, arkëtimin e taksës së rrugës, inspektimin dhe monitorimin e Autostradës dhe menaxhimin e mirëmbajtjes rutinë, mirëmbajtjes në situata të jashtëzakonshme dhe gjatë stinës së dimrit dhe riparimeve kapitale.

Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes duhet të vendoset në Autostradë ose pranë saj dhe të jetë lehtësisht e arritshme nga Autostrada. Koncesionari duhet ta shfrytëzojë vazhdimisht Qendrën me një nivel personeli të përshtatshëm për t'u marrë me veprimet në Autostradë.

Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes duhet të përmbajë një Qendër të kontrollit të trafikut (QKT) të dedikuar për monitorimin e trafikut në Autostradë dhe tunele. Qendra e kontrollit të trafikut duhet të ketë të paktën një sallë kontrolli të projektuar dhe ndërtuar enkas për këtë qëllim, e cila të jetë e përshtatshme për shfrytëzimin e objekteve të kontrollit të trafikut. Koncesionari duhet të sigurojë që salla e kontrollit të jetë e projektuar në mënyrë të tillë ergonomike që personeli shfrytëzues i pajisjeve të mund t'i kryejë pa rrezik dhe me efikasitet aktivitetet e lidhura me sigurinë dhe aktivitetet e tjera.

Qendra e kontrollit të trafikut duhet të jetë e pajisur me:

- Ekrane monitorë të sistemit të kamerave të vëzhgimit (CCTV);
- Lidhje të veçantë me telefonat e vendosur në anë të Autostradës;
- Telefona të dedikuar urgjence, që sigurojnë lidhje me Autoritetin Kontraktues, policinë dhe shërbimet e urgjencës;
- Sistem telefonik monitorimi për të raportuar për afatet e përgjigjes ndaj telefonatave;
- Pajisje monitorimi për taksën e rrugës;
- Pajisje të monitorimit me GPS për të gjitha automjetet operative të lëvizshme;
- Pajisje lidhëse me pikat dhe raportet e monitorimit të mirëmbajtjes gjatë stinës së dimrit.

Koncesionari ka firmë që ose ta vendosë Qendrën e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes në të njëjtat objekte ku ndodhet Qendra e kontrollit të trafikut e Tunelit të Thirrës ose të propozojë ta ndërtojë atë në një pikë tjetër për të cilën duhet të bjerë dakord me Inxhinierin e pavarur dhe e cila duhet aprovuar nga Autoriteti Kontraktues, me kushtimin e vetëm: se kjo vendndodhje e re nuk duhet të kërkojë zhvendosje të popullsisë nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Gjithashtu, në përputhje me klauzolën 21.14 të Kontratës së Koncesionit, Koncesionarit i lejohet të ngrejë Qendra të kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, jo më shumë se tri të tilla gjithsej për të gjitha Autostradën (përfshirë edhe Qendrën e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes), në mënyrë që të jetë në gjendje të përmbushë me sukses Kërkesat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen të kësaj Shtojce 5. Trualli shtesë që mund të kërkohet për ngritjen e Qendrës së kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes është objekt i klauzolës 21.14 të Kontratës.

3.1.6 Sistemi i komunikimit për situata të jashtëzakonshme

Koncesionari duhet të zbatojë dhe shfrytëzojë një sistem komunikimi për situata të jashtëzakonshme. Koncesionari është përgjegjës për projektimin, zbatimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rifreskimin teknologjik të këtij sistemi.

Qëllimi i sistemit të komunikimit për situata të jashtëzakonshme është t'u japë mundësi përdoruesve të Autostradës të kontraktojnë subjektin shfrytëzues të Autostradës për të kërkuar ndihmë dhe për të raportuar incidente ose probleme të tjera.

Përfitim i parësor që jep ky sistem ka lidhje me sigurinë meqë u jep mundësi përdoruesve të kërkojnë me shpejtësi ndihmë. Ai i jep subjektit shfrytëzues një burim të cmuar informacioni për Autostradën dhe për çdo problem që ndodh në të.

Sipas Kontratës së Koncesionarit, është detyrim për Koncesionarin që të sigurojë mbulim me shërbim telefonik urgjence për të gjithë gjatësinë e Autostradës. Mënyra e realizimit të këtij detyrimi është e dyfishtë: përmes një numri telefoni për urgjencat; dhe përmes telefonave të urgjencës në tunelin e Thirrës.

Numri i telefonit për urgjencat

Një numër telefoni për urgjencat katër-ose-pesë-shifror duhet të vendoset për Autostradën. Koncesionari, me asistencën e Autoritetit Kontraktues bën marrëveshje me shoqëritë e telefonisë celulare që ushtrijnë aktivitet në Shqipëri në mënyrë që të instalohen antena për të mbuluar me GSM të gjithë gjatësinë e rrugës. Koncesionari bën marrëveshje edhe me autoritetin kombëtar të telekomunikimeve për t'u pajisur me një numër telefoni karakteristik 4-ose-5-shifror i cili do të jetë numri i telefonit për urgjencat. Kur të marrin një telefonatë drejt këtij numri, shoqëritë e telefonisë celulare duhet ta përcjellin telefonatën tek Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Meqë Qendra e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes do të shfrytëzohet gjatë të gjithë ditës dhe natës në të shtatë ditët e javës, Njësitë e kundërpërgjigjes për situatat e jashtëzakonshme do të informohen dhe do të ndihmohen të lëvizin siç duhet.

Koncesionari ka detyrimin t'i bëjë publicitet me shpenzimet e veta këtij numri gjatë të gjithë gjatësisë së Autostradës, në distanca relativisht të shkurtra. Si kërkesë minimale, duhen vendosur tabela pas çdo kryqëzimi në Autostradë. Dimensionet, materialet, lartësia etj. e tabelave duhet të ndjekin standardet shqiptare dhe/ose evropiane.

Telefonat e urgjencës

Telefonat e urgjencës në tunelin e Thirrës duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- të jenë të përshtatshëm për instalim në tunele, sa i takon parrezikshmërisë në rast përplasjeje (kur një automjet përplasët me telefonin dhe e shkatërron atë);
- të mund të shihen dhe gjenden lehtë nga përdoruesit e Autostradës (në dritën e ditës, në errësirë dhe në kushte të dobëta shikimi);
- të identifikohen lehtësisht sa i takon vendndodhjes dhe kahut të lëvizjes;
- të jenë të thjeshtë në përdorim dhe të kenë funksionin e përdorimit pa duar;
- të përdorin teknika të fshirjes së zhurmave për të siguruar që cilësia e dëgjimit si për përdoruesin në rrugë ashtu edhe për centralistin në qendrën e kontrollit të jetë e mjaftueshme për ta zivilluar bisedën në kushtet e mjedisit rrugor të zhurmshëm;
- të kenë sinjalizues me tingull dhe pamje për telefonatat në ardhje;
- të kenë udhëzime përdorimi në shqip dhe anglisht dhe një përfaqësim grafik universal;
- të jenë të parrezikshëm në përdorim dhe mirëmbajtje.

Telefonat e urgjencës që janë instaluar më parë në tunelin e Thirrës duhet të kontrollohen për të verifikuar përmbushjen e standardeve të mësipërme dhe të modifikohen/zëvendësohen sipas nevojës nëse konstatohen mospërputhje në funksionin.

Telefonatave Koncesionari duhet t'u përgjigjet nëpërmjet një punonjësi centralist. Duhet të jetë e mundur që të merren të paktën 15 telefonata njëkohësisht (pra, sistemi duhet të ketë kapacitetin për të vënë në pritje maksimumi 15 telefonata).

Sistemi i komunikimit për situata të jashtëzakonshme duhet të kontrollohet nga një pajisje e specializuar për komunikimin në situata të jashtëzakonshme që duhet të jetë në sinergji të plotë me pajisjen e menaxhimit të trafikut. Koncesionari mund t'i integrojë të dyja këto pajisje/shërbime nëse është nevoja, brenda Qendrës së kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.

Konçesionari siguron që sistemi i komunikimit për situata të jashtëzakonshme të jetë i gatshëm njëzet e katër orë në ditë në të shtatë ditët e javës pa asnjë lloj ndërprerjeje.

3.1.7 **Infrastruktura mbështetëse**

Konçesionari duhet të zbatojë infrastrukturë mbështetëse që mundëson përmbushjen e kërkesave për objektet e sheshit të taksës, sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të trafikut, sistemin e komunikimit për situata të jashtëzakonshme dhe matjen e trafikut. Zbatimi i plotë i kësaj infrastrukture do të arrihet gjatë vitit të parë të Konçesionit, krahas periudhës së parë të ndërtimit të punëve kapitale.

Nuk pritet nga Konçesionari që të zbatojë një rrjet me tubacione nëntokë përgjatë rrugës për futjen e kablove. Një rrjet i tillë është i disponueshëm për objektin e Projektit. Megjithatë, nëse gjatë periudhës së konçesionit nga Konçesionari pritet të ndihmojë punën e ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues ose Nënkontraktorit e tij kundrejt ndërtimit të një infrastrukture të tillë njësoj siç vlen kjo kërkesë për të gjitha punimet e të tretëve të zbatuara përgjatë Autostradës.

Komunikimi në rrugë

Nëse konsiderohet i preferueshëm për çfarëdo arsye gjatë periudhës së konçesionit ose në mungesë të një rrjeti tubacionesh përgjatë një pjese të Autostradës, çdo kërkesë për komunikim në rrugë mund të përmbushet duke përdorur teknologjinë pa kablo. Në një rast të tillë, Konçesionari identifikon kërkesat e komunikimit të pajisjeve dhe instalimeve në Autostradë dhe propozon zgjidhjet e duhura teknike dhe teknologjike për mundësimin e tyre. Zbatimi i këtyre zgjidhjeve është objekt aprovimi nga Inzhinieri i pavarur dhe "mospasje kundërshtimi" nga Autoriteti Kontraktues.

Furnizimi me energji

Konçesionari është gjithashtu përgjegjës për projektimin, zbatimin dhe shfrytëzimin e vazhdueshëm të të gjithë furnizuesve të energjisë që nevojiten për mbledhjen e taksës së rrugës, menaxhimin e trafikut, komunikimin në situata të jashtëzakonshme dhe matjen e trafikut.

Konçesionari është përgjegjës për të gjitha kostot e energjisë dhe kostot e tjera të lidhura me furnizimin me energji gjatë gjithë periudhës së Konçesionit. Konçesionari është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me energji rezervë në çfarëdolloj forme (UPS, gjeneratorë etj.) në mënyrë që të arrihen kërkesat e ecurisë për autostradën dhe çdo objekt dhe sistem.

Kërkesa të tjera

Konçesionari projekton dhe zbaton infrastrukturë buzë rruge në mënyrë që për mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve të sigurohet futja në to arritja pa rruzik e tyre gjatë ditës dhe natës dhe në të gjitha kushtet atmosferike.

Konçesionari do të projektojë sa ta ketë të mundur sisteme teknike të tilla që të minimizohen vizitat e personelit të mirëmbajtës në rrugë. Kur vizitat nuk mund të eliminohen nga projektimi, Konçesionari siguron minimizimin e kohës së nevojshme për vizitat në rrugë. Konçesionari do t'i projektojë dhe zbatojë vendndodhjet për të siguruar që personeli që i viziton këto pika të jetë në kushte pune të parrezikshme.

Konçesionari duhet ta dijë se sisteme dhe pajisje të tilla që bëjnë pjesë në këto objekte ndodhen në autostradë ku janë të arritshme nga publiku. Konçesionari duhet t'i projektojë kabinat dhe ndërtesat dhe çdo objekt tjetër në rrugë në mënyrë të atillë që të sigurojë sigurinë e publikut në afërsi të pajisjeve. Konçesionari duhet të marrë

masat e përshtatshme për të parandaluar hyrjen e rrezikshme të publikut në strukturat ose objektet ku mund të ketë rreziqe.

3.1.8 Të ndryshme

3.1.8.1 Trajnimi

I gjithë personeli i angazhuar në shfrytëzim dhe mirëmbajtje duhet të ketë kualifikimet, njohuritë dhe përvojën e nevojshme për të përbushur në mënyrë të efektshme detyrat dhe përgjegjësitë. Për këtë qëllim, përpara fillimit të detyrës është i nevojshëm një trajnim i të gjithë personelit të angazhuar në shfrytëzim dhe mirëmbajtje. Gjithashtu, një program trajnimi i vazhdueshëm, përfshirë kurse rifreskimi, duhet të sigurojë që personeli të ketë njohuri për të gjitha aspektet e sistemeve inxhinierike në përdorim. Koncesionari nuk u ngarkon punonjësve detyra për të cilat nuk janë vlerësuar zyrtarisht se janë të aftë të kryejnë. Koncesionari mban evidencat e plota dhe të sakta për trajnimin dhe vlerësimin e aftësisë, të cilat ia vë në dispozicion Autoritetit Kontraktues sipas kërkesës dhe në momentin e kthimit.

3.1.8.2 Kërkesat për menaxhimin e përkohshëm të trafikut

I gjithë menaxhimi i përkohshëm i trafikut, për çfarëdo arsye, duhet të bëhet në përputhje me "praktikën e mirë të sektorit ekonomik" dhe standardet evropiane, përfshirë edhe mbështetjen tek standardet shqiptare. Në Manualin e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të përshkruar më lart duhet të përfshihen dispozitat e veçanta për menaxhimin e përkohshëm të trafikut.

3.1.8.3 Kërkesat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen për Punët (veprat)

Të gjitha punët (ndërtim i ri dhe/ose riparim kapitali) të ndërtuara nga Koncesionari duhet të mirëmbahen dhe shfrytëzohen në përputhje me seksionin 3 të kësaj Shtojce 5. Të gjitha materialet e përdorura në mirëmbajtjen, riparimin dhe zëvendësimin e Autostradës duhet të përbushin standardet e përmendura në Kërkesat për projektimin dhe ndërtimin, të përfshira në seksionin 6 të kësaj Shtojce 5.

3.1.8.4 Vendpushimet, pikat e karburantit dhe restorantet në buzë të rrugës

Koncesionari ka të drejtën të ndërtojë dhe shfrytëzojë vendpushime në buzë të Autostradës, që përfshijnë ndër të tjera pika karburanti dhe restorante. Koncesionari është përgjegjës për shpronësimin e truallit të nevojshëm nëse ky truall bie jashtë kufijve të Territorit të Projektit dhe për marrjen e lejeve të nevojshme për ndërtimin dhe investimin. Shfrytëzimi tregtar i këtyre pikave duhet të jetë në zbatim të legjislacionit tatimor shqiptar. Vendpushimet, objektet përkatëse dhe rampat hyrëse dhe dalëse dhe rrugët lidhëse me to duhet të përbushin standardet shqiptare dhe, në rastet kur standardet shqiptare nuk i trajtojnë sa duhet këto elemente, ato evropiane dhe të mirëmbahen (sipas rastit) në përputhje me standardet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të parashtruara në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5.

Nëse Koncesionari merr udhëzime për të lënë aty ku janë Vendpushime, pika karburanti dhe restorante buzë rrugës ekzistuese, prej tij kërkohet të bëjë përpjekje brenda normave ligjore dhe kompetencës që të përmirësojë rrugët lidhëse me këto vendpushime, pika karburanti dhe restorante buzë rrugë ekzistuese në përputhje me standardet shqiptare dhe evropiane. Prej tij kërkohet gjithashtu t'i mirëmbajë në përputhje me Kërkesat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen të përfshira në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5.

3.1.8.5 Pajisje që u përkasin të tretëve

Koncesionari menaxhon instalimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe largimin nga të tretët për çdo pajisje në Autostradë, nën Autostradë ose mbi Autostradë nga ky i tretë (me përjashtim të pajisjeve të instaluar nga Autoriteti Kontraktues ose nga sipërmarrës me ligj). Instalimi, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe largimi i pajisjeve të tilla duhet të ndihmohet nga Koncesionari për atë sa personi përkatës që i kryen këto procese zotëron licencat dhe lejet përkatëse për këtë punë. Kjo përfshin, ndër të tjera, pajisjet e instaluar nga organizatat tregtare që kërkojnë të përdorin infrastrukturën e Autostradës për të ndihmuar në ndërtimin ose instalimin e pajisjeve si pjesë e aktiviteteve

tregtar të tyre. Çdo kosto që i lind Koncesionarit në lidhje me instalimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen ose heqjen nga të tretë të çdo pajisjeje të tillë duhet të rikuperohet vetëm nga ana e tij prej të tretëve përkatës.

3.1.8.6 Marrja në konsideratë e përkeqësimit të kushteve të motit në përmbushjen e Kërkesave për kohën e kundërpërgjigjes

Koncesionari është përgjegjës për respektimin e afateve të përgjigjes që janë caktuar për detyrat e ndryshme dhe përmbushjen e kërkesave të këtij seksioni 3, si edhe të seksioneve 4, 5, 6, 7 dhe 8 të kësaj Shtojce 5. Mosrespektimi i këtyre kërkesave do penalizohet me pikë ecurie, sikurse përshkruhet në seksionin 7 të kësaj Shtojce 5. Mirëpo, për të konstatuar respektimin nga Koncesionari të afateve të kërkuara të përgjigjes, duhen marrë në konsideratë edhe kushtet e përkeqësuar të motit, si sa i takon vonesës së detyrueshme në mobilizim ashtu edhe sa i përket nevojës për të shtyrë/pezuilluar veprimet e planifikuara/të nisura për shkak të kushteve në fjalë. Koncesionari në çdo rast i paraqet justifikim i duhur Inxhinierit të pavarur dhe Autoritetit Kontraktues për devijimin nga afatet e kërkuara të përgjigjes. Shqyrtimi dhe aprovimi përfundimtar i rrethanave të jashtëzakonshme dhe devijimeve përkatëse bëhet nga Inxhinieri i pavarur.



3.2 Kërkesat për shfrytëzimin e rregullt

3.2.1 Hyrje

Koncesionari e shfrytëzon Autostradën në përputhje me Standardet e shfrytëzimit që përshkruhen më poshtë.

Koncesionari nxitet të miratojë dhe përdorë procese dhe procedura për të siguruar arritjen e standardeve të shfrytëzimit gjatë të gjithë periudhës së koncesionit.

Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktues jo më vonë se 40 (dyzet) ditë përpara fillimit të çdo Viti të kontratës Planin e menaxhimit të projektit ("Programi vjetor") ku përshkruhen me hollësi të gjitha informacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe shfrytëzimin e Autostradës dhe planin vjetor të shërbimeve që do t'u ofrohen Përdoruesve. Programi Vjetor përmban edhe një përshkrim të punimeve të ndërtimit dhe riparimeve kapitale të planifikuara për atë vit.

Koncesionari dorëzon relacione mujore dhe vjetore sipas kërkesave për raportimin të parashikuara në Lidhjen 5 të kësaj Shtojce 5.

3.2.2 Shfrytëzimi i Qendrës së kontrollit të trafikut

a) Përshkrimi i detyrës

Qendra e kontrollit të trafikut e Qendrës së kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes do të shfrytëzohet për të përmbushur kërkesat për situatat e jashtëzakonshme, kundërpërgjigjen për incidentet, arkëtimin e taksës së rrugës dhe menaxhimin e trafikut në Autostradë dhe në tunelin e Thirrës, si edhe të çdo segmenti tjetër ose tuneli tjetër të ndërtuar gjatë Periudhës së Koncesionit.

b) Kërkesat

Qendra e kontrollit të trafikut monitoron në mënyrë të përhershme Autostradën dhe tunelin/tunelet për t'i dhënë mundësi Koncesionarit të jetë në gjendje të reagojë ndaj çdo situatë jo normale, sipas nevojës.

Qendra e kontrollit do të jetë në funksionim njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë në javë, 365 ditë e vitit, nga një personel me trajnimin dhe përvojën e duhur, në mënyrë që:

- të sigurohet se Koncesionari ka prani të vazhdueshme;
- të monitorohet funksionimi i pajisjeve të taksës;
- të përdoren dhe mbikqyren pajisjet e mbledhjes së të dhënave të instaluara përgjatë Autostradës;
- të centralizohen telefonatat, sidomos telefonatat e urgjencës;
- të bashkërendohen ndërhyrjet në lidhje me incidentet;
- të informohen përdoruesit e rrugës nëpërmjet sistemit të informimit;
- të asistohen klientët në stacionet e pagimit të taksës, si dhe kur të jetë nevoja;
- të menaxhohet trafiku gjatë punimeve të ndërtimeve të reja dhe riparimeve kapitaleve (shih edhe Lidhjen 2 të kësaj Shtojce 5).

Një pjesëtar i personelit drejtues për Autostradën të Koncesionarit duhet të jetë në dezhurn gjatë gjithë kohës dhe është përgjegjës për bashkërendimin e veprimeve të Qendrës së kontrollit gjatë incidenteve, situatave të jashtëzakonshme dhe kushteve të dimrit.

Sidomos në rastin e tunelit ose tuneleve, situata e jashtëzakonshme duhet të diktohet normalisht nga Qendra e kontrollit të trafikut nëpërmjet monitorëve të sistemit me kamerave të vëzhgimit (CCTV), sensorëve të

kalimit/ndalimit të automjeteve, sinjalizuesve që zhbejnë incidente, detektorëve të tjerë, numrit të telefonit për urgjencat ose telefonave të urgjencës në tunelin e Thirrës. Qendra e kontrollit të trafikut është përgjegjëse që të thërrasë menjëherë shërbimet e nevojshme të urgjencës, të mbajë menjëherë në kontroll trafikun në hyrje në tunelit, të sigurojë kontrollin e nevojshëm të ndriçimit, ajrimit dhe pompimit dhe të japë informacione mbi trafikun për të minimizuar efektet e dyndjes. Koncesionari duhet të caktojë edhe një Mbikqyrës kontrolli të trafikut të tunelit i cili do të jetë përgjegjës për të gjitha operacionet e tunelit njëzet e katër orë në ditë në të shtatë ditët e javës. Koncesionari duhet të caktojë një Nëpunës sigurie përgjegjës për të gjitha aspektet e sigurisë në tunel. Në rast situatë të jashtëzakonshme apo incidenti në tunel, Nëpunësi i sigurisë është përgjegjës për të siguruar ekzekutimin e kundërpërgjigjes së duluar

Personeli i qendrës së kontrollit do të mbajë një regjistër me të gjitha telefonatat dhe veprimet e kryera dhe të regjistrojë kohën që është dashur për t'u përgjigjur secilit incident ose situatë të jashtëzakonshme.

Telefonatat që vijnë nga telefonat e urgjencës të instaluar buzë rruge duhet të marrin përgjigje dhe detajet e telefonatave dhe përgjigjet duhet të reflektohen në regjistrat operativë. Në veçanti sistemi duhet të regjistrojë automatikisht kohën që është dashur për t'u përgjigjur një telefonate.

Telefonatave duhet t'u përgjigjet një punonjës centralist.

Regjistrat duhet të evidentohen në format elektronik në mënyrë të pandryshueshme në mënyrë që evidencat të mos mund të fshihen apo manipulohen. Të gjitha të dhënat duhet të mbajnë vullën me kohën dhe datën.

c) Koha e përgjigjes

95% e të gjitha telefonatave që vijnë në numrin e telefonatave urgjente, nga telefonat e urgjencës të instaluar në tunelin e Thirrës, Autoriteti Kontraktues, policia dhe shërbimet e urgjencës duhet të marrin përgjigje nga një centralist brenda 1 (një) minute.

95% e të gjitha telefonatave duhet të marrin përgjigje nga një punonjës i personelit brenda 2 (dy) minutave.

Të gjitha telefonatat duhet të marrin përgjigje brenda 5 (pesë) minutave.

Periodha e matjes për vlerësimin e respektimit të kësaj kërkesë është 1 (një) muaj.

3.2.3 Shfrytëzimi i objekteve të menaxhimit të trafikut

a) Përshkrimi i detyrës

Koncesionari përdor objekte të menaxhimit të trafikut për të asistuar shfrytëzimin e Qendrës së kontrollit të trafikut në lidhje me menaxhimin e incidenteve, situatave të jashtëzakonshme dhe të Autostradës në përgjithësi.

Objektet e menaxhimit të trafikut janë llojet e mëposhtme të pajisjeve në instaluar në rrugë, të cilat pritet të zbatohen nga Koncesionari:

- Sinjalizimi për kontrollin e korsive – përdoret për të kontrolluar secilën korsë, për të shfaqur shpejtësinë e lejuar, aspektet e përgjithshme të sinjalistikës rrugore dhe aspekte të tjera të menaxhimit të përdorimit të korsisë;
- Tabela me mesazhe të ndryshme – përdoret për të shfaqur mesazhe me tekst për drejtuesit e mjeteve;
- Pikat e monitorimit të trafikut – përdoren për të mbledhur të dhëna mbi trafikun dhe për të diktuar incidentet;
- Kamerat e vëzhgimit (CCTV) – përdoren për monitorimin

- Pikat meteorologjike – përdoren për monitorimin e kushteve atmosferike dhe mjedisore, për t'u dhënë informacion drejtuesve të mjeteve dhe për monitorimin dhe raportimin e ecurisë së kontratës.

Nevoja dhe koha e instalimit, si edhe lloji dhe vendndodhja e saktë e pajisjeve të lartpërmendura janë elemente për të cilat duhet të bihet dakord me inxhinierin e pavarur dhe të cilat janë objekt i marrjes së “mospasje kundërshtimi” nga Autoriteti Kontraktues. Si minimum Koncesionari duhet të kujdeset që në çdo shesh takse të instalohen sisteme të zbulimit të incidenteve dhe që përdoruesit e rrugës të kenë në dispozicion informacion të përditësuar mbi statusin përpara dhe pas tunelit të Thirrës dhe në të gjitha pikat e taksës nëpërmjet tabelave me mesazhe të ndryshme dhe që të jenë vendosur të gjitha pajisjet e nevojshme të trafikut në mënyrë që të mbështeten dhe/ose plotësohen kërkesat për matjen e trafikut të parashikuara në seksionin 3.2.4 të kësaj Shtojce 5 dhe kërkesat e Sistemeve të menaxhimit të infrastrukturës që parashikohen në seksionin 4.2.3 të kësaj Shtojce 5.

b) Kërkesat

Objektet e menaxhimit të trafikut duhet të shfrytëzohen në atë mënyrë që të kontribuojnë pozitivisht në shfrytëzimin e përgjithshëm të Autostradës dhe në mënyrë që të ofrojnë një nivel rehatie dhe informimi për drejtuesit e mjeteve.

Qasja e përgjithshme kërkon:

- Monitorim të Autostradës;
- Analizë të situatave dhe vendimmarrje;
- Veprim nëpërmjet një shumëllojshmërie instrumentesh dhe strategjish operative, si:
 - Informimi dhe udhëzimi i përdoruesve të Autostradës;
 - Mobilizimi i burimeve (skuadrat e shpëtimit, shërbimet e urgjencës etj.);
 - Menaxhimi i incidenteve për të ulur pasojat e tyre dhe për të parandaluar përshkallëzimin

në përputhje me procedurat e përshkruara në Manualin e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, Manualin e mbrojtjes së shëndetit dhe jetës, Planin e menaxhimit mjedisor dhe social dhe në praktikën e mirë inxhinierike në përgjithësi.

Koncesionari duhet të përshkruajë dhe përcaktojë përdorimin e këtyre pajisjeve në kuadër të planit të integruar për shfrytëzimin e Autostradës siç e kërkon Manuali i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.

Si minimum Koncesionari i shfrytëzon objektet e menaxhimit të trafikut për të arritur funksionet e mëposhtme:

- Përmirësimi i sigurisë së Autostradës gjatë periudhave me kushte trafiku jo normale dhe incidente;
- Zbulimi i incidenteve;
- Dhënia e përgjigjes së shpejtë dhe të saktë incidenteve dhe mobilizimi i burimeve të duhura;
- Dhënia e asistencës dhe ndihmës për lëvizjen e shërbimeve të urgjencës gjatë incidenteve;
- Informimi i drejtuesve të mjeteve për incidentet dhe këshillimi për shpejtësinë e lejuar në afërsi;
- Menaxhimi i trafikut në mënyrë që trafiku të mund të largohet pa rrezik nga korsia me kufizimet e duhura të shpejtësisë në afërsi të mbylljes së korsisë;
- Menaxhimi i efektit të incidenteve duke u dhënë informacion përdoruesve të autostradës;
- Zvogëlimi i vonesave për përdoruesit e Autostradës përmes parandalimit të ngjeshjes dhe uljes së efektit të ngjeshjes;
- Përmirësimi i rehatisë së drejtuesve të mjeteve përmes dhënies së informacioneve aktuale, në kohë dhe në mënyrë të besueshme dhe

- Shtjellimi i planeve të veprimt për situatat e jashtëzakonshme që duhet të aprovohen nga autoritet policore dhe të forcave zjarrfikëse.

Kur sigurohen objekte të menaxhimit të trafikut që mund të përdoren për të asistuar në shfrytëzimin e Autostradës ato duhet të përdoren me efikasitet dhe siguri dhe në kohën e duhur për t'u dhënë përdoruesve të Autostradës informacion dhe/ose udhëzime.

Të gjitha operacionet e objekteve të menaxhimit dhe kontrollit të trafikut duhet të regjistrohen në format elektronik në mënyrë të pandryshueshme në mënyrë që evidencat të mos mund të fshihen apo manipulohen. Të gjitha të dhënat duhet të mbajnë vullën me kohën dhe datën.

Koncesionari duhet të vërë në dispozicion në mënyrë elektronike, në mënyrë të vazhdueshme, të dhëna dhe statusin e të gjitha pajisjeve të instaluara në rrugë që janë pjesë e objekteve të menaxhimit të trafikut. Formatit dhe përmbajtja e të dhënave dhe protokollit e komunikimit që duhen përdorur janë objekt marrëveshjeje me Inxhinierin e pavarur dhe aprovimi nga Autoriteti Kontraktues.

Konkretisht, si minimum në këto të dhëna përfshihen:

- Të dhëna për fluksin dhe shpejtësinë e trafikut nga çdo pikë monitorimi trafika;
- Informacion për çdo incident të zbuluar automatikisht ose manualisht, përfshirë vendndodhjen, pasojat, orën e ndodhjes dhe kohëzgjatjen e pritjes;
- Statusi i statjalistikës së kontrollit të korsive, përfshirë edhe konfigurimin;
- Statusi i tabelave me mesazhe të ndryshme, përfshirë edhe konfigurimin;
- Statusi i pikave meteorologjike dhe të dhënat prej tyre.

Sigurimi i të dhënave në kohë reale për disa prej llojeve të mësipërme të të dhënave duhet të negociohet dhe të zbatohet sipas nevojës.

c) Koha e përgjigjes

Mospërdorimi i objekteve të gatshme të menaxhimit dhe kontrollit të trafikut do të hetohet ose në momentin kur ndodh ngjarja ose të paktën çdo 6 (gjashë) muaj gjatë shqyrtimit operativ për të vlerësuar përdorimin e objekteve nga Koncesionari.

Periodha e matjes është çdo 6 (gjashë) muaj.

3.2.4 Matja e trafikut

a) Përshkrimi i detyrës

Për të pasur informacion të vazhdueshëm dhe të përditësuar për vëllimin e trafikut të Autostradës, Koncesionari duhet të instalojë disa pika të përhershme për matjen e trafikut. Në veçanti, Koncesionari, në konsultim me Inxhinierin e pavarur dhe në varësi të "mospasje kundërshtimi" nga Autoriteti Kontraktues, duhet të përfshijë pika të matjes së trafikut:

- Në disa vendndodhje në segmentin I dhe segmentin III të Autostradës, për të cilat duhet rënë dakord me Inxhinierin e pavarur, në mënyrë që të shikohen shpejtësitë e automjeteve dhe të merret informacion për evoluimin e nivelit ekzistues të shërbimit; dhe

- Në të gjitha sheshet e taksës që do të ndërtohen nga Koncesionari në mënyrë që të merret informacion për numrin, llojin dhe konfigurimin e automjeteve që shfrytëzojnë Autostradën.

b) Kërkesat

Pikat e numërimit të trafikut duhet të përbëhen nga një pajisje regjistrimit automatik të të dhënave dhe 2 (dy) qarqe me induksion për korsitë në shtresën e rrugës në mënyrë që të sigurohet kategorizimi i automjeteve ose një sistem i barasvlershëm me saktësi të ngjashme ose më të mirë në përmbushje të kërkesave të mëposhtme:

- Pikat të mbledhin automatikisht statistika për trafikun, të një forme për të cilën duhet rënë dakord me Inxhinierin e pavarur, por si minimum Pajisjet e matjes së trafikut duhet:
 - Të sigurojnë numërim të vazhdueshëm të numrit gjithsej të automjeteve për orë në secilin kah;
 - Të sigurojnë matjen e shpejtësisë së çdo automjeti;
 - Të sigurojnë numërim të vazhdueshëm të numrit gjithsej të automjeteve për orë në secilin kah, duke e klasifikuar secilin automjet në, minimumi, katër klasifikime të automjeteve të rënda dhe, minimumi, tre klasifikime për kategoritë e automjeteve të tjera. Të dhënat e hollësishme të klasifikimit duhet të propozohen nga Koncesionari dhe të aprovohen nga Autoriteti Kontraktues.
- Pajisjet e matjes së trafikut duhet të matin me një saktësi për të cilën duhet rënë dakord me Inxhinierin e pavarur, por si minimum me saktësinë e mëposhtme:
 - Matja e numrit gjithsej të automjeteve të rënda dhe automjeteve të tjera për secilin kah të lëvizjes duhet të jetë i saktë me plus/minus 5 (pesë) përqind gjatë çdo periudhe të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) orë me interval besimi 95 (nëntëdhjetë e pesë) përqind, pa shtrëmbërim nga regjistrimi i mangët apo i tepruar;
 - Matja e numrit gjithsej të automjeteve për secilin kah të lëvizjes duhet të jetë e saktë me plus/minus 3 (tre) përqind gjatë çdo periudhe të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) orë me interval besimi 95 (nëntëdhjetë e pesë) përqind, pa shtrëmbërim nga regjistrimi i mangët apo i tepruar.

Gjithashtu, Koncesionari, në bashkërendim me policinë rrugore shqiptare, duhet të kryejë kontrolle të rastësishme të automjeteve në lidhje me respektimin e rregullave dhe normave për ngarkesën për aks në fuqi, siç parashikohet në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr.8378, datë 22.07.1998, i ndryshuar) dhe konstatimet t'ia raportojë Autoritetit Kontraktues. Në rast se konstatohet një përqindje e lartë automjeteve me ngarkesë jo normale që e përdorin Autostradën në mënyrë të paligjshme, Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktues dhe më pas fut në përdorim me shpenzimet e veta brenda 6 (gjashtë) muajve objekte/pajisje të matjes së ngarkesës për aks në mënyrë që të monitorojë dhe rregullojë më nga afër kalimin e këtyre automjeteve. Shfrytëzimi i këtyre objekteve të matjes së ngarkesës për aks duhet të bëhet në bashkëpunim me policinë rrugore të Republikës së Shqipërisë në mënyrë që shkelësit të gjobiten, siç e kërkon ligji shqiptar. Instalimi i objekteve/pajisjeve të tilla dhe përzgjedhja e vendndodhjes përkatëse duhet të negociohet me Autoritetin Kontraktues dhe/ose Inxhinierin e pavarur dhe duhet të respektojë kërkesat e mëposhtme minimale:

- Pikat të mbledhin automatikisht statistika për ngarkesën për aks të automjeteve, të një forme dhe saktësie për të cilën duhet rënë dakord me Inxhinierin e pavarur, por si minimum këto pajisje duhet të matin dhe/ose regjistrojnë:
 - Peshën bruto të automjetit;
 - Distancën ndermjet akseve;
 - Ngarkesën për aks;
 - Ngarkesën për grup aksi;
 - Targën e automjetit dhe fotografinë e automjetit.

- Pajisjet duhet të matin me saktësitë e përcaktuara në standardin ASTM 1318-02 për pika e llojit I në fashën e temperaturave -20°C deri në +50°C.

Pikat e matjes së trafikut dhe ngarkesës për aks duhet të përpilojnë informacion statistikor dhe t'ia transmetojnë atë elektronikisht një baze të dedikuar të dhënash në Qendrën e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Format dhe përmbajtja e të dhënave dhe protokollet e komunikimit që duhen përdorur janë objekt diskutimi dhe marrëveshjeje me Inxhinierin. Koncesionari është përgjegjës për lidhjen ndërmjet pikave të matjes së trafikut dhe Qendrës së kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Koncesionari është përgjegjës për të gjitha kostot e lidhura me sigurimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e linjave të komunikimit gjatë periudhës së Koncesionit.

Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktues raporte përmbljedhëse tremujore mbi matjen e trafikut dhe/ose i jep mundësi përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktues të hyjë drejtpërdrejt në bazën e të dhënave të matjes së trafikut që ndodhet pranë Qendrës së kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Këto rregullime finalizohen me negociim ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues.

c) Koha e përgjigjes

Mosinstalimi dhe mospërdorimi në pas i objekteve të matjes së trafikut duhet të hetohet të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj.

3.2.5 Shfrytëzimi i shesheve të taksës

a) Përshkrimi i detyrës

Sheshet e taksës duhet të shfrytëzohen në mënyrë të atillë që arkëtimi i taksës së rrugës të bëhet sipas klauzolës 11 të Kontratës së Koncesionit dhe në mënyrë që:

- Të llogariten me saktësi taksat e duhura dhe të arkëtohen me efikasitet paratë;
- Të mos rrezikohen personeli dhe publiku që përdor objektet e arkëtimit të taksës së rrugës;
- Të zbulohen dhe parandalohen orvatjet për mashtrim nga publiku, personeli ose të tjerë;
- Të minimizohen vonesat për përdoruesit në kushte normale dhe të zbuten vonesat që ndodhin në kushte jo normale;
- Të parandalohen/minimizohen shkeljet e taksës së rrugës.
- Të jepet pa ndërprerje informacioni përkatës.

b) Kërkesat

i) Arkëtimi i taksës së rrugës

Koncesionari duhet të arkëtojë të ardhurat me një saktësi plus/minus 5%. Koncesionari e dëshmon respektimin e kësaj kërkesë nëpërmjet një numri masash, përfshirë auditimet dhe vrojtimet. Periudha e matjes është çdo 1 (një) muaj.

ii) Siguria

Çdo situatë e rrezikshme që ndodh duhet të regjistrohet dhe t'ia raportohet inxhinierit të pavarur. Koncesionari duhet të marrë masat për të parandaluar përsëritjen e çdo situatë të rrezikshme.

iii) Mashtrimi

Çdo orvatje për mashtrim duhet të regjistrohet dhe t'i raportohet Inxhinierit të pavarur. Koncesionari duhet të marrë masat për të parandaluar përsëritjen e çdo aktiviteti mashtrues.

iv) Vonesat

Objektet e arkëtimit të taksës së rrugës duhet të funksionojnë në mënyrë të tillë që:

- Në momente trafiku të pazakontë (për shembull, në fillim të periudhave të pushimeve) të minimizohen vonesat që u shkaktohen përdoruesve të Autostradës, nëpërmjet zbatimit të masave rezervë që e rrisin përkohësisht kapacitetin e shesheve të taksës. Pritet që Koncesionari të hartojë plane rezervë për të trajtuar situatat me trafik të parashikueshëm dhe të paparashikueshëm;
- Në rast defekti të komponentëve të objekteve të arkëtimit të taksës së rrugës, të shmangen vonesat për përdoruesit e Autostradës;
- Në çdo rast sheshi i taksës të shfrytëzohet në atë mënyrë që radha mesatare në të gjitha korsitë të mos jetë mesatarisht më shumë se 10 automjete. Lejohet një shkallë e arsyeshme tolerance gjatë fundjavave të pikut të verës në mënyrë që të shmangen projektet e shesheve të taksës për shkak të luhatjes sezonale të trafikut. Shkalla e tolerancës mund të perceptohet si numri i makinave shtesë që nuk krijojnë rrezik për makinat që presin në radhë, në bazë të karakteristikave gjeometrike të gjithë shesheve të taksës në fjalë (vendimi duhet të mbështetet në largësinë e sigurisë ndërmjet automjeteve etj.). Pajisja shtesë me Tabela me mesazhe të ndryshme mund të jetë e justifikuar nëse vendndodhja e sheshit të taksës është e tillë që gjatësia e radhës (përfshirë edhe tolerancën e lejuar) komprometon sigurinë e përdoruesve.

v) Shkeljet e taksës së rrugës

Koncesionari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar/minimizuar incidentet e shkeljeve të taksës së rrugës. Këto masa duhet të projektohen dhe zbatohen nga Koncesionari në bashkëpunim me Inxhinierin e pavarur në varësi të aprovimit të Autoritetit Kontraktues. Koncesionari duhet të instalojë dhe përdorë objektet dhe pajisjet e nevojshme në bazë të praktikës më të mirë ndërkombëtare për të parandaluar kalimin e një përdoruesi në anën tjetër të sheshit të taksës pa paguar taksën përkatëse me një mjet të pranueshëm pagese; këto objekte dhe pajisje mund të përfshijnë (ndër të tjera) tram e taksës nga ata që nuk ngrihen/shtyhen me lehtësi dhe që mbyllen menjëherë pas kalimit të një automjeti për të parandaluar kalimin e dy automjeteve rresht; pengesa trafiku dhe bllokues rruge të kontrolluara nga punonjësi i kabinës së taksës; kamera për leximin e targës; regjistruet me zë të veprimit; dhe alarm zanor që aktivizohet nga punonjësi i kabinës së taksës. Për çdo incident shkeljeje të taksës së rrugës që nuk mund të parandalohet, Koncesionari është përgjegjës për ta fiksuar përmes një Sistemi të kapjes së incidentit. Koncesionari është përgjegjës edhe për vendosjen e të gjitha proceseve të nevojshme të bashkërendimit me autoritetet shqiptare në mënyrë që informacioni për shkeljet e taksës së rrugës t'u kalohet menjëherë këtyre autoriteteve. Koncesionari duhet të mbajë evidenca për të gjitha shkeljet e taksës së rrugës dhe t'ia raportojë këto Autoritetit Kontraktues në relacionet mujore dhe vjetore. Këto raporte duhet të shoqërohen me të dhëna për targën e automjetit dhe fotografi të automjetit të shkelësit.

vi) Dhënia e informacionit

Koncesionari duhet të instalojë dhe shfrytëzojë një sistem automatik kontrolli i cili regjistron të gjitha automjetet, përcakton taksën në bazë të klasifikimit të automjetit dhe siguron që pagesa kryhet përpara hapjes së traut të

taksës. Koncesionari mban evidenca elektronike për të gjitha sa më lart në një bazë të përcaktuar të dhënash në Qendrën e kontrollit të trafikut. Gjithashtu, Koncesionari, në bazë të dispozitave për shfrytëzimin e objekteve të menaxhimit të trafikut të parashikuara në seksionin 3.2.3 të kësaj Shtojce 5, duhet të instalojë dhe shfrytëzojë një Sistem të kapjes së incidentit i cili do të monitorojë dhe regjistrojë çdo aktivitet anormal që ndodh gjatë shfrytëzimit të sheshit/shesheve të taksës. Sistemi i kapjes së incidentit duhet të jetë në gjendje të regjistrojë incidentet e shkeljeve të taksës së rrugës dhe të sigurojë informacionin e nevojshëm të identifikimit të automjeteve në mënyrë që shkelësit të identifikohen dhe ndiqen nga autoritetet shqiptare. Moskapja e incidentit të shkeljes së taksës së rrugës ose mossigurimi i informacioneve të nevojshme për identifikimin e shkelësit për autoritetet shqiptare do të thotë që incidenti do të konsiderohet si "jo incident" për të cilin Koncesionari nuk do të ketë të drejtë kompensimi. Koncesionari duhet të vërë në dispozicion të Autoritetit Kontraktues në format elektronik dhe në kohë reale në mënyrë të vazhdueshme statusin e çdo korsie dhe sheshi takse për të monitoruar nivelin përkatës të shërbimit, si edhe për të mbajtur në kontroll trafikun dhe të ardhurat. Të gjitha informacionet e tjera të mbledhura nga sheshet e taksës (përfshirë edhe të gjitha informacionet e lidhura me incidentet e shkeljeve të taksës së rrugës) duhet të vihen në dispozicion të Autoritetit Kontraktues, ose drejtpërdrejt duke i dhënë liri-hyrje në bazën elektronike të të dhënave të Koncesionari ose nëpërmjet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktues. Format dhe përmbajtja e të dhënave dhe protokollit e komunikimit që duhen përdorur janë objekt marrëveshjeje me Autoritetin Kontraktues.

c) Koha e përgjigjes

i) Arkëtimi i taksës së rrugës

Gabimet në sistem në arkëtimin e të ardhurave nga taksa e rrugës duhet të korrigjohen pa vonesë. Gabimet në të ardhurat duhet të hetohen pa vonesë dhe hapat për ndreqjen e shkakut duhet të merren brenda 7 (shtatë) ditëve pas ngjarjes.

ii) Siguria

Situatat e rrezikshme duhet të regjistrohen pa vonesë dhe duhet vepruar pa vonesë për korrigjimin e tyre.

iii) Mashtrimi

Tentativat për mashtrim duhet të regjistrohen pa vonesë dhe duhet vepruar pa vonesë për korrigjimin e tyre.

iv) Vonesat

Mospërmblidhja e kërkesave për vonesat duhet hetuar pa vonesë. Masat ndreqëse duhen marrë brenda 7 (shtatë) ditësh pune, nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga inzhinieri i pavarur.

v) Shkeljet e taksës së rrugës

Moszbatimi i masave për parandalimin e shkeljeve të taksës së rrugës dhe/ose i Sistemit të kapjes së incidentit menjëherë pas hapjes së shesheve të taksës për trafikun do të vlerësohet negativisht me Pikë ecurie në përputhje

me seksionin 7 të kësaj Shtojce 5, si edhe do të sjellë pasoja sa i takon kompensimit të shkeljeve të taksës së rrugës siç përshkruhet në klauzolën 11 të Kontratës së Koncesionit. Keqfunksionimi i masave për parandalimin e shkeljeve të taksës së rrugës duhet të hetohet menjëherë dhe duhen marrë masa ndreqëse brenda 24 (njëzet e katër) orëve, nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga Autoriteti Kontraktues.

vi) Dhënia e informacionit

Mosdhënia e informacionit të kërkuar në mënyrë të vazhdueshme duhet të hetohet menjëherë. Masat korrigjuese duhen marrë brenda 3 (tre) ditëve pune për të rivendosur fluksin e informacionit. Informacionet e identifikimit të automjeteve nga incidentet e shkeljeve të taksës së rrugës duhet t'u jepen autoriteteve shqiptare brenda 5 (pesë) minutave nga kryerja e shkeljes. Informacionet e plota dhe të hollësishme mbi incidentet e veçanta të shkeljeve të taksës së rrugës duhet t'i jepen Autoritetit Kontraktues sipas kërkesës brenda 30 (tridhjetë) minutave pasi kërkesa t'i jetë komunikuar Koncesionarit. Regjistrat e plotë mujorë për shkeljet e taksës së rrugës duhet t'i jepen Autoritetit Kontraktues sipas kërkesës brenda 7 (shtatë) ditëve pasi kërkesa t'i jetë komunikuar Koncesionarit.

Periodha e matjes për monitorimin e shfrytëzimit të shesheve të taksës është 1 (një) muaj.

3.2.6 Ngarkesat jo normale

a) Përshkrimi i detyrës

Koncesionari duhet t'u japë transportuesve këshilla dhe informacione për itinerarin e ngarkesave jo normale dhe të bashkërendojë me Autoritetin Kontraktues, sipas dispozitave të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr.8378, datë 22.07.1998, i ndryshuar). Koncesionari ka të drejtë të negociojë me transportuesin për një tarifë për çdo punë të lidhur me përpunimin e njoftimit dhe për rrugëtimin faktik që transportuesi do të bëjë përgjatë Autostradës. Kjo tarifë mund të faturohet për çdo punë të nevojshme përpara, gjatë ose pas kalimit të ngarkesës jo normale që lidhet drejtpërdrejt me kalimin e ngarkesën jo normale.

b) Kërkesat

Kjo detyrë përfshin procesin e dhënies së lejeve zyrtare për ngarkesa jo normale të përfshira në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr.8378, datë 22.07.1998, i ndryshuar).

c) Koha e përgjigjes ose toleranca

- Koncesionari siguron që të jetë arkëtuar dëmshpërblimi përpara datës së lëvizjes.
- Njoftimet e kapacitetit të pamjaftueshëm të ngarkesës në Autostradë duhet të bëhen brenda të nesërmes pas marrjes, me faks ose postë elektronike tek transportuesi.
- Njoftimet paraprake për automjetet e mëdha duhet t'i transmetohen Autoritetit Kontraktues brenda 1 (një) dite pune pas marrjes, me faks ose postë elektronike.
- Këshillat për itineraret e automjeteve të mëdha, për veprat e artit ose tunelet me kapacitet të pamjaftueshëm dhe rekomandimet për kufizimet ose punimet e përkohshme të nevojshme duhet t'i transmetohen Autoritetit Kontraktues brenda 5 (pesë) ditëve pune pas marrjes, me faks ose postë elektronike.
- Marrja dhe verifikimi i njoftimit përfundimtar për itinerarin e miratuar për automjetet e mëdha duhet të kryhet brenda 3 (tre) ditëve pune dhe njoftimit të Autoritetit Kontraktues për marrjen.

- Dhënia e informacioneve transportuesve për planifikimin e itinerareve duhet të bëhet brenda 1 (një) jave pas kërkesës.



3.3 Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja në ngjarje të jashtëzakonshme

3.3.1 Hyrje

Koncessionari e shfrytëzon dhe mirëmban Autostradën në rastet e situatave të jashtëzakonshme në përputhje me standardet që përshkruhen në poshtë.

Çdo tremujor Koncessionari dorëzon një raport ku përshkruan aktivitetet e operacioneve të jashtëzakonshme të ndërmarra në tremujorin e fundit.

3.3.2 Situatat e jashtëzakonshme

a) Përshkrimi i detyrës

Në situatat e jashtëzakonshme përfshihen, ndër të tjera:

- Mirëmbajtje ose riparim të jashtëzakonshëm të dëmeve të shkaktuara nga dukuritë natyrore që prekin drejtpërdrejt Autostradën, ku ndër të tjera përfshihen:
 - reshje shiu dhe erë me forcë të jashtëzakonshme;
 - shkarje dheu, rënie të mëdha masivësh shkëmborë dhe ngjarje të tjera të jashtëzakonshme me natyrë gjeoteknike;
 - përmbytje gjatë të cilave niveli i ujit rritet në tokën ngjitur me Autostradën ose ujërat e lumenjve ngrihen në nivelin e karrexhatës;
- Instalim i menaxhimit të përkohshëm të trafikut aty ku janë dëmtuar rruga ose veprat e artit.

Koncessionari ngre dhe mirëmban një sistem për t'i dhënë mundësi Autoritetit Kontraktues, Inxhinierit të pavarur dhe të gjitha shërbimeve të urgjencës të kontaktojnë me Qendrën e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes dhe me drejtuesit e lartë të Koncessionarit për autostradën në çdo orë të ditës dhe natës në të shtatë ditët e javës gjatë të gjithë periudhës së Koncesionit.

Koncessionari vë në dispozicion krahu e punës, impiantin, burimet teknike dhe materialet e nevojshme për të trajtuar incidentet e jashtëzakonshme brenda afateve të kërkuara të përgjigjes.

Koncessionari duhet të përgatisë skemat e menaxhimit të trafikut për itineraret e devijimit të trafikut dhe të bashkërendojë me masat e tjera organizative të trafikut në rast se duhen mbyllur segmente të ndryshme të rrugës.

b) Kërkesat

Koncessionari duhet të ketë hartuar përpara fillimit të operacioneve një Plan në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme i cili duhet të jetë rënë dakord nga Inxhinieri i pavarur. Ky plan është pjesë e Manualit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes që përshkruhet në klauzolën 3.1.4.3 të kësaj Shtojce 5. Plani në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme duhet të përditësohet çdo vit për të pasqyruar mësimet e nxjerra nga ngjarjet e jashtëzakonshme dhe incidentet në të shkuarën. Sa u takon situatave të jashtëzakonshme gjeoteknike, kërkesat minimale të nënpjesës përkatëse të Planit në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme jepen në Lidhjen 6 të kësaj Shtojce 5.

Situatat e jashtëzakonshme do të trajtohen brenda afateve të kërkuara të përgjigjes. Koncesionari duhet të sigurojë që të ketë një anëtar të ekipit drejtues të Qendrës së kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes në dispozicion në çdo moment për të trajtuar ngjarjet e jashtëzakonshme. Ngjarjet e jashtëzakonshme regjistrohen dhe i raportohen Inxhinierit të pavarur brenda 24 (njëzet e katër) orëve pasi ndodhin dhe në relacionet mujore sipas kërkesave të raportimit të Lidhjes 5 të kësaj Shtojce 5.

Koncesionari do të bëjë gjithçka të mundur në mënyrë të arsyeshme për të siguruar që nivelet normale të shërbimit të rivendosen sa më shpejt pas çdo ngjarjeje të jashtëzakonshme.

c) Koha e përgjigjes

Ngjarjet e jashtëzakonshme që ndodhin duhet të marrin përgjigje të efektshme dhe të duhur në vend, brenda 2 (dy) orëve pasi t'i jetë komunikuar Koncesionarit ngjarja e jashtëzakonshme. Zgjidhja përfundimtare e ngjarjeve të jashtëzakonshme varet nga lloji i tyre dhe kryhet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, në konsultim me Inxhinierin e pavarur në mënyrë që të bëhen të parrezikshme të gjitha segmentet e rrezikshme të autostradës dhe të informohet Qendra e kontrollit për llojin e defektit dhe për aktivitetet e nevojshme të mirëmbajtjes.

3.3.3 Trajtim i incidenteve

a) Përshkrimi i detyrës

Trajtim i incidenteve përfshin:

- Përgjigjen ndaj incidenteve dhe kërkesave për ndihmë;
- Përgjigjen ndaj defekteve që mund të jenë të rrezikshme për përdoruesit e rrugës;
- Instalimin e menaxhimit të përkohshëm të trafikut ose barrierave dhe tabelave paralajmëruese në mënyrë që të kryhen riparimet ose të mbrohen përdoruesit e rrugës nga rreziqet e mundshme;
- Largimin e shkëmbinjve, dherave, pemëve të rëna ose pengesave të tjera që përbëjnë rrezik për trafikun;
- Punën pastruese dhe riparuese për shkak të aksidenteve;
- Mirëmbajtjen në situatë të jashtëzakonshme, pa përfshirë atë që mbulon klauzola 3.3.2 e kësaj Shtojce 5, që duhet kryer pa vonesë.

Koncesionari ngre dhe mirëmban një sistem për t'i dhënë mundësi Autoritetit Kontraktues, policisë, Inxhinierit të pavarur dhe të gjitha shërbimeve të urgjencës të kontaktojnë me Qendrën e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes në lidhje me çdo incident.

Koncesionari vë në dispozicion krahu e punës, impiantin, burimet teknike dhe materialet e nevojshme për të trajtuar incidentet brenda afateve të kërkuara të përgjigjes.

b) Kërkesat

Në çdo moment 95% e të gjitha incidenteve të jashtëzakonshme duhet të marrin përgjigje brenda afateve të kërkuara të përgjigjes.

Periodha e matjes për vlerësimin e respektimit të kësaj kërkesë është 1 (një) muaj.

c) Koha e përgjigjes

Incidentet që ndodhin duhet të marrin përgjigje të efektshme dhe të duhur (pra të bëhet rruga e parrezikshme) në vend, 60 (gjashtëdhjetë) minutave pasi t'i jetë kaluar Koncesionarit incidenti. Zgjidhja përfundimtare e incidenteve varet nga lloji i tyre dhe kryhet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, në mënyrë që të bëhen të parrezikshme të gjitha segmentet e rrezikshme të autostradës dhe të informohet Qendra e kontrollit për aktivitetet e tjera të nevojshme.

Lejohet një shkallë e arsyeshme tolerance nëse Koncesionari po merret me më shumë se 1 (një) incident në të njëjtën kohë.

Lejohet gjithashtu një shkallë e arsyeshme tolerance për incidentet në vendndodhjet e renditura në kategorinë 2 dhe kategorinë 3 të Shtojcës 9 për sa kohë që këto vendndodhje qëndrojnë të hapura, si edhe në zona ku parashikohet komunikim me një palë të tretë.



3.4 Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja në stinë e dimrit

3.4.1 Hyrje

Koncesionari e shfrytëzon dhe mirëmban Autostradën gjatë stinës së dimrit në përputhje me standardet që përshkruhen më poshtë.

Një Plan i mirëmbajtjes gjatë dimrit i dorëzohet në version paraprak Inxhinierit të pavarur për aprovim përpara se Koncesionarit t'i lejohet të arkëtojë taksën e rrugës dhe jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara fillimit për herë të parë të operacioneve të dimrit; versioni përfundimtar i Planit të mirëmbajtjes gjatë dimrit duhet të dorëzohet 1 (një) muaj përpara fillimit të operacioneve. Planit i mirëmbajtjes gjatë dimrit duhet të përditësohet çdo vit për të përfshirë mësimet e nxjerra nga dimri i fundit.

Koncesionari ngre dhe mirëmban një sistem për t'i dhënë mundësi Autoritetit Kontraktues, Inxhinierit të pavarur dhe të gjitha shërbimeve të urgjencës të kontaktojnë me Qendrën e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.

Koncesionari, duke marrë parasysh kushtet klimatike të zonës dhe parashikimet e motit, do të përcaktojë fillimin dhe fundin e periudhës së dimrit. Koncesionari vendos të gjitha koordinimet e nevojshme me autoritetet shqiptare në mënyrë që gjatë stinës së dimrit parashikimi zyrtar i motit që përdoret nga Qeveria e Shqipërisë për të gjitha qëllimet e lidhura me funksionet e Republikës së Shqipërisë (përfshirë edhe menaxhimin dimëror të rrugëve publike) t'i vihet në dispozicion Qendrës së Kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të Koncesionarit. Koncesionari duhet të kryejë veprimet/procedurat dhe punimet thelbësore si më poshtë, si gjatë të gjithë stinës së dimrit ashtu edhe përpara se të fillojë dimri:

- i. Puna përpara fillimit të stinës së dimrit
Afërsisht 20 (njëzet) ditë përpara fillimit të periudhës së dimrit, personeli që do të angazhohet në punimet e mirëmbajtjes dimërore duhet të marrë informacion të hollësishëm për planin e pastrimit të dëborës dhe makineritë dhe pajisjet e nevojshme për mirëmbajtjen dimërore duhet të jenë të gatshme për inspektim për të siguruar që janë në gjendje të mirë pune. Në depon e përcaktuar për magazinimin e kripës duhen magazinuar sasi të nevojshme të kripës. Kripa e mbetur nga dimri i fundit duhet të shihet nëse është apo jo e përshtatshme për përdorim.
- ii. Puna në fillim të stinës së dimrit
Koncesionari, duke marrë parasysh kushtet klimatike të zonës, do të përcaktojë fillimin e periudhës së dimrit. Puna e realizuar gjatë periudhës së dimrit përfshin parandalimin e formimit të akullit në sipërfaqen e rrugës nëpërmjet hedhjes së sasisë së duhur të kripës; pastrimin e rrugës nga sipërfaqja e rrugës, njëkohësisht duke hedhur kripë dhe duke larguar automjetet e palëvizshme nga Autostrada. Koncesionari do të vihet në gatishmëri që në fillim të periudhës së dimrit. Automjetet, instalimet, pajisjet dhe materialet që do të përdoren gjatë periudhës së dimrit duhet të jenë gati për përdorim në depot e përcaktuara të magazinimit të kripës, në bazë të Planit për motin e keq, ndërsa personeli do të jetë në gatishmëri në çdo orë të ditës dhe natës (në shtëpi ose gjetkë) gjatë të gjithë stinës së dimrit, në mënyrë që të mund të veprohet menjëherë në rast të reshjeve të borës dhe ngricave.
Në kushte moti të keq, personeli i Koncesionarit duhet të jetë gati për të zënë pozicion brenda një kohe të shkurtër (në mënyrë orientuese, 2 orë) në mënyrë që të fillojë punën për pastrimin e borës. Gjatë mirëmbajtjes së periudhës së dimrit, personeli i Koncesionarit duhet të punojë pa pushim, derisa të jenë zbutur kushtet e motit të keq.
- iii. Fundi i mirëmbajtjes gjatë stinës së dimrit
Në varësi të kushteve mbizotëruese të motit dhe gjendjes së sipërfaqes së rrugës, Koncesionari do të përcaktojë fundin e mirëmbajtjes dimërore dhe do të kthehet në gatishmëri pas çdo episodi të veçantë moti të keq. Depot e magazinimit të kripës do të mbushen me sasi të nevojshme të kripës dhe të gjithë automjetet e përdorur gjatë pastrimit të dëborës do t'i nënshtrohen mirëmbajtjes dhe kontrollit.

- iv. Fundi i stinës së dimrit
Fundit i stinës së dimrit do të përcaktohet duke marrë parasysh kushtet klimatike të zonës dhe parashikimet e motit të zyrës meteorologjike.
- v. Puna pas fundit të stinës së dimrit
Koncesionari duhet të sigurojë pastrimin e depove të magazinimit të kripës dhe të kryejë riparimet & mirëmbajtjen e nevojshme të instalimeve.

3.4.2 Heqja e dëborës

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin aktivitetet e nevojshme për të mundësuar funksionimin e Autostradës gjatë periudhave me dëborë të dimrit.

Koncesionari ngre dhe mirëmban një sistem për t'i dhënë mundësi Autoritetit Kontraktues, Inxhinierit të pavarur dhe të gjitha shërbimeve të urgjencës të kontaktojnë me Qendrën e kontrollit.

Koncesionari vë në dispozicion krahu e punës, burimet teknike, pajisjet rezervë dhe materialet e nevojshme për të kryer aktivitetet e mirëmbajtjes gjatë dimrit brenda shteteve të kërkuara të përgjigjes.

b) Kërkesat

Duhet hequr pa vonesë dëbora në të gjithë gjerësinë e karrexhatës, përfshirë edhe korsinë e urgjencës/ndalimit. Pirgjet e dëborës nuk duhet të jenë në karrexhatë.

Nëse është e nevojshme, heqja e dëborës duhet të ndërthuret me përdorimin e agjentëve akull-largues për të hequr akullin nga sipërfaqja e rrugës.

c) Koha e përgjigjes

- Largimi i dëborës duhet të fillojë brenda 40 (dyzet) minutave prej fillimit të reshjeve të konsiderueshme të dëborës;
- Lartësia maksimale e dëborës kur Koncesionari duhet të ketë filluar largimin e dëborës është 10 centimetra;
- Pajisjet e largimit të dëborës duhet të shfrytëzohen në cikle me nga 2 (dy) orë në secilën pjesë të Autostradës;
- Dëbora e rënë mund të qëndrojë në rrugë deri në 2 (dy) orë ditën dhe 4 (katër) orë natën;
- E gjithë dëbora duhet të hiqet nga e gjithë gjerësia e karrexhatës, përfshirë edhe korsinë e urgjencës/ndalimit, brenda 6 (gjashhtë) orëve pas reshjeve të fundit të matshme të dëborës; kjo hapësirë kohe mund të jetë deri në 12 (dymbëdhjetë) orë gjatë periudhave me pik të theksuar trafiku; në ato pjesë të Autostradës ku ka shumë pak mundësi për të mbajtur dëborën e hequr në buzë të karrexhatës, në varësi të pëlqimit që jep Inxhinieri i pavarur, mund të mendohet të hiqet dëbora nga korsa e djathtë dhe korsa e ndalimit/urgjencës.
- Gjatë reshjeve të dendura të dëborës duhet të mobilizohen pajisje të mjaftueshme në mënyrë që të paktën 1 (një) korsi trafiku të qëndrojë e hapur në çdo moment;
- Akumulimet maksimale të lejueshme gjithsej në secilën korsi të karrexhatës janë 10 centimetra;
- Akulli në sipërfaqe duhet të trajtohet me agjent akull-largues brenda 2 (dy) orëve pas heqjes së dëborës;

- Periudha maksimale e kohës që nga fundi i reshjeve të matshme të dëborës gjatë së cilës Koncesionari duhet ta ketë shtyrë dëborën dhe akullin përtej bordeve të korsisë anësore të urgjencës është 7 (shtatë) ditë.

3.4.3 Mbjajtja nën kontroll e akullit

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë kërkon parandalimin e formimit të akullit dhe eliminimin e akullit në mënyrë që të mundësohet lëvizja pa rrezik e trafikut gjatë periudhave dimërore, duke përdorur agjentë kundër akullit dhe akull-largues.

Koncesionari vë në dispozicion krahun e punës, burimet teknike, pajisjet rezervë dhe materialet e nevojshme për të kryer aktivitetet e mbajtjes nën kontroll të akullit brenda afateve të kërkuara të përgjigjes.

b) Kërkesat

Duhet të parandalohet formimi i akullit në të gjithë gjerësinë e karrexhatës, përfshirë edhe korsinë e urgjencës/ndalimit, nëpërmjet përdorimit të agjentëve kundër akullit (për shembull, kripë). Karrexhata mund të mbetet me lagështirë por nuk duhet të ketë akull.

Nëse formohet akull për shkak të kushteve të këqija të motit, ai duhet trajtuar me agjent akull-largues. Sa herë që metodat e tjera nuk arrijnë ta mbajnë karrexhatën pa kushte rrëshqitjeje në përputhje me kohën e përgjigjes të parashikuar në këtë Shtojcë 5, Koncesionari duhet të përdorë lëndët abrazive. Koncesionari siguron që automjetet në patrullim të veprojnë për të rivendosur cilësinë e forcës së fërkimit të sipërfaqes duke përdorur menjëherë materiale abrazive dimri kur hasen kushte të rrëshqitjes ekstreme.

c) Koha e përgjigjes

Agjenti akull-largues duhet përhapur brenda 2 (dy) orëve pas marrjes së një vendimi në bazë të parashikimit të akullit apo motit të keq ose pasi Koncesionari të ketë marrë dënimin të formimit të akullit.

Koncesionari duhet të fillojë përdorimin e materialit abraziv në kushte akulli ekstrem brenda 6 (gjashtë) orëve nga momenti kur zbulohen për herë të parë kushte të tilla ose kur njoftohet Koncesionari.

3.5 Kërkesat për mirëmbajtjen rutinë

3.5.1 Hyrje

Koncesionari e mirëmban Autostradën në përputhje me standardet që përshkruhen më poshtë.

Vrojtimet vlerësuese për mirëmbajtjen që kanë nevojë për menaxhim të trafikut duhen kryer sa herë të jetë e mundur në të njëjtën kohë me vrojtimet e tjera që kërkojnë masa të ngjashme të menaxhimit të trafikut. Gjithashtu, të gjitha vrojtimet duhen organizuar në atë mënyrë që të minimizojnë ndërprerjen e udhëtimit dhe vonesat për Përdoruesit dhe prioritet u duhet dhënë të gjitha aspekteve të sigurisë.

Metodat e vrojtimit të përshkuara në këtë seksion përfaqësojnë teknologjinë e tanishme. Mund të përdoren teknologji të ngjashme ose më të mira në varësi të marrjes së aprovimit nga Inxhinieri i pavarur.

Koncesionari duhet të përgatisë programe tremujore të mirëmbajtjes rutinë. Programi fillestar duhet t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues në përputhje me klauzolën 21.8.12 të Kontratës së Koncesionit. Këto programe duhet të përditësohen dhe të dorëzohen për aprovim çdo tremujor.

Çdo tremujor Koncesionari duhet t'i dorëzojë Inxhinierit të pavarur një relacion ku përshkruhet puna e realizuar në tremujorin e fundit dhe programet e mirëmbajtjes të propozuara për të ardhmen siç përshkruhen më lart.

3.5.2 Mirëmbajtja e shtresave të rrugës

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin monitorim dhe ndërhyrje mirëmbajtje në shtresat e Autostradës për të arritur standardet minimale sa i takon gjendjes.

b) Kërkesat

Gjendja e shtresave duhet të testohet çdo vit për çdo pjesë të rrugës në përputhje me Kërkesat për inspektim të përshkruara në tabelën 4-1 të seksionit 4 të kësaj Shtojce 5 për të matur, analizuar dhe raportuar gjendjen e vlerësuar të shtresave të çdo karrexhate në pjesë prej 1 km secila. Gjendja e shtresës duhet të raportohet, sipas mënyrës të rënë dakord me Inxhinierin e pavarur, për secilin parametër të përfshirë në tabelën 3-1 të kësaj Shtojce 5.

Standardet minimale të pranueshme dhe metodat e vërtimit paraqiten në tabelën 3-1 më poshtë. Koncesionari duhet të ndërmerret të gjithë punën e nevojshme për të rikthyer pjesët nën-standard në një standard të pranueshëm. Koncesionari duhet të respektojë të gjitha rishikimet, shtesa, ndryshimet dhe zëvendësimet e mëpasshme që u bëhen standardeve/udhëzimeve të përshkruara me hollësi.

Koncesionari duhet të dorëzojë një raport vjetor ku jep informacionin si vijon:

- Gjendja e shtresave (për çdo kilometër të çdo korsie) duke përdorur parametrat e tabelës 3-1;
- Të dhëna të hollësishme për çdo riparim kapital të kryer vitin e fundit;
- Programi vjetor i mirëmbajtjes dhe ai për 3 (tre) vitet e ardhshme;
- Ndryshimet e propozuara për grafikun kohor të mirëmbajtjes rutinë.

Defektet në sipërfaqen e shtresës së rrugës që mund të përbëjnë rrezik të menjëhershëm për përdoruesit e rrugës (grupat, defektet e skajeve të rrugës etj.) do të trajtohen si defekte të kategorisë I (shih seksionin 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5).

Tabela 3-1: Parametrat vlerësues për mirëmbajtjen e shtresave të rrugës

Përshkrimi	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vërtimit	Objektivi/Koha e përgjigjes
Rezistenca në fërkim	$\geq 0,35$	Testues i rezistencës në fërkim	Çdo 36 muaj	Në çdo kohë, jo më shumë se 5% e rjetit mund të mos përmbushë nivelin e ecurisë
				18 muaj

Formimi i kanaleve ku kalojnë rrotat	Jo më shumë se 15mm.	mm	Çdo 12 muaj	Në çdo kohë, jo më shumë se 5% e rrjetit mund të mos përmbushë nivelin e ecurisë 18 muaj
Ashpërsia gjatësore	<3,0	Indeksi Ndërkombëtar i Ashpërsisë (IRI) m/Km	Çdo 12 muaj	Në çdo kohë, jo më shumë se 5% e rrjetit mund të mos përmbushë nivelin e ecurisë 18 muaj
Forca strukturore (jetëgjatësia e mbetur)	≥ 5 vjet	Deflektograf me peshë (dhe programi përkatës)	Kur duhet sipas Indeksit Ndërkombëtar të Ashpërsisë dhe rezultateve të kontroleve me sy, por të paktën çdo 48 muaj	Në çdo kohë, jo më shumë se 5% e rrjetit mund të mos përmbushë nivelin e ecurisë 24 muaj
Plasaritjet nga kalimi i rrotave	≤ 10%	Kontrolli me sy	Çdo 12 muaj	Në çdo kohë, jo më shumë se 10% e rrjetit mund të mos përmbushë nivelin e ecurisë 3 muaj

c) Koha e përgjigjes ose toleranca e lejuar

Gjendja e shtresës që nuk plotëson nivelet minimale të ecurisë të përshkruara në tabelën 3-1 duhet të kthehet në standardin e kërkuar brenda kohës së përcaktuar në tabelën 3-1. Sipërfaqja e riparuar duhet të jetë objekt i një raporti të ri po atë vit kur përfundojnë punimet.

Nëse rezistenca në fërkim bie nën standardin e pranueshëm, duhen vendosur menjëherë tabela paralajmëruese gjër në kthimin e gjendjes në normale.

3.5.3 Shpatet, punimet gjeoteknike dhe mirëmbajtja e bordit të paasfaltuar

a) Përshkrimi i detyrës

Mirëmbajtja e shpateve (mbushje e trupit të rrugës dhe gërryerje shpati), punimet gjeoteknike (masa stabilizimi/rehabilitimi) dhe bordet e paasfaltuara (kur ka) dhe sigurimi që të funksionojnë siç duhet.

Kjo detyrë përfshin:

- Në lidhje me shpatet dhe punimet gjeoteknike:
 - pastrimi i materialit të rrëshqitshëm deri në 200 m¹;
 - mirëmbajtja e kapacitetit të shpateve të gërryera për hapjen e rrugës, për të evituar defektet dhe për të mbrojtur rrugën nga prurjet shkëmbore;
 - parandalimi i kompromentimit të stabilitetit të shpateve dhe punimeve të tjera nga erozioni;
- Në lidhje me bordet e paasfaltuara:

- ruajtja e nivelit të duhur në raport me sipërfaqen e karrexhatës;
- rimbushja e gropave në bordet anësore të hapura nga shkaqe natyrore ose nga automjetet.

b) Kërkesat

Të gjitha shpatet, punimet gjeoteknike dhe bordet e paasfaltuara duhet të kontrollohen nga gjeolog inxhinier/inxhinierë gjeoteknik me kualifikimin dhe përvojën e duhur, në përputhje me kërkesat e programit të kontrollit dhe monitorimit dhe manualit përkatës që do të hartohet nga Koncesionari dhe aprovohet nga Autoriteti Kontraktues. Kur materiali rrëshqitës është më i madh 200 metra kub, Koncesionari njofton Inxhinierin e pavarur në mënyrë që të kryhen hetime shtesë në atë zonë në lidhje me kushtet ekzistuese gjeoteknike dhe rreziqet urgjente të mundshme.

Gjithashtu, për shpatet dhe punimet gjeoteknike zbatohen parashikimet specifike të tabelës 3-2.

Bordet anësore të paasfaltuara duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- mund të ketë një diferencë në nivel ndërmjet bordit anësor dhe sipërfaqes së karrexhatës jo më të madhe se 5 centimetra;
- prerja tërthore e bordit anësor nuk duhet të pengojë kullimin e ujit për t'u larguar nga karrexhata.

c) Koha e përgjigjes

Koncesionari duhet të veprojë pa vonesë për t'i bërë të parrezikshme bordet anësore dhe shpatet që mund të shkaktojnë rrezik të menjëhershëm për përdoruesit e rrugës ose që prekën gjerësinë e gatshme të karrexhatës si në një situatë të jashtëzakonshme (defekte të kategorisë I) në bazë të seksionit 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5. Nëse nuk është i mundur riparimi i menjëhershëm, duhen vendosur tabela të përkoreshme paralajmërimi dhe duhen bërë riparime urgjente për ta bërë zonën në fjalë të sigurt brenda 7 (shtatë) ditëve nga ndodhja e defekteve.

Riparimet e përhershme të bordeve anësore dhe qendrore duhen kryer brenda 28 (njëzet e tetë) ditëve pasi të jenë krijuar kushtet që lejojnë realizimin e punimeve të dhëtit.

Riparimet e përhershme të shpateve (pra punimet për rehabilitimin e shpateve dhe skarpateve), përkatësisht, të identifikuara nga Koncesionari dhe inxhinieri i pavarur, duhet të kryhen nga Autoriteti Kontraktues përpara fillimit të stinës së ardhshme të shirave dhe jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga shfaqja e defektit.

Tabela 3-2: Standardet e mirëmbajtjes për shpatet dhe punimet gjeoteknike

Përshkrimi	Niveli i shërbimit	Matja/zbulimi	Koha e lejuar për riparimet ose toleranca e lejuar
Mbushje e trupit të rrugës	Erozioni dhe deformimet nuk duhet të përbëjnë rrezik për rrugën. Në asfalt nuk duhet të duket asnjë plasaritje ose deformim.	Kontroll me sy 3 herë në vit (me instrumente nëse është nevojë).	Riparimet duhet të kryhen sa më shpejt.

Përshkrimi	Niveli i shërbimit	Matja/zbulimi	Koha e lejuar për riparimet ose toleranca e lejuar
Shpatet e gërryera për hapjen e rrugës	Rruga duhet të jetë e pastër nga prurjet shkëmbore. Zbatim i menjëhershëm i planit në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme (përdorimi i tabelave të përkohshme, devijimeve, sinjalizimit etj.).	Kontroll me sy Për rrëshqitjet më shumë se 200m ³ , vëllimi matet me rlievim topografik dhe lixhinieri i pavarur informohet, i cili më pas bën verifikimin.	<p>Prurjet duhen hequr.</p> <p>Vëllimet nën 50 m³:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nga shtresa e rrugës brenda 12 (dymbëdhjetë) orëve pas zbulimit, me kusht që korsia e prekur të jetë mbyllur (të jetë siguruar). Nga korsia anësore dhe kanalet anësore brenda 48 (dyzet e tetë) orëve pas zbulimit. <p>Nga 50 m³ deri në 200 m³:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nga shtresa e rrugës brenda 48 (dyzet e tetë) orëve pas zbulimit. Nga korsia anësore dhe kanalet anësore brenda 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) orëve pas zbulimit. <p>Mbi 200m³:</p> <ul style="list-style-type: none"> Operacionet e pastrimit duhet të fillojnë brenda 18 orëve pas zbulimit. Fluksi i trafikut të rivendoset sa më shpejt (në marrëveshje me dhënësin e grantit).



Përshkrimi	Niveli i shërbimit	Matja/zbulimi	Koha e lejuar për riparimet ose toleranca e lejuar
Kullimi i skarpateve	Kanalet e kullimit në kreshtë, shkallëzimet, bankinat e veshura dhe kanalet e tjera të veshura duhet të jenë pa prurje shkëmbore dhe të mos shfaqin asnjë dëmtim. Fluksi i ujërave nuk duhet të hasë në pengesa. Erozioni në shkallëzim dhe dalje të tombinave duhet të jetë minimal dhe të mos komprometojë stabilitetin e rrugës.	Kontroll me sy 3 herë në vit.	Pastrimi i prurjeve shkëmbore dhe riparimet duhet të bëhen brenda 4 javëve pas zbulimit ose siç parashikohet në raportin gjeoteknik vjetor.
	Hendeqet e kullimit duhet të jenë plotësisht funksionale.	Kontrolle vjetore me sy në pikat e shkarkimit dhe/ose puseta për të verifikuar rrjedhën e ujit.	Riparimet duhet të bëhen sa më shpejt por jo më vonë se stina e ardhshme pa shira.
Bankinat anësore	Duhet të jenë pa prurje shkëmbore. Dy bankinat e poshme nuk duhet të shfaqin asnjë zvogëlim të gjerësisë për shkak të defekteve të skarpateve poshtë tyre.	Kontroll me sy 3 herë në vit.	Riparimet duhet të kryhen brenda 12 muajve ose siç parashikohet në raportin gjeoteknik vjetor.
Gardhet mbrojtëse nga prurjet shkëmbore	Nuk duhet të kenë prurje shkëmbore të akumuluar dhe duhet të ruajnë kapacitetin për të mbrojtur në përputhje me kriteret dhe specifikimet e prodhuesit.	Kontroll me sy çdo vit dhe pas çdo rasti kur ka rënie/prurje shkëmbore.	Pastrimi dhe riparimet duhen kryer brenda 2 muajve nga rënia ose zbulimi i defektit.
Ankerat në shkëmb	Nuk duhet të kenë ndryshk me topri.	Kontroll me sy - nxjerrje e ankerave.	Riparimet duhet të kryhen brenda 12 muajve ose siç parashikohet në raportin gjeoteknik vjetor.
Muret mbajtëse dhe pritëse	Të mos kenë asnjë dëmtim të dukshëm ose deformime të tepërta. Xhamot të jenë në gjendje të mirë. Vrimat kultuese të jenë jo të bllokuara. Pas tyre të ketë shtunë pak ose aspak akumulim prurjesh shkëmbore.	Kontroll me sy çdo vit	Pastrimi dhe riparimet duhet të kryhen brenda 12 muajve ose siç parashikohet në raportin gjeoteknik vjetor.

Përshkrimi	Niveli i shërbimit	Matja/zbulimi	Koha e lejuar për riparimet ose toleranca e lejuar
Betonimi me beton të spërkatur	Të mos ketë plasaritje të tepruara, leskrim, shenja të presionit hidrostatik ose bimësisë së dukshme tejet.	Kontroll me sy çdo vit	Riparimet duhet të kryhen brenda 12 muajve ose siç parashikohet në raportin gjeoteknik vjetor.
Prita ngadalësuese	Duhet të jenë të qëndrueshme pa deformime të tepërta, pa akumulim prurjesh dhe pa komprometim të stabilitetit nga erozioni.	Kontroll me sy çdo vit	Riparimet/pastrimi i prurjeve shkëmbore duhet të bëhet brenda 12 muajve ose siç parashikohet në raportin gjeoteknik vjetor.
Rrjetat me anкера dhe rrjetat e hedhura mbi shpat	Duhet të shfaqin pak ose aspak dëmtime. Çdo akumulim prurjesh pas tyre nuk duhet të shkaktojë rritje të trysnisë lokale. Ankerat nuk duhet të kenë ndryshk me tepri.	Kontroll me sy çdo vit	Riparimet duhet të kryhen brenda 12 muajve ose siç parashikohet në raportin gjeoteknik vjetor.
Bimësi në skarpat (kur ka)	Bimësia të jetë në gjendje të mirë në të gjithë sipërfaqen. Bimësia në sipërfaqet e gërryera ose të riparuar të jetë rivendosur.	Kontroll me sy çdo vit	Riparimet duhet të kryhen brenda 12 muajve ose siç parashikohet në raportin gjeoteknik vjetor.

3.5.4 Mirëmbajtja e strukturave

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin monitorimin dhe ndërhyrjen për mirëmbajtje të strukturave për të arritur një standard minimal të gjendjes së "Mirë" (siç përcaktohet në tabelën 3-3).

Tabela 3-3: Klasifikimi i gjendjes së strukturave

Klasifikimi i gjendjes	Kategoria e gjendjes	Përshkrimi
6	Shkëlqyeshëm	Siç është ndërtuar
5	Shumë mirë	Asnjë problem nuk vihet re gjatë kontrollit të përgjithshëm ose kryesor
4	Mirë	Vetëm probleme të vogla
3	Pranueshëm	Të gjithë elementet strukturore kryesore janë në gjendje solide por mund të ketë humbje të vogël të vëllimit, plasaritje, prishje dhe brejtje
2	Keq	Humbje e avancuar e vëllimit, përkeqësim, prishje ose brejtje e avancuar

I	Rëndë	Humbja e vëllimit, përkeqësimi, prishja ose brejtja kanë prekur rëndë komponentët strukturorë parësorë. Mund të ketë prishje lokale të strukturës. Mund të ketë çarje nga presioni.
---	-------	---

Mirëmbajtja e strukturave inxhinerike përfshin kontrollet sipas seksionit 4 të kësaj Shtojce 5, në përputhje me standardet e njohura evropiane ku përfshihet praktika e mirë e sektorit ekonomik dhe Sistemi i menaxhimit të urave i Koncesionarit dhe vlerësimin e gjendjes së komponentëve duke marrë veçanërisht në konsideratë:

- papastërtitë (prurjet, mbetjet organike dhe joorganike, shkarravinat);
- bimësinë në strukturë, nën strukturë dhe përgjatë buzës së ujit në afërsi të urës (kur mund të prekë rëndë fortësinë e strukturës);
- rrjedhjet e ujit, sedimentet dhe njollat;
- dëmtimet e bojës mbrojtëse nga ndryshku (aatiruxho);
- gërryerjen, kalbjen, vjetrimin;
- gjendjen e hidroizolimit;
- plasaritjet dhe prishjen;
- dëmtimin e saldimeve ose xhuntove (në veçanti: plasaritjet e llaçit në mure, defektet e saldaturave, bulonave, perçinave, shufrave lidhëse në strukturat e çelikut);
- deformimet;
- zhvendosjet;
- humbjet e materialit ose erozionin;
- përkeqësimin e materialit të ndërtimit;
 - vandalizmat;
 - dëmet nga aksidentet.

Koncesionari ndërmerr kontrollet e parashikuara në seksionin 4 të kësaj Shtojce 5 dhe përgatit raportet e përshkruara më poshtë, si edhe sipas Lidhjes 5 të kësaj Shtojce 5. Koncesionari ndërmerr veprimet dhe riparimet i duhura për të arritur standardet e kërkuara.

Nëse zbulohen defekte ose dëmtime të rënda, duhen planifikuar riparimet e duhura ose duhet kryer një kontroll më i imtë. Nëse gjendja e një ure ose e një strukture tjetër përbën rrezik i menjehershëm për përdoruesit, trafiku në atë urë dhe/ose strukturë duhet të kufizohet pa vonesë. Defektet strukturorë që mund të përbëjnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës (beton i lëshuar etj.) do të trajtohen si defekte të kategorisë I në përputhje me seksionin 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5.

Me t'u bërë të parëzëshme rreziqet e mundshme, duhet kryer një kontroll i hollësishëm për të konstatuar shkallën e çdo problemi, punën ndreqëse që duhet të bëjë Koncesionari, grafikun kohor dhe çdo masë zbutëse, përfshirë edhe monitorimin.

b) Kërkesat

Kërkohej që elementet e poshtëpërmendur të një m/e/strukturore, si:

- shtresa e rrugës dhe trotuarët;

- parmakët, parapetet;
- konsolat;
- drenazhimi;
- brezat bashkues të urave;
- linjat e infrastrukturave të tjera publike;
- mekanizmat e lëvizjes së gjatësisë së urës;
- shtrati i lumit;
- menteshat;
- skarpitet dhe shpatet;
- struktura e sipërfaqes së urës;
- traversat kryesore;
- nyjat lidhëse;
- bazamenti dhe themeli i urës;
- shtyllat dhe themelet;
- muret mbajtës;
- këmbët e urës

duhet të mirëmbahen për të mbajtur të paktën klasifikimin e gjendjes "Mirë". Gjithashtu, zbatohen kërkesat edhe kërkesat specifike të tabelës 3-4.




Tabela 3-4: Nivelet e ecurisë së urave

Përshkrimi	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Sipeshësia e vrojtimit	Veprimi ndreqës	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
Kuverta e urës	Të mos ketë defekte në sipërfaqe, prishje ose beton të plasarit. Gjerësia e plasarit të mos jetë më shumë se 1 mm.	Kontroll me sy dhe matje	Siç përshkruhet në seksionin 4	Riparim i defekteve	Koha për riparimin – 6 muaj
Xhuntot e urave	Plotësisht funksionale dhe të mos pengojnë lëvizjen e strukturës ose lejojnë hyrjen e ujit	Kontroll me sy	Siç përshkruhet në seksionin 4	Riparim / zëvendësim i xhuntove	Koha për riparimin – 3 muaj

Përshkrimi	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vrojtimit	Veprimi ndreqës	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
Superstruktura e urës	<p>Superstruktura e urës duhet të jetë solide nga ana strukturore dhe nuk duhet të ketë prurje shkëmbore/dhera: të mos ketë leskra, plasaritje. Nuk lejohen dëmtimet e mbulesës prej betoni në strukturat beton-arme.</p> <p>Agregatet lidhëse duhet të mundësojnë nyjëzimin e duhur.</p> <p>Nyjat lidhëse duhet të jenë të pastra dhe solide.</p> <p>Platformat e nyjave lidhëse duhet të jenë të pastra dhe solide.</p>	Kontrolli me sy	Siç përshkruhet në seksionin 4	Pastrim, riparim i dëmtimeve, zëvendësim i elementeve me defekt	Koha për riparimin – 6 muaj
Nënstruktura e urës	<p>Të mos ketë humbje vëllimi ose plasaritje më të mëdha se 1 mm. Të mos ketë prishje.</p> <p>Nuk lejohen brejtje të dukshme.</p>	Kontrolli me sy	Siç përshkruhet në seksionin 4	Riparim	Koha për riparimin – 6 muaj
Parapetet e urës: metalik	<p>Parmakët, barrierat dhe parapetet të jenë të montuara dhe të funksionojnë si duhet.</p> <p>Metali:</p>	Kontrolli me sy	Siç përshkruhet në seksionin 4	Veprimi menjëherëshem – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj heqja dhe riparimi i dëmtimit	<p>Koha e përgjigjes – 45 minuta</p> <p>Koha për riparimin – 3 muaj</p>



Përshkrimi	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vrojtimit	Veprimi ndreqës	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
	<p>Të mos ketë humbje të dukshme të vëllimit.</p> <p>Të gjitha lidhjet të jenë solide dhe të shtrënguara.</p> <p>Të mos ketë pjesë që mungojnë ose që janë dëmtuar rëndë.</p> <p>Boja mbrojtëse të ofrojë një pamje estetike të arsyeshme.</p>				
Parapetet e urës: betoni	 <p>Parmakët, barrierat dhe parapetet të jenë të montuara dhe të funksionojnë si duhet.</p> <p>Betoni:</p> <p>Të mos ketë pjesë që mungojnë, janë dëmtuar ose përkeqësuar rëndë.</p> <p>Të mos ketë plasaritje më të mëdha se 2 mm.</p> <p>Nuk lejohen dëmtimet e mbulesës prej betoni ose gërryerje e dukshme.</p>	Kontroll me sy	Siç përshkruhet në seksionin 4	Veprimi menjehershëm – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj heqja dhe riparimi i dëmtimit	<p>Koha e përgjigjes – 60 minuta</p> <p>Koha për riparimin – 30 ditë</p>
Drenazhimi i urës	<p>Të mos ketë pjesë që janë dëmtuar ose përkeqësuar rëndë.</p> <p>Të mos ketë rrjedhje.</p>	Kalim i pastër dhe pa pengesë i ujërave. Nuk ka mbetje të dukshme	Siç përshkruhet në seksionin 4	Veprimi menjehershëm – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj heqja dhe riparimi i	<p>Koha e përgjigjes – 60 minuta</p> <p>Koha për</p>

Përshkrimi	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vrojtimit	Veprimi ndreqës	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
	Të mos ketë gërryerje të dukshme në pikat dalëse.	kripërash, prurjesh etj. Mbrojtja e pikave dalëse është e paprekur. Nuk duket se ka përmblytje.		dëmtimit	riparimin – 5 ditë
Trupi i rrugës në ngjitje me urën	Trupi i rrugës në ngjitje me urën është i lëmuar dhe në një kuotë me kuvertën e urës	Lëvizja e pliakës që lidh urën me trupin e rrugës është më pak se 10 mm.	Siç përshkruhet në seksionin 4	Veprimi menjehershëm – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi i dëmtimit	Koha e përgjigjes – 60 minuta Koha për riparimin – 6 muaj
Përforcimi i skarpateve dhe koneve të bazamenteve	Nuk lejohet dëmtimi, gërryerja ose deformimi i skarpatit dhe i koneve të bazamenteve	Kontroll me sy	Siç përshkruhet në seksionin 4	Veprimi menjehershëm – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi i dëmtimit	Koha e përgjigjes – 60 minuta Sa më shpejt
Pamja e urës	Të mos ketë shkarravina mbi struktura. Asnjë sipërfaqe e urës të mos ketë shkarravina.	Kontroll me sy	Siç përshkruhet në seksionin 4	Veprimi menjehershëm – pastrim	Koha për riparimin – 30 ditë

Sistemet hidroizoluese të elementeve strukturore duhen mbajtur të paprekur pa defekte të dukshme që vijnë nga rrjedhjet ose ndryshkja.

Nuk lejohet asnjë papastërti që mund të vihet re gjatë kontrollit rutinë ose atij të përgjithshëm.

Koncessionari duhet të dorëzojë një raport vjetor ku jep informacionin si vijon:

- Gjendja strukturore (për çdo urë ose strukturë tjetër) duke përdorur parametrat e tabelës 3-3;
- Propozime të hollësishme për trajtimin e çdo strukture në gjendje më pak se 4 ("Mirë");
- Të dhëna të hollësishme për çdo riparim kapital të kryer vitin e fundit;
- Të dhëna të përmbledhura për çdo kontroll të kryer vitin e fundit;

- Kopje të të gjitha raporteve të kontrollit;
- Programi vjetor i mirëmbajtjes dhe ai për 3 (tre) vitet e ardhshme;
- Ndryshimet e propozuara për grafikun kohor të mirëmbajtjes rutinë.

c) Koha e përgjigjes

Aktivitetet e mirëmbajtjes rutinë që nuk kërkojnë riparime strukturore, si rezultat i çdo inspektimi, duhet të përfundojnë brenda 1 (një) muaji, nëse nuk thuhet ndryshe në tabelën 3-4.

Nëse, si rezultat i kontrollit sipërfaqësor, kontrollit vjetor bazë ose kontrollit të hollësishëm, konstatohet se ekziston nevoja për riparime strukturore për ta kthyer strukturën në klasifikimin e gjendjes 4 ("Mirë"), atëherë koha e lejuar për përgatitjen e projektit dhe realizimin e punimeve është 2 (dy) vjet nga data e kontrollit.

Nëse, si rezultat i kontrollit sipërfaqësor, kontrollit vjetor bazë ose kontrollit të hollësishëm, konstatohet se ekziston nevoja për riparime kapitale ose rindërtim për ta kthyer strukturën në klasifikimin e gjendjes 4 ("Mirë"), atëherë koha e lejuar për përgatitjen e projektit dhe realizimin e punimeve është 2 (dy) vjet nga data e kontrollit.

Nëse gjendja e strukturës, sidomos traversat, kurvertat, shtyllat dhe bazamentet, përbën rrezik i menjehershëm për përdoruesit, duhet kufizuar pa vonesë trafiku në rrugë. Koncesionari do t'i përshpejtojë pa vonesë punimet në përputhje me një program të dorëzuar tek Autoriteti Kontraktues brenda 14 (katërnjëdhjetë) ditëve nga zbulimi i defektit.

Të gjitha defektet që mund të përbëjnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës dhe nuk kanë të bëjnë me superstrukturën i nënshtrohen riparimit urgjent sipas klauzolit 4.1.2.1 të seksionit 4 të kësaj Shtojce 5.

3.5.5 Mirëmbajtja e tunelit

a) Përshkrimi i detyrës

Objekti i mirëmbajtjes së tunelit është të mbahen aktivet e tunelit të Thirrës (si edhe aktivet e çdo tuneli tjetër që ndërtohet gjatë kohëzgjatjes së Koncesionit) në gjendje të parrezikshme dhe të shfrytëzueshme. Një mirëmbajtje e tillë duhet të nxisë parrezikshmërinë e publikut dhe personelit në udhëtim e sipër, të shmangë vonesat dhe të minimizojë çdo efekt mjedisor të padëshirueshëm.

Sistemet e monitorim-vlerësimit të tunelit duhet të funksionojnë së bashku në mënyrë që sistemi i përgjithshëm të funksionojë siç duhet dhe të sigurohet një mjedis i parrezikshëm për përdoruesit e tunelit. Është me rëndësi jetike që pajisjet e monitorim-vlerësimit të mirëmbahen mirë për të parandaluar avaritë e paparashikuara.

Qasja e mirëmbajtjes në lidhje me tunelet duhet të jetë në formën e kontrolleve të rregullta, shoqëruar me mirëmbajtje reaguese në përgjigje të rezultatit të këtyre kontrolleve. Kjo duhet të mbështetet me një program të vazhdueshëm mirëmbajtjeje rutinë (parandaluese) të verifikuar nga një program i plotë vetëkontrolli nga Koncesionari në varësi të aprovimit të Inxhinierit të pavarur që të kryejë auditimet e tij në çdo moment. Për të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike kjo mirëmbajtje parandaluese duhet të mbështetet në rekomandimet e prodhuesve.

Kjo detyrë përfshin monitorimin dhe mirëmbajtje parandaluese ose me ndërhyrje të tunelit/tuneleve për të arritur një standard minimal të gjendjes 4 ("Mirë") (siç përcaktohet në tabelën 3-5).

Tuneli(et): Koncesionari duhet të hartojë një program të plotë mirëmbajtjeje rutinë dhe riparimesh kapitale për të cilin duhet rënë dakord me Inxhinierin e pavarur dhe i cili duhet të shqyrtohet dhe përditësohet çdo vit. Riparimet kapitale duhet të përfshijnë remont kapital dhe zëvendësim të pajisjeve të tunelit dhe strukturës së tunelit, që duhet kryer në mënyrën dhe kohën që shkakton pengesën minimale për trafikun. Për punimeve civile, kërkesat e përgjithshme, specifikimet dhe udhëzime për hartimin dhe zbatimin e inspektimit të tunelit, monitorimit dhe punët e mirëmbajtjes janë dhënë në Shtojcën përkatëse 9.

Mirëmbajtja e tunelit, sa herë të jetë e mundur, duhet të kryhet gjatë periudhave me fluksin më të ulët të trafikut.

Mirëmbajtja e strukturave të tunelit dhe pajisjeve të monitorim-vlerësimit përfshin kontrollet sipas seksionit 4 të kësaj Shtojce 5, në përputhje me standardet e njohura evropiane ku përfshihet praktika e mirë e sektorit ekonomik dhe vlerësimin e gjendjes së komponentëve duke marrë veçanërisht në konsideratë:

- dherat, prurjet shkëmbore dhe shkarravinat;
- bimësinë në strukturë;
- drenazhimin e bllokuar;
- rrjedhjet e ujit, sedimente dhe njolla;
- dëmtimet e bojës mbrojtëse nga ndryshku (antiruxho) dhe karbonizimi;
- gërryerjen, kalbjen, vjetrimin;
- plasaritjet dhe çarjen;
- dëmtimin e saldimeve, xhuntove dhe bashkuesve (në veçanti: plasaritjet e llaçit në mure, defektet e saldaturave, bulonave, perçinave, shufrave lidhëse në strukturat e çelikut);
- deformimet;
- zhvendosjet;
- humbjet e materialit ose erozionin;
- përkeqësimin e materialit të ndërtimit;
- dëmet nga aksidentet.

Koncesionari ndërmerr kontrollet e parashikuara në seksionin 4 të kësaj Shtojce 5 dhe përgatit raportet e përshkruara më poshtë, si edhe sipas Lidhjes 5 të kësaj Shtojce 5.

Koncesionari ndërmerr veprimet dhe riparimet i duhure për të arritur standardet e kërkuara.

Nëse zbulohen defekte ose dëmtime të rënda, duhen planifikuar riparimet e duhura ose duhet kryer një kontroll më i intë. Nëse gjendja e strukturës përbën rrezik i menjehershëm për përdoruesit, trafiku në strukturë duhet të kufizohet pa vonesë. Defektet e tunelit që mund të përbëjnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës (beton i leskëruar etj.) do të trajtohen si defekte të kategorisë I në përputhje me seksionin 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5.

Me t'u bërë të parrezikshme rreziqet e mundshme, duhet kryer një kontroll i hollësishëm për të konstatuar shkallën e çdo problemi, punën ndreqëse që duhet të bëjë Koncesionari, grafikun kohor dhe çdo masë zbutëse, përfshirë edhe monitorimin.

b) Kërkesat

Kërkohej që elementet e poshtëpërmendur të tunelit, si:

- Veshja në sipërfaqe e mureve të tunelit;
- Veshja në brendësi të mureve të tunelit;
- Elementet e tjera strukturore;
- Kullimi;
- Brezat bashkues;
- Ankerat dhe sistemet mbështetëse mekanike;
- Bulona fiksues/sisteme mbështetës të E&M dhe Pajisjeve të Sinjalistikës;

të mirëmbahen në të paktën Klasifikimin e Gjendjes 4 ("Mirë") siç përshkruhet në tabelën 3-5 përveç "Bulona fiksues/sisteme mbështetës të E&M dhe Pajisjeve të Sinjalistikës" të cilët duhet të mirëmbahen të paktën në Klasifikimin e Gjendjes 5 ("Shumë Mirë") siç përshkruhet në Tabelën 3-5.

Gjendja e përgjithshme e elementeve strukturore të tunelit duhet të jetë jo më pak se klasifikimi i gjendjes 4 ("Mirë").

Kërkohej që të gjitha elementet mekanike dhe elektrike kryesore të tunelit, si:

- Sistemet e kontrollit
- Ajrimi
- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri
- Pompat e kullimit
- Ndriçimi
- Fokezimet

të mirëmbahen në përputhje të plotë me rekomandimet e prodhuesit.

Tabela 3-5: Klasifikimi i gjendjes për tunelin (vetëm elementet strukturore)

Klasifikimi i gjendjes	Kategoria e gjendjes	Përshkrimi i elementit strukturor
6	Shkëlqyeshëm	Siç është ndërtuar
5	Shumë mirë	Asnjë problem nuk vihet re gjatë kontrollit të përgjithshëm ose kryesor
4	Mirë	Vetëm probleme të vogla
3	Pranueshëm	Të gjithë elementet strukturore kryesore janë në gjendje solide por mund të ketë humbje të vogël të vëllimit, plasaritje, prishje dhe rrjedhje të vogla në bashkime.
2	Keq	Humbje e avancuar e vëllimit, përkeqësim, prishje dhe rrjedhje në bashkime.
1	Rëndë	Humbja e vëllimit, përkeqësimi dhe prishja kanë prekur rëndë komponentët strukturorë parësorë. Mund të ketë prishje lokale të strukturës. Mund të ketë çarje nga presioni. Përmblytje të rëndë ose të rregullt si rezultat i mosfunksionimit të sistemit të kullimit.

Koncesionari duhet të zbatojë një procedurë të rreptë auditimi për të verifikuar përmbushjen e këtyre objektivave dhe është përgjegjës për zbatimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme të programit të mirëmbajtjes parandaluese në rast se nuk arrihen objektivat e tabelës 3-6. Për çdo ndryshim të tillë duhet rënë dakord me Inxhinierin e pavarur.

Tabela 3-6: Respektimi i rekomandimeve të prodhuesit në lidhje me pajisjet e monitorim-vlerësimit të tunelit

Pajisja	Niveli i realizimit të mirëmbajtjes në përputhje me rekomandimet e prodhuesve
Me shumë rëndësi për parrezikshmërinë	99%
Gjithë pajisjet e tjera që nuk kanë shumë rëndësi për parrezikshmërinë	95%

Pajisjet kritike të sigurisë konsiderohen sistemet të cilat janë përfshirë në Shtojcën 1 të Direktivës 2004/54/KE e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian dhe/ose të çdo legjislacioni përkatës shqiptar.

Koncesionari duhet të dorëzojë një raport vjetor ku jep informacionin si vijon:

- Gjendja strukturore (për çdo tunel) duke përdorur parametrat e tabelës 3-5;
- Propozime të hollësishme për trajtimin e çdo tuneli në gjendje më pak se 4 ("Mirë");
- Pajisjet e monitorim-vlerësimit – niveli i përmbushjes duke përdorur parametrat e tabelës 3-6;
- Të dhëna të hollësishme për çdo riparim kapital të kryer vitin e fundit;
- Të dhëna të përmbledhura për çdo kontroll të kryer vitin e fundit;
- Kopje të të gjitha raporteve të kontrollit;
- Programi vjetor i mirëmbajtjes dhe ai për 3 (tre) vitet e ardhshme;
- Ndryshimet e propozuara për grafikun kohor të mirëmbajtjes rutinë.

Tabela 3-7: Nivelet e ecurisë së tunelit

Ërshkrimi	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vërtetimit	Veprimi ndreqës	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
Veshja në sipërfaqe të rureve të tunelit	Veshja duhet të jetë solide nga ana strukturore dhe nuk duhet të ketë prishje dhe plasaritje. Nuk lejohen	Kontroli me sy	1 muaj – sipërfaqësor	Pastrimi i veshjes jashtme. Riparimi i defekteve. Largimi	Koha për riparimin – 3 muaj

Përshkrimi	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vërtetimit	Veprimi i nevojshëm	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
	<p>dëmtimet e mbulesës prej betoni në strukturat beton-arme.</p> <p>Të mos ketë defekte në sipërfaqe.</p> <p>Pa bashkuese që rrjedhin dhe pa prurje të ngurta.</p> <p>Drenazhimi i pastruar.</p>		12 muaj – i hollësishëm	<p>prurjeve të ngurta.</p> <p>Zhblokim i drenazhimit.</p>	
<p>veshja në rëndësi të tureve të anelit</p>	<p>Shitësia e brendshme duhet të jetë aq e pastër sa për të siguruar nivelin e kërkuar të shkëlqimit.</p> <p>Duhet të jetë pa defekte, përfshirë heqjen e paneleve gjatë kontrollit parësor për të siguruar që bashkueset janë solide.</p>	Kontroll me sy	<p>1 muaj – sipërfaqësor</p> <p>12 muaj – i hollësishëm</p>	<p>Larje – vini re se kjo mund të pezullohet gjatë muajve të dimrit në marrëveshje me inxhinierin e pavarur.</p> <p>Veprimi menjehershëm – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi dhe rinovimi sipas nevojës.</p>	<p>Koha për riparimin – 1 muaj.</p> <p>Për shpeshtësinë e larjes duhet rënë dakord me inxhinierin e pavarur gjatë viteve të para të shfrytëzimit dhe kjo shpeshtësi duhet shqyrtuar çdo vit.</p>
<p>të gjitha strukturat e tjera</p>	<p>Të jenë të pastra dhe solide nga ana strukturore dhe të mos kenë defekte të konsiderueshme.</p>	Kontroll me sy	<p>1 muaj – sipërfaqësor</p> <p>12 muaj – i hollësishëm</p>	<p>Veprimi menjehershëm – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi dhe rinovimi sipas</p>	<p>Koha për riparimin – 6 muaj</p>

Shprehja	Përshkrimi	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vrojërimit	Veprimi ndreqës	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
					nevojës	
	brezat ashkues	Plotësisht funksionale, të mos pengojnë lëvizjen e strukturës	Kontrolli me sy	1 muaj - sipërfaqësor 12 muaj - i hollësishtëm	Pastrim, riparim i dëmtimeve	Koha për riparimin - 6 muaj
	ankerat dhe istemet mbështetëse teknike	Plotësisht funksionale dhe në gjendje të sigurojnë mbështetje pa trezik. Dëshiroi se është kryer testimi periodik i ankerave dhe testimi i tokëzimit dhe izolimit elektrik.	Kontrolli me sy dhe auditim	1 muaj - sipërfaqësor 12 muaj - i hollësishtëm	Veprimi i menjshprehur - rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi dhe rinovimi sipas nevojës	Koha për riparimin - 2 muaj
	menaxhimi i anelit	Plotësisht funksional. Të mos ketë pjesë që janë dëmtuar ose përbeqësuar rëndë. Dëshiroi që pompat, valvulat dhe tubat janë testuar dhe u është bërë shërbimi në përputhje me rekomandimet e prodhuesve. Të mos ketë rrjedhje. Të mos ketë gërryerje të dukshme në pjesat dalëse.	Kontrolli me sy dhe auditim. Kufiri i pastër dhe pa pengesë i ujërave. Nuk ka mbetje të dukshme krijëtrash, prurjeve etj. Mbrojtja e pjesëve dalëse është e paprekur. Nuk duhet se ka përmblyje.	1 muaj - sipërfaqësor 12 muaj - i hollësishtëm	Veprimi i menjshprehur - rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj luajtja dhe riparimi i dëmtimit	Koha e përgjigjes - 45 minuta Koha për riparimin - 3 ditë

Ershkrimi	Përcaktimi i nivelet të sigurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vrojtimit	Veprimi adresues	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
Sistemi i jrrimit	Tërësisht funksional. Dëshmi që sistemi është testuar dhe i është bërë shërbimi dhe është zëvendësuar në përputhje me rekomandimet e prodhuesve.	Kontrolli me sy dhe auditim	1 muaj - sipërfaqësor	Veprimi menjehershëm - rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi dhe rinovimi sipas nevojës	Koha e përgjigjes - 45 minuta Koha për riparimin - 3 ditë
	12 muaj - i hollësishëm		Koha për riparimin - 3 ditë		
Sistemi e driqimit	95% e ndriquesve funksionojnë si duhet. Dëshmi që sistemi i ndriqimit është testuar dhe i është bërë shërbimi dhe është zëvendësuar në përputhje me rekomandimet e prodhuesve.	Kontrolli me sy dhe auditim	1 muaj - sipërfaqësor	Veprimi menjehershëm - rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj zëvendësimi i pajtësive me defekt	Koha e përgjigjes - 45 minuta Koha për riparimin - 3 ditë
	12 muaj - i hollësishëm		Koha për riparimin - 3 ditë		
Ajisjet e mbrojtjes nga zjarri	Te gjitha pjesët e ekspozuara duhet t'u nënshtrohen proceseve të pastrimit normal të tunelit. Tërësisht funksional. Dëshmi që sistemi i mbrojtjes nga zjarri është testuar, i është bërë shërbimi dhe është zëvendësuar në përputhje me rekomandimet e	Kontrolli me sy dhe auditim	1 muaj - sipërfaqësor	Veprimi menjehershëm - rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi dhe rinovimi sipas nevojës	Koha e përgjigjes - 45 minuta Koha për riparimin - 3 ditë
	12 muaj - i hollësishëm		Koha për riparimin - 3 ditë		

Shprehja	Përcaktimi i nivelit të ecurisë	Mënyra e matjes	Shpeshtësia e vërtetimit	Veprimi ndreqës	Koha e përgjigjes / koha e riparimit
	prodhuesve.				
ë gjitha ajisjet dhe istemet e tjera teknike dhe letrike	Tërësisht funksional. Dëshmi që sistemet janë testuar, u është bërë shërbimi dhe janë zëvendësuar në përputhje me rekomandimet e prodhuesve.	Kontrolli me sy dhe auditim	1 muaj – sipërfaqësor 12 muaj – i thellësisht	Veprimi menjeherëshem – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi dhe rinovimi sipas nevojës	Koha e përgjigjes – 45 minuta Koha për riparimin – 5 ditë
nsioni resatar rinar, ekondor dhe istemet e akuzimit e enstacionet	Tërësisht funksional. Dëshmi që sistemet janë testuar, u është bërë shërbimi dhe janë zëvendësuar në përputhje me rekomandimet e prodhuesve.	Kontrolli me sy dhe auditim	1 vjetor – sipërfaqësor	Veprimi menjeherëshem – rivendosja e parrezikshmërisë, pastaj riparimi dhe rinovimi sipas nevojës	Koha e përgjigjes – 1 orë Koha për riparimin – 3 ditë

c) Koha e përgjigjes

Aktivitetet e mirëmbajtjes rutinë që nuk kërkojnë riparime strukturore, si rezultat i çdo inspektimi, duhet të përfundojnë brenda 1 (një) muaji, nëse nuk thuhet ndryshe në tabelën 3-7.

Nëse, si rezultat i kontrollit sipërfaqësor, kontrollit parësor ose kontrollit të posaçëm, konstatohet se ekziston nevoja për riparime strukturore për të kthyer strukturën në klasifikimin e gjendjes 4 ("Mirë") (siç përkufizohet në tabelën 3-5), atëherë koha e lejuar për përgatitjen e projektit dhe realizimin e punimeve është 1 (një) vit nga data e kontrollit.

Nëse, si rezultat i kontrollit sipërfaqësor, kontrollit parësor ose kontrollit të posaçëm, konstatohet se ekziston nevoja për riparime kapitale ose rindërtim për të kthyer strukturën në klasifikimin e gjendjes 4 ("Mirë") (siç përkufizohet në tabelën 3-5), atëherë koha e lejuar për përgatitjen e projektit dhe realizimin e punimeve është 2 (dy) vjet nga data e kontrollit.

Nëse gjendja e strukturës së tunelit përbën rrezik i menjeherëshem për përdoruesit, duhet kufizuar pa vonesë trafiku në rrugë. Koncesionari duhet të përshpejtojë pa vonesë punimet në përputhje me një program të dorëzuar tek Autoriteti Kontraktues brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga zbulimi i defektit.

Të gjitha defektet që mund të përbëjnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës dhe nuk kanë të bëjnë me strukturën e tunelit i nënshtrohen riparimit urgjent sipas klausolës 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5.

Vini re që mirëmbajtja e drenazhimit të tunelit duhet të bëhet në përputhje me seksionin 3.5.6 të kësaj Shtojce 5.

3.5.6 Mirëmbajtja e drenazhimit

3.5.6.1 Tubacionet e ujërave të zeza dhe të kullimit

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin:

- Zbrazjen e pusetave të shiut dhe të kolektorëve dhe pastrimin e tubave të kullimit (duke përfshirë sistemet e kullimit dhe ujërave të zeza të tunelit), dhe tubacioneve në mënyrë që të ruhet rrjedha e papenguar e ujit në çdo stinë;
- Kontrollin e rregullt funksional të instalimeve të drenazhimit;
- Monitorimin e vazhdueshëm të funksionimit të stacionit të pompave, kontrollet periodike mekanike dhe elektrike dhe mirëmbajtjen përkatëse të tubacioneve në stacionet e pompave.

b) Kërkesat

Pusetat e shiut dhe kanalet e kullimit si edhe pusetat e kullimit inspektohen, zbrazjen dhe pastrohen një herë në vit në pranverë pasi të jetë hequr rëra kundër akullit dhe sa herë që gropa e balies e pusetës mbushet ose sa herë që bllokohet tubacioni.

Kanalinat e sistemit të mbulimit dhe skara e kapakëve të jenë të pastër sa i takon zbrazjes.

Tubat e kullimit të shpëlahen çdo vit, nëse është e nevojshme, për t'i mbajtur tubacionet në gjendje pune.

Stacioni i pompave të mbahet në gjendje pune dhe të kontrollohet rregullisht në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Pas përfundimit të punave pusetat dhe tubacionet duhet të mos kenë rërë, prurje shkëmbore dhe mbetje organike.

Shkarkimet në lumenj dhe përrenj duhet të bëhen në respektim të ligjit shqiptar, Udhëzimeve të IFC-së për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë, për rrugët me pagesë dhe VNMS-së dhe PMMS-së së Koncesionarit, sipas seksionit 5.1 të kësaj Shtojce 5.

c) Koha e përgjigjes

Koncesionari duhet të veprojë pa vonesë nëse ndodhin defekte urgjente në drenazhim, që përbëjnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës, si situatë e jashtëzakonshme sipas seksionit 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5. Nëse nuk është e mundur riparimi i menjehershëm i defektit, duhet vendosur menjëherë tabela paralajmëruese dhe riparimi duhet kryer brenda 7 (shtatë) ditëve.

Kur shkarkimet nuk i plotësojnë kërkesat mëherë duhet punuar për të pakësuar ndotësit në nivelin e përcaktuar brenda 6 (gjashtë) muajve.

3.5.6.2 Tombinat

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë vlen për tombinat me gjatësi sa rruga deri në 0.6m, dhe përfshin pastrimin e tombinave dhe sigurimin që ato të funksionojnë në mënyrë të efektshme.

- heqje e çdo bimësie dhe prurjesh solide nga brendësia e strukturës;
- heqje e llucës së akumuluar që pengon kalimin e ujit;
- riparimi i izolantit (fugave) në xhunto;
- pastrim ose zhblokim sipas nevojës, për të hequr pengesat;
- riparim i defekteve.

b) Kërkesat

Tombinat duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme (me nivel tolerancë ±5% për të evituar penalizim për shkak të gabimeve në matje):

- tombinat nuk duhet të kenë defekte, por mund të kenë ca barishte dhe akumulim mbetjesh ose prurjesh solide;
- nuk duhet të ketë bllokim nga akulli në më shumë se 10% të diametrit të tombinës;
- tombinat nuk duhet të akumulojnë llucë me thellësi më shumë se 10% e diametrit të tombinës;
- nuk duhet të ketë ujë të ndenjor në tombinë me thellësi më shumë se 10% e diametrit të tombinës;
- pengesat nuk duhet ta pengojnë kalimin e ujit në atë shkallë saqë sistemet e kullimit me tubacione dëmtohen ose përmblyten.

Shënim: Nuk duhet përdorur kripë për pastrimin e tombinës së ngrirë.

c) Koha e përgjigjes

Koncessionari duhet të veprtojë pa vonesë për t'i bërë të parryzishme tombinat që kanë të ngjarë të përbëjnë rrezik për përdoruesit e rrugës, si situatë e jashtëzakonshme sipas seksionit 4.1.3.1 të kësaj Shtetje 5 dhe riparimet duhen kryer brenda 7 (shtatë) ditëve.

Tombinat që bien nën nivelin e kërkesave minimale duhen rikthyer në gjendjen minimale të kërkuar brenda 2 (dy) javëve. Në rast riparimi strukturor të tombinave koncessionari mund t'i kërkojë leje inxhinierit të pavarur për ta zgjatur afatit e riparimit, pasi të paraqesë prova se një shtyrje e tillë është e justifikuar.

3.5.6.3 *Hendeqet*

a) Përshtirimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin të gjitha aktivitetet që sigurojnë që hendeqet të mos jenë të bllojuara dhe që uji të mund të rrjedhë pa pengesë prej tyre në tombina dhe në kanalet shkarbuese.

b) Kërkesat

Hendeqet duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme (me nivel tolerancë ±5% për të evituar penalizim për shkak të gabimeve në matje):

- hendeqet nuk duhet të kenë defekte, por mund të kenë ca barishte dhe akumulim mbetjesh ose prurjesh solide;
- hendeqet nuk duhet të akumulojnë llucë me thellësi më shumë se 10cm;
- nuk duhet të ketë ujë të ndenjor në hendeq me thellësi më shumë se 10cm;
- pengesat nuk duhet ta pengojnë kalimin e ujit në atë shkallë saqë sistemet e kullimit me tubacione dëmtohen ose përmblyten;
- shkaktimet në lumet dhe përrejt duhet të bëhen në respektim të ligjit shqiptar, Udhëzimeve të HFC-së për mjedietin, shëndetin dhe sigurinë, për rrugët me pagesë dhe VBM-së dhe PMMS-së së Koncessionarit, sipas seksionit 3 të kësaj Shtetje 2.

c) Koha e përgjigjes

Koncessionari duhet të veprojë pa vonesë si situatë e jashtëzakonshme sipas seksionit 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5 për t'i bërë të parrezikshme hendeqet që kanë të ngjarë të përbëjnë rrezik për përdoruesit e rrugës dhe riparimet duhen kryer brenda 7 (shtatë) ditëve.

Hendeqet që bien nën nivelin e kërkesave minimale duhen rritur në gjendjen minimale të kërkuar brenda 2 (dy) javëve.

Kur shikohet nuk i plotësojnë kërkesat atëherë duhet punuar për të pakësuar ndotësit në nivelin e përcaktuar brenda 6 (gjashë) muajve.

3.5.7 Mirëmbajtja e objekteve të sheshit të taksës

a) Përshkrimi i detyrës

Mirëmbajtja e objekteve të sheshëve të taksës përfshin sipërfaqen e shtruar të sheshit të taksës dhe kabinat e taksës, pajisjet në rrugë dhe në sheshin e taksës, pajisjet e ndërmjetme (për shembull pajisjet e transmetimit, kabllo) dhe pajisjet e sektorit të administrimit të taksës së rrugës pranë Qendrës së kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.

Pajisjet në rrugë përfshijnë të gjitha aparatet dhe pajisjet dhe furnizimin përkatës me energji, kabllo e furnizimit me energji, kabllo e komunikimit, kabinat, shkallët, shtyllat, këmbët dhe çdo element tjetër që është parashikuar për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Pajisjet në sheshin e taksës përfshijnë çdo pajisje të lidhur me çdo kors, përfshirë barrierat, sensorët, tabelat me mesazhe të ndryshme, pajisjet e kabinave të taksës dhe pajisjet për arkëtimin e taksës.

Pajisjet ndërmjetëse përfshijnë të gjitha pajisjet ose sistemet e telekomunikimit dhe kabllo përkatëse që janë të nevojshme për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Pajisjet në central përfshijnë të gjitha pajisjet në ndërtesën e administrimit të taksës përfshirë kompjuterët, printerët, monitorët, pajisjet e komunikimit, furnizimin me energji, pajisjet e energjisë rezervë, kabllo e energjisë dhe komunikimit dhe çdo element tjetër që janë të nevojshme për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Mirëmbajtja e sipërfaqeve të shtruara të sheshit të taksës duhet të përbushë standardet e mirëmbajtjes së shtresave të përcaktuara në seksionin 3.5.2 të kësaj Shtojce 5.

Mirëmbajtja e kabinave të taksës duhet të jetë e tillë që kushtet e punës për personelin e arkëtimin të taksës të përbushin legjislacionin shqiptar për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Mirëmbajtja e të gjitha objekteve dhe pajisjeve të sheshit të taksës përfshin mbajtjen e të gjitha elementeve në gjendje pune përfshirë edhe pastrimin e tabelave dhe sinjaleve, reagimin ndaj defekteve, kryerjen e kalibrimit dhe kontrolleve në përputhje me udhëzimet e prodhuesve, riparimin e pajisjeve, diagnozën dhe riparimin e defekteve të programit dhe riparimin e bojës mbrojtëse.

b) Kërkesat

Sistemet dhe pajisjet duhet të mirëmbahen në mënyrë të tillë që në çdo moment të përbushen kërkesat operative të seksionit 3.2.4 të kësaj Shtojce 5.

Të gjitha pajisjet dhe sensorët duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen në përputhje me udhëzimet e prodhuesve.

c) Koha e përgjigjes

Koha e përgjigjes duhet të jetë e tillë që në çdo moment të përmbushen kërkesat operative të seksionit 3.2.4 të kësaj Shtojce 5.

Afati e përgjigjes duhet të maten që nga momenti kur zbulohet defekti, siç raportohet nga sistemi i kontrollit, ose siç zbulohet gjatë kontrollit, në varësi se cili moment është më i hershmi.

3.5.8 Mirëmbajtjes e sinjalizimit

3.5.8.1 Sinjalistikë vertikale

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin mirëmbajtjen e tabelave dhe pajisjeve të përhershme rrugore dhe informuese si edhe mirëmbajtjen e kunjave fiksë orientuese të rrugës ekzistuese në fillim të kontratës. Pastrimi, përmbushja, zëvendësimi dhe riparimi i tabelave dhe pajisjeve të konsumuara, të dëmtuara, të mangëta ose të humbura dhe i strukturave mbështetëse të tyre përfshihet në mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale.

Në këtë detyrë përfshihet edhe monitorimi i kushteve faktike përgjatë Autostradës në mënyrë që, nëse del nevoja, të shtohen tabelat shtesë të duhura për t'u siguruar që sistemi i sinjalistikës të jetë i plotë në çdo moment gjatë të gjithë periudhës së koncesionit.

b) Kërkesat

Sinjalistika vertikale duhet të përmbushë këto kërkesa:

- Tabelat të mos kenë defekte, të jenë të pastra dhe të vendosura saktë. Tabelat nuk duhet të jenë mbuluar nga gjethnaja, nga tabela ose struktura të tjera dhe të mos kenë hyrë në hapësirën e karrexhatës;
- Shtyllat e tabelave të jenë vertikale, të mos kenë dëmtime apo defekte strukturore dhe cipa/boja mbrojtëse të jetë e padëmtuar;
- Mbërthyeset e tabelave të jenë të mbërthyera dhe të mos kenë geryecje;
- Kunjat fiks në buzë të rrugës të jenë në gjendje të mirë, të jenë vertikal dhe elementet reflektues të jenë të pastër dhe të padëmtuar.

Këndi maksimal i lejuar i një table rrugore mund të jetë deri në 5% nga boshti absolut vertikal, tabela të mos jetë e rotulluar në mënyrë që të mos pengohet lexueshmëria.

c) Koha e përgjigjes

Tabelat e anuara dhe të rotulluara duhet të drejtohen në pranverë brenda datës 15 prill. Tabelat që nuk e plotësojnë nivelin e kërkesave minimale duhet të kthehen në standardin e lejuar brenda 3 (dy) javëve.

Nëse tabelat përbëjnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës (tabela të shkatërruara ose që mungojnë, tabela të rotulluara saqë nuk lexohen, tabela që janë anuar dhe kanë hyrë në hapësirën e karrexhatës), Koncesionari duhet të marrë masa pa vonesë dhe, nëse është e nevojshme, tabelat bëhen të parrezikshme duke i konsideruar si defekt i kategorisë I në përputhje me seksionin 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5.

3.5.8.2 Sinjalistika rrugore horizontale

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin mirëmbajtjen e vijëzimeve dhe sinjaleve horizontale. Kjo detyrë ka të bëjë edhe me përdorimin e elementeve të tjera të nevojshme të sinjalistikës horizontale.

Skemat e menaxhimit të trafikut që kërkojnë përdorimin e sinjalistikës horizontale duhet të aproohen paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues.

b) Kërkesat

Sinjalistika horizontale duhet të përmbushë këto kërkesa:

- sinjalistika horizontale të jetë e pastër dhe qartësisht e dukshme;
- sinjalistika horizontale të mos jetë përhapur më shumë se 10% e dimensionit original;
- të ketë mbetur të paktën 70% e materialit të vijëzimit;
- retro-reflektimi të jetë të paktën 100 $\text{med/m}^2/\text{lx}$ (për vijëzimet e bardha);
- retro-reflektimi të jetë të paktën 80 $\text{med/m}^2/\text{lx}$ (për vijëzimet e verdha);
- rezistenca në fërkim e vijëzimeve të jetë e njëjtë me sipërfaqet pa vijëzime (pra e njëjtë me rezistencën në fërkim të tapetit të rrugës).

Pikat e marrjes së kampionëve në bazë të kontrolleve me sy duhet të përzgjidhen për çdo 5km gjatësi të karrexhatës dhe testimi i hollësishëm kundrejt specifikimit të ccurisë duhet të bëhet në përputhje me seksionin 4 të kësaj Shtojce 5. Nëse pika e marrjes si kampion nuk e përmbush specifikimin atëherë supozohet se e gjithë gjatësia është me defekt, nëse nuk dëshmohet ndryshe nga Koncesionari.

Reflektorët horizontalë të ngulur në rrugë (symacet) duhet të jenë në gjendje siç janë instaluar në përputhje me projektin dhe duhet të reflektojnë si të rinj.

c) Koha e përgjigjes

Sinjalistika horizontale që përbën rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës duhet të zëvendësohet ose kur kjo nuk është e mundur, duhen vendosur tabela paralajmëruese brenda 24 (njëzet e katër) orëve.

Sinjalistika horizontale që bie nën nivelin e kërkesave minimale duhet rikthyer në gjendjen minimale të kërkuar brenda 3 (tre) muajve.

Symacet që mungojnë ose nuk funksionojnë duhen zëvendësuar brenda 3 (tre) muajve nëse nuk përbëjnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës, në ç'rast trajtohen si defekt i kategorisë I në përputhje me seksionin 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5.

3.5.9 Mirëmbajtja e objekteve elektrike/mekanike të rrugës

3.5.9.1 Ndriçimi

a) Përshkrimi i detyrës

Mirëmbajtja e ndriçimit përfshin ndriçimin e rrugës (shtyllat, mbajtëset, llampat, kabllo të elektronike dhe pajisjet e kontrollit) dhe zëvendësimin e llampave dhe elementeve të tjera, pastrimin e kupave dhe reflektorëve, riparimin e llampave të dëmtuara, drejtimin e shtyllave të anuara dhe riparimin e bojës mbrojtëse. Mirëmbajtja e ndriçimit të tunelit duhet të bëhet në përputhje me seksionin 3.5.5 të kësaj Shtojce 5.

b) Kërkesat

Ndriçimi rrugor duhet të mirëmbahet në plotësinë të këtyre kërkesave:

- në çdo moment 85% e të gjitha njësive ndriçuese të rrugës duhet të funksionojnë si duhet;
- në çdo vendndodhje nuk mund të mos funksionojnë më shumë se 3 nga 10 njësi ndriçimi radhazi;

- brenda 100m nga çdo kryqëzim rruge nuk mund të mos funksionojnë më shumë se 1 nga 10 njësi ndriçimi;
- brenda 100m nga çdo kryqëzim rruge nuk mund të mos funksionojnë më shumë se 2 njësi ndriçimi radhazi;
- shtyllat e ndriçimit të mbuluara nga pemët apo bimësi tjetër duhet të konsiderohen si jofunksionale;
- kabllo, qarqet dhe komponentët elektrikë duhet të testohen në përputhje me kërkesat vendore për të siguruar që në çdo moment instalimet të përmbushin standardet e sigurisë elektrike;
- shtyllat dhe mbajtëset e lampave të mos jenë anuar më shumë se [2%] nga boshti absolut vertikal;
- ripërtëritje e bojës mbrojtëse të shtyllave të ndriçimit për të ruajtur pamjen dhe integritetin.

Ndriçimi duhet monitoruar për defekte. Defektet duhet të klasifikohen ose:

- Si defekte që kërkojnë vëmendje urgjente sepse përbëjnë rrezik të mundshëm ndaj sigurisë së përdoruesve të rrugës (defekt i kategorisë I); dhe
- Si defekte që nuk përbëjnë rrezik të mundshëm ndaj sigurisë.

Mirëmbajtja e planifikuar çdo vit:

- Kontrolli dhe pastrimi i lampave dhe reflektorëve brenda datës 15 maj.

Mirëmbajtja e planifikuar çdo 5 (pesë) vjet:

- Shtyllat dhe kabinat e ndriçimit duhet të testohen për të parë stabilitetin strukturor dhe pritshmërinë për jetëgjatësinë e secilës njësi.

c) Koha e përgjigjes

Koncesionari merr masa pa vonesë nëse ndriçimi ka defekte urgjente (defekte që përbëjnë rrezik të mundshëm ndaj sigurisë së përdoruesve të rrugës), pra defekte të tilla duhen trajtuar si defekte të kategorisë I.

Ato pjesë të rrugës ku ndriçimi rrugor nuk i përmbush kërkesat duhet të kthehen në gjendjen minimale të kërkuar brenda 7 (shtatë) ditëve. Gjithsesi, në sheshet e taksës dhe në kryqëzime këto duhen kthyer në standardin minimal të kërkuar brenda 24 (njëzet e katër) orëve.

3.5.9.2 Pajisjet e menaxhimit dhe kontrollit të trafikut

a) Përshkrimi i detyrës

Mirëmbajtja e pajisjeve të menaxhimit dhe kontrollit të trafikut përfshin pajisjet në rrugë (pikat dhe aparatet në terren), pajisjet ndërmjetëse (për shembull, pajisjet e transmetimit, kabllo) dhe pajisjet në qendrën e kontrollit (në central). Vini re se kërkesat për të gjitha pajisjet e tilla në lidhje me tunelet duhet të jenë në përputhje me kërkesat e seksionit 3.5.5 të kësaj Shtojce 5.

Pajisjet në rrugë përfshijnë të gjitha aparatet dhe pajisjet dhe furnizimin përkatës me energji, kabllo e furnizimit me energji, kabllo e komunikimit, kabinat, shkallët, shtyllat, këmbët dhe çdo element tjetër që është parashikuar për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Pajisjet ndërmjetëse përfshijnë të gjitha pajisjet ose sistemet e telekomunikimit dhe kabllo përkatëse që janë të nevojshme për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Pajisjet në central përfshijnë të gjitha pajisjet në qendrën e kontrollit përfshirë kompjuterët, printerët, monitorët, pajisjet e komunikimit, furnizimin me energji, pajisjet e energjisë rezervë, kabllo e energjisë dhe komunikimit dhe çdo element tjetër që janë të nevojshme për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Mirëmbajtja përfshin mbajtjen e të gjitha elementeve në gjendje pune që arrijnë kërkesat e sigurisë të përshkruara në seksionin 3.2.3 të kësaj Shtojce 5, përfshirë edhe pastrimin e tabslavave dhe sinjalëve, reagimin ndaj defekteve,

kryerjen e kalibrimit dhe kontrollesë në përputhje me udhëzimet e prodhuesve, riparimin e pajisjeve, diagnozën dhe riparimin e defekteve të programit dhe riparimin e bojës mbrojtëse.

b) Kërkesat

Sistemet dhe pajisjet duhet të mirëmbahen në mënyrë të tillë që në çdo moment të përmbushen kërkesat minimale të përcaktuara në seksionin 3.2.3 të kësaj Shtojce 5.

Tabelat me mesazhe të ndryshme dhe sinjale duhet të pastrohen për të ruajtur ecurinë optike të aparateve.

Stacionet meteorologjike dhe sensorët përkatës duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen në përputhje me udhëzimet e prodhuesve.

c) Koha e përgjigjes

Koha e përgjigjes duhet të mbahet e tillë që në çdo moment të përmbushen kërkesat minimale të përcaktuara në seksionin 3.2.3 të kësaj Shtojce 5.

Afëtat e përgjigjes duhet të maten që nga momenti kur zbulohet defekti, siç raportohet nga sistemi i kontrollit, ose siç zbulohet gjatë kontrollit, në varësi se cili moment është më i hershmi.

3.5.9.3 *Objektet e matjes së trafikut*

a) Përshkrimi i detyrës

Mirëmbajtja e pajisjeve të matjes së trafikut përfshin pajisjet në rrugë (pikat/stacionet e matjes së trafikut dhe pikat e peshimit në lëvizje), pajisjet ndërmjetëse (për shembull, pajisjet e transmetimit, kablilot) dhe pajisjet në qendrën e kontrollit (në central) ose në mjediset e Autoritetit Kontraktues.

Pajisjet në rrugë përfshijnë të gjitha aparatet dhe pajisjet dhe furnizimin përkatës me energji, kablilot e furnizimit me energji, kablilot e komunikimit, kabinetat, shkallët, shtyllat, këmbët dhe çdo element tjetër që është parashikuar për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Pajisjet ndërmjetëse përfshijnë të gjitha pajisjet ose sistemet e telekomunikimit dhe kablilot përkatëse që janë të nevojshme për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë. Për të shmangur çdo dyshim, kjo përfshin çdo shërbim telekomunikimi që përdoret ndërmjet pikave dhe vendndodhjeve në distancë, për shembull linjat telefonike të marra me qira ose lidhjet me GSM/GPRS.

Pajisjet në central përfshijnë të gjitha pajisjet në qendrën e kontrollit ose në mjediset e Autoritetit Kontraktues përfshirë kompjuterët, printerët, monitorët, pajisjet e komunikimit, furnizimin me energji, pajisjet e energjisë rezervë, kablilot e energjisë dhe komunikimit dhe çdo element tjetër që janë të nevojshme për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Mirëmbajtja përfshin mbajtjen e të gjitha elementeve në gjendje pune që arrin kërkesat minimale të përcaktuara në seksionin 3.1.6 të kësaj Shtojce 5, përfshirë edhe reagimin ndaj defekteve, kryerjen e kalibrimit dhe kontrolleve në përputhje me udhëzimet e prodhuesve, riparimin e pajisjeve, diagnozën dhe riparimin e defekteve të programit dhe riparimin e bojës mbrojtëse.

b) Kërkesat

Sistemet dhe pajisjet duhet të mirëmbahen në mënyrë të tillë që në çdo moment të përmbushen kërkesat minimale të përcaktuara në seksionin 3.1.6 të kësaj Shtojce 5.

Të gjitha pajisjet dhe sensorët përkatës duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen në përputhje me udhëzimet e prodhuesve.

c) Koha e përgjigjes

Koha e përgjigjes duhet të jetë e tillë që në çdo moment të përmbushen kërkesat minimale të përcaktuara në seksionin 3.1.6 të kësaj Shtojce 5.

Afatet e përgjigjes duhet të maten që nga momenti kur zbulohet defekti, siç raportohet nga sistemi i kontrollit, ose siç zbulohet gjatë kontrollit, në varësi se cili moment është më i hershmi.

3.5.9.4 Objektet e komunikimit për situata të jashtëzakonshme dhe infrastruktura mbështetëse

a) Përshkrimi i detyrës

Mirëmbajtja e objekteve të komunikimit përfshin pajisjet në rrugë (telefonat e urgjencës në tunelin e Thirrës dhe çdo pajisje të tjerë të lidhur me ta), pajisjet ndërmjetëse (për shembull, pajisjet e transmetimit, kabllo) dhe pajisjet në Qendrën e kontrollit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes (në central).

Pajisjet në rrugë përfshijnë të gjitha aparatet dhe pajisjet e përcaktuara në seksionet 3.1.6 dhe 3.1.7 të kësaj Shtojce 5 dhe furnizimin përkatës me energji, kabllo të furnizimit me energji, kabllo të komunikimit, kabinat, shkallët, shtyllat, këmbët dhe çdo element tjetër që është parashikuar për ta mbajtur sistemit në funksionim të plotë.

Pajisjet ndërmjetëse përfshijnë të gjitha pajisjet ose sistemet e telekomunikimit dhe kabllo përkatëse që janë të nevojshme për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

Pajisjet në central përfshijnë të gjitha pajisjet në qendrën e kontrollit përfshirë kompjuterët, printerët, monitorët, pajisjet e komunikimit, furnizimin me energji, pajisjet e energjisë rezervë, kabllo të energjisë dhe komunikimit dhe çdo element tjetër që janë të nevojshme për ta mbajtur sistemin në funksionim të plotë.

b) Kërkesat

Sistemet dhe pajisjet duhet të mirëmbahen në mënyrë të tillë që në çdo moment të përmbushen kërkesat e gatishmërisë të përcaktuara në seksionin 3.1.6 të kësaj Shtojce 5.

Mirëmbajtja përfshin mbajtjen e të gjitha elementeve në gjendje pune që arrin kërkesat e ecurisë të përcaktuara në seksionin 3.1.6 dhe 3.1.7 të kësaj Shtojce 5, përfshirë edhe reagimin ndaj defekteve, kryerjen e kalibrimit dhe kontrolleve në përputhje me udhëzimet e prodhuesve, riparimin e pajisjeve, diagnozën dhe riparimin e defekteve të programit dhe riparimin e bojës mbrojtëse.

Objektet e identifikuara në seksionin 3.1.7 të kësaj Shtojce 5 duhet të mirëmbahen në gjendjen siç janë ndërtuar me kontroll vjetor të litarëve, gropave, kapakëve të gropave dhe të gjithë elementeve të tjera të objekteve.

Telefonat e urgjencës në tunelin e Thirrës në veçanti duhet të pastrohen çdo 2 (dy) muaj, përfshirë edhe pastrimin e kabinës për të ruajtur dukshmërinë e telefonave dhe pastrimin e zonës së folje-dëgjimit për të siguruar qartësi të folurës dhe pastërti për shëndetin. Në të njëjtën kohë me operacionin e pastrimit çdo telefon duhet të testohet për transmetim të saktë të zërit dhe për komunikim me centralin duke bërë telefonata të shkurtra provë dhe duke konfirmuar funksionimin me një centralist. Të gjitha pajisjet e tjera përkatëse duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen në përputhje me udhëzimet e prodhuesve.

c) Koha e përgjigjes

Koha e përgjigjes duhet të jetë e tillë që në çdo moment të përmbushen kërkesat e gatishmërisë të përcaktuara në seksionin 3.1.6 dhe 3.1.7 të kësaj Shtojce 5.

Afatet e përgjigjes duhet të maten që nga momenti kur zbulohet defekti, siç raportohet nga sistemi i kontrollit, ose siç zbulohet gjatë kontrollit, në varësi se cili moment është më i hershmi.

3.5.10 Objektet e sigurisë dhe gardhet rrethuese të rrugës

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin riparimin e dëmtimeve të objekteve të sigurisë dhe gardheve rrethuese të rrugës të shkaktuara nga përkeqësimi, aksidentet ose vandalizmi.

Objekte të sigurisë konsiderohen sa më poshtë:

- Barrierat anësore të sigurisë (përfshirë parapetet)
- Barrierat e sigurisë në mes të rrugës (përfshirë pamakët mbrojtës)
- Amortizatorët/zbutësit e përplasjes
- Pikat fundore dhe pikat kalimtare ndërmjet barrierave

b) Kërkesat

Objektet e sigurisë dhe gardhi mbrojtës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- gardhet dhe barrierat e sigurisë duhet të jenë të vazhdueshme pa pjesë të munguara me përjashtim të hyrjeve të ligjshme në autostradë dhe të mbikallimeve, si edhe pikat e palejuara hyrëse-dalëse të renditura në kategorinë 2 dhe kategorinë 3 të Shtojcës 9;
- gardhet dhe barrierat e sigurisë mund të kenë paksa geryerje por ky nuk duhet të cenojë integritetin strukturor të gardhit;
- gardhi i sigurisë duhet të jetë në nivel, i tendosur si duhet dhe të respektojë plotësisht specifikimet e prodhuesve;
- gardhi i sigurisë nuk duhet të ketë buçanë ose bashkuarje të lirura ose të munguara;
- gardhi rrethues kundër për pengimin e kalimit të kalishëve të egër mund të ketë defekte të vogla por duhet të përmbushë funksionin dhe të jetë solid nga ana strukturore.

c) Koha e përgjigjes

Dëmtimet nga aksidentet që prekin nivelimin dhe/ose integritetin strukturor të gardheve të sigurisë duhet të mbrohen me tabela paralajmëruese pa vonesë dhe të riparohen brenda 24 (njëzet e katër) orëve si defekt i kategorisë I në përputhje me seksionin 4.1.2.1 të kësaj Shtojce 5.

Koncessionari duhet të veprojë pa vonesë nëse pamakët apo gardhet me defekt përmbajnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit e rrugës dhe t'i trajtojë këto defekte si defekt i kategorisë I. Por nëse nuk është i mundur riparimi i menjehershëm, duhen vendosur tabela paralajmëruese dhe riparimi duhet të kryhet brenda 7 (shtatë) ditëve.

Dëmtimet nga aksidenti që cenojnë integritetin strukturor të barrierave ose gardheve rrethuese duhet të riparohen brenda 7 (shtatë) ditëve. Amortizatorët/zbutësit e përplasjes që janë dëmtuar nga aksidenti duhen zëvendësuar me të rinj brenda 7 (shtatë) ditëve.

Gjendja e barrierave dhe gardheve mbrojtëse që përndryshe bie poshtë nivelit të kërkesave minimale të seksionit 3.5.9, shkronja "b", duhet të riparohet ose zëvendësohet brenda 2 (dy) muajve. Nëse zëvendësohen dhe kur të zëvendësohen, barrierat e reja, amortizatorët e përplasjes dhe gardhet mbrojtëse duhet të përmbushin rregulloret EN 1317.

3.5.11 Mbjajtja në kontroll e bimësisë

a) Përshkrimi i detyrës

Kjo detyrë përfshin mirëmbajtjen e zonave të gjelbëruara brenda kufirit të Autostradës; korijen e barit, pastrimin me fshesë dhe kujdesin për zonat me bar, krasitjen e kaçubave dhe pemëve. Kjo detyrë përfshin edhe prerjen e pemëve që rriten në sipërfaqen e rrugës dhe të pemëve dhe degëve që zgjaten mbi sipërfaqen e rrugës për shkak të reshjeve të dëborës. Sipërfaqet e gjelbëruara ngjitur me sipërfaqet e shtruara nuk duhet të kenë rritje të tepruara bimësie. Në sipërfaqet e shtruara duhen hequr barërat.

Mbetjet e krijuara nga pastrimi i sipërfaqeve të gjelbëruara duhet të grihen në mënyrë mekanike në mënyrë që të mos ndikojnë negativisht në bimësinë përreth ose që të largohen nga terreni.

b) Kërkesat

Bimësia duhet mbajtur në kontroll sipas lartësive, vendndodhjeve dhe kufizimeve të parashikuara në tabelën 3-8 dhe diagramin më poshtë.

Koncessionari duhet të bëjë kontrole të njafueshme për të monitoruar lartësinë e barit në mënyrë që të mund të planifikohet korrja e barit për ta mbajtur barin nën lartësinë e kërkuar.

Krasitja e kaçubave dhe pemëve duhet bërë në vjeshtë pas kontrollit vjetor, por duhet bërë edhe sa herë është e nevojshme sipas konstatimeve të kontroleve të sigurisë për të evituar daljen e tyre mbi sipërfaqet e shtruara ngjitur me to, që mund të përbëjë rrezik për përdoruesit e rrugës.

Për sipërfaqet e shtruara duhet kryer mbajtja në kontroll e barërave sa herë që është e nevojshme çdo 4 (katër) javë pas kontroleve gjatë periudhës maj-shtator, për t'i mbajtur këto sipërfaqe pa barëra.

Mbetjet e krijuara nga pastrimi i sipërfaqeve të gjelbëruara duhet të grihen në mënyrë mekanike në mënyrë që të mos ndikojnë negativisht në bimësinë përreth ose që të largohen nga terreni pas çdo operacioni gjelbërimi.

c) Koha e përgjigjes

Ato pjesë ku mirëmbajtja e bimësisë bie nën nivelin minimal të kërkuar duhet të kthehen në minimumin e kërkuar brenda 7 (shtatë) ditëve, me përjashtim të korrjes së barit të hendekëve kur lejohen 28 (njëzet e tetë) ditë për kryerjen e punës.

Ngritjet e bimësisë duhen hequr nga sipërfaqet e shtruara ngjitur me to brenda 18 (tetëmbëdhjetë) orëve.


Pirgjet me mbetje të krijuara në sipërfaqet e shtruara duhet të largohen brenda 12 (dymbëdhjetë) orëve.

Tabela 3-8: Kërkesat e ecuresisë për bimësinë

Lloji	Lartësia (mm)	Fushëveprimi i kërkesave:
1	25 – 75	Korsitë e ndalimit të rrugëve qytetëse, ndarëset në mes, ishujt e trafikut dhe bordet e rrugës, bari në vendpushime (përfshirë edhe rreth orendive në vendpushime).
2	25 – 300	Rrugë joqytetëse dhe sipërfaqe të mëdha të gjelbëruara, përfshirë edhe kanalet e ujërave sipërfaqësore me gradient gjatësor $\geq 3\%$.
3	0 – 200	Mbajtja në kontrolli e bimësisë përreth: <ul style="list-style-type: none"> • Kujave fikse orientuese në buzë të rrugës • Shtyllave të tabelave rrugore • Kujave fikse në fund buzë të urave dhe tombinave • Parmakëve mbrojtës • Parmakëve orientues • Shtyllave të ndriçimit • Bazamenteve të urave
4	Pa bimësi ose thuasht pa bimësi	Vlen për mbajtjen në kontrolli e bimësisë përreth: <ul style="list-style-type: none"> • Skajeve të tombinave • Mureve në krye të rombinave • Kanaleve anësore të kullimit • Ujëkaluesve të tombinave • Kanaleve të ujërave sipërfaqësore me gradient gjatësor $\geq 3\%$ (me përjashtim të vendeve të caktuara për korrije bari në kërkesat specifike të kontratës) • Gropave të peshoreve • Bordurave dhe kanaleve • Kanaleve të veshura • Të gjitha sipërfaqeve të izoluar • Bordeve metalike • Kuvvertave të urave.
5	Heqje e rritjes së bimësisë kur zaptin zonën që duhet të jetë pa bimësi, anash ose nga sipër.	Zbatohet për bimësinë që përfshin pemë, kaçuba ose degë që varen në zonën që duhet të jetë pa bimësi (brenda 0,5m nga vija e kujave fikse orientues në buzë të rrugës ose brenda 6m mbi tapetin e rrugës) (Shih diagramin më poshtë)



EXTENT AND TYPE OF VEGETATION CONTROL



- NOTE 1: The distance must be a minimum of 1.0m on straight and on the outside of curves and a maximum of 5.0m on the inside of curves.
- NOTE 2: Vegetation that, above must be maintained free of all vegetation.
- NOTE 3: A minimum of 1.0m on straight and on the outside of curves and on the inside of curves.
- NOTE 4: There shall be no vegetation occurring in the road requirements.

4 Kërkesat e kontrollit dhe monitorimit

4.1 Kërkesat për kontrollin

4.1.1 Hyrje

Koncessionari duhet të kryejë kontrollet e përshkruara më poshtë, të evidentojë defektet sipas kërkesave të Lidhjes 3 të kësaj Shtojce 5 dhe në çdo rast të raportojë defektet në përputhje me kërkesat e Lidhjes 5 të kësaj Shtojce 5. Koncessionari duhet të hartojë një Manual për kontrollin dhe monitorimin, sikurse përshkruhet në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5.

4.1.2 Kontrollet për sigurinë

4.1.2.1 Defektet e kategorisë I

Kontrollet për sigurinë duhen kryer për të siguruar parrezikshmërinë funksionale të infrastrukturës së Autostradës. Kontrolli bëhet çdo ditë, përfshirë fundjavat dhe festat zyrtare, nga 2 (dy) teknikë, me një automjet që udhëton me shpejtësi të ulët. Në mënyrë që kontrollet e sigurisë të trajtojnë defektet e menjehershme gjeoteknike, skuadrën e kontrollit duhet ta shoqërojë një inxhinier gjeoteknik/gjeolog të paktën 1 (një) herë çdo muaj dhe/ose kur raportohet ndryshim i befasishtëm nga pajisjet e monitorimit gjeoteknik ose kur justifikohet nga rezultati i Sistemit për menaxhimin e risqeve gjeoteknike. Sa herë që e kërkon situata, kontrolli duhet bërë më këmbë. Këto kontrolle duhet të identifikojnë defektet që përbëjnë rrezik i menjehershëm për përdoruesit, pra defektet e kategorisë I. Lista orientuese e defekteve të kategorisë I jepet në Lidhjen 3 të kësaj Shtojce 5. Sa herë që hasen defekte të tilla, këto defekte duhet të regjistrohen dhe nëse është e mundur të ndreqen menjëherë ose përndryshe të bëhen të parrezikshme derisa të mund të bëhen pa rrezik riparimet. Riparimet me natyrë të përkohshme ose të përhershme duhen kryer sa më shpejt. Sa herë që nuk mund të kryhet një riparim i menjehershëm, vendndodhja e defektit duhet të shënohet me tabelë (vendosje e tabelave paralajmëruese dhe masa të tjera mbrojtëse – rrethimi me kona ose me gardh i defektit) nga personeli që kryen kontrollin dhe riparimet duhet të kryhen brenda 24 (njëzet e katër) orëve nëse nuk bihet dakord ndryshe me inxhinierin e pavarur.

Pagesa e Performances do të aplikohet nëse defektet e kategorisë I nuk ndreqen brenda afateve të përgjigjes të përcaktuara në seksionin 3 të kësaj Shtojce 5.

4.1.2.2 Defektet e kategorisë II

Të gjitha defektet e tjera të identifikuara gjatë kontrolleve të sigurisë që nuk përbëjnë defekte të kategorisë I kategorizohen si defekte të kategorisë II. Koncessionari duhet të caktojë nivelin e prioritetit për çdo defekt të kategorisë II, si defekt me prioritet të lartë, të mesëm ose të ulët. Defektet e kategorisë II duhet të riparohen brenda programeve të planifikuara të punës duke marrë në konsideratë prioritetin relativ për riparim (që duhet caktuar përmes një Sistemi të menaxhimit të mirëmbajtjes rutinë) por në çdo rast të gjitha këto riparime të tilla duhen kryer jo më vonë se 26 (njëzet e gjashtë) javë nga data e kontrollit që ka identifikuar defektin.

4.1.2.3 Evidentimi i defekteve

Të dhënat nga kontrollet e sigurisë duhet të regjistrohen në një aparat portativ për kapjen e të dhënave që përdor programe standarde për kapjen e të dhënave në përshatje me Kërkesat për mirëmbajtjen rutinë dhe duhet të shkarkohen në bazën e të dhënave të Sistemit të menaxhimit të mirëmbajtjes rutinë brenda 1 (një) dite pas kryerjes së vrojtimit. Niveli i hollësisë së regjistrimit përcaktohet në Lidhjen 3 të kësaj Shtojce 5.

4.1.3 Kontrollet teknike të hollësishme sistematike

Kontrollet teknike të hollësishme sistematike janë të nevojshme për të identifikuar defektet, për të konstatuar gjendjen dhe për të vendosur programe për mirëmbajtjen dhe riparimet e atyre defekteve që nuk kërkojnë vëmendje të menjehershme. Kërkesat për shpeshësinë e këtyre inspektimeve jepen në tabelën 4-1, më poshtë. Për

sa i përket tunelit të Thirrës, rezultati i inspektimeve teknike do të korrelohet, sipas nevojës, me rezultatet e programit të monitorimit me instrumente. Udhëzimi për projektimin dhe zbatimin e programit të monitorimit me instrumente të tunelit të Thirrës është dhënë në Shtojcën 9.

Tabela 4-1: Kontrollat teknike

Inspektimi	Shpeshtësia	Vërejtje
Kontrollet për sigurinë	2 herë/ditë me interval të paktën 8 orë kur ka ditë dite	Mund të kryhet nga një automjet që lëviz me jo më shumë se 50 km/h. Duhet kryer kontrolle shtesë për sigurinë gjatë dhe pas kushteve të rënda të motit për të identifikuar ndonjë pasojë që mund të përbëjë rrezik për përdoruesit e rrugës. Lidhet me kohën e përgjigjes për incidentet dhe situatat e jashtëzakonshme.
Cijendja e shtresës E - Kontrolli me sy	2 herë/ditë me interval të paktën 8 orë kur ka ditë dite	Kontrolli me sy i të gjitha sipërfaqeve të shtrara. I kryer gjatë kontrolleve për sigurinë për të identifikuar defektet që përbëjnë rreziqe të mundshme për përdoruesit e rrugës.
Cijendja teknike e shtresës e përcaktuar me parametrat e mëposhtëm teknikë dhe funksionalë: <ul style="list-style-type: none">• Cilësia e ecjes së automjetit - ashpërsia• Thellësia e kanalëve të bëra nga gomat• Rezistenca në rrëshqitje• Cijendja e sipërfaqes - plasaritjet nga kalimi i rrotave• Forca strukturore (jetëgjatësia e mbetur)	Shtih Tabelën 3-1 të seksionit 3	Matjet, analiza dhe raportet duhet të plotësohen brenda datës 30 nëntor çdo vit. Duhet të hartohet programi i kontrollit, së bashku me çdo vërtetim tjetër shtesë, për të vendosur programet e mirëmbajtjes rutinë, periodike dhe madhore. Të gjitha punimet ndërchyese të mirëmbajtjes të ndërmarra për ndreqjen e pjesëve të sipërfaqes së shtruar që nuk përmbush standardin e kërkuar (siç përsëritet në tabelën 3-1) janë objekt i një raporti në të njëjtin vit kalendarik në të cilin kanë përfunduar punimet.
Kontrollet e tunelit		Struktura e tunelit përfshin: <ul style="list-style-type: none">• Të gjitha pjesët e strukturës së tunelit, përfshirë:<ul style="list-style-type: none">- Veshjet strukturore, paretet veshëse muret anësore, dyshemetë, dyert dhe

Inspektimi	Shpeshtësia	Vërejtje
		<p>portat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Godinat e shërbimit dhe sallat e impianteve - Tubat e ajrimit <p>Pajisjet për monitorim dhe evaluim përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha pajisjet dhe sistemet e lidhura me monitorimin dhe kontrollin e impiantit, trafikun, komunikimet dhe sigurinë, përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> - Ajrimin - Ndriçimin - Drenazhimin dhe pompimin - Mbrojtjen kundër zjarrit dhe sistemet dhe alarmet në përgjigje të situatave të jashtëzakonshme - Sistemet e komunikimit dhe kontrollit të trafikut, përfshirë telekomandat dhe mbylljet në distancë - Sistemet e shfrytëzimit të tunelit dhe kontrollimit të impianteve - Furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë - Godinat e shërbimit dhe sallat e impianteve
<ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli për sigurinë - 	2 në ditë	Kontrolli me sy i tunelëve, i kryer gjatë kontrolleve për sigurinë për të identifikuar defektet që përbëjnë rreziqe të mundshme për përdoruesit e rrugës.
<ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli sipërfaqësor - 	Çdo muaj	<p>Një shqyrtim sipërfaqësorë e pjesëve të tunelit dhe rrethinave për të parë stabilitetin dhe dëmtimet, e kryer nga personeli që ka trajnimin e duhur për nivelin e këtij kontrolli. Kontrolli evidenton praninë e prurjeve solide, prurjeve ose mbetjeve të çdo lloji, defektet që përbëjnë ose mund të shkaktojnë degradim të rëndë të strukturës së tunelit ose rrezik për përdoruesit e rrugës. Me t'u bërë të parrezikshme rreziqet e mundshme, duhet kryer një kontroll më i hollësishëm nga një person i kualifikuar, për të konstatuar shkallën e çdo problemi, punën ndreqëse dhe grafikun kohor.</p> <p>Kontrolli i intë me sy i pjesëve përfaqësuese</p>

Inspektimi	Shpeshësia	Vërejtje
		<p>të tunelit rrugor dhe pajisjeve të tij. Një kontroll nga personel i trajnuar me përvojë. Kontrolli duhet kryer dhe raportuar në përputhje me standardet evropiane dhe praktikën e mirë të sektorit të ekonomisë siç bëhet dakord me Autoritetin Kontraktues.</p>
<p>Kontrolli i përgjithshëm</p>	<p>Jo më vonë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2 vjet pas kontrollit të fundit të përgjithshëm ose parësor • Një vit pas kontrollit të fundit të përgjithshëm ose parësor për funksionet M&E <p>Kontrollet kryhen me intervalet për të cilat bëhet dakord me inxhinierin e pavarur por normalisht këto intervale nuk duhet të jenë më shumë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjashtë vjet për strukturat e tunelit • Tre vjet për funksionet mekanike dhe elektrike 	<p>Kontrolli i përgjithshëm duhet të hartohet për të vendosur programet e mirëmbajtjes rutinë, periodike dhe madhore.</p> <p>Si pjesë e kontrollit M&E duhet bërë një manovër stërvitore së bashku me të gjitha shërbimet e urgjencës.</p> <p>Qëllimi i kësaj manovre stërvitore është të dëshmohet funksionimi i saktë i të gjitha pajisjeve të sigurisë dhe situatave të jashtëzakonshme si edhe niveli i duhur i përgjigjes nga shërbimet e urgjencës.</p> <p>Një kontroll nga personel i trajnuar me përvojë. Kontrolli duhet kryer dhe raportuar në përputhje me standardet evropiane dhe praktikën më të mirë të sektorit të ekonomisë siç bëhet dakord me Autoritetin Kontraktues.</p> <p>Dokumentet bazë janë skicat e ndërimit, skicat elektrike, manuali e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes dhe raportet e kontroleve të mëparshme parësore dhe të përgjithshme.</p> <p>Kryhet një shqyrtim e hollësishme nga afër e të gjitha pjesëve të arritshme të tunelit, që mund të kërkojë heqjen e paneleve veshëse, kapakëve, grilave të ventilatorëve etj., për të arritur peshë të tyre.</p> <p>Të gjitha dokumentet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë duhet të shqyrtohen gjatë kontrollit parësor për të parë nëse janë në përputhje me standardet dhe nëse janë të plota.</p> <p>Raporti përmban rekomandime për punimet riparuese ose zëvendësuese.</p>

Inspektimi	Shpeshtësia	Vërejtje
- Kontrolli parësor	Konsiderohet se Kontrolli Parësor e zëvendëson nevojën për çdo Kontroll të Përgjithshëm që i bie të bëhet atë vit.	Kontrolli parësor duhet të hartohet për të vendosur programet e mirëmbajtjes rutinë, periodike dhe madhore. Shqyrtim nga afër i një zone apo defekti të veçantë që përbën shqetësim.
- Kontrolli i Posaçëm	Sipas nevojës	Kontrolli i Posaçëm kryhet: <ul style="list-style-type: none"> • Për të hetuar një problem të veçantë të konstatuar gjatë një kontrolli ose që dihet se ka ndodhur në tunele të tjera të ngjashme; • Në intervale prej jo më shumë se 6 muaj për çdo pjesë të strukturës së tunelit që ka kufizime për peshën; • Kur një pjesë e strukturës së tunelit duhet të mbajë një ngarkesë të padukshme jo normale përpara, gjatë ose pas kalimit të ngarkesës nëse nuk dihet nëse ngarkesa të ngjashme janë mbajtur pa rrezik më parë; • Nëse ka ndodhur zhvendosje, ngritje, lëvizje ose vithisje më shumë se e lejon projekti. Duhet kryer matje për të vlerësuar urgjencën e mazave ndreqëse të nevojshme; • Për strukturën dhe pajisjet e tunelit pas përmbytjes; • Pas një aksidenti madhor ose pas një zjarri brenda tunelit për të hetuar dëmtimet që mund t'i jenë bërë tunelit, pajisjeve dhe të gjitha funksioneve të sigurisë. <p>Raporti i kontrollit të posaçëm duhet të përfshijë rekomandime të hollësishme për punimet ndreqëse ose zëvendësuese, monitorimin në të ardhmen ose ndryshime të procedurave të punës.</p>
Sheshet e taksës	6 muaj	Kontroll me sy i sipërfaqeve të shtruara në maj dhe nëntor
Sinjalistika vertikale	6 muaj	Në maj dhe nëntor

Inspektimi	Shpeshtësia	Vërejtje
Ndriçimi i rrugës:		
• Llampat	2 javë	I gjithë ndriçimi duhet kontrolluar një herë çdo dy javë pasi të ketë rënë errësira.
• Njësitë e ndriçimit	12 muaj	Kontrolli dhe pastrimi të mbyllet brenda datës 15 maj.
• Shtyllat dhe kasetat	3 vjet	Kontrolli i strukturës dhe sigurisë
Shjalistika rrugore horizontale	12 muaj	E gjithë gjatësia e Autostradës duhet të kontrollohet në muajin nëntor (kontroll në errësi)
Symacet në rrugë	6 muaj	Në maj dhe nëntor (kontroll në errësi)
Pajisjet e menaxhimit dhe kontrollit të trafikut	6 muaj	Në maj dhe nëntor
Pajisjet e taksës së rrugës	3 muaj	Zbulim i çdo defekti të dukshëm në barriera, sensorë etj.
	<p>Kontroll me sy i pajisjeve të korsive në fillim të çdo turni</p> <p>Kontroll vjetor për parrezikshmërinë elektrike dhe mekanike</p> <p>Çdo kontroll tjetër sipas udhëzimeve të prodhuesve për mirëmbajtjen</p>	Të kontrollohen të gjitha pajisjet e taksës për të parë mos kanë përkeqësime dhe për të parë e vazhdojnë të jenë të parrezikshme
Pajisjet e komunikimit	<p>Kontroll i kabinave të telefonit në tunel gjatë pastrimit rotinë çdo 2 muaj</p> <p>Kontroll vjetor për parrezikshmërinë elektrike dhe mekanike</p> <p>Çdo kontroll tjetër sipas udhëzimeve të prodhuesve për</p>	